

**ANALIZA E PROCEDIMEVE TË ÇËSHTJEVE PENALE
NË APEL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

osce

2007

Botuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
Sheraton Hotel & Towers, Kati i I-rë
Sheshi “Italia”
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 235993/235997
Faks: +355 4 248684
www.osce.org/albania

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2007.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

ISBN: 978-99943-993-8-3

343.196(496.5)(048.83)

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Analiza e procedimeve të çështjeve penale
në Apel në Republikën e Shqipërisë / OSBE.
- Tiranë : OSBE, 2007.
144 f. ; 165x235

Shtypi nga “albPAPER”

Përmbajtje

Falënderime.....	vii
Tabela e shkurtimeve	ix
PËRMBLEDHJE	1
Hyrje	1
Qëllimi i raportit	2
Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve	3
Metodologjia	8
KREU 1: ARSYETIMI LIGJOR NË KONTEKSTIN E PROCEDIMIT	
TË ÇËSHTJEVE PENALE NË APEL	11
I. HYRJE	11
II. E DREJTA PËR APELIM NË ÇËSHTJET PENALE SIPAS SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE ASAJ SHQIPTARE	13
III. KOMPETENCAT E GJYKATAVE TË APELIT PËR RISHIKIMIN E ÇËSHTJEVE PENALE	15
IV. ARSYETIMI LIGJOR NË PROCEDURAT E ANKIMEVE PENALE	19
A. Arsyetimi ligjor në vendimet penale të apelit	20
1. E drejta përkatëse ndërkombëtare dhe ajo shqiptare	20
2. Gjetjet	22
B. Arsyetimi në vendimin e dënimit	27
1. E drejta përkatëse ndërkombëtare dhe shqiptare	27
2. Gjetjet	27
C. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit	31
1. E drejta ndërkombëtare dhe ajo shqiptare	31
2. Gjetjet	32
D. Interpretimi dhe zbatimi i së drejtës materiale dhe procedurale nga gjykatat e apelit	34
1. Interpretimi dhe zbatimi i së drejtës materiale	34
2. Interpretimi dhe zbatimi i së drejtës procedurale	37
E. Probleme me vlerësimin e provave nga gjykatat e apelit	40
1. Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe shqiptar	40
2. Gjetjet	42
F. Studim rasti	45
V. PËRFUNDIME DHE PERSPEKTIVA	47
VII. REKOMANDIME	49

KREU 2: APELI I VENDIMEVE PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT TË ARRESTIT NË BURG	52
I. HYRJE	52
II. E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE SHQIPTARE MBI CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT TË ARRESTIT NË BURG	53
A. Prova të pranueshme për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg	53
B. Arsytimi dhe justifikimi i vendimeve për arrest në burg	57
C. Apeli i vendimeve për arrest në burg	60
III. JUSTIFIKIMI I VENDIMEVE PËR ARREST NË BURG: GJETJET	61
A. Përdorimi i formulimit stereotip në vendimet për caktimin e masës së arrestit në burg	62
B. Përpjestueshmëria e masës së sigurimit të arrestit në burg	67
C. Mosmarrja në konsideratë e argumenteve të mbrojtjes	69
IV. PËRFUNDIM	74
V. REKOMANDIME	76
KREU 3: VONESAT NË PROCEDIMET E ÇËSHTJEVE PENALE NË APEL	79
I. HYRJE	79
II. E DREJTA PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE DHE AJO SHQIPTARE	80
III. DORËZIMI DHE KOMUNIKIMI I AKTEVE TË GJYKATËS	82
A. Dorëzimi i vendimeve me shkrim nga gjykatat e shkallës së parë	82
1. E drejta përkatëse shqiptare dhe ndërkombëtare	83
2. Gjetjet	84
3. Të dhëna statistikore mbi kohën që nevojitet për dorëzimin e vendimeve me shkrim	87
4. Zgjidhje të mundshme lidhur me pamjaftueshmërinë e afateve procedurale për nxjerrjen e vendimeve me shkrim dhe paraqitjen e ankimeve	90
5. Përfundim	93
B. Transferimi i fashikujve të gjykimit nga gjykatat e shkallës së parë në gjykatat e apelit	93
1. E drejta ndërkombëtare dhe ajo shqiptare	93
2. Gjetjet	94
C. Shtyrjet në orarin e seancave të apelit	101
1. Thirrja e palëve dhe planifikimi i seancave në apel	102
2. Zgjidhjet	105
IV. PËRFUNDIME	107
V. REKOMANDIME	109

KREU 4: TRANSPARENCA DHE AKSESI NË

PROCEDIMET GJYQËSORE	114
I. HYRJE	114
II. TRANSPARENCA E VEPRIMTARIVE DHE PROCEDIMEVE	
GJYQËSORE: E DREJTA PËR SEANCË PUBLIKE	116
A. Bërja publike e listave të gjyqeve	117
B. Aksesit i publikut në ndërtesën e gjykatës	119
III. BOTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE	119
A. Praktika shqiptare	122
IV. PROCESVERBALET NË PROCEDIMET GJYQËSORE	123
V. AKSESI NË REGJISTRAT E GJYKATËS	124
VI. PËRFUNDIME	125
VII. REKOMANDIME	127

SHTOJCA

Shtojca A:

Tabela e fashikujve të gjykimit që janë konsultuar lidhur me procedimet e çështjeve penale në apel	132
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----

Shtojca B:

Tabela e vendimeve për caktimin e masës së arrestit në burg që janë konsultuar lidhur me procedimet e çështjeve penale në apel	134
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----

Falënderime

Raporti u hartua nga Maya Goldstein-Bolocan. Autorja dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u shprehin mirënjohje të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe punonjësve të stafit administrativ të gjykatave që na kanë mundësuar marrjen e informacionit mbi të cilin është mbështetur ky raport. Hartimi i këtij raporti nuk do të ishte bërë i mundur pa ndihmën e zyrave të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në rrethe, të cilat e mblodhën informacionin. Frank Dalton dha udhëzime analitike dhe bëri komente gjatë procesit të hartimit. Ama Kraja dha ndihmë me vlerë për mbledhjen e informacionit në gjykatën e rrethit dhe atë të apelit në Tiranë, përpunoi të dhënat statistikore dhe ndihmoi për redaktimin e versionit në shqip. Mira Kroqi, Sokol Bega dhe Alina Karallli e përkthyen raportin në shqip. Përgjegjësia për ndonjë gabim apo harresë mbetet e autores.

Tabela e shkurtimeve

ABA-CEELI	Organizata e juristëve amerikanë – Iniciativa ligjore për vendet e Evropës qendrore dhe Euroazisë (tani njihet me emrin ABA-ROLI ose Organizata e juristëve amerikanë – Iniciativa e Shtetit të së Drejtës)
DUDNj	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
FVL	Programi i formimit vazhdues ligjor
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KE	Këshilli i Evropës
KEDNj	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore
Komentari i KP	Komentari i Kodit penal
Komentari i KPrP	Komentari i procedurës penale
KP	Kodi penal i Republikës së Shqipërisë
KPrC	Kodi i procedurës civile të Republikës së Shqipërisë
KPrP	Kodi i procedurës penale të Republikës së Shqipërisë
OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
PNDPCP	Pakti Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike
PZhGjD	Programi për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë

PËRMBLEDHJE

Hyrje

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, sistemi shqiptar i drejtësisë penale ka pësuar ndryshime rrënjësore dhe ka bërë përparime të mëdha gjatë kalimit të tij nga një instrument shtetëror në një institucion publik, i cili mbron qytetarët dhe përkrah shtetin e së drejtës. Baza e re ligjore është përmirësuar në mënyrë që t'i përshtatet sa më mirë standardeve ndërkombëtare. Shkolla e Magjistraturës konsiderohet një institucion i dobishëm dhe i aftë për të përmirësuar më tej aftësitë dhe përgatitjen e gjyqtarëve. Gjykata për Krime të Rënda, e krijuar në janar 2004, ka treguar se është e gatshme dhe e aftë të japë drejtësi në mënyrë efektive dhe me paanësi, pavarësisht nga detyra e saj e ndjeshme ndaj politikës. Gjykatat në Shqipëri janë plotësisht operative dhe funksionojnë rregullisht.

Megjithatë, mbetet edhe shumë për të bërë derisa sistemi gjyqësor shqiptar të mund të konsiderohet vërtetë efikas, i drejtë dhe plotësisht i pavarur e i përgjegjshëm. Zvarritjet dhe vonesat ende e pengojnë punën e gjykatave. Aftësia dhe niveli profesional i pabarabartë i gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në administrimin e drejtësisë përbëjnë pengesë për gjykime të drejta. Aksesit për informacion të saktë mbi aktivitetet gjyqësore (p.sh., për orarin e gjyqeve), ka nevojë të përmirësohet, ndërkohë që vendimet e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese janë të vetmet që botohen rregullisht. Në këtë drejtim, mungesa e besimit të publikut tek sistemi është mjaft e përhapur.

Në përputhje me mandatin e saj për të ndihmuar qeverinë shqiptare në procesin e reformës ligjore dhe gjyqësore, si dhe të forcimit të shtetit të së drejtës, në vitin 2003, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nisi zbatimin e Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë (PZhGjD). Projekti synon të vlerësojë përputhjen e sistemit gjyqësor shqiptar me legjislacionin vendës dhe standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë dhe të hartojë raporte analitike¹ që përmbajnë rekomandime

¹ Deri tani Programi për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë ka botuar dy raporte. "Raporti i periudhës tetor 2003-korrik 2004" u botua në janar 2005 dhe trajton çështje që lidhen me administrimin e drejtësisë nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Raporti i dytë, "Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri", u botua në nëntor 2006 dhe nënvizon një numër çështjesh që lidhen me të drejtat gjatë paraburgimit, të drejtën për mbrojtje efektive, mundësinë e viktimave të dhunës në familje për të marrë drejtësi, si dhe çështjet e transparencës dhe mbrojtjes së dëshmitarëve. Raportet analitike janë botuar në shqip dhe anglisht.

konkrete për rritjen e efikasitetit, drejtësisë, transparencës dhe aksesit për përdoruesit.

Ky raport, "Analiza e procedimeve të çështjeve penale në apel në Republikën e Shqipërisë", publikohet në kuadër të Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë dhe paraqet një vlerësim të procedurës dhe praktikës së gjykatave penale të apelit. Duke qenë se gabimet gjyqësore dhe keqzbatimi i së drejtës materiale dhe asaj procedurale janë veçori të pashmangshme të të gjithë sistemeve gjyqësore, nivelet e ndryshme të shqyrtimit gjyqësor janë thelbësore për të filtruar dhe minimizuar të metat e vendimeve që merren nga gjykatat e shkallëve më të ulta. Për shkak të rëndësisë së tyre në zgjidhjen e gabimeve të mundshme të drejtësisë dhe funksionit të tyre "udhëzues" kundrejt gjykatave të ulta, është thelbësore që gjykatat e apelit t'i kryejnë veprimtaritë e tyre në mënyrë transparente dhe efikente dhe që shqyrtimi që ndërmarrin të jetë i një cilësie të lartë. Ndërsa disa raporte e kanë parë si temë me interes veprimtarinë e gjykatave të rretheve dhe e kanë analizuar atë, kjo është hera e parë që baza ligjore dhe funksionimi i gjykatave penale të apelit bëhet objekt i një shqyrtimi të detajuar.

Shpresojmë që kjo analizë të shërbejë si mjet për autoritetet vendëse dhe organizmat ndërkombëtare në përpjekjet e tyre të vazhdueshme për përmirësimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri, si dhe për individët dhe organizatat që punojnë në fushën e drejtësisë. Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, shpresojmë që ky raport t'u hyjë në punë Shkollës së Magjistraturës dhe fakulteteve të ndryshme të drejtësisë në Shqipëri në sipërmarrjen e tyre për arsimimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve të ardhshëm në Shqipëri.

Qëllimi i raportit

Ky raport analizon procedurat dhe praktikat e gjykatave të apelit në çështjet penale dhe i vlerëson ato duke i krahasuar me standardet ndërkombëtare të gjykimit të drejtë dhe të drejtën shqiptare procedurale.

Qëllimi i raportit është të identifikojë çështjet procedurale, praktike dhe strukturore që ndikojnë në punën e gjykatave penale të apelit, dhe të bëjë rekomandime për përmirësimin e tyre. Raporti fokusohet në një numër çështjesh dhe ndahet në katër kapituj.

Kapitulli 1 paraqet qëllimin e **shqyrtimit gjyqësor të gjykatave penale të apelit** në zbatim të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj shqiptare, përqendrohet në **cilësinë e arsytimit ligjor** të pasqyruar në vendimet gjyqësore, si dhe vlerëson **se si kryhet ky shqyrtim**. Cilësia e procesit të vendimmarrjes në apel shihet te këto fusha: dhënia e dënimit; marrja në konsideratë e argumenteve të mbrojtjes; zbatimi i së drejtës materiale dhe procedurale dhe vlerësimi i provave.

Kapitulli 2 diskuton çështje që lidhen me nevojën e **justifikimit të duhur dhe të mjaftueshëm** gjatë caktimit të masës së sigurisë “arrest në burg” dhe **llojin e autoritetit shqyrtues** që ushtrohet nga gjykatat e apelit në këtë drejtim.

Kapitulli 3 përqëndrohet te çështja e **vonesave procedurale** gjatë gjykimit të çështjeve penale në apel, sidomos te vonesat e gjykatës së shkallës së parë në dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe kalimit të dosjeve nga njëra gjykatë në tjetrën. Ky kapitull merret gjithashtu me çështjen e shtyrjeve të shpeshta dhe të pajustificuara të seancave në apel.

Kapitulli 4 trajton çështjen e **transparencës dhe aksesit në informacionin që lidhet me çështjet gjyqësore**. Ai analizon të drejtën e publikut për të marrë pjesë në gjykim dhe për të marrë vendimet gjyqësore, si dhe shqyrton shkurtimisht çështjen e transparencës së procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësor dhe regjistrave të gjykatës.

Secili prej kapitujve përmban një numër rekomandimesh të posaçme që sugjerojnë si mund të trajtohen problemet e identifikuar në procedimet e çështjeve penale në apel.

Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve

Vëzhgime të përgjithshme

Rregullat procedurale që drejtojnë shqyrtimet në apel shpesh nuk respektohen. Gjykatat penale të apelit shpesh nuk arrijnë t'i argumentojnë në mënyrë korrekte dhe të plotë vendimet e tyre. Ato, gjithashtu, nuk e ushtrojnë rolin e tyre udhëzues kundrejt gjykatave më të ulta. Në disa nga rastet e shqyrtuara, gjykatat e apelit kanë bërë interpretime problematike të ligjit dhe nuk kanë adresuar në mënyrë korrekte argumentet e mbrojtjes. Vonesat në shqyrtimin e çështjeve penale në apel janë të zakonshme. Si rrjedhim, e drejta e individëve për një gjykim të drejtë shpesh shkelet. Ekziston nevoja për përmirësim të mëtejshëm, me qëllim që gjykatat penale të apelit t'i kryejnë veprimtaritë e tyre me efektivitet, drejtësi dhe transparencë.

Arsyetimi ligjor në kontekstin e procedimeve penale në apel

Ajo çka pritet nga gjykatat e apelit është që t'i shqyrtojnë me shumë kujdes çështjet e sjella para tyre dhe ta interpretojnë e zbatojnë ligjin në mënyrë korrekte dhe konsekuente brenda kufijve të procedurave të qarta ligjore. Për më tepër, gjykatat e apelit duhet të japin një arsyetim të qartë dhe të plotë në vendimet që merren për çështjet e shqyrtuara në themel, pasi të kenë vlerësuar siç duhet provat në favor dhe kundër të pandehurit. Siç përshkruhet në raport, një nga të metat më të mëdha është mosarsyetimi i vendimeve në mënyrë

korrekte dhe të plotë nga gjykatat e apelit.² Arsyetimi përgjithësisht i dobët i vendimeve gjyqësore të gjykatave të apelit nuk e përmbush kërkesën për një shqyrtim të mirëfilltë dhe të hollësishëm, ashtu siç kërkohet nga e drejta shqiptare dhe ajo ndërkombëtare, si dhe duket se shkel parimin e prezumimit të pafajësisë.

Rekomandime

Për të plotësuar kërkesat për një shqyrtim të mirëfilltë dhe të hollësishëm, gjyqtarët e apelit duhet t'i arsyetojnë plotësisht vendimet e tyre në përputhje me të drejtën shqiptare dhe atë ndërkombëtare. Gjykatat e apelit duhet të trajtojnë në mënyrë sistematike çdo shkak të ankimit të ngritur nga palët në kërkesën e tyre dhe të trajtojnë të gjitha çështjet e rëndësishme për gjykimin e tyre, dhe jo thjesht të mbështesin konkluzionet e nxjerra nga gjykata më e ulët. Ashtu si me vendimet e shkallës së parë, gjykatat e apelit duhet të japin një përshkrim të rrethanave të faktit dhe provave mbi të cilat kanë mbështetur vendimet e tyre, si dhe arsyet pse gjykata nuk i pranon provat e kundërta. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu pretendimet e palëve, si dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre. Nëse vendimet e gjykatave të apelit përmbysin ose ndryshojnë vendimet e dhëna nga gjykata më e ulët, ato duhet të japin arsye të mbështetura dhe të qarta për këtë. Nëse del se faktet nuk janë vërtetuar në mënyrë korrekte dhe të plotë nga gjykata e shkallës së parë, gjykatat e apelit duhet të ushtrojnë autoritetin e tyre për të urdhëruar përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, ose për të marrë prova të reja qoftë edhe kryesisht. Për t'i ndihmuar gjyqtarët që të përmirësojnë aftësitë e tyre arsyetuese ligjore, Shkolla e Magjistraturës duhet të sigurojë trajnim shtesë për shkrimin dhe arsyetimin ligjor / gjyqësor në kontekstin e programit të formimit të vazhdueshëm profesional ligjor dhe të programit profesional fillestar shkollor.

Ankimet ndaj vendimeve për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg"

Sipas së drejtës ndërkombëtare dhe asaj shqiptare, të gjitha vendimet që caktojnë masën e sigurimit "arrest në burg", përfshirë ato për të cilat apeli ka marrë vendim, duhet të jenë të bazuara dhe të arsyetuara në mënyrën e duhur. Gjyqtarët në Gjykatën e Rrethit Tiranë nuk i arsyetojnë vendimet e tyre për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" dhe nuk tregojnë se kjo masë është "zgjidhja e fundit". Nga ana tjetër, gjykatat e apelit shpesh i "vulosin" pa i shqyrtuar në mënyrë të mirëfilltë vendimet e shkallës së parë dhe nuk përmbushin detyrën e tyre për t'i korrigjuar ato kur nuk janë të bazuara në mënyrë korrekte. Kjo praktikë shkel standardet e një gjykimi të drejtë dhe e vendos personin e akuzuar në një pozitë të pajustificueshme, ku barra e provës kalon te i akuzuari dhe parimet themelore të drejtësisë, si ai i prezumimit të pafajësisë dhe i gjykimit në gjendje të lirë, shpërfillen.

² Shih shpjegimin në "Metodologjia", faqet 8-10

Rekomandime

Gjykatat e apelit duhet t'i kryejnë më fuqimisht dhe efektivisht funksionet e tyre kontrolluese. Ato duhet t'i shqyrtojnë në tërësi vendimet për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg", pavarësisht nga shkaqet e ankimit ose nga shkaqet e përmendura në vendimin që është nën shqyrtim. Ato duhet t'i prishin ato vendime të cilat nuk janë plotësisht të arsyetuara, dhe duhet vazhdimisht t'i udhëzojnë gjykatat më të ulta që në vendimet e tyre për caktimin e masës së sigurimit të japin arsye të detajuara dhe të *individualizuara* që marrin parasysh ekzistencën e shkaqeve të qenësishme për ta urdhëruar këtë masë, si dhe ekzistencën e përpjesëtueshmërisë së masës së arrestit për rastin konkret. Kurset e Shkollës së Magjistraturës që trajtojnë arsyetim dhe shkrim ligjor duhet të merren veçanërisht me këtë kërkesë në kontekstin e vendimeve për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg". Gjyqtarët e shkallës së parë dhe ata të apelit duhen trajnuar lidhur me praktikën e parimeve bazë dhe kuadrin ligjor për masën e sigurimit "arrest në burg". Avokati i Popullit duhet të kryejë hetime të plota mbi pakujdesinë që pretendohet të jetë treguar nga autoritetet kompetente gjyqësore në trajtimin e çështjeve për masat e sigurimit "arrest në burg" dhe të rekomandojë zgjidhje aty ku do të zbulohen shkelje. Inspektoriatet përkatëse në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë duhet të kryejnë inspektime të rregullta mbi trajtimin e çështjeve për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" nga ana e gjykatave.

Vonesat procedurale në procedimet e çështjeve penale në apel

E drejta për t'u gjykuar brenda një afati kohor të arsyeshëm njihet nga e drejta ndërkombëtare. Vonesat në trajtimin e çështjeve penale dhe zvarritjet e mëdha në gjyq nxisin mosndëshkimin dhe pakësojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Ndërkohë që vonesat e pajustificuara në trajtimin e çështjeve nga gjykatat janë të mëdha, janë të shmangshme dhe mund t'i atribuohen shtetit, ato mund të shkelin të drejtën e personit të akuzuar për një shqyrtim gjyqësor të drejtë. Megjithatë, shpesh shtyrjet dhe vonesat rezultojnë thjesht në humbje kohe dhe burimesh. Në Shqipëri, janë vënë re praktika jo të unifikuara dhe vonesa në dorëzimin e vendimeve me shkrim e të plota nga gjykatat e shkallës së parë. Në shumicën e rasteve, vendimet me shkrim të gjykatave të rrethit në Shqipëri, të marra si shembull, janë dorëzuar me vonesë dhe pasi kishte kaluar afati dhjetëditor për paraqitjen e ankimit. Dispozitat aktuale që parashikojnë afatin kohor për dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe paraqitjen e ankimit duket se japin afate kohore jashtëzakonisht të shkurtra. Praktika tregon se ato kanë qenë të vështira për t'u respektuar. Vonesat dhe praktikën e ndryshme të gjykatave në dorëzimin e vendimeve me shkrim, bashkë me afatin kohor të shkurtër për paraqitjen e ankimit, mund të pengojnë mundësinë e të pandehurve (ose prokurorëve) për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën për t'u ankuar. Vonesat shkaktohen gjithashtu nga mosrespektimi i afateve

kohore procedurale për transferimin e dosjeve ndërmjet gjykatave. Së fundi, ato shpesh shkaktohen nga shtyrjet e shpeshta e të pajustificuara të seancave ankimore që i atribuohen mosparaqitjes së palëve.

Rekomandime

Dorëzimi, nga ana e shkallës së parë, i vendimeve me shkrim dhe plotësisht të arsyetuara

Përmirësimet në këtë fushë mund të arrihen duke identifikuar praktikatat e gjykatave që kanë efikasitet të lartë, dhe duke i zbatuar këto praktika në gjykatat e tjera.

Dispozitat e Kodit të procedurës penale (KPrP) mbi afatet kohore për dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe paraqitjen e ankimit mund të rishikohen për t'i bërë më lehtësisht të zbatueshme. Kodi mund të ndryshohet duke shtuar një dispozitë që parashikon afate kohore më të gjata për dorëzimin e vendimeve me shkrim në çështjet komplekse, dhe një dispozitë që rregullon afatin kohor për paraqitjen e ankimit duke marrë si referim datën e dorëzimit të vendimit me shkrim. Autoritetet gjyqësore duhet të jenë më vigjilente për të siguruar që vendimet depozitohen dhe dorëzohen brenda periudhës kohore të parashikuar nga ligji. Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të marrë masa disiplinore në rastet kur gjyqtarët janë përgjegjës për vonesa të paarsyeshme në dorëzimin e vendimeve me shkrim.

Transferimi i dosjeve të çështjeve midis gjykatave të shkallës së parë dhe atyre të apelit

Rekomandohet që Ministri i Drejtësisë të nxjerrë një udhëzim që të specifikojë detyrat ligjore për stafin e gjykatave lidhur me dorëzimin e dosjeve të çështjeve në kohën e duhur në gjykatat përkatëse të apelit, nëse një çështje ankimohet. Një vëzhgim sistematik i këtyre praktikave duhet të ndërmerret nga kryetarët e gjykatave dhe kancelarët e gjykatave të rrethit, si dhe inspektorët pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Planifikimi dhe programimi i seancave ankimore

Duhet miratuar praktika dhe procedura efektive për administrimin e ngarkesës së çështjeve. Gjithashtu, duhen nxjerrë udhëzime që përcaktojnë se çfarë përbën shkak të arsyeshem për zvarritjen/shtyrjen e seancës. Kryetarët e Gjykatave duhet të ndajnë mes tyre "praktikat më të mira" administrative. Për gjyqtarët dhe administratorët e gjykatave duhet organizuar trajnim i detyrueshem për administrimin e ngarkesës së çështjeve.

Mosparaqitja e palëve dhe njoftimi i fletëthirrjeve

Kur vonesat shkaktohen nga mungesa e pajustificuar e avokatit mbrojtës, Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të marrë masa disiplinore në përputhje

me ligjin. KPrP-ja mund të ndryshohet duke parashikuar dispozita në bazë të së cilave gjykatat të vendosin gjoba për palët e thirrura të cilat nuk paraqiten për shkaqe të paarsyeshme; të autorizojë gjykatën të nxjerrë një urdhër ndalimi për të pandehurin që nuk është paraqitur pa arsye; të përfshijë mundësinë që gjykata të miratojë masa disiplinore ndaj avokatëve mbrojtës dhe prokurorëve dhe të kërkojë zëvendësimin e këtyre të fundit kur nuk paraqiten. KPrP-ja mund të ndryshohet për të kërkuar që ankimuesi të deklarojë qartë në kërkesën ankimore adresën e tij për dorëzimin e njoftimeve gjyqësore në të ardhmen, me qëllim që çdo dokument i dërguar në atë adresë të quhet i dorëzuar.

Transparenca dhe aksesimi në procedimet gjyqësore

Ndershmëria dhe transparenca e veprimtarive dhe shqyrtimeve gjyqësore nxisin vlera themelore të tilla si besimi i publikut në sistemin gjyqësor, të kuptuarit e administrimit të drejtësisë, si dhe përgjegjësia gjyqësore. E drejta shqiptare parashikon një detyrim të përgjithshëm për gjyqësorin që të mundësojë marrjen e informacionit që gjendet në dokumentet zyrtare, sipas një kërkesë, dhe ta bëjë këtë ashtu si çdo institucion tjetër shtetëror. Në Shqipëri, transparenca e procedimeve gjyqësore, përfshirë edhe ajo e procedimeve në apel, pengohet nga një numër i madh vështirësish praktike dhe logjistike, siç janë praktikatat e paqëndrueshme për sigurimin e informacionit të përditësuar mbi procedimet gjyqësore, ambientet e pamjaftueshme në gjykata dhe aksesimi i kufizuar në vendimet gjyqësore. Praktikatat jo të unifikuara në mbajtjen e regjistrave të gjykatës dhe procesverbalet e pasakta të shqyrtimeve gjyqësore mund ta pengojnë gjithashtu transparencën e veprimtarive gjyqësore.

Rekomandime

Të përgjithshme

Të gjithë nëpunësit publikë, përfshirë nëpunësit e gjykatave dhe të drejtësisë, duhet të trajnohen mbi të drejtën e informacionit për dokumentet zyrtare. Nëpërmjet fushatave publike të ndërgjegjësimit, publiku i gjerë duhet të sensibilizohet lidhur me të drejtat e tij për të ndjekur shqyrtimet gjyqësore dhe për të marrë informacion mbi dokumentet publike, duke përfshirë këtu edhe vendimet gjyqësore. Çdo gjykatë apeli duhet të ketë strukturat e duhura për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion që bëhen nga publiku. Gjatë kontrollit që kryejnë, Inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet t'i marrin parasysh çështjet e transparencës.

Mundësia e marrjes së informacionit gjyqësor dhe e pjesëmarrjes në seancat gjyqësore në apel

Të gjitha gjykatat duhet të mundësojnë për publikun, rregullisht dhe në mënyrë të qëndrueshme, informacion të përditësuar mbi datën, kohën dhe vendin e

zhvillimit të seancës gjyqësore publike (edhe për ato seanca që janë shtyrë nga ditët e mëparshme). Të gjitha godinat e gjykatave të apelit duhen pajisur me ambientet e duhura për pjesëmarrjen e publikut në seancat gjyqësore.

Vendimet gjyqësore

Brenda një periudhe të shkurtër, të gjitha vendimet gjyqësore të çështjeve penale në apel duhet të bëhen të disponueshme për çdo palë të interesuar, në bazë të një kërkesë dhe pas një pagese që mbulon vetëm koston, sipas ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".³ Brenda një periudhe afatgjatë, në të gjitha gjykatat e apelit duhet të vihen në punë faqe interneti që të botojnë përmbledhje të vendimeve gjyqësore, kronologji të seancave gjyqësore dhe arsytet për shtyrjen e tyre. Brenda një periudhe afatmesme, një numër i madh vendimesh gjyqësore duhet të botohet i plotë. Meqë kjo është një sipërmarrje ambicioze, do të ishte e mjaftueshme që brenda një periudhe afatshkurtër të botoheshin të plota të paktën vendimet më të rëndësishme të gjykatave të apelit. Përveç kësaj, do të ishte e dobishme të botohej të paktën një numër vendimesh që mund të zgjidhen rastësisht, për të garantuar që gjyqtarët të dinë se çdo vendim i dhënë prej tyre mund të shqyrtohet lehtësisht nga ana e publikut. Ministria e Drejtësisë duhet të nxjerrë udhëzime mbi aksesin e publikut në drejtësi. Udhëzimet duhet të japin gjithashtu mënyrat me të cilat i jepet informacioni mbi vendimet gjyqësore dhe mbi dokumentet e tjera shtypit dhe publikut në shkallë të gjerë.

Regjistrat dhe procesverbalet e gjykatave

Nevojitet më shumë qëndrueshmëri dhe saktësi në mbajtjen e regjistrave të gjykatave që lidhen me apelin e çështjeve penale. Rekomandohet të përdoren standarde të njëjta për identifikimin dhe regjistrimin e çështjeve. Do të ishte mirë që në të gjitha gjykatat të përvetësohen procese të reja elektronike dhe teknologjike për mbajtjen e procesverbaleve me qëllim që të lejohet mbajtja e shpejtë dhe e saktë e tyre.

Metodologjia

Kapitulli 1 bazohet në analizën e pesëmbëdhjetë dosjeve të zgjedhura rastësisht. Për trembëdhjetë nga këto dosje, gjykimet në apel kishin përfunduar gjatë periudhës janar 2005 - dhjetor 2006. Ndërkohë, vendimet e apelit në dy dosjet e tjera ishin shpallur gjatë periudhës tetor 2003 - dhjetor 2004. Më hollësisht, analiza mbulon: katër çështje në Tiranë, tri çështje në Vlorë, gjashtë çështje në Shkodër (në këto çështje, katër ankime janë paraqitur ndaj vendimeve të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe dy ndaj vendimeve të Gjykatës së Rrethit

³Ligji nr. 8503, datë 30 qershor 1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", neni 3.

Kukës), dhe dy çështje në Gjirokastrë.⁴ Për t'u ardhur në ndihmë vëzhguesve, të cilët shqyrtuan me kohë të pjesshme dosjet gjyqësore, u shpërnda një formular-model i gatshëm. Për të gjitha çështjet u fotokopjuan vendimet gjyqësore të gjykatave të rrethit dhe apelit, të cilat u shqyrtuan me kujdes, sidomos përsa i përket arsytimit. Si procesverbalet e procedimeve të shkallës së parë, ashtu edhe të apelit u shqyrtuan me kujdes, për të vlerësuar përputhjen e tyre me standardet e një procesi të drejtë gjyqësor. Për të identifikuar shkaqet e ankimit dhe për të vlerësuar se si ishin trajtuar nga gjykatat e shkallës së dytë, u shqyrtuan gjithashtu kërkesat ankimore të paraqitura nga avokatët mbrojtës. Ndërkohë që shumë prej gjetjeve të raportuara bazohen në analizën e akteve gjyqësore, disa bazohen edhe në vëzhgimin e drejtëpërdrejtë të seancave penale në apel.

Në Kapitullin 2 analiza bazohet në një shqyrtim të detajuar të dhjetë vendimeve të Gjykatës së Rrethit Tiranë për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të cilat janë zgjedhur rastësisht, ankimeve ndaj tyre dhe vendimeve përkatëse të Gjykatës së Apelit Tiranë.⁵ Të gjitha vendimet për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ishin marrë nga Gjykata e Rrethit Tiranë gjatë vitit 2006.⁶ Vendimet u analizuan për të identifikuar të metat e funksionit të shqyrtimit dhe arsytimit të gjykatave të apelit në këtë fushë.

Kapitulli 3 jep informacion statistikor mbi ecurinë e ankimeve të çështjeve penale duke ju referuar afateve kohore të vendosura në Kodin e procedurës penale. Së pari, në bazë të informacionit të marrë nga tri gjykatat e rrethit të Tiranës, Durrësit dhe Kukësit jepen të dhëna statistikore mbi kohën që nevojitet për të dorëzuar vendimet me shkrim nga shkalla e parë.⁷ Së dyti, jepen të dhëna statistikore mbi numrin e ditëve të nevojshme për transferimin e

⁴Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u ka paraqitur kryetarëve të gjykatave përkatëse të rretheve një kërkesë për zgjedhjen e rastësishme mes çështjeve që përfshijnë vepra të rënda penale. Çështjet e analizuarra përfshinin krimet seksuale (Kodi penal [KP], nenet 101, 102, 102/a dhe 104), dhunën në familje (KP, nenet 84, 85, 86, 87, 88, 88/a, 88/b, 89, 90, 91, 92 dhe 110), prostitucionin (KP, nenet 113, 114 dhe 114/a), vrasjen (KP, nenet 78, 79, 82, 83), veprat penale që lidhen me lëndët narkotike (KP, nenet 283, 284, 284/c), si dhe veprat penale që lidhen me korrupsionin (KP, nenet 244, 245, 248, 259 dhe 260). Për një tabelë të çështjeve të analizuarra shih shtojcën A.

⁵Më 31 janar 2007, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i drejtoi Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Tiranë një kërkesë zyrtare për të konsultuar dhjetë kopje vendimesh për caktimin e masës së sigurimit, të zgjedhura rastësisht, për të cilat Gjykata e Apelit Tiranë kishte shpallur një vendim në periudhën nga janari 2006 deri në datën e kërkesës (janar 2007), së bashku me vendimet përkatëse të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe njoftimet e apelit. Për një tabelë të rasteve të konsultuara, shih Shtojcën B.

⁶Pas ankimit ndaj këtyre vendimeve, Gjykata e Apelit Tiranë kishte dhënë nëntë vendime në vitin 2006 dhe një në janar të vitit 2007.

⁷Gjashtëdhjetë raste u morën si referim nga regjistri i Gjykatës së Rrethit Tiranë i quajtur “Numërator i vendimeve penale për gjykatat e shkallës së parë”; tridhjetë raste u morën si referim nga regjistri i Gjykatës së Rrethit Durrës i quajtur “Regjistri i çështjeve penale”; tridhjetë raste të tjera u morën si referim nga “Libri i dorëzimit të dosjeve” të Gjykatës së Rrethit Kukës.

dosjeve gjyqësore nga gjykatat e shkallës së parë në gjykatat e apelit të Tiranës, Kukësit, Durrësit, Shkodrës, Vlorës dhe Gjirokastrës. Çdo gjykatë apeli i dha Prezencës së OSBE-së në Shqipëri informacion mbi 20 çështje të pasqyruara në “Regjistrin themeltar penal”, për të cilat vendimi i gjykatës së apelit ishte dhënë gjatë vitit 2006.⁸

Gjetjet e raportit bazohen gjithashtu në intervistat e bëra me aktorët që punojnë në sistemin e drejtësisë penale (avokatë, gjyqtarë, prokurorë).

⁸ Për të mbledhur të dhënat, kryesekretareve dhe kancelarëve të gjashtë gjykatave të apelit iu kërkua informacioni përkatës që gjendej në regjistrin përkatës themeltar të çështjeve penale. Në Gjirokastrë, për çështjet e marra në konsideratë ishte marrë një vendim gjyqësor midis vitit 2006 dhe 2007. Regjistri përmbante informacion të hollësishëm mbi ankimet penale, të tillë si data e regjistrimit të çështjes së ankimuar në sekretarinë e gjykatës së apelit, emri i të pandehurit, pala ankimuese, akuza, të dhëna për numrin, datën, gjyqtarin dhe gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin, dispozitivi dhe masa e dënimit, të dhëna lidhur me dosjen (p.sh., numrin e dosjes së çështjes), numri dhe tipi i vendimit të marrë për çështjen nga gjykata e apelit së bashku me emrin e gjyqtarit raportues ose kryetarit të trupit gjykues në apel.

KREU I

ARSYETIMI LIGJOR NË KONTEKSTIN E PROCEDIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE NË APEL

I. HYRJE

Në sistemet bashkëkohore të drejtësisë penale, gjykatat e apelit luajnë një rol të rëndësishëm për ndreqjen e gabimeve të mundshme gjyqësore, si dhe kontribuojnë për zhvillimin e jurisprudencës së një vendi. Vendimet e apelit janë mjetet parësore me anë të së cilave, përmes vlerësimit të gabimeve që kanë ndodhur gjatë gjykimit, zhvillohet e drejta penale materiale dhe ajo procedurale. Në ushtrimin e kompetencës së tyre rishikuese, gjykatat e apelit luajnë një “rol udhëzues” ndaj gjykatave më të ulta, sepse vendimet që ato marrin, madje edhe në kontekstin e sistemit të së drejtës civile (sistemi kontinental), në përgjithësi, ndiqen prej gjykatave më të ulta.⁹

Duke pasur parasysh rëndësinë që kanë gjykatat e apelit, është e domosdoshme që shqyrtimet e bëra prej tyre në çështjet penale të jenë të mirëfillta dhe me cilësi të lartë. Kjo do të thotë që gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, pritet që gjykatat e apelit t’i shqyrtojnë me shumë kujdes rastet që u dërgohen për gjykim dhe ta interpretojnë e ta zbatojnë ligjin në mënyrë të saktë dhe të njëtrajtshme, brenda kufijve të procedurave të qarta ligjore. Ato duhet ta analizojnë me hollësi çështjen që u dërgohet për gjykim, arsyet e dhëna nga gjyqtari në vendimin e ankimuar, si dhe argumentet dhe ankesat e palës që ka paraqitur apelin. Ajo që është më e rëndësishme është se, gjykatat e apelit duhet të japin një argumentim të plotë e të qartë, si dhe një arsyetim të shëndoshë në vendimet e marra për çështjet në themel, pasi t’i kenë vlerësuar siç duhet provat në favor dhe kundër të pandehurit. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastet kur gjykatat e apelit i ndryshojnë apo i prishin vendimet e gjykatës së shkallës së parë, raste

⁹ *Stare decisis* është doktrina e karakterit detyrues të precedentëve gjyqësorë, tipike për juridiksionet *common law*, sipas së cilës vendimet e gjykatës janë të detyrueshme për gjykatën që i nxjerr ato si dhe për gjykatat e shkallëve më të ulta brenda të njëjtit juridiksion. Megjithëse kjo doktrinë nuk zbatohet formalisht në vendet që zbatojnë sistemin e së drejtës civile (sistemi kontinental), në praktikë edhe në këto sisteme ligjore precedentët drejtojnë vendimmarrjen gjyqësore në mënyrë që gjykatat të marrin vendime të ngjashme për çështje të ngjashme siç bëhet në vendet *common law*. Shih J.H. Merryman, *The Civil Law Tradition* [Tradita e së drejtës civile], botimi i 2^{te} (Stanford, Kaliforni, Stanford University Press, 1996), faqe 47. Për më tepër, vendimet e gjykatës shpesh përbëjnë bazën e komentareve ligjorë, të cilët janë një burim i rëndësishëm ligjor për sistemet e së drejtës civile.

në të cilat gjykatat kanë përgjegjësi të plotë për të shpjeguar përse vendime të tilla konsiderohen të mangëta.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, nëpërmjet vëzhgimit të gjyqeve dhe studimit të dosjeve të çështjeve,¹⁰ ka vërejtur mangësi në ushtrimin e kompetencave kontrolluese të gjykatave të apelit. Më konkretisht, në rastet e studiuara, gjykatat e apelit shpeshherë bënin vetëm një analizë të përciptë e sipërfaqësore të çështjes në shqyrtim, në vend që t'i ushtronin plotësisht kompetencat e tyre për një rishikim të gjerë, siç parashikohet në ligj. Në shumicën e rasteve, vendimet u morën pas një seance që zgjati vetëm pak minuta.¹¹ Gjatë këtyre seancave, gjykata shpesh nuk i trajtoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe nuk i vlerësoi siç duhet provat përkatëse. Marrja në pyetje e palëve të pranishme në seanca u bë shpesh sipërfaqësore, gjë që rezultoi në vendime të argumentuara dobët (vendimet nuk ishin më të gjata se dy apo tri faqe). Siç është vërejtur në disa raste, kur gjykata e shkallës së parë duket se ishte mbështetur në prova të dobëta e të gabuara dhe si pasojë nuk kishte arsyetuar siç duhet, gjykata e apelit nuk i kishte adresuar këto probleme, duke lënë në fuqi kështu *de facto* gabimet dhe dobësitë e vendimeve të lëshuara nga një gjykatë e shkallës më të ulët. Nga ana tjetër, procesi përgjithësisht i dobët i vendimmarrjes dhe i arsyetimit ligjor të gjykatave të apelit nuk e përmbush kërkesën për një rishikim të drejtë e të plotë siç parashikohet në legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar dhe mund ta cenojë parimin e prezumimit të pafajësisë.¹²

Ky kapitull paraqet shkurtimisht kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe atë shqiptar

¹⁰ Ky kapitull bazohet në analizën e pesëmbëdhjetë çështjeve. Për 13 çështje, procedurat e apelit u përfunduan gjatë periudhës janar 2005 - dhjetor 2006, ndërsa për dy të tjerat, vendimet e apelit u dhanë gjatë periudhës tetor 2003 - dhjetor 2004. Më konkretisht: katër dosje gjyqësore për procedurat e apelit për çështje penale në Tiranë, tri dosje gjyqësore për procedurat e apelit për çështje penale në Vlorë, gjashtë dosje gjyqësore për procedurat e apelit për çështje penale në Shkodër (nga të cilat katër apeli ishin kundër vendimeve të marra nga Gjykata e Rrethit Shkodër dhe dy kundër vendimeve të marra nga Gjykata e Rrethit Kukës), si dhe dy dosje gjyqësore për procedurat e apelit për çështje penale në Gjirokastrë. Në të gjitha çështjet, fashikujt e shkallës së parë dhe të apelit janë studiuar me shumë imtësi për të evidentuar shkeljet e procesit të drejtë si dhe për të vlerësuar mënyrën se si janë kryer procedimet. Duhet vërejtur se në këto dosje ka aq përsëritje të fenomeneve të vëna re saqë statistikisht nuk ka të ngjarë që studimi i një numri më të madh dosjesh do të ndryshonte ndjeshëm gjetjet dhe përfundimet e këtij kapitulli. Për një trajtim më të gjerë mbi metodologjinë, ju lutem referojuni "Metodologjisë" në faqet 8-10.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u ka drejtuar një shkresë kryetarëve të gjykatave përkatëse të rretheve për të përzgjedhur çështjet e mësipërme në mënyrë të rastësishme ndër çështjet për vepra penale të tilla si marrëdhënie seksuale me dhunë (KP nenet 101, 102, 102/a dhe 104), dhuna në familje (KP nenet 84, 85, 86, 87, 88, 88/a, 88/b, 89, 90, 91, 92 dhe 110), prostitucioni (KP, nenet 113, 114 dhe 114/a), vrasje (KP nenet 78, 79, 82, 83), vepra penale që kanë lidhje me narkotikët (KP nenet 283, 284, 284/c), si dhe vepra penale që lidhen me korrupsionin (KP, nenet 244, 245, 248, 259 dhe 260).

¹¹ Shpeshherë çështjet në apel përfundojnë me një apo dy seanca.

¹² Për një trajtim më të gjerë të kompetencës rishikuese që ushtrohet nga gjykatat e apelit në Shqipëri, shih më poshtë, në faqet 15-17.

mbi procedurat e apelit në çështjet penale. Më pas, trajton kompetencat e gjykatave penale të apelit për rishikimet gjyqësore sipas së drejtës shqiptare dhe diskuton zbatimin e tyre në praktikë. Pas prezantimit të kuadrit të zbatueshëm ligjor, në këtë kapitull jepet një analizë e arsytimit ligjor siç ushtrohet nga gjykatat penale të apelit për sa u përket vendimeve, veçanërisht në lidhje me: caktimin e dënimit, marrjen parasysh të argumenteve të mbrojtjes, zbatimin e ligjit material dhe atij procedural, si dhe vlerësimin e provave. Në përfundim, jepen disa rekomandime për problemet e vërejtura që i përkasin kësaj çështjeje.

II. E DREJTA PËR APELIM NË ÇËSHTJET PENALE SIPAS SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE ASAJ SHQIPTARE

E drejta për të apeluar kundër vendimeve në çështjet penale është e garantuar nga e drejta ndërkombëtare.¹³ Në nenin 14 (5) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), thuhet: “Çdo person i shpallur fajtor për një shkelje ka të drejtën të kërkojë që shpallja fajtor dhe dënimi i tij të shqyrtohen nga një instancë gjyqësore më e lartë, në përputhje me ligjin”.¹⁴ Megjithëse e drejta për ankim nuk thuhet shprehimisht në KEDNj-në, në vendimet e GjEDNj-së duket se kjo është një e drejtë e qenësishme në kuadrin e së drejtës për një gjykim të drejtë, e parashikuar nga neni 6. Kjo e drejtë shprehet gjithashtu edhe në nenin 2 të protokollit 7 të KEDNj-së.¹⁵

E drejta e apelit u takon të gjithë atyre që janë dënuar për kryerjen e një veprë penale, pavarësisht se sa e rëndë është kjo vepër.¹⁶ Megjithatë, në nenin 2 (2) të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashikohet që e drejta për apelim mund të kufizohet me ligj, nëse vepra penale është vepër e lehtë, nëse për gjykimin e personit gjykata më e lartë e shtetit ka qenë shkalla e parë e gjykimit, ose nëse personi është dënuar pas një apeli kundër pafajësisë së personit.¹⁷ Duke qenë se në përgjithësi e drejta për rishqyrtim garanton që

¹³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon që të gjitha konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria janë të zbatueshme në vend në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk janë të vetë-zbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji. Kushtetuta, neni 122.

¹⁴ PNDKP, neni 14, pika 5.

¹⁵ Në protokollin 7 të KEDNj-së, neni 2, pika 1 thuhet: “Çdo person i deklaruar fajtor për një vepër penale nga një Gjykatë, ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, është e përcaktuar me ligj”. Protokollin nr. 7 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, neni 2, pika 1. Shqipëria e ka ratifikuar Protokollin 7 më datë 10 shkurt 1996.

¹⁶ Komiteti i të Drejtave të Njeriut, Koment i Përgjithshëm nr. 13, paragrafi 17. Sipas Komitetit të të Drejtave të Njeriut, një padi që përfshin një dënim një vjeçar është aq e rëndë sa të lejojë rishikim nga një gjykatë më e lartë pavarësisht nëse ligji vendës e klasifikon apo jo si vepër penale. Çështja “Salgar de Montejó kundër Kolumbisë” (64/1979), 24 mars 1982, 1 Sel./ Dec. 127, at 129-30.

¹⁷ Protokollin 7 i KEDNj-së, neni 2, pika 2.

një çështje penale të shqyrtohet të paktën nga dy shkallë të gjyqësorit, nëse ligji vendës parashikon më shumë se një shkallë apeli, personit të dënuar i duhet dhënë mundësia t'i ezaurojë në mënyrë efektive secilën nga këto shkallë.¹⁸

Si në rastin e procedimeve në shkallën e parë, *garancitë e një gjykimi të drejtë që parashikohen nga neni 6 i KEDNj-së* janë të zbatueshme për secilën shkallë të apelit,¹⁹ pavarësisht nëse apeli bëhet për faktin apo për ligjin.²⁰ Të drejtat për një proces të rregullt gjyqësor që duhen respektuar edhe në apel, përfshijnë ndër të tjera të drejtën për të pasur kohën dhe mjetet e mjaftueshme për përgatitjen e apelit, të drejtën e pasjes së një avokati mbrojtës, të drejtën e barazisë së armëve (ku përfshihet e drejta për t'u informuar rreth paraqitjes së argumenteve nga pala kundërshtare), e drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë e aftë, e pavarur dhe e paanshme, si dhe e drejta për një vendim të arsyetuar dhe të shpallur publikisht brenda një afati të arsyeshem.²¹ Gjithsesi, mënyra se si zbatohen garancitë në çështjet konkrete varet nga veçoritë specifike të procedimeve përkatëse. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, duhet marrë parasysh tërësia e procedimeve të kryera brenda një sistemi vendës, funksionet në ligj dhe në praktikë të organit të apelit, si dhe mënyra me të cilën paraqiten dhe mbrohen interesat e palëve.²²

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, parashikon të drejtën e përgjithshme për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një shkallë më të lartë, me përjashtim të rasteve kur kjo e drejtë mohohet shprehimisht në Kushtetutë.²³ Më tej, Kodi i procedurës penale (KPrP) parashikon të drejtën e përgjithshme për të apeluar vendimet e gjykatës së shkallës së parë në çështjet penale.²⁴ Kjo e drejtë mund të ushtrohet nga palët të cilat kanë marrë pjesë në gjykimin e shkallës së parë.²⁵ Çështjet që vijnë nga gjykatat e shkallës së parë, në apel, shqyrtohen me trup gjykues të

¹⁸ Çështja "Henry kundër Xhamaikës" (230/1987), 1 nëntor 1991, Raporti i Komitetit të Drejtave të Njeriut; (A/47/40), 1992, faqe 218, paragrafi 8.4.

¹⁹ Çështja "Delcourt kundër Belgjikës", GjEDNj, 17 janar 1970, paragrafi 25.

²⁰ Po aty.

Kërkesat për leje për të paraqitur një ankim gjithashtu i nënshtrohen nenit 6. Çështja "Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar", GjEDNj, 2 mars 1987.

²¹ Shih çështjen "Melin kundër Francës", GjEDNj, 22 qershor 1993, ku gjykata nuk gjeti shkelje, por vuri re që disa të drejta lidhur me një gjykim të drejtë, duhen respektuar edhe në procedimet e apelit.

²² Çështja "Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar", GjEDNj, 2 mars 1987, paragrafi 56.

²³ Në nenin 43 të Kushtetutës thuhet: "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe".

²⁴ Në nenin 422 të KPrP-së parashikohet se i pandehuri dhe palët private mund t'i apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë.

²⁵ KPrP, nenet 408-411. Shih gjithashtu Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, *Procedura penale, Komentar* (Tiranë, Botimet Morava, 2003), faqe 528 [më poshtë i quajtur Komentari i KPrP].

përbërë nga tre gjyqtarë.²⁶ Këto çështje mund të shqyrtohen si për çështje të faktit, ashtu edhe të ligjit.²⁷

Në Shqipëri aktualisht funksionojnë gjashtë gjykata të zakonshme apeli: në Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, me gjithsej 47 gjyqtarë.²⁸ Gjyqtarët e gjykatave të apelit emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.²⁹ Ashtu si edhe gjyqtarët e tjerë, gjyqtarët e gjykatave të apelit janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjit.³⁰

III. KOMPETENCAT E GJYKATAVE TË APELIT PËR RISHIKIMIN E ÇËSHTJEVE PENALE

Rishikimet në apel duhet të jenë më shumë se thjesht verifikime të kërkesave procedurale dhe duhet të përbëjnë një këqyrje të hollësishme të çështjes nga gjykata kompetente, në lidhje me faktin dhe ligjin.³¹ Kjo pikëpamje gjen mbështetje edhe në KPrP. Në Shqipëri, ankimet e vendimeve penale mund të bëhen si për çështje të faktit, ashtu edhe të ligjit.³² Neni 425 i KPrP-së parashikon që gjykata e apelit “e shqyrton çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet

²⁶ Ligji nr. 8436, datë 28 dhjetor 1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri”, neni 7.

²⁷ Gjykata e Lartë, e cila është organi më i lartë apeluar në Shqipëri, ka kompetencë të rishikojë vendimet e gjykatave të apelit vetëm në lidhje me interpretimin e ligjit. Po aty, neni 13.

²⁸ Përveç gjykatave të zakonshme të apelit, ekziston edhe Gjykata Ushtarake e Apelit (që gjendet pranë Gjykatës së Apelit Tiranë) si dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë funksionon gjithashtu edhe një Kolegj Zgjedhor i cili përbëhet nga gjyqtarë të zgjedhur me short nga gjykatat e tjerat të apelit në vend. Deri në nëntor të vitit 2007 numri i gjyqtarëve të apelit, përfshirë edhe ata të Gjykatës Ushtarake të Apelit (që gjendet brenda Gjykatës së Apelit Tiranë), si dhe ata të Gjykatës për Krimet e Rënda, ishte 67. Violanda Theodhori, Drejtore e Karrierës dhe Vlerësimit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

²⁹ Gjyqtarëve të Gjykatave të Apelit u kërkohet të kenë të paktën pesë vjet përvojë pune në gjykatat e rretheve dhe të dallohen për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etike dhe morale. Shih ligjin nr. 8436, datë 28 dhjetor 1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri”, neni 24, pika 1. Përveç këtyre, gjyqtarët e apelit duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 19 të ligjit nr. 8436, datë 28 dhjetor 1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri”, si të gjithë gjyqtarët e tjerë.

³⁰ Kushtetuta, neni 145.

³¹ Gjykatat që dëgjojnë çështjet e apelit duhet të shqyrtojnë jo vetëm vlefshmërinë e shkaqeve të apelit por edhe nëse është respektuar parimi i një procesi të rregullt gjyqësor (d.m.th., garancitë tradicionale për një gjykim të drejtë, siç është prezumimi i pafajësisë, e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e drejta e barazisë së armëve, etj.) edhe në lidhje me parregullsitë që nuk janë raportuar. Shih Raportin Vjetor të Komisionit Ndëramerikan për të Drejtat e Njeriut 1990-1991, Raporti 74/90 – Çështja 9850 (Argjentinë), Rezoluta Nr. 22/88 e 23 mars 1988, seksioni III, paragrafi 18, mund të gjendet në <http://iachr.org/annualrep/90.91eng/Argentina9850.htm> [kjo faqe interneti është konsultuar për herë të fundit më 19 nëntor 2007].

³² Komentari i KPrP-së, faqe 541.

vetëm në shkaqet e paraqitura në ankim”,³³ duke i dhënë kështu gjykatës një kompetencë të gjerë për ta rishikuar të gjithë çështjen në themel. Duket se kjo tregon që gjykata e apelit mund të korrigjojë gabime – për faktin apo për ligjin – të bëra nga gjykata e shkallës më të ulët përtej atyre të ngritura nga ankuesi, si dhe mund t’i ndryshojë apo prishë vendimet sa herë që ta konsiderojë të nevojshme. Sipas KPrP-së, gjykata e apelit mund të rishikojë madje edhe pjesën e vendimit që ka lidhje me bashkëtëpandehurit, të cilët nuk kanë paraqitur ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura në ankim.³⁴

Një ankim mund të depozitohet, ndër të tjerë, nga prokurori, i pandehuri apo përfaqësuesi i tij ligjor, dhe ankimi mund të bëhet kundër të gjithë vendimit apo pjesëve të tij.³⁵ Meqenëse shkaqet e paraqitura për ankim mund të përfshijnë çështje që lidhen me interpretimin ligjor apo me interpretimin e fakteve të çështjes, kur ankohet ndaj një dënimi penal, i pandehuri mund të kërkojë që dënimi të priset, duke paraqitur argumente se gjyqtari i çështjes ka gabuar në vlerësimin e fakteve apo se vendimi është bazuar në një interpretim dhe zbatim të pasaktë të ligjit material apo procedural penal. Kur trajton shkaqet e ankimit, Komentari i KPrP-së përmend vetëm faktin që një ankim mund të depozitohet nga një i pandehur kundër vendimit që e ka shpallur të pafajshëm³⁶ apo fajtor, kundër llojit dhe masës së dënimit, si dhe kundër “motiveve të vendimit”, d.m.th. kundër pjesës arsyetuese të vendimit.³⁷ Në Shqipëri, fusha e gjerë e rishikimit që u është dhënë gjykatave të apelit nënkupton që të gjitha çështjet përkatëse ligjore dhe faktike duhen shqyrtuar në themel, për sa të jetë e mundur, deri në një vendim përfundimtar për të gjithë çështjen e ankuesit.³⁸ Kjo kompetencë e gjerë rishikuese është në përputhje me vetë qëllimin e procedimeve të apelit në çështjet penale dhe konkretisht shërben për të plotësuar mangësitë dhe për të korrigjuar gabimet që mund të kenë ndodhur në gjykimin e mëparshëm.

Pas një ankimi, gjykata e apelit mund ta lërë në fuqi, ta ndryshojë apo ta prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për çështjen në themel. Për rastin e fundit, ajo mund ta pushojë çështjen apo të prishë vendimin dhe t’ia kthejë aktet gjykatës së shkallës së parë.³⁹

³³ KPrP, neni 425, pika 1.

³⁴ Po aty.

³⁵ Ankimi mund të paraqitet edhe nga: prokurori i rrethit dhe prokurori i gjykatës së apelit, pavarësisht nga kërkesa që ka bërë në seancë përfaqësuesi i prokurorisë; i dëmtuari/i dëmtuari akuzues, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij; paditësi civil dhe i padituri civil. Shih KPrP, nenet 408-412.

³⁶ Këtu duhet pasur parasysh se një vendim që pushon çështjen për shkak se fakti nuk ekziston, nuk mund të apelohej nga i pandehuri. KPrP, neni 329.

³⁷ Komentari i KPrP-së, faqe 528.

³⁸ Komentari i KPrP-së, faqe 542.

³⁹ KPrP, neni 428.

Në rastet kur *kërkuesi është prokurori, gjykata e apelit*:

-mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të ndryshojë llojin ose ta rrisë masën e dënimit, të ndryshojë masat e sigurimit dhe të caktojë çdo masë tjetër sigurimi të parashikuar me ligj;

-mund t'i japë dënim atij që është deklaruar i pafajshëm, t'i japë pafajësi për një shkak të ndryshëm nga ai që pranohet në vendimin e apeluar apo të caktojë një masë sigurimi;

-mund të zbatojë, të ndryshojë ose të përjashtojë dënimet plotësuese dhe masat e sigurimit.⁴⁰

Në rastet kur një vendim apeloher vetëm nga i pandehuri, zbatohet parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*no reformatio in pejus*). Kjo do të thotë që gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë ose t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar.⁴¹

KPrP-ja nuk përcakton në mënyrë të veçantë rastet në të cilat një vendim mund të apeloher. Kështu, tabela e paraqitur në faqen vijuese, e bazuar në Kodin e procedurës penale të Bosnje-Hercegovinës, mund ta ndihmojë lexuesin që të jetë më i qartë mbi shkaqet e paraqitjes së një ankimi si dhe për çfarë shkaqesh mund të korrigjohen apo të ndryshohen vendimet e gjykatës së shkallës së parë. Lista e shkaqeve të paraqitura këtu nuk është e plotë. Shkaqet e dhëna më poshtë janë përzgjedhur nga neni 297 në nenin 300 të Kodit të procedurës penale të Bosnje-Hercegovinës.

⁴⁰ KPrP, neni 425, pika 2.

⁴¹ KPrP, neni 425, pika 3.

Një vendim mund të apelohe për shkak të:	Shembuj
shkeljeve të rënda të dispozitave të procedurës penale*	<p>a) nëse përbërja e trupit gjykues është e parregullt apo nëse një gjyqtar, i cili nuk ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në themel apo është përjashtuar nga gjykimin e çështjes me vendim të formës së prerë, merr pjesë në shpalljen e vendimit;</p> <p>b) nëse një gjyqtar, i cili duhej të ishte përjashtuar, ka marrë pjesë në gjykimin në themel;</p> <p>c) nëse gjykimin e çështjes në themel është mbajtur në mungesë të një personi, prania e të cilit kërkohet me ligj, apo nëse në gjykimin e çështjes në themel, të pandehurit, avokatit mbrojtës apo palës së dëmtuar, pavarësisht kërkesës së tyre, u është mohuar përdorimi i gjuhës së vet gjatë gjykimin të çështjes në themel, si dhe u është mohuar mundësia për ta ndjekur zhvillimin e gjykimin të çështjes në themel në këtë gjuhë;</p> <p>ç) nëse është shkelur e drejta për t'u mbrojtur;</p> <p>d) nëse pjesëmarrja e publikut është mohuar gjatë gjykimin të çështjes në themel në kundërshtim me ligjin;</p> <p>dh) nëse gjykata ka marrë një vendim për të cilin nuk është kompetente, apo nëse gjykata i ka refuzuar akuzat në mënyrë të parregullt për shkak të mungesës së juridiksionit kompetent;</p> <p>e) nëse në vendimin e saj, gjykata nuk i ka zgjidhur plotësisht elementet e akuzës;</p> <p>ë) nëse vendimi është bazuar në prova të cilat sipas KPrP-së nuk mund të përdoren për të bazuar vendimin;</p> <p>f) nëse dënimi i tejkalon akuzat e përmendura në kërkesën për gjykim apo akuzat e ndryshuara gjatë gjykimin;</p> <p>g) nëse formulimi i vendimit është i pakuptueshëm, kundërshton vetveten apo është në kundërshtim me shkaqet e vendimit apo nëse vendimi nuk ka asnjë bazë apo nëse në të nuk janë cituar arsyet në lidhje me faktet vendimtare;</p> <p>gj) nëse gjykata nuk ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë të parregullt disa dispozita të KPrP-së në përgatitjen e gjykimin të çështjes në themel, apo në dhënien e vendimit, dhe kjo ka ndikuar apo mund të kishte ndikuar në dhënien e një vendimi të ligjshëm dhe të rregullt.</p>
shkeljeve të kodit penal**	<p>a) nëse vepra për të cilën procedohet i akuzuari, përbën një vepër penale apo jo;</p> <p>b) nëse ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale;</p> <p>c) nëse ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, dhe sidomos nëse parashkruhet procedimi penal apo nëse procedimi nuk mund të vazhdojë për shkak të amnistisë apo faljes apo nëse çështja është vendosur tashmë me anë të një vendimi të detyrueshëm me ligj;</p> <p>ç) nëse një ligj, i cili nuk mund të zbatohet është zbatuar për veprën penale, e cila është objekti i akuzës;</p> <p>d) nëse vendimi që cakton dënimin, vendimi që vendos pezullimin e dënimit apo vendimi që cakton masën e sigurimit i ka tejkalluar kompetencat që ka gjykata sipas ligjit;</p> <p>dh) nëse janë shkelur dispozitat për llogaritjen e uljes së dënimit për shkak të kohës që personi ka kaluar në paraburgim.</p>
faktet janë marrë në konsideratë gabimisht apo në mënyrë të paplotë***	<p>a) kur gjykata ka vendosur në mënyrë të gabuar disa fakte vendimtare apo nuk i ka vendosur fare ato;</p> <p>b) kur kjo gjë tregohet nga fakte apo prova të reja.</p>
vendimit përsa u përket sanksioneve****	<p>a) një vendim mund të kundërshtohet për shkak të dënimit apo dënimit të pezulluar, nëse gjykata nuk e ka caktuar në formë të drejtë dënimin përsa u përket rrethanave rënduese dhe lehtësuese të cilat kishin shërbyer në dhënien e një mase më të rëndë apo më të lehtë dënimi. Gjithashtu një vendim mund të kundërshtohet për shkak se gjykata ka zbatuar apo nuk ka zbatuar dispozitat për zbutjen e dënimit, lirimimin nga dënimi apo pezullimin e një dënimi, megjithëse mund të kenë ekzistuar kushtet ligjore për këtë.</p>

* KPrP i Bosnje-Hercegovinës, neni 297

** Po aty, neni 298.

*** Po aty, neni 299.

**** Po aty, neni 300, paragrafi 1.

IV. ARSYETIMI LIGJOR NË PROCEDURAT E ANKIMEVE PENALE

E drejta ndërkombëtare dhe ajo shqiptare parashikojnë detyrimin e gjyqtarëve për të arsyetuar vendimet e tyre. Është shumë e rëndësishme që gjykatat të japin një arsyetim të qartë dhe të plotë për vendimet që ato marrin. Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar dhe vlerësuar, lejon vlerësimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë dhe është një kërkesë paraprake e nevojshme për të përgatitur një ankim në mënyrë efektive. Gjatë arsyetimit të vendimeve të tyre mbi çështjet penale, gjyqtarët e apelit duhet të shqyrtojnë kërkesat dhe argumentet e paraqitura nga ankimuesi, të analizojnë në detaje bazat dhe arsyetimin e vendimit të ankimuar (përfshirë pjesën e vendimit mbi dënimin), të japin një interpretim të saktë të ligjit dhe të gjykojnë e vlerësojnë provat në mënyrë korrekte.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka vënë re se një nga mangësitë më domethënëse në procedimin e ankimeve penale në Shqipëri është mungesa e arsyetimit të vendimeve në mënyrë korrekte dhe të plotë nga ana e gjykatave të apelit.⁴² Kjo cenon të drejtën për një proces të rregullt, e drejtë kjo e mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare dhe ajo shqiptare. Mungesa e arsyetimit të duhur ligjor ndikon në përgjithësi në cilësinë e vendimmarrjes së gjykatave të apelit për çështjet penale, gjë që është vënë re në katër fusha kryesore:

- mungesa e arsyetimit të mjaftueshëm në vendimet penale të apelit, përfshirë vendimet mbi dënimin;
- mostrajtimi i të gjitha shkaqeve të ankimit;
- gabime në interpretimin e ligjit procedural dhe atij material;
- gjykim dhe vlerësim i pamjaftueshëm i provave.

Mjaft faktorë, si dhe mungesa e profesionalizmit, aftësitë e pamjaftueshme të argumentimit ligjor, dhe një nivel i ulët i të kuptuarit të parimit bazë të prezumimit të pafajësisë dhe pasojave të tij, janë shpjegime të mundshme për mosarsyetimin e duhur që pasqyrohet në vendimet gjyqësore. Ndërsa kjo është diçka e dukshme për vendimet e gjykatës së shkallës së parë, ajo del edhe më në pah në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e apelit.

⁴² Shih diskutimin më poshtë, seksioni IV, nënseksionet nga A-ja deri tek F, faqe 20-47.

A. Arsyetimi ligjor në vendimet penale të apelit

1. E drejta përkatëse ndërkombëtare dhe ajo shqiptare

Standardet ndërkombëtare për një proces të rregullt të shprehura nëpërmjet praktikës gjyqësore u kërkojnë gjyqtarëve që t'i arsyetojnë vendimet e tyre.⁴³ Ndonëse nuk kërkohet shprehimisht në nenin 6 të KEDNj-së, e drejta e një vendimi të arsyetuar bën pjesë në të drejtën e një gjykimi të drejtë siç garantohet nga neni 6, pika 1 i KEDNj-së, dhe gjen zbatim si në çështjet civile ashtu dhe ato penale.⁴⁴ Përveç së drejtës që ka personi i akuzuar për të kuptuar motivet e vendimeve që prekin të drejtat e tij, një vendim plotësisht i arsyetuar lejon publikun ta vlerësojë sistemin e drejtësisë dhe u jep mundësi qytetarëve të zakonshëm të shohin se si administrohet drejtësia në emër të tyre.

Kërkesa për një vendim të arsyetuar u tregon palëve se “ato janë dëgjuar” dhe është veçanërisht e rëndësishme për ushtrimin efektiv të së drejtës për t’u ankuar, pasi në mungesë të arsyeve që justifikojnë një vendim gjyqësor, apeluasi nuk mund ta kundërshtojë në mënyrë të plotë dhe efektive vendimin e gjykatës më të ulët.⁴⁵ Një vendim i arsyetuar, i cili në rastin e një dënimi, shpjegon qartë faktet dhe provat mbi të cilat është bazuar vendimi, tregon përse janë hedhur poshtë argumentet e mbrojtjes dhe tregon gjithashtu se në rastin konkret është respektuar parimi themeltar i prezumimit të pafajësisë.⁴⁶

Ashtu si në rastin e garancive të tjera të një procesi të rregullt, e drejta e një vendimi të arsyetuar respektohet edhe në kontekstin e procedimeve

⁴³ Çështja “Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar”, KEDNj, 18 shkurt 1999, paragrafi 60.

⁴⁴ D.J. Harris, M. O’Boyle, C. Warbrick, *Law of the European Convention on Human Rights* [E drejta e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut] (Londër, Butterworths, 1995), faqe 215.

⁴⁵ Çështja “Suominen kundër Finlandës”, KEDNj, 24 korrik 2003, paragrafët 34-38. Në atë rast Gjykata argumentoi se, edhe pse një gjykatë kombëtare ka një “hapësirë vlerësimi” (d.m.th., liri veprimi) në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe pranimin e provave në mbështetje të kërkesave të palëve, një autoritet është i detyruar ta justifikojë aktivitetin e tij duke dhënë arsyet për vendimet e tij. Një vendim i arsyetuar ia jep një pale mundësinë të bëjë ankim kundër tij, si dhe mundësinë për rishikimin e vendimit nga një organ apelimi. Vetëm nëpërmjet një vendimi të arsyetuar, publiku mund të vlerësojë administrimin e drejtësisë. Në çështjen Suominen kundër Finlandës, Gjykata gjithashtu mori në konsideratë se ankueses i ishte mohuar e drejta për një procedim të rregullt për shkak të refuzimit nga gjykata të provave të propozuara nga kjo e fundit.

⁴⁶ Në nenin 6, pika 2 të KEDNj-së thuhet se çdo person i akuzuar për një shkelje të ligjit prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. KEDNj-ja shprehet se ky parim “kërkon, ndër të tjera, që gjatë përmbushjes së detyrave të tyre, anëtarët e një gjykate të mos fillojnë me idenë se i akuzuari e ka kryer krimin; barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të akuzuarit. Në këtë dispozitë thuhet gjithashtu se i takon prokurorit të njoftojë të akuzuarin për çështjen e ngritur kundër tij, me qëllim që ai të mund të përgatisë dhe të paraqesë mbrojtjen e tij sipas rastit, dhe të paraqesë prova të mjaftueshme për ta bindur atë”. Shih çështjen “Barberá, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës”, KEDNj, 6 dhjetor 1988, paragrafi 77.

përfundimtare të apelit.⁴⁷ Në apel dhe në shkallën e parë, një arsyetim i tillë është i nevojshëm që një çështje penale të zhvillohet dhe të paraqitet në mënyrë të qartë dhe logjike. Ky arsyetim pasqyrohet, ndër të tjera, në marrjen në konsideratë të çështjeve që lidhen me paraburgimin, pyetjen e dëshmitarëve, marrjen e provave dhe dhënien e dënimit. Ashtu siç theksohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, edhe pse gjykatave vendëse u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi për sa u përket strukturës dhe përmbajtjes së vendimeve të tyre, ato gjithmonë duhet “*të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i bazojnë vendimet e tyre*” me qëllim që “*i akuzuari ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar*”.⁴⁸ Edhe pse Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vëren se, nuk është gjithmonë e nevojshme që arsyet e dhëna në fazën e apelit të jenë aq të plota,⁴⁹ nocioni i zhvillimit të një seance gjykimi të drejtë kërkon që një gjykatë vendëse e cila ka dhënë arsye të pakta në vendimet e saj, qoftë duke përfshirë arsyet e dhëna nga një gjykatë më e ulët ose qoftë duke dhënë shpjegime të tjera, të trajtojë në fakt çështjet thelbësore që i janë paraqitur asaj për gjykim, dhe jo thjesht të konfirmojë gjetjet e një gjykate më të ulët.⁵⁰ Megjithëse në praktikë nuk është e nevojshme që gjykata t’i përgjigjet në detaje çdo pyetjeje,⁵¹ kur paraqitet një kërkesë, e cila pranohet, dhe është vendimtare për zgjidhjen e çështjes, atëherë gjykatës i kërkohet gjithmonë që në vendimin e saj “*të shprehet qartë dhe në mënyrë specifike*”.⁵²

Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë kërkon që të gjitha vendimet gjyqësore të arsyetohen.⁵³ Duke analizuar natyrën e kësaj kërkesë,⁵⁴ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë ka nënvizuar se vendimet e gjykatave – si të gjykatave të rretheve ashtu dhe ato të apelit – duhet të përfshijnë, të paktën në një formë të përmbledhur, “*rrethanat e faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta*”.⁵⁵ Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e procedimeve në apel, ku palët kanë nevojë që t’u jepet një mundësi për të kundërshtuar në mënyrë efektive çështjet faktike ose

⁴⁷ Shih çështjen “X kundër RFGj”, KEDNj, 31 mars 1992.

⁴⁸ Çështja “Hadjanastassiou kundër Greqisë”, 16 dhjetor 1992, paragrafi 33.

⁴⁹ Shih çështjen “X kundër RFGj”, KEDNj, 31 mars 1992.

⁵⁰ Çështja “Albina kundër Romanisë”, 28 prill 2005, paragrafi 34; çështja “Helle kundër Finlandës”, 19 dhjetor 1997, paragrafi 60.

⁵¹ Çështja “Van der Hurk kundër Hollandës”, KEDNj, 19 prill 1994, paragrafi 61.

⁵² Çështja “Hiro Balani kundër Spanjës”, KEDNj, 9 dhjetor 1994, paragrafi 28; çështja “Ruiz Torija kundër Spanjës”, KEDNj, 9 dhjetor 1994, paragrafi 30, ku Gjykata gjeti shkelje.

⁵³ Kushtetuta, neni 142.

⁵⁴ Në Shqipëri vendimet përbëhen nga tri pjesë: hyrja, pjesa përshkruese ose arsyetuese dhe dispozitivi. Komentari i KPrP-së, faqe 498.

⁵⁵ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendimi nr. 100, 1 shkurt 2001, i cituar në Komentarin e KPrP-së, faqe 499. Arsyetimi duhet gjithashtu të përmbajë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, vlerësimin e rrezikshmërisë së të pandehurit, si dhe arsyet e caktimit të llojit dhe masës së dënimit. Shih po aty. Shih gjithashtu KPrP neni 383, pika 1 (ç).

procedurale të cilat përbëjnë themelin e vendimeve të gjykatave të shkallës së parë. Komentari i KPrP-së shprehet se vendimi gjyqësor duhet të tregojë shprehimisht rrethanat e faktit si dhe provat që e vërtetojnë atë, pretendimet e palëve dhe arsyet e pranimimit ose mospranimimit të tyre, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, vlerësimin e rrezikshmërisë së të pandehurit dhe arsyet e caktimit të llojit dhe masës së dënimit.⁵⁶

2. Gjetjet

Është vënë re se, në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe atë shqiptare, gjykatat shqiptare shpesh nuk i arsyetojnë në mënyrë korrekte dhe të plotë vendimet e tyre. Ndërkohë që, shpesh, vendimet e gjykatave të shkallës së parë duket se janë të arsyetuara dobët – gjyqtarët duket se mbështeten në prova të dobëta dhe të pamjaftueshme, si dhe japin shpjegime problematike – gjykatat e apelit nuk e kryejnë detyrën e tyre themelore për të rishikuar cilësinë dhe njëtrajshmërinë e procesit të vendimmarrjes të gjykatave të shkallës së parë. Sa herë që gjykatat e apelit nuk vënë në dukje një shkëlqim të tillë proceduralë (d.m.th., arsyetim të pamjaftueshëm të vendimeve apo një mungesë totale të arsyetimit), ato nuk e ushtrojnë në mënyrë të mirëfilltë dhe të plotë funksionin e tyre të rishikimit, në kundërshtim me standardet shqiptare dhe ndërkombëtare për një proces të rregullt gjyqësor. Çështjet e mëposhtme japin shembuj të asaj që është përshkruar më lart.

Çështja e Altin Dikos (çështja e përdhunimit)

Altin Diko u shpall fajtor për përdhunim të përsëritur të kunatës sipas nenit 102, pika 2, të KPrP-së, dhe u dënua më 14 korrik 2004 nga Gjykata e Rrethit të Tiranës me nëntë vjet burgim. Sipas kërkesës për gjykim, viktima supozohej të ishte rrëmbyer nga i akuzuari dhe ishte mbajtur në një shtëpi private në Durrës për dhjetë ditë, periudhë gjatë së cilës i ishte nënshtruar akteve të përsëritura të dhunës fizike dhe psikologjike. Organi i akuzës u përqendrua tek deklaratimet e viktimës dhe dëshmitarëve, si dhe në thëniet e anëtarëve të familjes të cilët thjesht konfirmuan zhdukjen e viktimës për “pak ditë” pa dhënë shpjegime të tjera për arsyet e mungesës së saj. Pavarësisht kundërthënieve në deklaratimet e viktimës

⁵⁶ Komentari i KPrP-së, faqe 498.

Duke qenë se, siç përmendet më sipër, komentari i referohet detyrës së një gjykate për të trajtuar pretendimet e palëve dhe për të treguar arsyet për pranimin apo mospranimin e tyre, mbrojtjet e garantuara nga drejta shqiptare e tejkalojnë standardin minimal ndërkombëtar aktual. Ai në fakt u kërkon gjykatave jo vetëm që të trajtojnë në mënyrë të qartë çështje të lidhura drejtpërdrejtë me fajësinë e të pandehurit, por gjithashtu të trajtojnë çdo çështje tjetër (qoftë dhe të parëndësishme) të ngritur nga i pandehuri në ankimin e tij.

dhe të dëshmitarëve, nuk u bë asnjë përpjekje nga gjykata e shkallës së parë për t'i qartësuar ato. Në vend që elementet e veprës penale të ishin sqaruar në mënyrë të plotë dhe logjike, vendimi i gjykatës së shkallës të parë shkurtimisht shprehej se i akuzuari kishte "ushtruar dhunë psikike dhe fizike dhe kishte kryer marrëdhënie seksuale me dhunë me të". Elementet e veprës penale nuk u dhanë dhe nuk u analizuan më tej. Në një paragraf, vendimi shprehej se për dhjetë ditë me radhë⁵⁷ i akuzuari e kishte mbajtur viktimën në dhomën e një shtëpie dhe se më 29 janar 2004 ajo kishte mundur të largohej dhe të shkonte në shtëpinë e prindërve të saj – të cilët më vonë e kishin shoqëruar atë në komisariatit e policisë. Vendimi jo vetëm që nuk dha asnjë shpjegim se si personi i akuzuar kishte mundur ta mbante viktimën, në vendin ku përdhunimi i supozuar kishte ndodhur, kundër dëshirës së saj, por ai nuk tregoi as cilat kishin qenë shkaqet e largimit të saj.

Në vend që të paraqiste një analizë të saktë dhe të detajuar dhe një diskutim të provave në favor dhe kundër të akuzuarit të çështjes, vendimi prej një faqeje i Gjykatës së Rrethit u shpreh vetëm se fajësia e tij u duk të ishte "plotësisht e provuar me deponimet e viktimës, me deponimet e dëshmitarëve të tjerë, si dhe me prova të tjera shkresore". Është për t'u çuditur që prova shkresore – që ka të ngjarë të jetë ekspertiza mjekoligjore – tregonte që gjatë kontrollit fizik dhe gjinekologjik, nuk ishte gjetur asnjë shenjë e dhunës fizike në trupin e viktimës. Pas paraqitjes së një përmbledhjeje faktesh, në vendim nuk tregohet se cilët dëshmitarë konfirmonin teorinë e akuzës dhe se si kishte kontribuar dëshmia e tyre.

Më 23 korrik 2004, mbrojtja e të akuzuarit paraqiti një ankim në të cilin argumentohej se vendimi ishte i mbështetur në prova jo të plota dhe kontradiktore dhe i kërkoi gjykatës së apelit ta pushonte çështjen dhe të lironte të akuzuarin.

Më 14 janar 2005, Gjykata e Apelit në Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nga shqyrtimi i procesverbaleve doli se, gjatë seancave gjyqësore në apel, trupi gjykues i drejtoi vetëm dy pyetje të akuzuarit, konkretisht: (1) nëse viktimë e kishte lejuar marrëdhënien seksuale ose nëse ai kishte përdorur dhunë kundër saj; dhe (2) pse ishte në Durrës – një fakt që i akuzuari e mohoi dhe për të cilin gjykata nuk pati pyetje të tjera. Vendimi i apelit, më pak se një faqe, shprehet si vijon: "Ngjarja kriminale provohet plotësisht me shpjegimet e dëshmitarëve të pyetur si H.I. dhe S.S., dhe thëniet e të dëmtuarës". Edhe pse në ndryshim nga vendimi i shkallës së parë, gjykata e apelit të paktën tregoi se mbi cilat

⁵⁷Në periudhën 19-29 janar 2004.

deklarata të dëshmitarëve u bazua për të konfirmuar vendimin e fajësisë, ajo përsëri nuk tregoi se çfarë pjesësh dhe elementesh u konsideruan bindës në mbështetje të vendimit që u mor.

Duket se Gjykata e Apelit të Tiranës nuk e arsyetoi mjaftueshëm vendimin e saj duke mos treguar faktet dhe provat e veçanta mbi të cilat ai u bazua, si dhe duke mos shprehur qartë arsyet për mospranimin e provave të kundërta të paraqitura nga i akuzuari. Veçanërisht, dhe njësoj si vendimi i gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk tregoi se në ç'mënyrë provat e treguara në vendim (kryesisht deklaratimet e dëshmitarëve dhe thënia e viktimës) kishin qenë vendimtare në marrjen e një vendimi fajësie. Vendimi, me fjalë të tjera, nuk citon arsyet që lidhen me faktet vendimtare.

Ndërsa gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar u bazua në prova të pavenda (d.m.th., akti i ekspertimit mjekoligjor që shprehej se në trupin e viktimës nuk gjendej asnjë shenjë dhune fizike, siç konfirmohet prej studimit të dosjes nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri), dhe bëri një argumentim të gabuar duke u bazuar te ajo provë, gjykata e apelit nga ana tjetër nuk e njohu atë si gabim.

Çështja “Liçaj” (ose çështja e trafikut të drogës)

Më 6 dhjetor 2004, në vijim të një gjykimi të shkurtuar, **Selvie Liçaj** – një grua 70-vjeçare – u dënua nga Gjykata e Rrethit të Vlorës për mbajtje të lëndëve narkotike⁵⁸ dhe mbajtjen e armëve pa lejen e organeve kompetente.⁵⁹ Ashtu siç pasqyrohet në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, akuzat kundër gruas u bazuan në një kontroll të policisë që rezultoi në kapjen e 6 kg cannabis sativa dhe 2 armë zjarri automatike të gjetura në një kasolle pranë shtëpisë në të cilën e akuzuara jetonte me të shoqin.

Dosja e prokurorit kishte përmbajtjen e mëposhtme:

- procesverbali i kontrollit të banesës
- procesverbali i këqyrjes, marrjes në sequestrim të 6 kg lëndëve narkotike dhe 60 fishekëve
- akti i ekspertimit biokimik për lëndën dhe aktet e ekspertimit tekniko-balistik
- deklaratimet e të pandehurës gjatë hetimeve paraprake
- dëshmia e bashkëshortit të së akuzuarës, Salo Liçaj, i cili akuzonte bashkëshorten e tij se e kishte fshehur drogën, e cila nuk ishte gjetur nga policia gjatë një operacioni të kryer dy vjet më parë me qëllim shkatërrimin e cannabis sativa.

⁵⁸ KP, neni 283.

⁵⁹ KP, neni 278, pika 2.

Pas një përshkrimi përmbledhës të fakteve, Gjykata e Rrethit Vlorë arriti në përfundimin se e akuzuara kishte konsumuar elementet e veprave penale për të cilat ishte akuzuar.⁶⁰ Vendimi gjithashtu shprehej se e akuzuara “është madhore, e përgjegjshme para ligjit, dhe veprat penale për të cilat akuzohet ...dhe prandaj do të përgjigjet edhe për sanksionet e parashikuara nga këto dispozita”. Është i habitshëm fakti që gjykata e shkallës së parë nuk ka diskutuar dhe analizuar elementet e veprave penale,⁶¹ dhe as nuk ka diskutuar dhe treguar se si provat e paraqitura nga prokurori mbështesin vendimin e fajësisë për të akuzuarën. Më konkretisht, duke renditur dokumentet e paraqitura në dosjen e prokurorit, gjykata thjesht vuri re se procesverbali⁶² i sekuestrimit të 6 kg bimëve narkotike dhe 60 fishekëve, tregonte që vepra penale ishte kryer nga e akuzuara. Nga sa më sipër, duket se, duke bërë thjesht një renditje të dokumenteve, gjykata e shkallës së parë nuk e ka bazuar mjaftueshëm vendimin e saj.

Është me vlerë të përmendet se, edhe pse vendimi i fajësisë ishte marrë në vijim të një gjykimi të shkurtuar,⁶³ e drejta shqiptare nuk i përjashton gjykatat nga detyrimi i tyre për të arsyetuar plotësisht vendimet edhe kur zbatohen të tilla procedura. Ashtu siç tregohet edhe në Komentarin e KPrP-së, gjykimi i shkurtuar nuk lidhet me asnjë kusht – aq më pak me një pranim fajësie nga i akuzuari. Ai kërkon vetëm që i akuzuari të kërkojë që çështja të vendoset në gjendjen në të cilën ndodhen aktet në dosje, në kohën që çështja kalon për gjykim. Për rrjedhojë gjykata mund ta deklarojë fajtor ose jo të akuzuarin bazuar në vlerësimin që ajo u bën akteve në dosjen e prokurorit. Përfitimi nga një gjykim i shkurtuar nuk duhet të fitojë përparësi mbi nevojën për drejtësi në çështjen konkrete, për këtë qëllim gjykata e pranon kërkesën e të akuzuarit për gjykim të shkurtuar vetëm atëherë, dhe nëse, është e bindur se çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa nevojën për t’ia nënshtruar ato një shqyrtimi

⁶⁰ KP, neni 283, pika 1; KP, neni 278, pika 2.

⁶¹ Sipas nenit 278, pika 2 të KP-së mbajtja e armëve, bombave apo minave, lëndëve plasëse pa lejen e organeve shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet. Neni 283 i KP-së midis të tjerash shprehet se, mbajtja e substancave narkotike dhe psikotrope (përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla), si dhe e farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin, ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

⁶² Procesverbali i kqyrjes, marrjes e sekuestrimit me cilësinë e provës materiale, datë 19 janar 2004.

⁶³ Një gjykim i shkurtuar mund të fillohet me kërkesën e të akuzuarit apo mbrojtësit të tij përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Kur gjykata çmon se çështja mund të gjykohet edhe në bazë të dokumentacionit që ndodhet në dosje, ajo mund të bëjë një gjykim të shkurtuar. Në seancë, e cila kryesisht mbahet në prani të të akuzuarit dhe mbrojtësve të tij (si dhe palëve private), prokurori paraqet rezultatet e hetimit paraprak dhe jep opinionin e tij në lidhje me kërkesën e të akuzuarit për gjykim të shkurtuar. Në vijim të atij opinionit, dëgjohet i akuzuari. Nëse gjykata shprehet për vendim fajësie, dënimi ulet automatikisht me 1/3. Shih KPrP, nenet 403-406; shih gjithashtu Komentarin e KPrP-së, faqe 515-516.

të mëtejshëm gjyqësor.⁶⁴ Ashtu si në çdo çështje tjetër, në vijim të një gjykimi të shkurtuar, një gjykatë duhet të justifikojë dhe të motivojë plotësisht vendimin që ajo merr për çështjen në themel. Të tilla vendime mund të apeloher më pas nga palët, si përsa u përket fajësisë ashtu edhe masës së dënimit.⁶⁵

Më 13 dhjetor 2004, avokati mbrojtës i të akuzuarës ankimoi vendimin duke kërkuar pezullimin e dënimit prej 5 vjetësh për shkak të shkallës së ulët të rrezikshmërisë së të akuzuarës (siç tregohet, midis të tjerash, nga mosha e saj, gjendja shëndetësore dhe fakti që ajo nuk kishte qenë e dënuar më parë).

Më 3 qershor 2005, Gjykata e Apelit të Vlorës la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Pas përmbledhjes së gjetjeve nga kontrolli i kryer në banesë dhe të gjithçkaje tjetër që ishte përmendur më parë nga Gjykata e Rrethit, Gjykata e Apelit të Vlorës arsyetoi se:

(a) e akuzuara ka kërkuar gjykim të shkurtuar, ka pranuar fajësinë dhe kjo kërkesë i është pranuar;

(b) fajësia e të akuzuarës është provuar “edhe me” aktet e administruara në dosje, si procesverbali i kontrollit të banesës, procesverbali i sekuestrimit të provave materiale, dhe aktet e ekspertizës biokimike dhe balistike.

Gjykata e apelit, shumë shkurt arriti në përfundimin se: “duke qenë se fajësia e të akuzuarës mbështetej në prova, *gjykata me të drejtë e ka deklaruar atë fajtorë*”. Duket se, në vend që të nxirrte në pah mungesën e arsytimit në vendimin e gjykatës së rrethit, gjykata e apelit dha në mënyrë të ngjashme një vendim me të meta, duke përsëritur gabimin e bërë nga gjykata e shkallës së parë. Edhe sikur ankimi të ishte bërë kundër llojit të dënimit (dhe jo kundër vendimit), gjykata duhej të kishte ushtruar pushtetin e gjerë të njohur nga ligji për të rishikuar “*hollësisht*” çështjen, edhe përtej shkaqeve për të cilat vendimi ishte ankuar.⁶⁶ Gjykata mund ta kishte prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta pushonte çështjen për prova të pamjaftueshme. Një mundësi tjetër ishte që gjykata e apelit ta kishte prishur vendimin dhe ta kthente çështjen në gjykatën më të ulët për rigjykim. Në secilin prej rasteve, gjykata duhet të kishte theksuar detyrimin e gjykatës së shkallës më të ulët për të arsyetuar plotësisht vendimet e saj duke treguar “*faktet dhe provat*” mbi të cilat ishte bazuar vendimi.⁶⁷

⁶⁴ Komentari i KPrP-së, faqe 519-520.

⁶⁵ KPrP, neni 406, pika 3. Shih gjithashtu Komentari i KPrP-së, faqe 518.

⁶⁶ Shih KPrP, neni 425, pika 1, dhe diskutimin më sipër, faqet 15-17.

⁶⁷ KPrP, neni 383 (ç).

B. Arsyetimi në vendimin e dënimit

1. E drejta përkatëse ndërkombëtare dhe shqiptare

Sipas standardeve ndërkombëtare, gjykata duhet të japë arsye konkrete për caktimin e një dënimi (d.m.th. në lidhje me llojin dhe masën e dënimit). Kjo është veçanërisht e vërtetë kur bëhet fjalë për një masë që e privon personin nga liria e tij, rast në të cilin vendimi i gjykatës duhet të japë një argumentim specifik dhe të detajuar.⁶⁸ Kjo gjë eviton arbitraritetin dhe garanton që personi i akuzuar dhe shoqëria në përgjithësi të kuptojnë arsyet e dënimit.

Në caktimin e një dënimi, gjykata duhet të sigurohet që dënimi i dhënë të jetë i individualizuar, në kuptimin që të jetë dhënë në përputhje me rrethanat e të akuzuarit dhe të veprës. Në nenin 47 të KP-së thuhet se në caktimin e dënimit të një personi, gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.⁶⁹ Duke theksuar rëndësinë e arsytimit të mjaftueshëm në vendimet e gjykatës, Komentari i KPrP-së thotë se vendimi i dënimit duhet të tregojë qartë, përveç sa më sipër, një vlerësim të rrezikshmërisë së të pandehurit si dhe *arsyet e caktimit të llojit dhe masës së dënimit*.⁷⁰ Kështu gjykata duhet të tregojë rrethanat që janë marrë parasysh në dhënien e dënimit apo në vendimin për mosdhënien e tij.

Sipas së drejtës shqiptare, një i pandehur mund të apelojë vendimet e dënimit të gjykatës së shkallës së parë. Duke qenë se Shqipëria nuk ka direktiva të përcaktuara me ligj në lidhje me dhënien e dënimit⁷¹ të cilat do t'i udhëzonin gjykatat në vendosjen e dënimeve, një arsyetim i detajuar i gjykatave të apelit është shumë i rëndësishëm në kuadrin e rolit të tyre udhëzues.

2. Gjetjet

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri vëren se në mjaft raste, gjykatat e apelit nuk argumentojnë dhe provojnë në mënyrë korrekte dhe të plotë vendimet mbi llojin dhe masën e dënimit.

⁶⁸ Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (92) 12 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare në lidhje me unifikimin në dhënien e dënimeve, thotë: "1. Në përgjithësi, gjykatat duhet të paraqesin arsye konkrete për dhënien e dënimeve. Kjo gjë duhet bërë veçanërisht kur jepen dënime që e privojnë personin nga liria. 2. Ajo çka vlen si arsyetim është një motivim për dënimin përkatës brenda masave dhe llojeve normale të dënimeve për llojin e krimit dhe arsye-timeve të shpallura për dënimin.

⁶⁹ KP, neni 47.

⁷⁰ Komentari i KPrP-së, faqe 498-499.

⁷¹ Duhet patur parasysh se ajo që thuhet në Komentarin e KPrP-së mund të konsiderohet si udhëzuese për dhënien e dënimeve.

Në shumë raste nuk ka një arsytim të individualizuar dhe formulimi i vendimit të dënimit është standard, duke iu referuar për shembull shumë vakët e cekët rrezikshmërisë së të pandehurit apo të veprës së kryer.

Në çështjen e **Altin Dikos**, të dënuar për përdhunim,⁷² Gjykata e Rrethit Tiranë, në marrjen e masës së dënimit merr parasysh “rrezikshmërinë shoqërore të veprës e të të pandehurit, etj.” Faktorët e tjerë nuk trajtohen më tej. Ndërkohë, Gjykata e Apelit nga ana e saj nuk i trajton me më tepër hollësi këto kritere dhe shprehet njësoj: “lloji dhe masa e dënimit janë në përputhje me rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të autorit”.

Në disa raste gjykatat nuk trajtojnë me hollësi as rrethanat lehtësuese apo rënduese mbi të cilat bazohet vendimi i dënimit, ose edhe kur e bëjnë një gjë të tillë nuk e bëjnë mjaftueshëm. Në raste të tjera, duket se gjykatat e apelit nuk u japin rëndësinë e duhur elementeve të marra parasysh në caktimin e vendimit për dënimin, kjo do të thotë që disa faktorëve rëndues u jepet më tepër prioritet krahasuar me të tjerët, pa dhënë shpjegim për këtë. Së fundi, shpeshherë vendimet rendisin një numër faktorësh, por nuk tregojnë shprehimisht cilët faktorë konsiderohen rëndues e cilët lehtësues.⁷³

Më 5 tetor 2004, **Gjergj Selimaj** u dënua nga Gjykata e Rrethit Vlorë për vrasjen e bashkëshortes së tij në rrethana rënduese.⁷⁴ Gjykata e Apelit Vlorë e ndryshoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke e dënuar të pandehurin për vrasje me paramendim dhe e uli dënimin e tij nga burgim i përjetshëm në njëzet e katër vjet burg. Në diskutimin e masës së dënimit, Gjykata e Apelit mori parasysh ndër të tjera, “pendimin e thellë” të të pandehurit pas kryerjes së krimit si dhe personalitetin e tij. Edhe pse faktorët e tjerë lehtësues dhe rëndues të marrë në konsideratë (d.m.th., fakti që ai u dorëzua në polici pas kryerjes së krimit dhe motivet e dobëta) duket se janë analizuar mjaftueshëm në vendim, nuk tregohen fakte që të mbështesin pendimin e supozuar të të akuzuarit. Më tej gjykata nuk jep shpjegime se si ndikoi personaliteti i të pandehurit në dhënien e dënimit.

Në rastin e **Selvie Liçajt**, të përmendur më sipër,⁷⁵ avokati mbrojtës i 70-vjeçares e apeloj vendimin e Gjykatës së Rrethit Vlorë, i cili e dënonte

⁷² Shih diskutimin e kësaj çështjeje në faqet 22-24.

⁷³ Për shembull, nëpër vendime në përgjithësi përdoret “mosha e re e të pandehurit” pa treguar nëse kjo gjë konsiderohet rrethanë lehtësuese apo rënduese.

⁷⁴ I pandehuri – i cili vrau bashkëshorten e tij me sqepar – u dënua nga Gjykata e Rrethit Vlorë për vrasje me dashje të kryer në mënyrë të tillë që i ka shkaktuar mundime të veçanta viktimës. KP, neni 79 (e).

⁷⁵ Shih diskutimin në faqet 24-26.

me pesë vjet burg, dhe kërkoi që ekzekutimi i vendimit me burgim të pezullohej dhe klientja e tij të vihej në periudhë prove.⁷⁶ Në kërkesën ankimore, avokati kërkoi që gjykata të mbante parasysht rrezikshmërinë e pakët shoqërore të së pandehurës, ndër të tjera moshën e saj, gjendjen shëndetësore, si dhe faktin që ajo nuk kishte qenë e dënuar më parë.⁷⁷ Gjykata e Apelit Vlorë e refuzoi kërkesën dhe konfirmoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke u shprehur se gjykata e shkallës së parë e kishte vlerësuar siç duhet rrezikshmërinë shoqërore të së pandehurës dhe të veprës për të cilën ishte dënuar. Gjykata argumentoi që megjithëse është e vërtetë që e pandehura përbën rrezikshmëri të ulët “rrezikshmëria e veprave për të cilat ajo akuzohet [d.m.th., mbajtje e lëndëve narkotike dhe armëmbajtje pa leje] për shkallën e përhapjes që kanë aktualisht paraqitet shqetësuese dhe në raport me njëra tjetrën këto rrezikshmëri për përcaktimin e drejtë të dënimit, prioritet merr rrezikshmëria e veprës, ndaj kërkesa e bërë në ankim për aplikimin e nenit 59 të KP-së nuk ka vend të zbatohet”. Gjykata nuk e sqaron me hollësi se përse fakti që vepra penale është shumë e përhapur duhet të mbizotërojë ndaj faktorëve të tjerë, siç është rrezikshmëria e ulët shoqërore që paraqet e akuzuara. Më tej, vlen të përmendet që neni 50 i KP-së parashikon një listë të gjatë të rrethanave rënduese dhe përhapja e një veprë nuk renditet në këtë nen. Së fundmi, fakti që një vepër është shumë e përhapur nuk duhet konsideruar si një tregues i rëndësisë së veprës. Shumica e krimeve të lehta janë edhe më të shpeshtat.

Duket se në çështjen konkrete – ku e pandehura është një grua 70-vjeçare e padënuar më parë – gjykata mund të kishte menduar caktimin e një mase që nuk e privon personin nga liria. Sipas standardeve ndërkombëtare, përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç shprehet nga Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm “kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës”,⁷⁸ dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë

⁷⁶ Neni 59 i KP-së parashikon që nëse personi dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale kanë një rrezikshmëri të pakët, gjykata, kur jep dënim me burgim gjer në pesë vjet mund të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë duke u pezulluar vendimi i dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepra penale po aq të rëndë apo më të rëndë. Afati i provës është tetëmbëdhjetë muaj gjer në pesë vjet. KP, neni 59.

⁷⁷ Avokati argumentoi gjithashtu se gjykata duhet të kishte marrë parasysht sasinë e pakët të drogës si dhe faktin që e pandehura ishte penduar (siç tregohet nga fakti që ajo kishte pranuar fajësinë dhe kishte shpërguar me hollësi veprat penale të kryera).

⁷⁸ Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R (99) 22 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Rritjen e Popullimit të Burgjeve, paragrafi 1.

masa të cilat nuk e bëjnë këtë.⁷⁹ Ndërkohë që e drejta penale shqiptare parashikon një sërë masash alternative për burgimin, gjykata nuk mori parasysh asnjërën prej tyre.⁸⁰

Në rastin e **Leonard Hankut**, i cili u dënua me 6 vjet për kryerje të marrëdhënieve seksuale me dhunë me një të mitur, nuk është e qartë se si i ka vlerësuar Gjkata e Rrethit Tiranë faktorët rëndues dhe lehtësues në dhënien e vendimit të dënimit. Gjkata vetëm i është referuar në mënyrë standarde rrezikshmërisë të veprës penale (kryerjes së marrëdhënieve seksuale me dhunë me një të mitur) dhe autorit të veprës, si dhe faktit që i pandehuri kishte qenë i dënuar më parë. Fakti që viktimi e fali të pandehurit, mosha e re e të pandehurit, si dhe fakti që i pandehuri kishte një fëmijë të mitur, janë cituar si rrethana lehtësuese dhe për këtë nuk janë dhënë sqarime, si dhe pse këto mbizotërojnë ndaj natyrës së rëndë të krimit. Në fakt, gjykata e dënoi të pandehurin me gjashtë vjet burgim, që duket të jetë një dënim mjaft i lehtë duke pasur parasysh që sipas ligjit, ky krim është i dënueshëm me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.⁸¹ Nga ana tjetër, Gjkata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë kishte vendosur drejt në lidhje me caktimin e dënimit, duke iu referuar në mënyrë standarde rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit të veprës, si dhe faktit që ai kishte qenë dy herë i dënuar më parë.

Duket se në rastin konkret, gjykata e apelit ka humbur një mundësi për të shtjelluar vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, pra nuk ka udhëhequr gjykatat e shkallës së parë lidhur me këtë, gjë që është shumë e nevojshme. Për më tepër, dënimi i dhënë duket i lehtë, duke pasur parasysh arsyetimin e bërë nga gjykata, gjë që të krijon përshtypjen se krimet ndaj grave për shkak të gjinisë dhe dhuna ndaj grave nuk merret seriozisht dhe të dyja këto trajtohen me një zemërbutesi të pajustificueshme nga sistemi gjyqësor.

⁷⁹ Po aty, në paragrafin 14. Duhet inkurajuar përdorimi i masave që nuk e privojnë personin nga liria sa herë të jetë e mundur, pasi këto po konsiderohen gjithnjë e më shumë si mjete më efektive për trajtimin e shkelësve në shoqëri duke përfiturar në këtë mënyrë edhe shkelësi, edhe shoqëria.

Shih Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për masat që nuk e privojnë personin nga liria (rregullat e Tokios), të miratuara me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 45/110 të datës 14 dhjetor 1990, preambula, e cila mund të gjendet në : http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/h_comp46.htm (për herë të fundit është parë më 19 nëntor 2007).

⁸⁰ Masat alternative për burgim shkurtimisht përfshijnë: vënie në periudhë prove, pezullim i vendimit me burgim dhe detyrim për të kryer detyra me interes publik, lirim para kohe me kusht, copëzimi i dënimit me burgim, si dhe gjobat. Shih KP, nenet 34, 58- 65. Duhet përmendur se pjesa më e madhe e masave alternative nuk zbatohen në praktikë për shkak të mungesës së një kuadri të përshtatshëm institucional dhe mungesës së infrastrukturës në Shqipëri.

⁸¹ KP, neni 101, pika 1.

C. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit

1. E drejta ndërkombëtare dhe ajo shqiptare

E drejta për një proces të rregullt gjyqësor kërkon që një gjykatë vendëse që ka dhënë shumë pak arsye në marrjen e një vendimi, qoftë duke përfshirë ose jo arsyet e dhëna nga një gjykatë më e ulët, të adresojë çështjet thelbësore të paraqitura përpara saj për gjykim dhe jo thjesht të mbështesë gjetjet e një gjykate më të ulët.⁸² E drejta për një gjykim të drejtë përfshin ndër të tjera, të drejtën e palëve që të paraqesin vërejtje të cilat i konsiderojnë me vend për çështjen.⁸³ KEDNj-ja garanton të drejta që nuk janë teorike e të rreme, por “konkrete dhe efektive”⁸⁴ dhe kjo e drejtë mund të konsiderohet efektive vetëm kur të tilla vërejtje janë marrë parasysh dhe janë shqyrtuar siç duhet nga gjykata. Me fjalë të tjera, një nga efektet e nenit 6, pika 1 të KEDNj-së është që gjykata detyrohet t’i shqyrtojë siç duhet kërkesat, argumentet dhe faktet e paraqitura nga palët përpara se të gjykojë nëse ato kanë lidhje me vendimin apo jo.⁸⁵ GjEDNj-ja vëren se megjithëse në praktikë nuk është e nevojshme që gjykata të japë përgjigje të detajuara për çdo pyetje,⁸⁶ nëse diçka që paraqitet është thelbësore për rezultatin e çështjes, gjykata duhet të merret më të në mënyrë të veçantë gjatë gjykimit.⁸⁷ Për shembull, në çështjen *Hiro Balani kundër Spanjës*, kërkuesi kishte bërë një kërkesë e cila kërkonte një përgjigje të veçantë e të shpejtë nga ana e gjykatës. Gjykata nuk ktheu përgjigje, duke e bërë kështu të pamundur të merrej vesh nëse gjykata thjesht e kishte shpërfillur çështjen apo kishte në mend të mos e pranonte dhe nëse do të ishte kështu, për cilat arsye. Sipas GjEDNj-së kjo është një shkelje e së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar nga neni 6, pika 1 i KEDNj-së.⁸⁸ Parimet e përshkruara këtu, janë të zbatueshme për seancat gjyqësore dhe procedimet në shkallë të dytë.

Siç u përmend më sipër, sipas nenit 425 të KPrP-së, gjykata e apelit e shqyrton në tërësi çështjen që i është paraqitur.⁸⁹ Në interpretim të termit “në tërësi”,

⁸² Çështja “Albina kundër Rumanisë”, 28 prill 2005, paragrafi 34; çështja “Helle kundër Finlandës”, 19 dhjetor 1997, paragrafi 60.

⁸³ Po aty, paragrafi 30.

⁸⁴ Çështja “Artico kundër Italisë”, 13 maj 1980, paragrafi 33.

⁸⁵ Çështja “Albina kundër Rumanisë”, paragrafi 30. Në këtë rast GjEDNj-ja vëren se gjykimi i gjykatës së apelit në një çështje civile nuk ishte i motivuar mjaftueshëm për faktin se ai u referohej argumenteve të shprehur nga gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj, pa trajtuar argumentat e paraqitur nga pala ankuuese. Shih po aty paragrafi 34.

⁸⁶ Çështja “Van der Hurk kundër Hollandës”, GjEDNj, 19 prill 1994, paragrafi 61.

⁸⁷ Çështja “Hiro Balani kundër Spanjës”, GjEDNj, 9 dhjetor 1994, paragrafi 28.

⁸⁸ Shih po aty.

⁸⁹ KPrP, neni 425. Duke bërë këtë gjë, “[gjykata e apelit] shqyrton edhe pjesën që u takon të bashkëpandehurve që nuk kanë bërë ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura në ankim”.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë komenton se është detyrë e gjykatës së apelit “të marrë në shqyrtim dhe t’u japë përgjigje shkaqeve të parashtruara në ankim nga kërkuesi”.⁹⁰

2. Gjetjet

OSBE-ja ka vërejtur se shpesh, gjykatat e apelit nuk marrin në shqyrtim çdo shkak të ngritur për ankim. Ato gjithashtu nuk marrin në konsideratë e as nuk i përmendin argumentet e paraqitura nga ankimuesi në kërkesën ankimore.

Për shembull, në çështjen **Diko**, i cili më 14 korrik 2004 u dënua nga Gjykata e Rrethit Tiranë me 9 vjet burgim për përdhunim në rrethana rënduese,⁹¹ avokati mbrojtës i të pandehurit apelo vendimin e shkallës së parë duke kërkuar që klienti i tij të deklarohej “i pafajshëm” dhe të lirohej.⁹²

Kërkesa ankimore⁹³ argumentoi se vendimi i Gjykatës së Rrethit ishte i bazuar në prova të pamjaftueshme pasi mbështetej ekskluzivisht në ato që dukeshin si deklarime kontradiktore të viktimës, bërë në faza të ndryshme të procedimit. Më konkretisht, avokati mbrojtës argumentoi, mes të tjerash, se:

(1) vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë nuk ishte i bazuar në prova, përfshirë edhe faktin që akti i ekspertimit mjekoligjor, përmendur në vendimin e gjykatës si pjesë e provave në mbështetje të dënimit, në fakt konkludonte se tek viktimja nuk ishin konstatuar shenja dhune;

(2) denoncimi i viktimës ishte “kontradiktor dhe i paqartë”, përfshirë faktin që ajo kishte dhënë deklarime kontradiktore përpara prokurorit (duke deklaruar se ishte përdhunuar disa herë nga i pandehuri) dhe përpara gjykatës (duke deklaruar se i pandehuri e kishte përdhunuar vetëm një herë);

(3) pretendimi i viktimës që ajo kishte mundur të dilte nga shtëpia ku kishte ndodhur dhuna e supozuar duke e goditur të pandehurin në kokë me një “send të fortë” ishte i pabazuar, pasi gjatë ekzaminimit të të pandehurit nuk ishte gjetur asnjë shenjë apo dëmtim i dukshëm;

(4) çështja duhej të ishte pushuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë pasi viktimja, gjatë procesit gjyqësor, e kishte tërhequr padinë.

⁹⁰ Komentari i KPrP-së, faqe 549.

⁹¹ I pandehuri u dënua nga gjykata e shkallës së parë për marrëdhënie seksuale me dhunë më shumë se një herë. Sipas nenit 102, pika 2 të KP-së, përdhunimi i përsëritur dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

⁹² Shih kërkesën ankimore të paraqitur më 23 korrik 2004 nga avokati mbrojtës Kosta Karanxha, faqe 3. Më shumë informacion mbi këtë çështje mund të gjendet në seksionin “Arsyetimi ligjor në procedimet e ankimeve penale”, faqe 19.

⁹³ Drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë më 23 korrik 2004.

Me gjithë artikulumin dhe paraqitjen relativisht të qartë dhe të hollësishme të shkaqeve të ankimit në kërkesën ankimore, gjykata e apelit në vendimin e saj nuk trajtoi dhe as nuk njohu ndonjë nga argumentet e rëndësishme (ose nën-argumentet), dhe nuk shpjegoi se mbi cilat baza deklarimi i viktimës u konsiderua i besueshëm dhe shërbeu si provë kryesore për dhënien e dënimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Ajo që bie edhe më shumë në sy është se vendimi i gjykatës së apelit nuk evidentoi që Gjkata e Rrethit Tiranë e kishte mbështetur vendimin e saj në mënyrë të gabuar në prova të pabaza – domethënë akti i ekspertimit të mjekut ligjor që dëshmoi mungesën e shenjave të dhunës mbi trupin e viktimës. Pas shqyrtimit të të gjithë dosjes së kësaj çështjeje, mund të pohohet se konkluzionet e këtij akti ekspertimi mbështesin pretendimet e avokatit mbrojtës.⁹⁴ Është e qartë pra, që një provë e tillë nuk duhej marrë parasysh kundër të pandehurit.

Duket se, duke mos adresuar, as përmbledhtazi, argumentet e ngritura në ankim, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë ka shkelur si të drejtën shqiptare ashtu edhe atë ndërkombëtare. Për më tepër, gjykata e apelit të paktën duhej të kishte ndryshuar vendimin e shkallës së parë duke evidentuar natyrën e palogjikshme dhe kontradiktore të arsyetimit të gjykatës më të ulët ku i referohej, në mënyrë të gabuar, aktit të ekspertimit mjekoligjor si provë për ta dënuar të pandehurin në rastin konkret.

Vërejtje dhe përfundime të ngjashme mund të nxirren edhe në çështje të tjera.

Më 22 maj 2003, **Leonard Hanku** u deklarua fajtor për përdhunimin e një të miture⁹⁵ dhe u dënua me pesë vjet burgim nga Gjkata e Rrethit Tiranë. Në formulimin e dënimit, gjykata u bazua në:

- deklarimin e viktimës (që ajo ishte përdhunuar nga i pandehuri; që ia kishte treguar ngjarjen kumatës së partnerit me të cilin bashkëjetonte; dhe që ditën tjetër ajo kishte njoftuar gjithashtu partnerin e saj përpara se të shkonte në polici);
- deklarimet e dëshmitarëve (të partnerit të viktimës dhe kumatës së tij, të cilët konfirmonin se ajo u kishte treguar rreth përdhunimit; partneri kishte deklaruar edhe që viktimi i kishte thënë se i pandehuri e ngacmonte shpesh);
- konkluzionin e ekspertimit mjekoligjor dhe në procesverbalin për sekuestrimin e provës materiale (që tregonin se të brendshmet e viktimës ishin grisur në një anë).
- aktin e dëshmisë mjekoligjore (që deklaronte se viktimi kishte një ekimozë në kofshën e majtë).

⁹⁴ Altin Diko, dosja penale nr. 757, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, më 22 mars 2004.

⁹⁵ KP, neni 101, pika 1, parashikon që kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur mes moshës 14-18 vjeç dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Më 28 maj 2003, avokati i të pandehurit e apeloj vendimin me argumentin se nuk bazohej në prova të mjaftueshme. Ankimi argumentoi se:

- (a) dënimi ishte i bazuar vetëm në thëniet e dëshmitarëve, të cilët kishin treguar një histori të dëgjuar;
- (b) procesverbali për sekuestrimin e provës materiale (që tregonin se të brendshmet e viktimës ishin grisur në një anë) ishte konsideruar padrejtësisht si provë, pasi nuk vërtetonte që përdhunimi kishte ndodhur (ato mund të kishin qenë të grisura që më parë);
- (c) akti i dëshmisë mjekoligjore, i cili tregonte se viktimja kishte një plagë në kofshën e majtë, nuk vërtetonte që ajo ishte përdhunuar.

Më 6 tetor 2003, gjykata e apelit konfirmoi vendimin e shkallës së parë. Në vendimin e saj, gjykata e apelit u mjaftua thjesht me një përmbledhje të provave, pothuajse duke përsëritur gjetjet e shkallës së parë, pa adresuar dhe pa përmendur shkaqet e ngritura nga i pandehuri në ankim. Gjykata e apelit arriti në përfundimin se provat e cituara nga gjykata e shkallës së parë ishin në fakt të mjaftueshme për ta deklaruar të pandehurin fajtor. Vendimi më pas u shpreh se, përveç shpjegimeve të hollësishme të dhëna nga viktimja në polici dhe më pas në gjykim, fajësia e të pandehurit provohej edhe nga “dëshmitarët e pyetur, provat materiale, dëshmia mjekoligjore nr. 1033, sipas së cilës e dëmtuara kishte një ekimozë me dimensione 3 x 2 cm në kofshën e majtë, dhe nga rrobat e të dëmtuarës (të brendshmet dhe bluza) që ishin të grisura”. Gjykata e apelit nuk adresoi, dhe as nuk shpjegoi pse argumentet e të pandehurit nuk u konsideruan të vlefshme.

D. Interpretimi dhe zbatimi i së drejtës materiale dhe procedurale nga gjykatat e apelit

Prezenca në Shqipëri e OSBE-së ka vërejtur se, në disa raste, gjykatat e apelit gabojnë në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave së të drejtës materiale dhe procedurale. Kjo është shqetësuese, pasi gjykatat e apelit duhet të luajnë një rol të rëndësishëm për t’i udhëzuar gjykatat më të ulëta në interpretimin, sqarimin dhe zbatimin e së drejtës materiale dhe procedurale, duke kontribuar kështu në zhvillimin dhe formimin e jurisprudencës në Shqipëri.

1. Interpretimi dhe zbatimi i së drejtës materiale

Më 5 tetor 2004, **Gjergj Selimaj** u deklarua fajtor për vrasjen në rrethana cilësuese⁹⁶ të ish-gruas së tij (duke i shkaktuar mundime të veçanta viktimës)

⁹⁶ Sipas nenit 79 (e) të KP-së, vrasja me dashje e kryer duke i shkaktuar viktimës mundime të veçanta dënohet me jo më pak se njëzet vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. KP, neni 79 (e).

dhe u dënua me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Rrethit Vlorë. Sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në mbrëmjen e 30 tetorit 2002, pas një debati mes viktimës dhe të pandehurit në shtëpinë e nënës së këtij të fundit, i pandehuri rrëmbeu një sqepar dhe e goditi viktimën në kokë duke i shkaktuar vdekje. Vendimi u mbështet në deklaratimet e dëshmitarëve në gjyq (të gjithë konfirmonin një histori abuzimesh në të kaluarën), në deklarinimin e nënës së të pandehurit (e cila e kishte zënë të pandehurin në flagrancë menjëherë pas krimin), në gjetjet e aktit të ekspertimit mjekoligjor që konkludonte se vdekja kishte qenë e mundimshme (dhe jo e menjëhershme),⁹⁷ si dhe në aktin e ekspertimit biologjik që konkludonte se gjaku i gjetur në rrobat e të pandehurit dhe në sqepar i përkiste viktimës.

Avokati mbrojtës e apeloj vendimin, duke arsyetuar se gjykata e shkallës së parë kishte gabuar në cilësimin e veprës si vrasje në rrethana cilësuese (duke i shkaktuar mundime të veçanta), dhe kërkoi që vepra të konsiderohej si vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike⁹⁸ ose, vrasje me dashje e cilësuar,⁹⁹ për të cilat ligji parashikon dënim më të ulët.¹⁰⁰

Më 22 dhjetor 2004, *Gjykata e Apelit Vlorë ndryshoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë që e deklaronte të pandehurin fajtor për vrasje me paramendim*, dhe e uli dënimin nga burgim i përjetshëm në 24 vjet. Duke vepruar në këtë formë, gjykata arsyetoi se mendimi kriminal i të pandehurit për të kryer vrasje nuk kishte lindur “menjëherë”, por “prej kohësh”, dhe ishte ndezur nga debatet e vazhdueshme me viktimën, i fundit prej të cilëve kishte ndodhur menjëherë përpara vrasjes. Duke refuzuar kërkesën e avokatit mbrojtës (domethënë që krimi të cilësohej “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike”), gjykata e apelit deklaroi se gjendja e tronditjes së fortë psikike duhej përcaktuar nga “provokimi ose veprimet e padrejta nga ana e viktimës”. Gjykata vazhdoi më tej duke deklaruar se, sipas praktikave gjyqësore të zbatueshme, “vepra të padrejta konsiderohen ato *veprime të kundraligjshme të drejtuara jo vetëm kundër të pandehurit, por edhe familjarëve apo të afërmeve të tij*” që t’i shkaktojnë të pandehurit tronditje të fortë psikike, duke e shtyrë atë të humbasë kontrollin e veprimeve të tij.

⁹⁷ Akti i ekspertizës mjekoligjore nr. 128, 12 dhjetor 2002.

⁹⁸ Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike dënohet me burgim deri në tetë vjet. KP, neni 82.

⁹⁹ Vrasja me dashje dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet. KP, neni 76.

¹⁰⁰ Në ankim, avokati argumentonte se gjykata nuk kishte marrë në konsideratë konkluzionet e aktit të ekspertimit mjekoligjor që kishte kërkuar mbrojtja, gjetjet e të cilit ishin në kundërshtim të drejtë me ato të paraqitura nga eksperti gjatë procesit gjyqësor. Akti i ekspertimit i paraqitur nga mbrojtja deklaronte se goditjet me sqepar në trupin e viktimës ishin të shpeshta, të vrullshme dhe me instensitet të lartë, kështu që karakteri i vdekjes ka qenë “absolut”. Akti i ekspertimit mjekoligjor nr. 73, 8 qershor 2004.

Ky vendim mund të kritikohet në disa aspekte.

Së pari, duke deklaruar se tronditja psikike duhet përcaktuar nga “vepra të padrejta”, të cilat nga ana tjetër konsiderohen “veprime të kundraligjshme”, duket qartë që gjykata e apelit e ka lexuar gabim dhe e ka keqinterpretuar ligjin. Sipas neni 82 të KP-së, tronditja psikike duhet të shkaktohet nga “dhuna ose fyerja e rëndë”.¹⁰¹ Në ligj nuk përmenden “vepra të padrejta”, dhe as që këto të fundit të jenë të kundraligjshme. Më tej, gjykata e apelit e ka shpërfillur hipotezën “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike” kryesisht duke u bazuar në arsyetimin se grindja mes ish-bashkëshortëve përpara vrasjes nuk ishte aspak “e pazakontë”, dhe si e tillë nuk kishte mundësinë të shkaktonte një gjendje të tronditjes së fortë psikike tek i pandehuri. Duke e kufizuar analizën veç në këto elemente, duket se gjykata ka humbur një mundësi për të qartësuar domosdoshmërinë e “elementit të përpjesëtueshmërisë” në vrasjet e ashtuquajtura të kryera “në gjaknxehtësi e sipër”. Më konkretisht, gjykata duhej të kishte theksuar që provokimi/faktori nxitës (me fjalët e së drejtës shqiptare “dhuna ose fyerja e rëndë”) duhet që në çdo ngjarje të jetë i një natyre dhe rëndese të tillë të mjaftueshme sa të shtyjë një person me moral dhe arsyetim mesatar të bjerë në një gjendje “të tronditjes së fortë psikike” dhe të humbasë kontrollin.

Së dyti, duket se gjykata e apelit ka gabuar duke e cilësuar veprën penale si “vrasje me paramendim” në rastin konkret, dhe ka bërë një keqinterpretim të dispozitës penale, me pasoja potencialisht negative për vendime të ardhshme në çështje të ngjashme. Ndryshe nga dispozitat e tjera penale, neni 78, pika 1, i KP-së thotë vetëm se vrasja me paramendim dënohet me burgim nga 15 gjer në 20 vjet,¹⁰² pa përcaktuar elementet e veprës penale. Sipas komentarit të Kodit penal (pjesa e posaçme), elementi i paramendimit ekziston kurdoherë që një person vret me dashje, me gjakftohtësi, dhe për motive të dobëta.¹⁰³ Me qëllim që ky element të ekzistojë, e drejta penale në shumë vende kërkon që të kalojë një interval kohor relativisht i gjatë mes lindjes së mendimit kriminal dhe kryerjes së krimit, dhe që ky qëllim ka ekzistuar në mënyrë të pandërprerë në mendjen e të pandehurit deri në përfundimin e krimit.¹⁰⁴ Për të përcaktuar

¹⁰¹ KP, neni 82.

¹⁰² KP, neni 78, pika 1.

¹⁰³ Ismet Elezi, *E drejta penale (Pjesa e posaçme)* (Tiranë, Erik, 2007), faqet 42-44. Sipas botimit, paramendimi nënkupton ekzistencën e “dashja e drejtpërdrejtë e paramenduar”, vazhdim gjakftohtë deri kur krimi përfundohet, një interval kohe relativisht të gjatë midis shkakut provokues dhe çastit të kryerjes së vrasjes, dhe një paracaktim të kohës dhe mjeteve për ta kryer atë.

¹⁰⁴ Shih Cass. Pen. Sez. 1, 13 maj 1993. Komentari i Kodit penal (pjesa e posaçme) përdor gjuhë të ngjashme, por të turbullt. Ai thotë se duhet të kalojë një interval kohe relativisht i gjatë midis shkakut provokues dhe çastit të kryerjes së vrasjes, dhe që “dashja gjakftohtë (me qetësi shpirtërore)” duhet të ketë vazhduar në mënyrë të pandërprerë deri në çastin e kryerjes së krimit. Ismet Elezi, *E drejta penale (Pjesa e posaçme)* (Tiranë, Erik, 2007), faqet 43-44.

nëse paramendimi është vërtet i pranishëm, gjykata duhet të vlerësojë të gjitha rrethanat konkrete në një çështje, si zgjedhja e mjetit për të kryer vrasjen, shkakun e krimit, zgjedhjen e kohës më të përshtatshme për kryerjen e krimit dhe mënyrat e kryerjes së tij – të gjitha faktet që i paraprijnë vetë kryerjes së krimit. Argumentimi i gjykatës se i pandehuri e vrau ish-gruan e tij me paramendim nuk duket se gjen mbështetje në faktet e konstatuara si nga gjykata e shkallës së parë ashtu edhe nga ajo e apelit. Më specifikisht, koha dhe rrethanat e vrasjes (fakti që vrasja u parapri nga një zënkë në shtëpinë e nënës së të pandehurit në një kohë kur ajo dhe dëshmitarë të tjerë të mundshëm ishin të pranishëm), dhe dinamika (si mjeti i përdorur për të vrarë – sqepari, dhe fakti që i pandehuri nuk u përpoq aspak që të fshihte provat materiale apo trupin e viktimës), duket se kundërshtojnë pretendimin se viktima kishte vepruar me gjakftohtësi në kryerjen e një krimi të paramenduar dhe të planifikuar me kujdes. Duket se gjykata e apelit mund ta kishte ri-cilësuar vrasjen më mirë si vrasje me dashje, por në rrethana rënduese, pasi ishte kryer: (a) për motive të dobëta (i pandehuri e vrau ish-gruan pasi ajo i kishte thënë fjalë fyese gjatë grindjes); dhe (b) egërsisht dhe pa mëshirë.¹⁰⁵

2. Interpretimi dhe zbatimi i së drejtës procedurale

Më 6 dhjetor 2004, pas një gjykimi të shkurtuar, **Selvie Liçaj** u deklarua fajtor nga Gjykata e Rrethit Vlorë për mbajtje të lëndëve narkotike dhe armëve luftarake. Sipas ligjit, nëse gjykimi i shkurtuar përfundon me deklarimin fajtor të të pandehurit, gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën.¹⁰⁶ Dispozitivi i vendimit duhet të tregojë si dënimin që do të jepej sikur gjykimi të ishte zhvilluar sipas procedurës së zakonshme, ashtu edhe dënimin real pas zbritjes me një të tretën.¹⁰⁷ Në çështjen në fjalë, gjykata e dënoi të pandehurën me pesë vjet burgim. Megjithatë vendimi deklaroi se dënimi duhet të ulet me një të tretën, ai nuk tregoi periudhën e burgimit që duhej kryer pas zbritjes, në shkelje të së drejtës procedurale në fuqi. Në vijim të ankimit të të pandehurit kundër dënimit, gjykata e apelit konfirmoi vendimin e shkallës së parë pa e ndrequr gabimin, duke e lënë të paqartë periudhën e saktë të burgimit që e pandehura do të kryente.

Ardian Guri u deklarua i pafajshëm nga Gjykata e Rrethit Shkodër më 24 tetor 2005 për trafikimin e narkotikëve.¹⁰⁸ Në seancë gjyqësore,

¹⁰⁵ KP, neni 50 (a) dhe (c). Këto rrethana rëndojnë dënimin, që normalisht është nga dhjetë gjer në njëzet vjet burgim.

¹⁰⁶ Shih KPrP, neni 406.

¹⁰⁷ Komentari i KPrP-së, faqe 516.

¹⁰⁸ KP, neni 283/a.

prokurori paraqiti një akt ekspertimi nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë¹⁰⁹ që deklaronte se në makinën e të pandehurit¹¹⁰ ishin gjetur mbi katër kilogramë lëndë pluhuri me ngjyrë kremi që përmbante heroinë dhe monoacetilmorfinë – të dyja të cilësuara me ligj si lëndë narkotike dhe psikotropike.¹¹¹ Procesverbali i gjyqit tregon se toksikologu që kishte hartuar aktin ishte thirrur disa herë nga gjykata, por nuk ishte paraqitur asnjëherë. Vendimi i gjykatës përmend se për shkak se emri i aktit ishte shkruar keq, më 26 maj 2005 mostra të marra nga kjo lëndë u dërguan në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Tiranë për ri-ekzaminim. Në përgjigje të mosveprimit nga ky i fundit, mostrat e marra nga lënda iu dërguan Institutit të Policisë Shkencore në Tiranë. Më 24 tetor 2005, akti i ekspertimit kimiko-ligjor i Institutit të Policisë Shkencore në Tiranë konkludoi se *mostrat e pluhurit nr.1 dhe nr.2 objekt të këtij eksperimentimi kanë në përbërje të tyre paracetamol dhe kafeinë*,¹¹² *mostra nr.3 sjellë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë ka në përbërje të saj paracetamol, kafeinë, 6-acetilmorfinë, heroinë*.¹¹³ Duke përmendur gjetjet e aktit të ekspertimit në vendimin e saj më 24 tetor 2005, Gjykata e Rrethit Shkodër e deklaroi të pandehurin të *pafajshëm, duke arsyetuar se mbajtja e paracetamolit dhe e kafeinës nuk është veprim që dënohet me ligj*.¹¹⁴ Gjykata duket se e ka mbështetur vendimin e saj në ekspertimet kimiko-ligjore të kryera nga Instituti i Policisë Shkencore në Tiranë – akti nr. 4173, shtator 2005, dhe akti nr. 4910, tetor 2005. Vlen të përmendet se, në arsyetim, vendimi i gjykatës nuk nxjerr në pah konkludimet kontradiktore të dy akteve, dhe nuk shpjegon pse provat e një eksperti u konsideruan më të vlefshme se ato të ekspertit tjetër. Me të njëjtin vendim, trupi gjykues refuzoi kërkesën e prokurorit për t’ia transferuar aktet atij për hetim të mëtejshëm pas pushimit të akuzës nga gjykata.¹¹⁵ Si përfundim, gjykata urdhëroi që provat materiale (pluhuri ngjyrë kremi i sekuestruar nga policia e Shkodrës) të asgjësoheshin në bazë të nenit 190, pika 1 (b), të KPrP-së.

¹⁰⁹ Akti i ekspertizës kimiko-ligjore nr. 281, 2003.

¹¹⁰ Lënda ishte sekuestruar në makinën e të pandehurit pas ndalimit të tij në zbatim të një urdhër-arresti të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Shkodër mbi dyshimin se i pandehuri kishte kryer veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike (neni 284/1 i KP-së).

¹¹¹ Ligji nr. 7975, datë 26 korrik 1995, “Për barnat narkotikë dhe lëndët psikotrope”, tabela 1, lista IV.

¹¹² Analiza e ekspertizës kimike konkludonte që dy mostrat ishin ekzaminuar një herë më parë – akti i ekspertimit kimik nr. 4173, datë 14 shtator 2005 – dhe si rrjedhojë nuk mund të ekzaminohej një herë të dytë.

¹¹³ Akti i ekspertimit kimiko-ligjor nr. 4910 i Institutit të Policisë Shkencore në Tiranë, 24 tetor 2005.

¹¹⁴ KPrP, neni 388, pika 1 (c).

¹¹⁵ KPrP, neni 377.

Më 4 nëntor 2005, prokurori paraqiti një ankim me anë të të cilit kërkoi ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe transferimin e akteve tek ai për hetim të mëtejshëm.

Më 28 shkurt 2006, *Gjykata e Apelit Shkodër konfirmoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë që e deklaronte të pandehurin të pafajshëm*. Në një vendim me dy faqe që kryesisht përsëriste faktet e deklaruara në vendimin e shkallës së parë, gjykata e apelit arsyetoi se gjykata e rrethit kishte “vendosur me të drejtë pafajësinë e të pandehurit” pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjykata gjithashtu deklaroi se, megjithëse prokurori kishte kërkuar kthimin e akteve për hetim të mëtejshëm, ai nuk kishte dhënë arsye pse çështja kundër Gurit duhej të mbahej e hapur, pasi hetime të mëtejshme mund të kryheshin pavarësisht nga rezultati i çështjes në fjalë.

Duket se gjykata e apelit nuk i ka evidentuar gabimet procedurale të bëra nga gjykata e shkallës së parë.

Së pari, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për të asgjësuar provat materiale – pluhurin natyra e të cilit diskutohej në këtë çështje – pas përfundimit të procesit gjyqësor duhet konsideruar si i çuditshëm dhe i palogjikshëm, në mos keqdashës. Sipas nenit 190, pika 1 (b) i KPrP-së, gjykata ose prokurori, në *vendimin përfundimtar* ose në vendimin e pushimit të çështjes, mund të urdhërojë që sendet “mbajtja ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar, u dorëzohen enteve përkatëse ose zhduken”.¹¹⁶ Vendimi i gjykatës për të asgjësuar provat në këtë rast duket i palogjikshëm, në momentin që u referohet provave “mbajtja ose qarkullimi i të cilave është e ndaluar” me ligj. Nëse gjykata ka nxjerrë përfundimin se vërtet lënda nuk ishte drogë, duke vendosur pafajësinë e të pandehurit, atëherë duhej t’ia kishte kthyer sendet personale personit të cilit ato i përkisnin – pra, të pandehurit, në përputhje me ligjin.¹¹⁷

Së dyti, duket se Gjykata e Apelit Shkodër nuk e ka korrigjuar vendimin e shkallës së parë që refuzonte kërkesën e prokurorit për t’ia transferuar aktet këtij të fundit për hetim të mëtejshëm. Neni 377 i KPrP-së thotë se, në rastet kur prokurori e tërheq akuzën dhe kërkon t’i kthehet dosja për hetim të mëtejshëm, gjykata ka për detyrë t’ia kthejë dosjen. Ndërsa, nëse në momentin që akuza tërhiqet vërtetohet se i pandehuri është i pafajshëm,

¹¹⁶ Komentari i KPrP-së shprehet se urdhri për të asgjësuar provat duhet të lëshohet vetëm “në përfundimin e një çështjeje penale”. Komentari i KPrP-së, faqe 247-248.

¹¹⁷ Shih KPrP, neni 190, pika 1 (ç).

gjykata nuk e kthen dosjen dhe liron të pandehurin.¹¹⁸ Në një vendim të vitit 2002 për këtë çështje, Gjykata e Lartë vendosi në favor të prokurorit dhe ndryshoi vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, duke deklaruar se "... gjykata nuk duhet të pranojë tërheqjen e akteve, vetëm atëherë kur del qartë që i pandehuri është i pafajshëm...". Gjykata e Lartë vijoi duke thënë se, nëse pafajësia e të pandehurit është e dyshimtë, atëherë gjykata duhet ta pranojë kërkesën e prokurorisë.¹¹⁹

Duket se, në çështjen në fjalë, nisur nga rezultati kontradiktor i akteve të ekspertimit të përmendura në vendimin e shkallës së parë, pafajësia e të pandehurit mund të ishte me mjaft dyshim për gjykatën, dhe kjo e fundit duhej t'ia kishte kthyer dosjen prokurorit për hetim të mëtejshëm. Gjykata e Apelit Shkodër, duke mos korigjuar vendimin e shkallës së parë në këtë aspekt, përligji gabimet e bëra në procesin gjyqësor për të interpretuar dhe zbatuar të drejtën procedurale.

Së treti, dhe ndoshta më e rëndësishmja, gjykata e apelit mund ta kishte prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë për arsyetim kontradiktor ose të pamjaftueshëm. Sipas nenit 383 të KPrP-së, me qëllim që të jetë i vlefshëm, një vendim gjyqësor duhet të përmbajë, mes të tjerash, provat mbi të cilat bazohet vendimi si dhe *arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta*.¹²⁰ Duke qenë se vendimi i shkallës së parë nuk tregoi qartë se pse u konsideruan të vlefshme dhe të besueshme rezultatet e ekzaminimit të dytë të kryer nga Instituti i Policisë Shkencore në Tiranë dhe jo rezultatet e ekzaminimit të kryer nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Tiranë, gjykata e apelit mund ta kishte shfuqizuar vendimin.

E. Probleme me vlerësimin e provave nga gjykatat e apelit

1. Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe shqiptar

Gjatë procesit gjyqësor, provat zakonisht paraqiten me kërkesën e palëve. Gjykata vendos për pranueshmërinë e provave përmes një urdhri, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji ose ato që janë haptazi të panevojshme.¹²¹ Përveç provave të

¹¹⁸ Shih KPrP, neni 377. Shih gjithashtu Komentarin e KPrP-së, faqe 491. Komentari i KPrP-së thotë gjithashtu se, nëse në momentin që tërhiqet akuza vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj, atëherë gjykata nuk e jep dosjen por e vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes. Shih po aty.

¹¹⁹ Shih Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendimi nr. 157, datë 28 shkurt 2002, në Komentarin e KPrP-së, faqe 492-493.

¹²⁰ KPrP, neni 383 (ç).

¹²¹ KPrP, neni 151, pika 2.

paraqitura nga palët, gjykata mund të marrë prova edhe kryesisht.¹²² Gjukata i çmon provat duke përcaktuar saktësinë, vërtetësinë si dhe fuqinë provuese të tyre, pas shqyrtimit të tyre në tërësi.¹²³ Megjithëse përgjithësisht është në dorë të gjykatave vendëse që të vlerësojnë nëse e gjejnë të përshtatshme për të thirrur dëshmitarë¹²⁴, Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut ka deklaruar se, sipas neni 6, “një gjykatë duhet të japë arsye për të cilat vendos që të mos thërrasë për të dhënë dëshmi ata dëshmitarë të cilët janë kërkuar shprehimisht për t’u marrë në pyetje”.¹²⁵ GjEDNj-ja arriti në një përfundim të ngjashëm në çështjen *Vidal kundër Belgjikës*.¹²⁶ Në atë çështje, përveç deklaratave verbale të të dy të pandehurve, apeluesi (i cili më parë ishte deklaruar i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë pas dëshmisë së disa dëshmitarëve) u dënua nga një gjykatë apeli bazuar vetëm në provat e dosjes, pa thirrur dëshmitarët që mbrojtja i kishte kërkuar për t’i marrë në pyetje. Gjukata arriti në përfundimin se gjykata e apelit refuzoi në mënyrë të pajustificuar të dëgjonte dëshmitarët, në papajtueshmëri me garancitë për një gjykim të drejtë të shprehura nga neni 6.¹²⁷ Megjithëse Gjukata gjykoj se gjykata vendëse ishte përqendruar në mosdhënien e arsyeve të refuzimit, kjo çështje mund të kuptohet edhe si e tillë që GjEDNj-ja vuri në dyshim vetë vendimin i cili përjashtonte marrjen e dëshmive që mund të siguronin prova në favor të të pandehurit, i cili më pas u dënua me katër vjet burgim për një krim të rëndë.¹²⁸

Një gjykatë apeli duhet të çmojë provat e paraqitura në gjykimin e shkallës së parë dhe mund të plotësojë, në raste të veçanta, përfundimet në të cilat ka arritur gjykata në lidhje me faktet.¹²⁹ Kështu, në varësi të natyrës së çështjes dhe të shkaqeve të ankimit, gjykata e apelit mund të mbështetet në provat e marra gjatë gjykimin në shkallën e parë, të urdhërojë përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, tërësisht ose pjesërisht, dhe gjithashtu të marrë prova të reja, me kërkesën e palëve ose kryesisht.¹³⁰

¹²² KPrP, neni 367.

¹²³ KPrP, neni 152. Shih gjithashtu Komentarin e KPrP-së, faqe 504.

¹²⁴ Çështja “Vidal kundër Belgjikës”, GjEDNj, 22 prill 1992, para. 33. Neni 6, pika 3 (d), nuk kërkon paraqitjen dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në favor të të pandehurit, qëllimi thelbësor i neni 6 është që të garantohet një barazi e plotë armësh në çështje. Shih çështjen “Engel dhe të tjerë kundër Holandës”, GjEDNj, 8 qershor 1976, para. 91.

¹²⁵ Çështja “Bricmont kundër Belgjikës”, neni 158 (1989).

¹²⁶ Çështja “Vidal kundër Belgjikës”, GjEDNj, 22 prill 1992, para. 34.

¹²⁷ Shih po aty. Gjukata deklaroi se “heshtja e plotë” e gjykatës së apelit ndaj kërkesës së të pandehurit për të dëgjuar dëshmitarë në seancën e apelit ishte në kundërshti me konceptin e një gjykimi të drejtë, që është edhe thelbi i neni 6. Për më tepër që Gjukata e Apelit e Brukselit (të cilës i ishte ridërguar çështja nga Gjukata e Kasacionit) e kishte rritur dënimin që ishte dhënë më parë nga Gjukata e Apelit e Liezhit, e cila kishte ulur dënimin nga katër vjet në tri, dhe nuk e kishte pezulluar çështjen siç kishte bërë Gjukata e Apelit e Liezhit.

¹²⁸ D.J. Harris, M. O’Boyle, C. Warbrick, *Law of the European Convention on Human Rights* [E drejta e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut] (Londër, Butterworths, 1995), faqe 269.

¹²⁹ KPrP, neni 152. Shih gjithashtu Komentarin e KPrP-së, faqe 496-497.

¹³⁰ KPrP, neni 427. Komentari i KPrP-së, faqe 550.

2. Gjetjet

Në Shqipëri, aftësitë jo plotësisht të formuara dhe jo gjithmonë të përshtatshme për pyetjen e dëshmitarëve sjellin ndonjëherë vlerësim të provave të parëndësishme dhe mosshqyrtim të çështjeve thelbësore gjatë një procedimi penal. Si rrjedhojë, rrezikohet e drejta e të pandehurit për një gjykim të drejtë, e cila është në përputhje me nenin 6, pika 1, të KEDNj-së.

Prezenca në Shqipëri e OSBE-së ka vërejtur se, në proceset gjyqësore, dëshmitarëve shpesh u bëhen vetëm pyetje të përcipta dhe sipërfaqësore rreth ngjarjeve vendimtare. Për shembull, shpesh mungojnë pyetjet kyçe mbi vendngjarjen e krimin, sqarimet lidhur me shkaqet e sakta të fakteve të veçanta, si dhe prania e dëshmitarëve të tjerë të mundshëm e me vlerë. Kjo praktikë rezulton në moskonstatimin e plotë dhe të saktë të fakteve që janë nën shqyrtim gjyqësor nga ana e gjykatës. Kjo mangësi e gjykimit të shkallës së parë ndikon padyshim edhe në seancat pasuese penale në apel. Edhe pse gjykatat e shkallës së dytë kanë për detyrë që të korrigjojnë vendimet e shkallës së parë, aty ku faktet duket se janë provuar në mënyrë të pasaktë ose jo të plotë, ato shpesh nuk e bëjnë këtë. Me gjithë autoritetin e gjerë që u garanton ligji, gjykatat e apelit shpesh heqin dorë nga detyrimi i tyre për të “rishqyrtuar tërësisht” çështjen, dhe në praktikë ato nuk këqyrin, ose nuk marrin më tej, prova për të cilat ato gëzojnë autoritetin që t’i ekzaminonjë.¹³¹ Është vënë re se në kuadrin e seancave në apel, në vijim të paraqitjes së çështjes dhe kërkesave të palëve përpara trupit gjykues, të pandehurit i bëhen pak pyetje nga trupi gjykues, dhe funksioni i gjykatës për të kërkuar rishqyrtim të provave ose prova të reja nuk ushtrohet në rregull thuajse kurrë. Megjithëse, si në sisteme të tjera ligjore, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor duhet konsideruar si përjashtim, duket se ka çështje në të cilat trupi gjykues i apelit duhet ta ushtrojë këtë pushtet për të arritur në një zgjidhje të drejtë të çështjes.

Më tej, është vëzhguar se, në disa çështje ku gjykatat e apelit kanë refuzuar të dëgjojnë provat e kërkuara nga një palë, ato nuk kanë justifikuar dhe arsyetuar drejt vendimin e tyre, në shkëlqje të së drejtë shqiptare dhe asaj ndërkombëtare.

Për shembull, në çështjen e **Altin Dikos**, i cili ankimoi dënimin e tij me nëntë vjet burgim për përdhunim, avokati mbrojtës argumentoi se çështja duhej pushuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, pasi viktimë, më 26 maj 2004 – gjatë procesit gjyqësor – e kishte tërhequr padinë e saj. Avokati argumentoi se, ndërsa i pandehuri ishte deklaruar fajtor për përdhunim nga gjykata e shkallës së parë sipas nenit 102, pika 2, të KP-së (marrëdhënie seksuale me dhunë më shumë se një herë), viktimë kishte deklaruar në gjyq se ishte përdhunuar nga i pandehuri vetëm një herë, megjithëse kjo nuk ishte

¹³¹ KPrP, neni 427.

pasqyruar në procesverbalin e gjyqit. Nëse deklarata e saj do të ishte marrë në konsideratë, argumenton avokati mbrojtës, vepra duhej ri-cilësuar nga vepra e parashikuar prej nenit 102, pika 2, në atë të parashikuar prej nenit 102, pika 1, të KP-së (marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura), e cila mund të ndiqet penalisht vetëm në bazë të ankimit të viktimës, dhe si rrjedhojë çështja duhej të ishte pushuar.

Në këtë sfond, avokati mbrojtës i paraqiti Gjykatës së Apelit Tiranë një kërkesë paraprahe për të rimarrë në pyetje viktimën për të qartësuar deklaratimet e saj dhe rrethanat e çështjes, dhe argumentoi se dënimi duhej ndryshuar në apel. Nëse kjo kërkesë do të ishte pranuar, padyshim që do të kishte qenë vendimtare për rezultatin e çështjes. Gjithsesi, gjykata e apelit e refuzoi si të pabazë gjatë procesit të apelit, pa dhënë asnjë arsye ose shpjegim për këtë vendim, në shkelje të së drejtës shqiptare dhe të nenit 6, pika 3 (d), të KEDNj-së.¹³²

Ndërsa, për të qartësuar rrethanat dhe për të vlerësuar besueshmërinë e palëve, të gjithë dëshmitarët që mund të japin dëshmi të rëndësishme duhen dëgjuar, në disa çështje dhe për arsye që mbeten të paqarta, gjykatat e apelit as nuk e marrin mundimin të dëgjojnë dëshmitarë vendimtarë të mundshëm, kur këta të fundit nuk janë dëgjuar nga trupi gjykues i shkallës së parë.

Shembujt e mëposhtëm e ilustronjë këtë pikë.

Gazmir Koleci u deklarua fajtor më 11 mars 2005 nga Gjykata e Rrethit Tiranë për armëmbajtje pa leje në bazë të nenit 278, pika 2, të KP-së dhe u dënua me tri vjet burgim. Në të njëjtin vendim, gjykata ndryshoi cilësimin juridik të veprës bërë nga prokurori nga vrasje me dashje e mbetur në tentativë në plagosje të lehtë me dashje,¹³³ dhe e pushoi këtë të fundit pas tërheqjes së ankimit nga ana e viktimës. Sipas ankimit, viktima gjendej në një lokal me dy miq, E. Denaliaj dhe S. Dorzi, kur u ndez një grindje mes këtij të fundit dhe të pandehurit. Kur viktima ndërhyri për t'i ndarë, i pandehuri e goditi. Më vonë atë ditë, pasi grindja u rindez mes të pandehurit dhe viktimës jashtë të njëjtit lokal, i pandehuri e qëllloi me pistoletë, duke e plagosur viktimën në shpatullën e djathtë. Megjithëse dëshmia e Dorzit mund të ishte e dobishme për të qartësuar rrethanat e ngjarjes, për arsye të paqarta, ai nuk u dëgjua si dëshmitar në gjyq.¹³⁴ Pas një këqyrjeje të kujdesshme, dosja gjyqësore nuk

¹³² Sipas kësaj dispozite, kushdo që akuzohet për një vepër penale ka të drejtë, mes të tjerash, të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij nën të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij. KEDNj, neni 6, pika 3 (d).

¹³³ KP, neni 89.

¹³⁴ Dosja gjyqësore nuk përmban informacion nëse ndonjë nga palët apo trupi gjykues u përpoq të gjente dhe të thërriste dëshmitarin.

dukej se përmbante informacion nëse ndonjë nga palët ishte përpjekur për ta gjetur këtë dëshmitar kyç.

Në gjykim, një nga dëshmitarët, i cili ishte gjithashtu mik i viktimës, dhe që kishte ndërhyrë për të ndarë viktimën dhe të pandehurin, deklaroi se të dy ishin të dehur kur kishte ndodhur incidenti. Gjatë marrjes në pyetje, viktima deklaroi: “Unë u qëllova nga i pandehuri, i cili është një mik i imi. As vetë nuk e di se si krisi pistoleta... Ai shtiu në ajër dhe unë u përpoqa t’i marr armën nga dora, dhe u plagosa...”. Në bazë të kësaj deklarate, mes provave të tjera, gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën për vrasje të mbetur në tentativë.

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë u ankimua nga prokurori (i cili kërkoi ta ndryshonte vendimin dhe që i pandehuri të dënohej për vrasje të mbetur në tentativë) dhe, më 12 tetor 2004, nga avokati mbrojtës (i cili kërkoi që dënimi të modifikohet dhe që i pandehuri të vihej në provë për një periudhë prej pesë vitesh).¹³⁵

Më 11 mars 2005, Gjykata e Apelit Tiranë prishi vendimin e shkallës së parë që e kishte pushuar akuzën “plagosje e lehtë me dashje”,¹³⁶ dhe e dënoi të pandehurin me gjashtë vjet burgim për vrasje të mbetur në tentativë. Gjykata e apelit e modifikoi vendimin e shkallës së parë me argumentin se ai ishte i arsyetuar në mënyrë të papërshtatshme. Më pas argumentoi se:

grindja midis të pandehurit dhe të dëmtuarit, përdorimi i armës nga ana e të pandehurit, duke e qëlluar direkt të dëmtuarin në trup, e duke i shkaktuar atij plagosje të lehtë me armë zjarri, tregon së qëllimi i të pandehurit ka qenë për ta vrarë të dëmtuarin e jo për ta plagosur lehtë atë. Mënyra dhe rrethanat se si ka ndodhur ngjarja, mjeti që i pandehuri ka përdorur, vendi ku është plagosur i dëmtuari dhe se pasoja nuk ka ardhur për shkaqe të njohura nga i pandehuri, krijojnë bindje të plotë se i pandehuri duhet të përgjigjet për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i KP-së [pjesa me shkrimin korsiv është theksuar qëllimisht nga autori].

Në marrjen e vendimit, gjykata e apelit as nuk bëri një rishqyrtim gjyqësor e as nuk mori në shqyrtim prova të reja. Edhe një herë, dëshmitari Dorzi, dëshmia e të cilit mund të kishte hedhur dritë mbi rrethanat e ngjarjes, përfshirë edhe një motiv të mundshëm për vrasjen e mbetur në tentativë, nuk u dëgjua.

¹³⁵ Ankimi i të pandehurit argumentonte se dënimi duhej ndryshuar nisur nga një sërë rrethanash lehtësuese, si moshë e re e të pandehurit, mungesa e precedentëve penalë dhe pendimi e tij.

¹³⁶ Ndjekja penale për kundërvajtjen penale “plagosje e lehtë me dashje” (KP, neni 89) mund të nisë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit. Shih KPrP, neni 284, pika 1.

F. Studim rasti

Një analizë e çështjes së diskutuar më poshtë ilustron disa nga problemet e evidentuara në cilësinë e rishqyrtimit të ushtruar nga gjykatat e apelit, dhe në arsyetimin ligjor të përdorur nga to.

Taulant Saçaj u deklarua fajtor për “shfrytëzim të prostitucionit” nga Gjykata e Rrethit Tiranë më 8 qershor 2005 dhe u dënua me tri vjet burgim. Megjithëse fillimisht ai akuzohej për “shfrytëzim të prostitucionit në rrethana rënduese” duke e detyruar ose shtrënguar viktimën që të ushtronte prostitucion jashtë shtetit¹³⁷ (vepër që dënohet nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim), prokurori më pas e ndryshoi akuzën në “shfrytëzim të prostitucionit”, që mbart një dënim më të lehtë.¹³⁸

Çështja vërtitej rreth një deklaratë që viktimia i kishte lëshuar policisë së Vlorës ku ajo pretendonte se i pandehuri, duke shfrytëzuar moshën e saj të re (ajo ishte 14 vjeç në kohën e ngjarjes), e kishte bindur në vitin 1998 që të shkonte në Londër, dhe me të mbërritur atje, e kishte bindur që të ushtronte prostitucion, si dhe kishte ushtruar dhunë ndaj saj në mënyrë të përsëritur.¹³⁹ Duke u bazuar kryesisht mbi këtë deklaratë të viktimës lëshuar policisë, gjykata e shkallës së parë e deklaroi të pandehurin fajtor për “shfrytëzim prostitucioni” dhe e dënoi me tri vjet burgim. Për të përcaktuar dënimin, gjykata mori në konsideratë rrezikshmërinë e veprës, si dhe atë të të pandehurit, i cili, duke e mashtruar viktimën me anë të propozimit për martesë, e kishte shtyrë që të ushtronte prostitucion. Në lidhje me dënimin, gjykata deklaroi se kërkesa përfundimtare e prokurorit ishte “e drejtë”, pasi pasqyronte rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit. Nuk jepej asnjë argument tjetër për sa i përket rëndësisë së rrethanave rënduese dhe vlerësimit të rrethanave që mund të justifikonin dhënien e një dënimi relativisht të lehtë.

Më 11 korrik 2005, i pandehuri apeloj kundër dënimit dhe kërkoi një ulje të dënimit prej tri vjetësh burgim duke argumentuar se ai ishte i martuar me viktimën, se ata të dy prisnin një fëmijë dhe se ai ishte penduar.

Më 23 shtator 2006, Gjykata e Apelit Vlorë vendosi në favor të apellesit duke e shkurtuar dënimin nga tri në dy vjet.

¹³⁷ KP, neni 114/a, pika 5.

¹³⁸ KP, neni 114 parashikon që “shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”.

¹³⁹ Prova të tjera në favor të akuzës përfshinin dhe një deklaratë të nënës si viktimës, siç raportohet në procesverbalin e gjyqit.

Vendimi i gjykatës së apelit mund të kritikohet në disa aspekte.

Së pari, duket se, në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë gaboi duke e cilësuar faktin si “shfrytëzim të prostitucionit” dhe jo “shfrytëzim të prostitucionit në rrethana rënduese”, që mbart një dënim më të ashpër. Siç pohohet nga trupi gjykues dhe pasqyrohet në vendimin e gjykatës, shfrytëzimi i përsëritur kishte ndodhur ndaj një viktime që ishte e mitur në kohën e krimit, dhe që ishte mashtruar nga abuzuesi i saj. Përkundrajt këtij sfondi, duket se gjykata mund ta kishte dënuar të pandehurin për shfrytëzim prostitucioni duke marrë në konsideratë rrethanat rënduese të mësipërme, dhe ta dënonte atë me një periudhë burgimi më të ashpër se ai i dhënë (dënimi për shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese luhetat nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim).¹⁴⁰ Edhe pse parimi *reformatio in pejus* e pengonte gjykatën e apelit që të jepte një dënim më të ashpër pas ankimit të të pandehurit, kjo e fundit të paktën mund ta kishte konfirmuar dënimin (tri vjet burgim) e dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Në të njëjtën kohë, mund të kishte evidentuar gabimin e shkallës së parë në cilësimin e veprës dhe dënimin rezultues. Më përgjithësisht, mund të kishte udhëzuar gjykatat më të ulëta që të ushtrojnë detyrimin e tyre për të marrë në shqyrtim dhe për të ekuilibruar drejt të gjithë faktorët në një çështje, jo vetëm faktorët rëndues që ndikojnë në marrjen e vendimeve mbi dënimin, dhe që të arsyetojnë në mënyrë korrekte dhe të plotë vendimet e tyre lidhur me këtë aspekt.

Së dyti, vendimi i gjykatës së apelit për të ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Vlorë për sa i përket dënimit duket i arsyetuar keq, në mos krejtësisht i pakuptueshëm. Duke shkurtuar kohën e burgimit nga tri në dy vjet, vendimi ul edhe më tepër atë dënim që duket të jetë tepër i lehtë. Në vendimin e gjykatës së apelit lexohet:

[...] mënyra e kryerjes së veprës penale, raportet e krijuara, fakti që vepra është kryer, e inicuar dhe nga vullneti i të dëmtuarës, reagimi i saj, pas një periudhe relativisht të gjatë dhe në kohën kur kanë qenë bashkëshortë dhe ndikimi që duhet të ketë dënimi si mjet edukimi në krijimin rishitaz të marrëdhënieve familjare, çmohet të jepet një masë e tillë dënimi, me efekt edukativ, nisur dhe nga qëndrimi pendues, në seancë gjyqësore, e rrethana të tjera. [pjesa me shkrimin korsiv është theksuar qëllimisht nga autori]

Gjykata nuk jepte shpjegime mbi faktorët lehtësues, për të sqaruar se si këta ndikonin në dënimin e dhënë. Megjithëse gjykatat e apelit nuk kanë për detyrë të japin arsye po aq të hollësishme sa gjykatat e shkallës së parë, dhe megjithëse ato mund t’u referohen, deri në një farë shkalle, arsyeve të dhëna nga gjykatat e shkallës së parë në vendimet e tyre, arsyetimi i gjykatës së

¹⁴⁰ KP, neni 114/a, pikat 1, 4 dhe 6.

apelit në këtë çështje duket problematik. Megjithëse “pendimi i thellë” nga ana e autorit të një krimi mund të përbëjë një faktor lehtësues,¹⁴¹ gjykata nuk dha asnjë tregues se kjo pendesë ishte vërtet e pranishme në rastin në fjalë. Në fakt, pendimi i shfaqur vetëm gjatë seancës gjyqësore mund të konsiderohet i pasinqertë.¹⁴² Gjithashtu, ndërsa referimi për “mënyrën në të cilën është kryer vepra penale dhe marrëdhëniet që janë krijuar” është tepër i përgjithshëm, referimi për dënimin si një “mjet edukimi” për të ripërtërirë marrëdhëniet familjare nuk pasqyron asnjë parim ligjor dhe duhet hedhur poshtë. Megjithëse, me ligj, gjykatat kanë në dorë të marrin në konsideratë rrethana lehtësuese dhe rënduese në përcaktimin e dënimit, gjykata në këtë rast mori në konsideratë rrethana që dukeshin të ishin pa peshë. Vlen të përmendet gjithashtu që, në pjesën hyrëse të vendimit, gjykata e apelit gaboi duke thënë se si i pandehuri, ashtu edhe viktimja kishin përfituar nga ushtrimi i saj i prostitucionit. Kjo është mjaft e habitshme, pasi kundërshton faktet e pohuara nga Gjykata e Rrethit Vlorë; dhe për më tepër gjykata e apelit nuk adresoi asnjë gabim që ishte bërë nga gjykata e rrethit në vendimin e kësaj të fundit, dhe as nuk mori në shqyrtim prova të reja.

V. PËRFUNDIME DHE PERSPEKTIVA

Me gjithë pushtetin e tyre të gjerë që u fal ligji për të rishqyrtuar imtësisht çështjet që kanë në dorë, gjykatat e apelit shpesh abdikojnë nga detyra e tyre për të ndërmarrë një shqyrtim gjithëpërfshirës të çështjeve që u janë paraqitur, dhe në praktikë nuk hetojnë, ose nuk zhvillojnë më tej, provat të cilat kanë autoritetin t’i shqyrtojnë.

Siç shpjegohet në analizën e çështjeve të mësipërme, një nga mangësitë më domethënëse është mosarsyetimi i vendimeve në mënyrë korrekte dhe të plotë nga ana e gjykatave të apelit. Kjo përbën një shkelje serioze të së drejtës për një gjykim të drejtë. Në disa çështje, Prezenca në Shqipëri e OSBE-së ka vërejtur se gjykatat e apelit nuk kanë evidentuar dhe korrigjuar vendimet e gjykatës së shkallës së parë kur arsyetimi është dukur hapur si i palogjikshëm dhe kontradiktor. Në raste të tjera, gjykatat e apelit nuk kanë adresuar argumentet e paraqitura nga apeluesi, ose kanë dhënë interpretime të gabuara të së drejtës materiale dhe procedurale.

¹⁴¹ KP, neni 48 germa (ç). Sipas Komentarit të Kodit Penal (Pjesa e përgjithshme), pendimi i thellë nga ana e të pandehurit shprehet në pranimin e plotë të akuzës, në shpjegimin e saktë të rrethanave të kryerjes së veprës penale, në tregimin e bashkëpunëtorëve të mundshëm, në sqarimin e motiveve të veprës. Shih Ismet Elezi, Skënder Kaçupi, dhe Maksim Haxhia, *Komentari i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë (Pjesa e përgjithshme)* (Tiranë, GEER, 2006), faqe 238.

¹⁴² Po aty.

Ka të ngjarë që një kombinim i disa faktorëve të mundshëm, përfshirë standarde të ulëta profesionalizmi, aftësi të pamjaftueshme për argumentim ligjor, ndonjëherë njohuri e papërshtatshme e dispozitave materiale dhe procedurale, si dhe një shpërfillje e përgjithshme e parimit themelor të prezumimit të pafajësisë, kontribuojnë në arsyetimin e dobët ligjor të vendimeve gjyqësore. Megjithëse ndonjëherë kjo vërehet në vendimet e shkallës së parë, është edhe më e habitshme kur shtrihet edhe te vendimet e apelit, duke pasur parasysh rolin orientues që këto gjykata duhet të luajnë në një sistem drejtësie modern dhe të drejtë.

Megjithëse nuk duhen konsideruar si një “ilaç çudibërës”, arsimimi i përshtatshëm dhe trajnimi profesional mund të kontribuojnë për të zgjidhur disa nga çështjet dhe faktorët e përmendur më lart. Që nga korriku 2005, të gjithë gjyqtarëve në detyrë u është kërkuar që të marrin pjesë në programin e formimit të vazhduar profesional mbi edukimin ligjor (FVP) të ofruar nga Shkolla e Magjistraturës, për një maksimum prej njëzet ditësh në vit. Megjithëse deri së fundmi vetëm tri seanca trajnimi u janë kushtuar temës së arsyetimit dhe shkrimit ligjor, kjo lëndë, që në tetor 2006, është përfshirë në të gjitha trajnimet e ofruara nga Shkolla e Magjistraturës nën programin FVP, dhe është mësuar për rreth një orë e gjysmë në çdo modul trajnimi.¹⁴³ Tema “arsyetimi dhe shkrimi ligjor” është gjithashtu pjesë e programit profesional fillestar mësimor të Shkollës së Magjistraturës, sipas të cilit studentët e vitit të parë duhet të zhvillojnë 32 orë mbi këtë temë. Studentët e vitit të dytë që u nënshtrihen programit të praktikës para-profesionale zhvillojnë trajnime praktike dhe në terren se si të arsyetojnë dhe artikulojnë ligjërisht vendimet gjyqësore.¹⁴⁴

Megjithëse trajnimi FVP gëzon pjesëmarrje të kënaqshme, gjyqtarët e apelit marrin pjesë rrallë. Edhe pse pjesëmarrja në FVP në praktikë është fakultative,¹⁴⁵ ajo regjistrohet në dosjen personale të secilit gjyqtar dhe merret në konsideratë për ngritje në detyrë dhe emërimet të ardhshme.¹⁴⁶ Gjithashtu, kjo zë një kategori më vete në sistemin e ri të vlerësimit që po implementohet në gjykatat pilot.¹⁴⁷

¹⁴³ Trajnimi bazohet në leksione teorike, studime rasti dhe diskutime në klasë. Intervistë me Arjana Fullanin dhe Arta Mandron (janar 2007).

¹⁴⁴ Programi mësimor i trajnimit të vazhduar, i Shkollës së Magjistraturës 2006-2007, i disponueshëm në <http://www.magjistratura.edu.al> (vizituar për herë të fundit më 19 nëntor 2007).

¹⁴⁵ Ndryshime të fundit në ligj e bëjnë vazhdimin e edukimit ligjor të detyrueshëm për gjykatësit, por asnjë sanksion nuk është vendosur për ata që nuk e kanë bërë. Shih ligji nr. 8136, datë 31 korrik 1996, “Për shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, nenet 2, 23.

¹⁴⁶ Prezenca në Shqipëri e OSBE-së, *Analizë e sistemit ligjor në Shqipëri* (Tiranë, OSBE, 2004), faqe 257.

¹⁴⁷ ABA/CEELI, *Judicial Reform Index for Albania* [Indeks i reformës gjyqësore për Shqipërinë], vëllimi III (Washington, DC, American Bar Association [Organizata e juristëve amerikanë], 2006), faqe 17 (i referohet “Sistemit të vlerësimit të profesionalizmit dhe etikës së gjyqtarëve”, kapitulli 12).

VI. REKOMANDIME

- Gjyqtarët e apelit duhet të arsyetojnë plotësisht vendimet e tyre në përputhje me të drejtën vendëse dhe atë ndërkombëtare. Kjo do të thotë që :
 - gjykatat e apelit duhet t'i përmbahen detyrës së tyre për të shqyrtuar sistematikisht *çdo shkak ankimi të ngritur nga palët* në kërkesat e tyre. Vendimet e gjykatave të apelit duhet të përmendin dhe t'i japin zgjidhje çdo shkak të paraqitur në ankim, qoftë edhe përmbledhtazi. Nëse një trup gjykues në apel refuzon shkaqet e ankimit, duhet të shpjegojë arsyet pse e bëri këtë;
 - nëse gjykatat e apelit japin arsye të pakta për vendimet e tyre (për shembull, kur konfirmojnë një vendim të gjykatës më të ulët, ato përfshijnë arsyet e paraqitura nga gjykata më e ulët), ato gjithsesi duhet të *adresojnë të gjitha çështjet thelbësore* që u janë paraqitur për gjykim jo *vetëm* duke konfirmuar përfundimet e nxjerra nga një gjykate më të ulët;
 - vendimet gjyqësore – si të gjykatave të shkallës së parë ashtu edhe të gjykatave të apelit – duhet të përfshijnë një *përshkrim të rrethanave faktike dhe provave mbi të cilat bazohen vendimet, si dhe arsyet pse gjykata nuk ka pranuar provat e kundërta*. Ato duhet të përfshijnë gjithashtu pretendimet e palëve dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre;
 - nëse vendimet e gjykatës së apelit prishin, ose ndryshojnë, vendimet e lëshuara nga një gjykatë më e ulët, ato duhet të japin arsye të shëndosha dhe të qarta për këtë veprim. Më konkretisht, gjykatat e apelit duhet të shpjegojnë qartësisht:
 - çfarë faktorësh i shtynë të bënin një peshim/vlerësim të fakteve dhe provave të ndryshëm nga ai i bërë prej gjykatave më të ulta;
 - rezultatet e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor (në rastet kur është bërë); dhe
 - arsyet për mospranimin e pretendimeve/argumenteve të palëve;
 - gjykatat e apelit duhet të japin *arsyet për të cilat vendosin të mos thërrasin ata dëshmitarë* që janë kërkuar shprehimisht për t'u marrë në pyetje;

- gjykatat e apelit duket të kryejnë një “rishqyrtim tërësor” të çështjes që u është paraqitur duke trajtuar çështje që shkojnë përtej shkaqeve të ankimit, kur kjo gjykohet e nevojshme;
- nëse faktet nuk duken të jenë vërtetuar drejt apo plotësisht, gjykatat e apelit duhet të ushtrojnë autoritetin e tyre për të urdhëruar përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor (pjesërisht ose tërësisht), ose të sigurojnë prova të reja, qoftë edhe kryesisht;
- rekomandohet që gjykatat e apelit të *justifikojnë drejt vendimet për dënimet* (lloji i masës së dënimit) duke dhënë *arsyetim të përshtatshëm dhe të individualizuar që tregon se si u është dhënë rëndësi rrethanave lehtësuese dhe rënduese*. Në vendimet e tyre, gjykatat e apelit duhet të udhëzojnë vazhdimisht gjykatat më të ulëta që këto të fundit të veprojnë në të njëjtën mënyrë. Gjithashtu, rekomandohet që në marrjen e vendimeve për dënim gjykatat e apelit:
 - të marrin në konsideratë rrezikshmërinë e veprës penale, të personit që e ka kryer, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese;
 - të konsiderojnë siç duhet format alternative të dënimit, përfshirë edhe masat që nuk kërkojnë mbajtjen në burg. Dënimi me burgim duhet të përfaqësojë masën e fundit, aty ku masa të tjera duken të papërshtatshme në rastin konkret; dhe
 - të japin një arsyetim të plotë kur vendosin për një dënim të lehtësuar, përfshirë përmendjen e rrethanave specifike që e bëjnë dënimin më të lehtë të përshtatshëm në rastin konkret.
- Me qëllimin për të asistuar gjyqtarët në përmirësimin e aftësive të tyre mbi arsyetimin ligjor, Shkolla e Magjistraturës rekomandohet të ofrojë trajnime shtesë mbi shkrimin dhe arsyetimin ligjor, si në kuadrin e programit të FVP-së, ashtu edhe në atë të programit profesional fillestar. Nisur nga kufizimet financiare me të cilat përballlet Shkolla, i duhet kushtuar rëndësia e duhur rritjes së asistencës nga ana e donatorëve ndërkombëtarë dhe qeverisë në këtë fushë. Trajnimi mund:
 - të projektohet në një mënyrë të tillë që të trajtojë mangësitë e evidentuara në këtë raport, dhe nuk duhet të jetë i izoluar, por i ndërthurur me trajnime dhe leksione mbi shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimin e provave, si dhe me parimet e përgjithshme të drejtësisë;

- të ketë në thelb praktikën dhe të zhvillohet duke përdorur studime rasti që përfaqësojnë “praktikat më të mira dhe më të këqija”; dhe aq sa është e mundur, këto shembuj duhen marrë nga çështje të vërteta.
- Do të ishte mirë që ligji të ndryshohej për ta bërë pjesëmarrjen në kurset e FVP-së të detyrueshme për të gjithë gjyqtarët në detyrë.
- Gjithashtu rekomandohet që, në vlerësimin e aftësisë dhe formimit profesional të gjyqtarëve të gjykatave të apelit, inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të evidentojnë qartësisht në raportet e tyre mangësitë dhe problemet në lidhje me cilësinë e punës së këtyre gjyqtarëve në kontekstin e procedimeve të apelit.¹⁴⁸

¹⁴⁸ Ligji nr. 8436, datë 28 dhjetor 1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 45; shih gjithashtu ligjin nr. 8811, datë 17 maj 2001, “Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë”, neni 16, pika 1 (b).

KAPITULLI 2

APELI I VENDIMEVE PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT TË ARRESTIT NË BURG

I. HYRJE

Nëse dikush është në pritje të një gjykimi për akuza penale ai nuk duhet, si rregull i përgjithshëm, të mbahet në arrest në burg. Kjo është në përputhje me parimin e lartë të prezumimit të pafajësisë¹⁴⁹ dhe me të drejtën për liri¹⁵⁰ siç shprehet edhe në konventat ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë.

Sipas së drejtës ndërkombëtare dhe asaj shqiptare, të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, përfshirë ato vendime që janë marrë në apel, duhet të jenë të bazuara në mënyrë korrekte dhe të arsyetuara në mënyrë të mjaftueshme dhe të qartë. Kur gjykatat e apelit gjykojnë vendimet e ankimuarat të caktimit të masës së sigurisë së arrestit në burg, ato kanë detyrimin të marrin në shqyrtim në mënyrë të mirëfilltë, në tërësi dhe me korrektësi ekzistencën e fakteve dhe shkaqeve konkrete që përligjin caktimin e masës “arrest në burg”, si dhe të prishin ato vendime të cilat nuk janë plotësisht të arsyetuara dhe të bazuara mjaftueshëm në kuadrin ligjor. Është detyrë e gjykatave të apelit që vazhdimisht të udhëzojnë gjykatat më të ulëta që të përfshijnë në vendimet e tyre për caktimin e masës së arrestit në burg një arsyetim të hollësishëm dhe të individualizuar që merr parasysh ekzistencën e provave të mirëfillta për të urdhëruar një masë të tillë si dhe përpjesëtueshmërinë e masës së sigurimit “arrest në burg” në rastin konkret.

Ky kapitull trajton çështje të lidhura me nevojën për arsye të përshtatshme dhe për baza të mjaftueshme ligjore mbi zbatimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, duke u përqendruar në detyrimin e gjykatës së apelit për të kryer rolin e saj udhëzues në këtë kontekst dhe për të ndryshuar vendimet e shkallës së parë aty ku ato kanë mangësi në këtë aspekt. Siç është vëzhguar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, shpesh gjykatat nuk i arsyetojnë në mënyrë korrekte dhe të plotë vendimet e tyre mbi caktimin e masës së arrestit në burg. Në praktikë, ato nuk shprehin se cilat janë faktet e posaçme që justifikojnë arrestin në burg përkundrejt lirimit në pritje të gjykimit dhe nuk tregojnë që kjo masë është vetëm zgjedhja e fundit. Në disa raste, gjykatat madje nuk marrin parasysh argumentet e paraqitura nga mbrojtja

¹⁴⁹ KEDNj, neni 6, pika 2; PNDP, neni 14, pika 2.

¹⁵⁰ KEDNj, neni 5, pika 1; PNDP, neni 9, pika 1.

ose nuk e provojnë bindshëm ekzistencën e “dyshimit të arsyeshëm”.¹⁵¹ Atëherë kur gjykatat e apelit thjesht konfirmojnë dhe vulosin pa i shqyrtuar vendimet për arrest në burg, të cilat janë të arsyetuara në mënyrë të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme, në vend që t’i ndreqin këto vendime, këto gjykata heqin dorë nga autoriteti i tyre rishikues. Me anë të këtyre praktikave, gjykatat e apelit kontribuojnë në përjetësimin e vendimeve që nuk arsyetohen mjaftueshëm, në kundërshti me të drejtën ndërkombëtare dhe vendëse, dhe në shkelje të standardeve për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

Ky kapitull hapet me një prezantim të kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe vendës mbi paraburgimin, duke u përqendruar veçanërisht në nevojën për një arsyetim korrekt dhe të përshtatshëm të këtyre vendimeve, dhe të llojit të autoritetit shqyrtues që ushtrohet nga gjykatat e apelit në këtë kontekst. Më tej, ky kapitull merr në shqyrtim praktikën e Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit në këtë fushë, duke nxjerrë në pah mangësi serioze në llojin e arsyetimit ligjor dhe të justifikimit të bërë në rastet konkrete të analizuara. Analiza bazohet në një shqyrtim të hollësishëm të të dhjetë vendimeve për caktimin e masës së arrestit në burg të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Tiranë, të ankimeve ndaj këtyre vendimeve dhe të vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë.¹⁵² Si përfundim, ky kapitull paraqet disa vërejtje përmbyllëse dhe një komplet rekomandimesh praktike dhe të plota që kanë për qëllim trajtimin e problemeve të identifikuara.

II. E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE SHQIPTARE MBI CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT TË ARRESTIT NË BURG

A. Prova të pranueshme për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg

Nëse dikush është në pritje të gjykimit për akuza penale ai nuk duhet, si rregull i përgjithshëm, të mbahet në arrest në burg. Sipas standardeve ndërkombëtare për një gjykim të drejtë, ekziston një supozim në favor të lirit të të pandehurit deri në zhvillimin e gjyqit. Kjo është në përputhje me parimin e lartë të prezumimit të pafajësisë¹⁵³ dhe me të drejtën për liri.¹⁵⁴ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) kërkon që heqja e lirisë të zbatohet bazuar dhe në përputhje

¹⁵¹ Për shembull, Gjykata e Apelit Shkodër ka vërejtur me shqetësim se, në kontekstin e masës së sigurimit “arrest në burg”, vazhdojnë të ekzistojnë raste kur gjykatat e shkallës së parë nuk arrijnë të provojnë mjaftueshëm, me fakte dhe prova ekzistencën e “dyshimit të arsyeshëm”, pra që personi i përfshirë ka kryer një krim. Shih “Vështrim i përgjithshëm mbi veprimtarinë e Gjykatës së Apelit Shkodër për 2006”, faqe 11.

¹⁵² Për një diskutim mbi metodologjinë e ndjekur për të analizuar rastet, shih më poshtë “III. Justifikimi i Vendimeve për Arrest në Burg: Gjetjet”, faqe 48, veçanërisht shënimin 57.

¹⁵³ KEDNj, neni 6, pika 2; PNDCP, neni 14, pika 2.

¹⁵⁴ KEDNj, neni 5, pika 1; PNDCP, neni 9, pika 1.

me procedurat e përcaktuara nga ligji vendës (parimi i ligjshmërisë).¹⁵⁵ Në mënyrë të ngjashme, sipas nenit 5 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) një personi mund t'i hiqet liria vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe në përputhje me ligjin, dhe vetëm për qëllimet e renditura në ligj. Këto rrethana të jashtëzakonshme përfshijnë arrestimin ose ndalimin e ligjshëm të një personi me qëllim për ta sjellë atë përpara autoritetit ligjor kompetent mbështetur në dyshimin e arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, ose kur në mënyrë të argumentuar mendohet e domosdoshme për ta parandaluar që të kryejë një krim tjetër ose të largohet.¹⁵⁶ Siç është theksuar edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), një person i akuzuar për një krim duhet të jetë i lirë në pritje të gjykimit përveçse në ato raste kur shteti mund të tregojë që ekzistojnë arsye "të forta dhe të mjaftueshme" që justifikojnë vazhdimin e mbajtjes së personit në burg.¹⁵⁷ Përveç ekzistencës së "dyshimit të arsyeshëm",¹⁵⁸ Gjykata ka evidentuar katër arsye të tjera të rëndësishme që lejojnë mbajtjen e një personi në paraburgim. Këto arsye janë: rreziku që personi të largohet, rreziku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë, domosdoshmëria për të parandaluar një krim tjetër, dhe domosdoshmëria për të ruajtur rendin publik. Kështu, kufizimet ndaj të drejtës për liri në pritje të gjykimit duhet të shihen si të jashtëzakonshme dhe duhen lejuar vetëm kur vendimi i gjykatës jep një justifikim bindës.

Neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë rithekson parimin e ligjshmërisë dhe më tej deklaron se heqja e lirisë mund të justifikohet, mes të tjerash, vetëm kur

¹⁵⁵ PNDPCP, neni 9, pika 1 thotë: "Çdo njeri ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit të tij. Askush nuk mund t'i nënshtrohet arrestit apo burgimit arbitrar. Askujt nuk mund t'i hiqet liria përveçse në ato raste kur ka baza dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji". Më tej deklaron:

Kushdo që arrestohet ose ndalohet për shkak të një akuze penale duhet të paraqitet sa më shpejt përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar nga ligji me funksione gjyqësore dhe duhet të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose duhet të lirohet. Ndalimi i personave që presin të gjykohen nuk duhet të jetë rregull, por lirimi mund të kushtëzohet me garanci të mjaftueshme për të siguruar daljen e të interesuarit para gjyqit, praninë e tij në të gjitha aktet e procedurës, kur është rasti, edhe për ekzekutimin e gjykimit.

Çdo njeri që privohet nga liria e tij me masa arrestimi ose ndalimi ka të drejtën e rekursit në një gjykatë me qëllim që kjo të vendosë pa vonesë lidhur me ligjshmërinë e masës së ndalimit dhe të urdhërojë lirimin e tij në qoftë se ndalimi është i paligjshëm. Çdo njeri që është viktimë e një arrestimi a ndalimi të paligjshëm ka të drejtën e dëmshpërblimit.

Shih po aty, neni 9, pikat 3-5.

¹⁵⁶ KEDNj, neni 5, pika 1 (c).

¹⁵⁷ Çështja "Wemhoff kundër Gjermanisë", GjEDNj, 27 qershor 1968, paragrafi 12. Shih gjithashtu çështjen "Jablonsky kundër Polonisë", GjEDNj, 21 dhjetor 2000, paragrafi 80.

¹⁵⁸ Për të provuar ekzistencën e "dyshimit të arsyeshëm", duhet të ketë prova për veprimet që implikojnë drejtpërdrejtë personin ose prova shkresore ose akte ekspertimi që e vërtetojnë këtë gjë. Shih Monica Macovei, *E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit – Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Manuallet e të drejtave të njeriut, nr. 5* (Strasbourg, Këshilli i Evropës, 2002), faqe 26.

Thjesht fakti që një person ka kryer një krim – qoftë edhe të ngjashëm – në të kaluarën nuk përbën një bazë të mjaftueshme për dyshim të arsyeshëm. Çështja "Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar", GjEDNj, 30 gusht 1990.

ekziston “dyshimi i arsyeshëm” që një person ka kryer një vepër penale.¹⁵⁹ Sipas KPrP-së, kërkesat për arrest në burg dhe provat në të cilat këto bazohen i dorëzohen gjykatës kompetente nga prokurori.¹⁶⁰ Ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm duhet mbështetur në prova dhe jo thjesht në hamendësimet apo bindjet e një gjyqtari.¹⁶¹ Megjithëse ekzistenca e një “dyshimi të arsyeshëm të mbështetur në prova” se një person ka kryer një vepër penale është gjithmonë një element i domosdoshëm për mbajtjen në burg, nuk është e mjaftueshme, në vetvete, për të justifikuar arrestin në burg, madje edhe kur një person është kapur në flagrancë.¹⁶²

Kështu, arresti në burg, sipas KPrP-së, mund të vendoset mbështetur në kombinimin e kushteve të mëposhtme:

- së pari, kur ka “një dyshim të arsyeshëm të mbështetur në prova”¹⁶³ se një person ka kryer një vepër penale [kriteri i dyshimit të arsyeshëm];
- së dyti, kur (a) ekzistojnë arsye të forta që rrezikojnë sigurimin e provave ose vërtetësinë e këtyre provave; ose (b) i pandehuri i është fshehur drejtësisë ose ekziston dyshimi se mund të largohet; ose (c) për shkak të rrethanave të krimit ose të personalitetit të të pandehurit ekziston rreziku që ai mund të kryejë krime të rënda ose të tjera vepra të ngjashme penale [kriteri i veçantë].¹⁶⁴

Gjithashtu, sipas së drejtës shqiptare, një vendim për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” mund të lëshohet nga gjykata vetëm si *zgjedhja e fundit*, atëherë

¹⁵⁹ Neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta) thotë:

1. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.
2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:
 - a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
 - b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;
 - c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
 - ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;
 - d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
 - dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.
3. Askujt nuk mund t’i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor [pjesa me shkrimin korsiv është theksuar qëllimisht nga autori].

¹⁶⁰ KPrP, neni 244, pika 1.

¹⁶¹ Komentari i KPrP-së, faqe 319.

¹⁶² Kjo do të ishte një shkelje e prezumimit të pafajësisë. KEDNj, neni 6 (2). Shih Nuala Mole dhe Chatarina Harby, *E drejta për një proces të drejtë gjyqësor – Një udhëzues për zbatimin e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Manuallet e të drejtave të njeriut, nr. 3* (Strasburg, Këshilli i Evropës, 2002), faqe 26.

¹⁶³ KPrP, neni 228, pika 1.

¹⁶⁴ KPrP, neni 228, pika 3. Kushtetuta, neni 27.

kur çdo masë tjetër më pak shtrënguese është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veprës dhe të pandehurit.¹⁶⁵ Këto masa alternative parashikohen nga KPrP-ja për të minimizuar përdorimin e masës së arrestit në burg dhe përfshijnë, për shembull, arrestin në shtëpi, moslejimin për t'u larguar nga vendi apo për të banuar në një vend të caktuar, ose detyrimin për t'u paraqitur në polici.¹⁶⁶ Dispozita që cakton arrestin në burg si masë të fundit duhet të lexohet në ndërthurje me nenin 229 të KPrP-së, i cili mjaft qartë vendos parimin e përpjesëtueshmërisë në përcaktimin e masës më të përshtatshme të sigurimit. Kështu, në lëshimin e vendimeve, gjykata duhet të marrë parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurisë të përligjura nga rasti konkret. Çdo masë duhet të jetë në raport me "rëndësinë e veprës penale dhe sanksionit të parashikuar për këtë veprë". Në bërjen e këtij përcaktimi, gjykata duhet të marrë në konsideratë vazhdimësinë, përsëritjen dhe faktorët e tjerë rëndues ose lehtësues.¹⁶⁷ Këta faktorë duhen provuar në çdo rast, si dhe duhen paraqitur arsyet pse masa e sigurisë duket më e përshtatshme në rrethanat përkatëse.¹⁶⁸ Për shembull, kur gjykata e gjen të papërshtatshëm masën e arrestit në shtëpi për një rast konkret (dhe si rrjedhojë e sheh si domosdoshmëri arrestin në burg), gjykata duhet t'u referohet elementeve të veçanta të lidhura me faktet, si dhe motiveve dhe personalitetit të individit, për të treguar se, për shembull, ai shfaq një prirje për t'u larguar nga banesa apo për të kryer vepra të tjera penale.¹⁶⁹

Në përmbledhje, përpara se të urdhërojë arrestin në burg në një rast konkret, gjyqtari duhet të ndërmarrë dy hapa. Ai duhet:

- (a) të verifikojë ekzistencën e "dyshimit të arsyeshëm" (mbështetur nga prova) që i akuzuari ka kryer vërtet një veprë penale, dhe që ekziston një *rrezik konkret dhe specifik* arratisjeje, dhe/ose ndërhyrjeje në procesin e drejtësisë, dhe/ose kryerje të veprave të tjera penale;
- (b) të vendosë nëse arresti në burg është vërtet (duke pasur parasysh rrethanat specifike të krimit dhe personalitetin e autorit) masa e fundit dhe se merret në përpjesëtueshmëri me rastin konkret. Nga ana tjetër, kjo kërkon kryerjen e një vlerësimi, nëse në një rast konkret mundet të zbatohen masa më pak shtrënguese.

¹⁶⁵ KPrP, neni 230, pika 1.

¹⁶⁶ Sipas KPrP-së, urdhrat shtrëngues të ndalimit janë: ndalim i daljes jashtë shtetit, detyrim për t'u paraqitur përpara policisë gjyqësore, ndalim ose detyrim për të qëndruar në një vend të caktuar, garanci pasurore (për shembull dorëzani); arrest në shtëpi; arrest në burg, dhe shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik. Shih KPrP neni 232.

¹⁶⁷ KPrP, neni 229. Komentari gjithashtu thotë se çështjet e sigurisë kryesisht kanë lidhje me karakterin e të pandehurit, shkallën e rrezikut që ai paraqet, rrezikun e krimeve të tjera. Komentari i KPrP-së, faqe 326.

¹⁶⁸ Po aty.

¹⁶⁹ Shih Gjykata Italiane e Kasacionit, seksioni II, 21 tetor 1997 – 21 nëntor 1997, nr. 5699, CED 209281.

Secili prej faktorëve dhe kriterëve të lartpërmendura duhet të ekzistojë e të jetë objektivisht i verifikueshëm, si dhe duhet të mbështesë heqjen e lirisë dhe të deklarohet nga gjykata në çdo rast.

Kur në seancën e vleftësimit, arresti apo ndalimi vlerësohet si i paligjshëm, gjykata duhet ta lirojë menjëherë personin e arrestuar apo të ndaluar, dhe prokurori mund të apelojë vendimin në gjykatën e apelit ose drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë.¹⁷⁰

B. Arsyetimi dhe justifikimi i vendimeve për arrest në burg

Standardet ndërkombëtare dhe jurisprudenca kërkojnë nga gjykatat që të japin arsye për vendimet dhe gjykimet e tyre.¹⁷¹ Një vendim i arsyetuar u tregon palëve që zëri i tyre është dëgjuar dhe lejon këqyrje publike të administrimit të drejtësisë.¹⁷² Në kontekstin e paraburgimit, gjykata është e detyruar të respektojë prezumimin e pafajësisë dhe duhet të regjistrojë argumentet në favor dhe kundër lirimit në një vendim të arsyetuar.¹⁷³ Kryesisht, mbi bazën e arsyeve të dhëna në këto vendime dhe të fakteve të vërteta të përmendura në ankim nga apeluasi, gjykata duhet të vendosë nëse është shkelur ose jo neni 5 (3) i KEDNj-së (d.m.th., nëse arresti në burg është i paligjshëm).¹⁷⁴ Gjithashtu, vetëm duke pasur një vendim të arsyetuar, i akuzuari mund të ushtrojë me efikasitet të drejtën e tij për të pasur një vleftësim të shpejtë të ligjshmërisë së arrestit nga një gjykatë më e lartë.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) në jurisprudencën e saj ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme mjaftueshmërinë e një justifikimi dhe arsyetimi të përshtatshëm për sa i përket paraburgimit. GjEDNj-ja në një sërë rastesh ka deklaruar se arsyetimi i gjykatave vendëse do të konsiderohet gjithmonë i papërshtatshëm nëse është “abstrakt” ose “i bazuar në stereotipe”.¹⁷⁵ Për shembull, në çështjen *Yağcı dhe Sargin kundër Turqisë* Gjykata bëri të qartë që një vendim i bazuar në një formulim stereotip pa dhënë shpjegime se pse ekziston

¹⁷⁰ KPrP, neni 259, pika 4.

¹⁷¹ Shih çështjen “Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar”, GjEDNj, 18 shkurt 1999, para. 60, dhe çështjen “Smirnova kundër Ruisë”, GjEDNj, 24 tetor 2003, para 71. Vazhdimi i mbajtjes në burg duhet të jetë subjekt i shqyrtimit të shpejtë gjyqësor që duhet të marrë në konsideratë jo vetëm nëse ndalimi fillestar ishte i justifikuar, por edhe nëse është ende i përshtatshëm.

¹⁷² Çështja “Suominen kundër Finlandës”, GjEDNj, 1 korrik 2003, para. 34-37

¹⁷³ Çështja “Letellier kundër Francës”, GjEDNj, 26 qershor 1991, para. 35; Yağcı dhe Sargin kundër Turqisë, GjEDNj, 23 maj 1995, para. 50-52. Shih gjithashtu çështjen “Labita kundër Italisë”, GjEDNj, 6 prill 2000, para. 152.

¹⁷⁴ Shih çështjen “Labita kundër Italisë”, GjEDNj, 6 prill 2000, para. 152.

¹⁷⁵ Çështja “Clooth kundër Belgjikës”, GjEDNj, 12 dhjetor 1991, para. 44; çështja “Yağcı dhe Sargin kundër Turqisë”, GjEDNj, 23 maj 1995, para. 52.

rreziku për t'iu fshehur drejtësisë nuk do të konsiderohet kurrë i pranueshëm nga Gjykata.¹⁷⁶ Për sa i përket diskutimit të *rrezikut të largimit*, GjEDNj-ja gjithashtu ka deklaruar se ai nuk mund të matet vetëm në bazë të ashpërsisë së dënimit të mundshëm që personi rrezikon, por duhet të vlerësohet duke iu referuar disa faktorëve të tjerë të rëndësishëm, si veçanërisht, *karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe të gjitha lidhjet e tij me shtetin ku ai po ndiqet penalisht, si dhe lidhjet e tij ndërkombëtare*.¹⁷⁷ Raste të mëparshme kur personi është arratisur pasi është akuzuar për një vepër penale, ose prova specifike se ai ka në plan të arratiset, do të ishin gjithashtu të rëndësishme për të sugjeruar rrezikun e arratisjes.¹⁷⁸ Në çështjen *Českz kundër Republikës së Çekisë*, për shembull, Gjykata arriti në përfundimin se ekziston rreziku i arratisjes pasi apeluesi i kishte besuar një shumë të madhe parash një të njohuri, kishte blerë një makinë duke përdorur kartën e identitetit të një personi tjetër, dhe kishte siguruar një pasaportë të rreme.¹⁷⁹ Në *Letellier kundër Francës*, përkundrazi, gjykata gjeti se nuk ekzistonte rreziku i arratisjes pasi apeluesi ishte nënë e fëmijëve të mitur dhe puna si menaxhere e një biznesi ishte burimi i vetëm i saj i të ardhurave.¹⁸⁰ Gjykata e Strasburgut gjithashtu ka theksuar që *argumentet në favor dhe kundër lirimit nuk duhet të jenë "të përgjithshme dhe abstrakte"*.¹⁸¹ Gjykatat kanë për detyrë të shpjegojnë pse ekziston rreziku në raste konkrete, dhe, si në çështje të tjera, përdorimi i çdo formulimi stereotip në këtë kontekst do të konsiderohej i papranueshëm.¹⁸² Ashpërsia e dënimit të mundshëm, megjithëse është e rëndësishme, nuk përbën një provë më vete dhe nuk mund të justifikojë e vetme refuzimin për të qenë i lirë.¹⁸³ Si përfundim, fakti që i akuzuari ka mundësi të arratiset nuk e përlligj përfundimin që ai do të largohet nëse lirohet.¹⁸⁴

¹⁷⁶ Çështja "Yağcı dhe Sargin kundër Turqisë", GjEDNj, 23 maj 1995, para. 52.

¹⁷⁷ Çështja "Neumeister kundër Austrisë", GjEDNj, 27 qershor 1968, para. 10; çështja "Smirnova kundër Rusisë", GjEDNj, 24 korrik 2003, para. 60. Shih gjithashtu çështjen "Yağcı dhe Sargin kundër Turqisë", GjEDNj, 9 qershor 1995, para. 52; çështja "Letellier kundër Francës", GjEDNj, 26 qershor 1991, para. 43.

¹⁷⁸ Çështja "Matznetter kundër Austrisë", GjEDNj, 10 nëntor 1969.

¹⁷⁹ Çështja "Českz kundër Republikës së Çekisë", GjEDNj, 6 qershor 2000.

¹⁸⁰ Shih po aty.

Në një rast tjetër, apeluesi (i cili kishte patentë piloti) kishte fluturuar jashtë shtetit disa herë gjatë një periudhe lirimi dhe gjithmonë ishte kthyer. Shih çështjen "Stögmüller kundër Austrisë", GjEDNj, 10 nëntor 1969.

¹⁸¹ Shih po aty në para. 63, që citon çështjen "Clooth kundër Belgjikës", GjEDNj, 12 dhjetor 1991, para. 44.

¹⁸² Shih çështjen "Yağcı dhe Sargin kundër Turqisë", GjEDNj, 9 qershor 1995; shih gjithashtu çështjen "Tomasi kundër Francës", GjEDNj, 27 gusht 1992, para. 98.

Në çështjen "Letellier kundër Francës", për shembull, gjykata vendosi që rreziku i arratisjes nuk ekzistonte për një grua, nënë e fëmijëve të mitur dhe menaxhere e një biznesi, burimi i saj i vetëm i të ardhurave. Shih çështjen "Letellier kundër Francës", GjEDNj, 27 qershor 1968, para. 41.

¹⁸³ Çështja "Neumeister kundër Austrisë", GjEDNj, 27 qershor 1968, para.10; çështja "Letellier kundër Francës" (para. 43).

¹⁸⁴ Çështja "Stögmüller kundër Austrisë", GjEDNj, 10 nëntor 1969.

Për sa i përket *rrezikut për të ndërhyrë në procesin e drejtësisë*, lirimi mund të refuzohet aty ku ekziston një rrezik i bazuar se i akuzuari, nëse lihej i lirë, do të kryente veprime që do të ndikonin administrimin e drejtësisë (për shembull, duke lajmëruar të dyshuar të tjerë, duke asgjësuar dokumente, ose duke u përpjekur që të ndikojë mbi dëshmitarët).¹⁸⁵ GjEDNj-ja ka arritur në përfundimin se, megjithëse ky rrezik mund të jetë real në fillim të procesit, mund të venitet gradualisht ose mund të zhduket krejtësisht me kalimin e kohës.¹⁸⁶ Mundësia e këtij rreziku nuk mund të bazohet *in abstracto* – një rrezik i përgjithësuar është i pamjaftueshëm, dhe duhet të sigurohen prova mbështetëse.¹⁸⁷

Në lidhje me *rrezikun e veprave të tjera penale* si shkak për paraburgim, GjEDNj-ja ka theksuar se ky rrezik duhet të jetë real, dhe që masa duhet të jetë e përshtatshme në raport, mes të tjerash, me *të kaluarën dhe personalitetin e individit*. Një rast i tillë do të ishte, për shembull, kur personi është dënuar më parë për të njëjtën vepër ose për krime të ngjashme me atë për të cilën po hetohet.¹⁸⁸ Nga ana tjetër, paraburgimi nuk vlerësohet i përshtatshëm kur krimet nuk janë të krahasueshme as në natyrën e tyre e as në shkallën e rëndësisë me ato të kryera në të kaluarën.¹⁸⁹ Megjithatë, nuk mund të hamendësohet automatikisht se ekziston rreziku i krimeve të tjera thjesht nga fakti që i akuzuari ka precedentë penalë.¹⁹⁰

Në mënyrë të ngjashme, KPrP-ja kërkon që vendimet e gjykatave që caktojnë masën e sigurimit personal (masa shtrënguese dhe ndaluese), të tregojnë “shkaqe të posaçme dhe të dhëna që e përligjin” zbatimin e tyre.¹⁹¹ Për ta shtjelluar më tej këtë aspekt, Komentari i KPrP-së thotë se “është e rëndësishme që shkaqet të jenë ligjore” dhe të siguruara gjatë një seance vleftësimi për masën e sigurimit. Siç shpjegon edhe Komentari, nuk mjafton thjesht që të deklarohet se, nëse i pandehuri lirohet, ai mund të dëmtojë provat, të arratiset ose të kryejë krime të tjera. Këto pretendime nuk duhet të jenë “supozime të paargumentuara”, por “të dhëna bindëse”, ekzistenca e të cilave duhet verifikuar nga gjyqtari.¹⁹² Në të gjitha çështjet, ekzistenca e këtyre kushteve duhet argumentuar në aktin që përcakton masën personale të sigurimit. Me fjalë të tjera, dyshimi se i akuzuari është arratisur më parë apo se ekziston mundësia të arratiset duhet diskutuar, ose duhen paraqitur fakte që tregojnë se ai

¹⁸⁵ Çështja “Wemhoff kundër Gjermanisë”, GjEDNj, 27 qershor 1968, para. 14.

¹⁸⁶ Shih çështjen “Tomasi kundër Francës”, GjEDNj, 27 gusht 1992, para. 92-95.

¹⁸⁷ Çështja “Clooth kundër Belgjikës”, GjEDNj, 12 dhjetor 1991, para. 43.

¹⁸⁸ Po aty.

¹⁸⁹ Në çështjen “Cloth kundër Belgjikës”, një çështje për vrasje dhe zjarrvënien të qëllimshme, apeli ishte dënuar më parë për tentativë vjedhjeje me dhunë dhe braktisje. Shih çështjen “Clooth kundër Belgjikës”, GjEDNj, 12 dhjetor 1991.

¹⁹⁰ Çështja “Muller kundër Francës”, GjEDNj, 17 mars 1997, para. 44.

¹⁹¹ KPrP, neni 245, gërma c.

¹⁹² Komentari i KPrP-së, faqet 321-22.

mund të kryejë vepra të tjera penale të së njëjtës natyrë ose më të rënda.¹⁹³ Gjithashtu vendimet e marra që mbështesin dyshimin se i akuzuari mund të dëmtojë provat duhet të tregojnë kohëzgjatjen e masës së sigurimit.¹⁹⁴

C. Apeli i vendimeve për arrest në burg

Standardet ndërkombëtare i sigurojnë çdokujt që i është hequr liria të drejtën që gjykata të rishikojë brenda një kohe të arsyeshme ligshmërinë e mbajtjes së tij në burg.¹⁹⁵ Sipas së drejtës shqiptare, vendimet e arrestit në burg mund të ankimohen në një gjykatë më të lartë. Kjo e drejtë mund të ushtrohet nga i pandehuri ose avokati mbrojtës brenda dhjetë ditësh nga zbatimi ose njoftimi i vendimit për arrest në burg.¹⁹⁶ Ankimi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka lëshuar vendimin, e cila më pas duhet t'ia përcjellë çështjen gjykatës brenda pesë ditësh.¹⁹⁷ Ankimi më pas duhet dëgjuar brenda dhjetë ditësh nga marrja e dokumentacionit.¹⁹⁸ Në apel, gjykata merr në shqyrtim çështjen në tërësi, pavarësisht nga shkaqet e ankimit apo nga shkaqet e dhëna në pjesën e arsytimit të vendimit që ankimohet.¹⁹⁹ Kjo do të thotë se gjykata që ka marrë në shqyrtim ankimin duhet të vendosë nëse ekzistojnë ose jo të gjitha shkaqet dhe kriteret për zbatimin e masës së sigurimit, pavarësisht nëse këto janë paraqitur në ankim. Për këtë, gjykata duhet të mbështetet në prova ekzistuese ose të reja.²⁰⁰ Pas ankimit të të pandehurit, gjykata mund të prishë, ndryshojë ose të lërë në fuqi vendimin për caktimin e masës së arrestit në burg qoftë edhe duke dhënë shkaqe të ndryshme nga ato të paraqitura në pjesën arsyetuese të vendimit të ankimuar.²⁰¹ Kur vendimi nuk merret brenda afateve ligjore, vendimi për caktimin e masës së arrestit në burg anulohet.²⁰² Në mënyrë të ngjashme me vendimet për arrest në burg (si dhe vendimet që zgjasin mbajtjen në burg), edhe vendimet e apelit duhet të jenë të justifikuara dhe arsyetuara në mënyrë korrekte. Komentari i KPrP-së thekson më tej përgjegjësinë e veçantë që kanë gjykatat e apelit për të verifikuar që arresti në burg përdoret vetëm si masë e fundit, kur masa të tjera më pak shtrënguese janë të papërshtatshme në rastin konkret.²⁰³

¹⁹³ Kjo, për shembull, mund të argumentohet për një person që vjedh në mënyrë të përsëritur. Shih Komentari, faqe 325.

¹⁹⁴ Po aty.

¹⁹⁵ KEDNj, neni 5, pika 4.

¹⁹⁶ Kur gjykata ka refuzuar një kërkesë për arrest në burg, ankimi mund të bëhet gjithashtu nga prokurori. Shih KPrP, neni 249, pika 1.

¹⁹⁷ KPrP, neni 249, pika 3.

¹⁹⁸ KPrP, neni 249, pika 5.

¹⁹⁹ KPrP, neni 249, pika 6.

²⁰⁰ Komentari i KPrP-së, faqe 339.

²⁰¹ KPrP, neni 249, pika 6.

²⁰² KPrP, neni 249, pika 7.

²⁰³ Komentari i KPrP-së, faqe 328. Kur një vendim mbështetet në argumentet se sigurimi ose saktësia e provave do të rrezikoheshin, prokurori duhet t'i përcaktojë këto argumente, ndërsa gjyqtari duhet t'i verifikojë dhe të japë argumente për zbatimin e masës së sigurimit. Po aty, faqe 338.

III. JUSTIFIKIMI I VENDIMEVE PËR ARREST NË BURG: GJETJET

Një vendim për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg duhet të përmbajë një përshkrim të përmbledhur të fakteve dhe akuzës, bashkë me referimin e veprës penale për të cilën akuzohet personi i arrestuar me qëllim përmbushjen e kriterit të “dyshimit të arsyeshëm”, si dhe një paraqitje të shkaqeve të posaçme dhe të dhënave konkrete që justifikojnë ligjërisht një vendim për arrest në burg. Gjithashtu, vendimet duhet të shprehin qartë se paraburgimi është vërtetë në raport me nevojat e sigurimit në rastin konkret, dhe po zbatohet si masë e fundit. Duke pasur parasysh parimet bazë të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për liri të një individ që është në pritje të gjyqimit, është detyrë e gjykatës që të përcaktojë se të gjitha kriteret e lartpërmendura janë të pranishme në rastin konkret.

Në pjesën dërrmuese të të dhjetë rasteve të shqyrtuara, OSBE-ja ka vëzhguar se, në kundërshti me kërkesat procedurale dhe me të drejtën ndërkombëtare, ka një mungesë të provave dhe justifikimit korrekt në vendimet që fillimisht caktojnë arrestin në burg. Si model i përgjithshëm, vendimi thjesht deklaroi se, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga policia, ekziston një “dyshim i arsyeshëm i mbështetur në prova” se i dyshuari ka kryer veprën penale.²⁰⁴ Në vend që të paraqesë të dhëna specifike mbi shkaqet dhe rrethanat e posaçme që kanë përlligjur dhe justifikuar heqjen e lirisë së të dyshuarit përpara gjyqimit, gjykata shpesh mjaftohet me parafrazimin e dispozitave procedurale dhe/ose përdor shprehje standarde. Për shembull, thjesht duke përsëritur tekstualisht ligjin, vendimi mund të deklarojë se, në rastin konkret, “ekziston rreziku se i dyshuari mund të largohet”, ose që, për shkak “të rrezikshmërisë së personalitetit të tij dhe të rrezikshmërisë që paraqet vepra penale”, ai mund të kryejë krime të tjera. Edhe më keq, në shumicën e rasteve, vendimet mund t’u referohen në mënyrë të përgjithshme kriterëve të specifikuar në nenet 228, 229 dhe 230 të KPrP-së pa iu referuar në asnjë çast fakteve dhe rrethanave specifike të çështjes. Kjo mungesë e specifikave shkel të drejtën procedurale ndërkombëtare dhe vendëse dhe pengon mundësinë për t’u ankuar ndaj vendimeve në mënyrë të efektshme, sepse e bën të vështirë, në mos të pamundur, për avokatët mbrojtës që të kundërshtojnë në bazë të shkaqeve ligjore specifike.

Megjithëse, ashtu si vendimet për caktimin e masës së arrestit në burg (dhe vendimet që zgjasin mbajtjen në burg), vendimet e dhëna nga apeli duhet të

²⁰⁴ Në praktikë, seanca dëgjimore për vendosjen e masës së sigurimit kryesisht shihet thjesht si një formalitet. Nga personat e intervistuar nga OSBE-ja në kuadrin e sondazhit mbi paraburgimin, vetëm 8 për qind pohuan se arsyet e vendimit për arrest në burg ishin përmendur nga gjyqtari gjatë komunikimit të vendimit. 45 për qind e të intervistuarve deklaruan se u ishte bërë e ditur që vendimi mund të ankimohej. Shih OSBE Prezenca në Shqipëri, *Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri* (Tiranë, OSBE, 2006), faqe 34 [më poshtë Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri].

justifikohen dhe arsyetohen në mënyrë të përshtatshme, OSBE-ja ka vëzhguar se kjo gjë ndodh shumë rrallë. Në shumicën e rasteve të analizuara, Gjykata e Apelit Tiranë nuk verifikon vazhdimin e ekzistencës së shkaqeve për paraburgim, ose nuk paraqet në mënyrë specifike arsye shtesë ose të reja që justifikojnë dhënien e kësaj mase. Kryesisht duket se gjykata bën vetëm një shqyrtim elementar dhe sipërfaqësor të përmbajtjes së vendimeve për arrest në burg, duke mosushtruar funksionin e saj si kontrolluese, i cili pikërisht mishëron rolin e saj. Në praktikë, megjithëse shumë vendime për arrest në burg janë të arsyetuara në mënyrë të papërshtatshme (ato thjesht u referohen shkaqeve të renditura për caktimin e masës së sigurimit së arrestit në burg pa dhënë rrethana specifike në mbështetje të tyre), Gjykata e Apelit Tiranë pothuajse pa ndryshim i ka konfirmuar ato, duke mos e evidentuar këtë shkelje procedurale. Në vend që të funksionojë si një mekanizëm efektiv për rishikimin e ligjshmërisë së arrestit në burg, gjykata shpesh “vulos kalimthi” vendimin e ankimuar, duke përsëritur ekzistencën e shkaqeve për paraburgim mbi baza po aq të papërshtatshme dhe jobindëse. Si përfundim, duhet vërejtur se, megjithëse avokati mbrojtës shpesh nuk arrin të paraqesë një ankim të argumentuar mirë dhe bindës kundër arrestit në burg, kjo nuk i justifikon mangësitë në praktikën e gjykatës, siç u përmend më lart. Në të vërtetë, siç u tha edhe më sipër, neni 249, pika 6, i KPrP-së autorizon gjykatat e apelit që të rishikojnë vendimet për caktimin e masës së sigurimit në tërësinë e tyre dhe pavarësisht nga shkaqet e paraqitura në ankim.

Më poshtë jepen shembuj të praktikave në fjalë siç janë vëzhguar përmes një analize të dhjetë vendimeve për arrest në burg të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Tiranë, të ankimeve përkatëse ndaj vendimeve, si dhe vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë.²⁰⁵ Vendimet e analizuara janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Teksti është ndarë në paragrafe që trajtojnë secilin prej problemeve të vërejtura: (a) përdorimin e formulimit stereotip në vendimet për arrest në burg; (b) mosvlerësimin e duhur të kriterit të përpjesëtueshmërisë; (c) mosmarrjen në konsideratë të argumenteve të mbrojtjes nga ana e gjykatave.

A. Përdorimi i formulimit stereotip në vendimet për caktimin e masës së arrestit në burg

Siç ilustron dhe më poshtë, gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit shpesh përdorin një formulim stereotip dhe standard ose thjesht parafrzojnë dispozitat procedurale përkatëse kur u referohen shkaqeve ligjore për arrest në burg.

²⁰⁵ Për një shpjegim mbi metodologjinë e përdorur për të analizuar vendimet për arrest në burg, shih seksionin “Metodologjia”, faqet 8-10.

Më 24 mars 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë zgjati mbajtjen në burg të qytetarit **Gjok Biba**, i cili ishte arrestuar në flagrancë dhe akuzohej për vjedhje automjeti dhe armëmbajtje pa leje të armëve të gjahut.²⁰⁶ Pas një paraqitjeje të përmbledhur të fakteve siç tregoheshin në raportin e policisë, gjykata e shkallës së parë e vleftësoi të ligjshëm ndalimin e tij dhe caktoi masën e sigurimit së arrestit në burg. Arsyetimi i gjykatës shfaqet vetëm në dy rreshta që shkruajnë *“nga sa u parashtrua më lart, gjykata çmon se duhet pranuar kërkesa e prokurorisë, pasi ekzistojnë kushtet dhe kriteret e neneve 228 e vijues i KPrP-së”*. Nuk jepet asnjë specifikë për këto kushte. Në apel, avokati mbrojtës i të pandehurit kërkoi që arresti në burg të zëvendësohej me masën e sigurimit *“detyrim për t’u paraqitur përpara policisë gjyqësore”*.²⁰⁷ Avokati mbrojtës argumentoi se, duke qenë se i akuzuari nuk kishte precedent penal, kishte familje dhe fëmijë, nuk ekzistonin tregues se ai mund të përpiqej t’i shmangej drejtësisë ose që ishte i rrezikshëm sa për të përligjur mbajtjen e tij në burg përpara gjykimit.

Më 10 prill 2006, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e shkallës së parë duke përdorur një formulim të ngjashëm të përmbledhur dhe standard. Pasi deklaroi se, në bazë të fakteve të paraqitura në raportin policor, ekziston *“një dyshim i arsyeshëm”* që i akuzuari të ketë kryer krim, gjykata e apelit e gjeti të drejtë masën e sigurimit të vendosur nga gjykata më e ulët, pasi kjo e fundit *“ka aplikuar drejt kriteret që parashikohen nga nenet 228, 229, 230 të KPrP-së”*, dhe se masa ishte e përshtatshme duke marrë parasysh *“rrezikshmërinë e veprës dhe të pandehurit”*. Duket qartë se, në rastin në fjalë, të dyja gjykatat nuk kanë diskutuar shkaqet e posaçme për arrest në burg, si dhe përpjesëtueshmërinë dhe përshtatshmërinë e masës në rastin konkret. Përdorimi i një formulimi të tillë të standardizuar është i papranueshëm si nga e drejta vendëse, ashtu edhe nga ajo ndërkombëtare.

Më 27 gusht 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë zgjati mbajtjen në burg të qytetarit **Ferik Tafa**, i cili dyshohej për prodhim dhe shitje lëndësh narkotike në bashkëpunim me të tjerë²⁰⁸ dhe ishte arrestuar ndërsa kryente këtë vepër penale më 24 gusht 2006. Megjithëse shkalla e parë paraqiti me hollësi ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm (kryesisht bazuar mbi drogën e sekuestruar në çastin e arrestimit dhe gjatë kontrollit në shtëpinë e të dyshuarit, si dhe mbi përgjimet e ambientit midis të akuzuarit dhe bashkëpunëtorit të tij),²⁰⁹ ajo nuk provoi ekzistencën e

²⁰⁶ KP, nenet 134 dhe 280.

²⁰⁷ KPrP, neni 234.

²⁰⁸ KP, neni 238, pika 2.

²⁰⁹ Vlen të përmendet se autorizimi për përgjim të ambientit ishte renditur në dokumentet që mbështesnin kërkesën për arrest në burg. Megjithatë, procesverbali nuk tregon qartë nëse përgjimet janë bërë kur i akuzuari gjendej në ambientet e policisë apo në një vendndodhje tjetër.

shkaqeve (kriteret e veçanta) për paraburgim – thjesht iu referua neneve 228 dhe 229 të KPrP-së. Gjykata e Apelit Tiranë duket se e konfirmoi vendimin e shkallës së parë për arrest në burg duke u bazuar në të njëjtat argumente të përgjithshme dhe të papërshtatshme. Më specifikisht, vendimi i gjykatës së apelit deklaroi se gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar drejt ekzistencën e kushteve të përgjithshme dhe të kriterëve të parashikuara në nenet 228, 229 dhe 230 të KPrP-së, se rrezikshmëria shoqërore e autorit dhe e veprës penale ishin në përputhje me dispozitat e mësipërme, dhe se masa duket e përshtatshme kundrejt shkallës së nevojave të sigurimit që kërkohen në rastin konkret, të parashikuara nga neni 229, pika 1. Ekzistenca e rreziqeve të individualizuara dhe të provuara nuk ishte paraqitur askund në vendimin e gjykatës së apelit.

Më 8 shkurt 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi arrest në burg për qytetarin **Elvis Ismail** **sufaj**, i akuzuar për vjedhje automjeti në bashkëpunim me të tjerë. Sipas raportit të policisë, i dyshuari, në bashkëpunim me individë të tjerë, kishte vjedhur një automjet më 2 shkurt 2006, dhe ishte arrestuar dy ditë më pas ndërsa përpiqej ta shiste. Megjithëse arrestimi nga ana e policisë u konsiderua i paligjshëm, gjykata urdhëroi arrest në burg për të dyshuarin duke mosparaqitur faktet specifike në mbështetje të vendimit – thjesht iu referua rrezikshmërisë së veprës penale, personalitetit të të pandehurit, dhe ekzistencës së “kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta” të neneve 228 dhe 229 si elemente në mbështetje të masës. Pas ankimit të bërë nga i pandehuri (i cili kërkoi që masa të zëvendësohej thjesht me detyrimin për t’u paraqitur), Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e shkallës së parë. Duhet vërejtur se, edhe pse në diskutimin e “kriterit të dyshimit të arsyeshëm”, vendimi i apelit paraqet një listë të gjatë provash që pretendojnë të mbështesin ekzistencën e tij, vendimi nuk tregon se si këto fakte kanë lidhje me rastin konkret. Për shembull, vendimi u referohet, mes të tjerash, procesverbaleve të inspektimit të garazhit ku mendohej se mbahej makina e vjedhur, si dhe deklarimeve të disa individëve (përfshirë edhe të bashkëpunëtorëve të dyshuar) pa dhënë asnjë shpjegim se si këto elemente provonin një kuadër faktesh në mbështetje të ekzistencës së “dyshimit të arsyeshëm”. Në diskutimin e argumenteve të tjera për vendosjen e paraburgimit, Gjykata deklaroi se, duke marrë parasysh përfshirjen e përsëritur të të dyshuarit në vjedhjen e automjeteve dhe personalitetin e tij, ekziston rreziku se ai mund të kryejë të njëjtën vepër *si dhe* “të largohet, duke iu fshehur hetimit”. Megjithëse, duke marrë parasysh recidivizmin, rreziku i krimeve të tjera mund të duket i justifikuar në rastin konkret, një hamendësim i përgjithësuar dhe i paprovuar se i pandehuri mund t’i fshihet drejtësisë nuk mjafton, në vetvete, për të justifikuar paraburgimin.

Më 20 gusht 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë zgjati mbajtjen në burg të **Nasser Almalak**, i akuzuar për marrëdhënie seksuale dhe homoseksuale në vende publike (nenet 107, 25 i KP) dhe për prostituim në bashkëpunim me të tjerë (nenet 113, 25 i KP). Prokurori i kërkoi gjykatës që të konfirmonte arrestimin në flagrancë të të dyshuarit dhe të vendoste masën e sigurimit arrest në burg. Gjykata vleftësoi të ligjshëm ndalimin dhe caktoi masën e sigurimit të arrestit në burg. Në vendim lexohet “nga materiali kallzues del qartë fakti se këto marrëdhënie homoseksuale janë kryer kundrejt shpërblimit në vende të dukshme publike”. Megjithëse i akuzuari ishte arrestuar bashkë me katër individë të tjerë (të gjithë të akuzuar për të njëjtin krim), vendimi nuk diskuton në asnjëfarë forme se si akuza lidhet me secilin prej tyre. Vendimi nuk shpjegon se si është e mundur për policinë të kapë njëkohësisht pesë persona të gjithë të përfshirë në pranimin e pagesës apo në negocimin e pagesës për marrëdhënie homoseksuale – dhe ta bëjë këtë pa marrë një denoncim nga një palë e tretë, gjë që do të kishte kërkuar lëshimin e një urdhër-arresti. Megjithëse nuk është e domosdoshme që gjatë seancës së vleftësimit të masës së sigurimit gjykata të vërtetojë që vepra penale ka ndodhur vërtet, duhet të tregojë që provat e paraqitura të vërtetojnë mjaftueshëm se ka të ngjarë që *secili* individ i pandehur të ketë kryer krimin.

Pas diskutimit se çfarë gjykata konsideroi baza të arsyeshme për arrestimin, vendimi më pas thjesht thoshte “*nisur nga rrezikshmëria shoqërore e veprave penale, gjykata çmon se kërkesa e prokurorisë është e bazuar në ligj e duhet pranuar*”. Por, Gjykata e Rrethit nuk e argumentoi vendimin e caktimit të arrestit në burg, për shembull duke treguar prova që mbështesnin ekzistencën e “dyshimit të arsyeshëm”, dhe nuk iu referua dhe nuk mbështeti specifikisht me të dhëna ekzistencën e rrezikut të largimit, rrezikut të ndërhyrjes në procesin e drejtësisë, ose rrezikut të përsëritjes së të njëjtit krim apo krimeve të tjera. Duke qenë se rrezikshmëria e veprës penale nuk është e mjaftueshme, në vetvete, për të justifikuar paraburgimin, vendimi duket se është lëshuar në shkelje të së drejtës shqiptare dhe asaj ndërkombëtare.

Më 7 shtator 2006, ankimi i të dyshuarit ndaj vendimit u refuzua nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila la në fuqi vendimin shkallës së parë për arrest në burg pas një seance shumë të shkurtër dëgjimore. Apeluesi mohoi kryerjen e veprave për të cilat akuzohej dhe pretendoi se, në çastin e arrestimit, ai ishte përfshirë në shpërndarjen e prezervativëve për llogari të OJF-së që ai përfaqësonte. Në mënyrë të ngjashme me vendimin e shkallës së parë, edhe ai i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk ishte i arsyetuar dhe nuk shqyrtoi e as iu përgjigj kërkesës së apeluesit për ta zëvendësuar masën e arrestit në burg me masën më pak të rreptë të arrestit në shtëpi. Megjithëse duket se vendimi të paktën është përpjekur, deri në një farë shkalle, të shqyrtojë

dhe të justifikojë ekzistencën e kriterit të “dyshimit të arsyeshëm”,²¹⁰ përsëri nuk provon në mënyrë të kuptueshme dhe nuk shpreh qartë ekzistencën konkrete të shkaqeve të tjera shtesë dhe të domosdoshme për paraburgim (d.m.th., rreziku i arratisjes, rreziku i dëmtimit të provave, ose rreziku i përsëritjes së krimin). *Çuditërisht, këto argumente as nuk përmenden në vendim, i cili deklaroi vetëm ekzistencën e “kushteve të parashikuara në nenin 228”*. Vendimi gjithashtu nuk tregon se pse zbatimi i masave të tjera më pak të ashpra u konsiderua i papërshtatshëm në atë fazë të procedimit. Më specifikisht, gjykata e apelit parafrazon një pjesë të formulimit të përdorur nga KPrP-ja, ku arsyetohet që “në caktimin e masës së sigurimit arrest në burg kundër Nasser Almalak, përveç kushteve të parashikuara nga neni 228 kanë ekzistuar edhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, të përcaktuara në nenin 229 të Kodit të Procedurës Penale. Masa arrest në burg për apeluesin për veprën penale të marrëdhënies seksuale në vende publike dhe të prostituimit përputhet me shkallën e nevojave të sigurimit dhe është në raport me rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për kryerjen e këtyre dy veprave. Këto kriteret përputhen me kërkesat e nenit 229 të KPrP-së”.²¹¹ Duhet vërejtur se ky i fundit u referohet kriterëve të përpjesëtueshmërisë në caktimin e masës së sigurimit personal arrest në burg. Megjithatë e njëjta dispozitë i referohet vazhdimësisë, përsëritjes dhe faktorëve të tjerë rëndësues ose lehtësues si kriteret në të cilat mbështeten vendimet për masat e zbatueshme, gjykata as nuk përfilloi t’i merrte këta faktorë në shqyrtim.

Siç përmendet dhe më lart, GjEDNj-ja e ka bërë të qartë që arsyetimi i gjykatës do të konsiderohet gjithmonë i papërshtatshëm nëse është “abstrakt” ose “stereotip”.²¹² Prezenca në Shqipëri e OSBE-së ka bindjen se, duke mos siguruar informacion specifik që përlligj paraburgimin, dhe duke përdorur formulime stereotipe si më lart, vendimi nuk është në përputhje me kërkesat e së drejtës vendëse dhe ndërkombëtare. Të njëjtat vëzhgime mund të bëhen edhe për çështjen e paraqitur si më poshtë.

Më 4 janar 2007, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi paraburgimin për qytetarin **Arben Çela**, i cili akuzohej për falsifikim dokumentesh pasi ishte

²¹⁰ Përveç faktit që individët e përfshirë (përfshirë edhe apeluesin), në mënyrë të supozuar, u arrestuan në flagrancë nga policia (gjatë kryerjes së aktit të prostituimit dhe marrëdhënies homoseksuale në vende publike), vendimi për z. Almalak argumenton se kriteri i “dyshimit të arsyeshëm” mbështetet gjithashtu nga deklarata e një individ i cili deklaronte se po bënte marrëdhënie seksuale kundrejt pagesës me të akuzuarin në çastin kur u ndaluan nga policia.

²¹¹ Në fakt, neni 229 i KPrP deklaroi, mes të tjerash, “gjykata që cakton masat e sigurimit duhet të marrë parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete”. KPrP, neni 229, pika 1 dhe 2.

²¹² Çështja “Clooth kundër Belgjikës”, GjEDNj, 12 dhjetor 1991, para. 44; çështja “Yağcı dhe Sargin kundër Turqisë”, GjEDNj, 23 maj 1995, para. 52.

arrestuar në flagrancë më 13 dhjetor 2006.²¹³ Megjithëse Gjykata e Rrethit Tiranë kishte diskutuar në vendimin e saj fillestar ekzistencën e kriterit të përpjesëtueshmërisë, nuk diskutonte ekzistencën e shkaqeve të tjera për paraburgim. Gjykata e Apelit nuk e ndreqi këtë mangësi, por thjesht iu referua në mënyrë të përgjithshme ekzistencës së kushteve të neneve 228 dhe 229 të KPrP-së. Më pas vërejtë se i akuzuari paraqiste një rrezikshmëri të lartë shoqërore, pasi dyshohej “të kishte kryer gjashtë vepra penale” (vepra të lidhura me falsifikimin e dokumenteve).

B. Përpjesëtueshmëria e masës së sigurimit të arrestit në burg

Prezenca në Shqipëri e OSBE-së ka vërejtur gjithashtu se, përveç argumentimit të pamjaftueshëm, madje në disa raste mosdhënies së argumentimit, të shkaqeve ligjore për paraburgim, gjykatat në vendimet e para vazhdimisht nuk vlerësojnë si duhet përpjesëtueshmërinë e masës në rastet konkrete dhe, për më tepër, nuk marrin në konsideratë mundësinë e zbatimit të një mase më pak të ashpër. Në praktikë, ato nuk arrijnë të tregojnë arsyet pse masat alternative më pak të ashpra konsiderohen të pamjaftueshme në atë fazë të procedimit. Gjykatat e apelit, nga ana tjetër, nuk e ndreqin këtë mangësi të dukshme.

Më 27 janar 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë zgjati mbajtjen në burg për një të mitur të akuzuar për vjedhje të përsëritur (të një kompjuteri dhe një faksi) në bashkëpunim me të tjerë.²¹⁴ Pasi renditi provat e paraqitura në dosjen e policisë, gjykata e shkallës së parë argumentoi për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. Duke përdorur një formulim më se standard, gjykata deklaroi se, duke marrë në konsideratë ekzistencën e rrethanave të përcaktuara në nenin 228, pika 3 (a) dhe (b) [rreziku i dëmtimit të provave dhe rreziku i largimit], 229 (2) [raporti midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet], dhe 230 [domosdoshmëria për arrest në burg], duhet zbatuar masa personale e sigurimit e parashikuar nga neni 238 i KPrP-së [arrest në burg]. Por vendimi nuk jep më asnjë lloj të dhëne të individualizuar që të justifikojë arrestin.

Më 1 shkurt 2006, avokati mbrojtës i të pandehurit e ankimoi vendimin duke argumentuar se gjykata e shkallës së parë nuk kishte paraqitur argumentet ligjore për caktimin e masës.

²¹³ KP, nenet 186, 187, 188, 190, 191 dhe 192.

²¹⁴ KP, neni 134, pika 2. I mituri u arrestua në bazë të nenit 253 të KPrP, i cili parashikon arrestimin e një personi të dyshuar për kryerjen e një krimi që dënohet me të paktën dy vjet heqje lirie kur ekziston rreziku i largimit. Sipas prokurorisë, i pandehuri dhe bashkëpunëtori i tij kishin vjedhur, më 22 shtator 2005, një makinë faksi, duke e shitur të nesërmen, dhe një muaj më pas kishin vjedhur një kompjuter dhe *hard disk*, që më pas i kishin hedhur sepse ishin të prishur.

Avokati gjithashtu argumentoi se:

- (a) vlera e vogël e sendeve të vjedhura (një kompjuter i vjetër) nga i akuzuari, i cili gjendej në kushte ekonomike të mjera, nuk justifikonte vendosjen e një mase kaq të ashpër;
- (b) i pandehuri nuk ishte dënuar kurrë më parë;
- (c) i pandehuri nuk i ishte fshehur dhe nuk ishte përpjekur t'i fshihej drejtësisë që nga kryerja e krimit të supozuar (vjedhja mendohej të kishte ndodhur më 24 tetor 2005, ndërsa ai u arrestua më 24 janar 2006);
- (d) gjykata nuk e kishte justifikuar ekzistencën e rrezikut se ai mund të dëmtonte provat.

Më 15 shkurt 2006, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët që vendosi masën arrest në burg nisur nga ekzistenca e rrezikut të largimit, por kundërshtoi argumentin e mbështetur në rrezikun e dëmtimit të provave në rastin konkret. Megjithëse gjykata e apelit theksoi se gjykata e shkallës së parë nuk e kishte justifikuar si duhet caktimin e masës,²¹⁵ edhe gjykata e apelit bëri gjithashtu të njëjtën gjë. Gjykata e Apelit, në fakt, vetëm argumentoi se, nisur nga recidivizmi dhe personaliteti i të akuzuarit, ekzistonte rreziku që ky i fundit mund të përsëriste të njëjtin krim dhe të largohej. Nuk u dhanë arsye të tjera për të shpjeguar rrezikun e arratisjes, dhe nuk duket të jetë bërë asnjë peshim i faktorëve në favor dhe kundër këtij rreziku.

Më tej, në diskutimin e elementit të përpjesëtueshmërisë, Gjykata e Apelit argumentoi, mes të tjerash, se: (a) pa marrë në konsideratë që koha duhet të përgjysmohet në rastin e një të mituri, arresti në burg është në raport me dënimin për krimin (gjashtë muaj deri në pesë vjet); (b) vepra penale është e përhapur në Tiranë. Ky fakt nuk duhet të anojë në favor të arrestit në burg, pasi përhapja e krimit nuk bën pjesë në rrethanat rënduese që gjykata mund të marrë parasysh në përcaktimin e përpjesëtueshmërisë së masës së sigurimit në rastin konkret.²¹⁶ Për më tepër, duhet vërejtur se shumë krime të vogla, për të cilat arresti në burg do të dukej i papërshtatshëm, janë gjithashtu të përhapura.

²¹⁵ Gjykata e apelit gjeti se gjykata më e ulët nuk kishte paraqitur argumente dhe të dhëna specifike që justifikonin zbatimin e masës arrest në burg në shkelje të KPrP neni 245, pika 1 (c).

²¹⁶ KPrP, neni 229, pika 2, parashikon se, në përcaktimin e përpjesëtueshmërisë së një mase të sigurimit personal, gjykata duhet të marrë në konsideratë, mes të tjerash, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara në Kodin penal, neni 50, ku jepet një listë e gjatë me rrethana rënduese, dhe nuk përfshihet shpeshësia e krimit, ose fakti që është i përhapur. Gjithsesi, Komentari i Kodit penal (pjesa e përgjithshme) duket se sugjeron që gjykata mund të marrë në konsideratë rrethana të tjera rënduese, të paspecifikuara. Shih Ismet Elezi, Skënder Kaçupi, dhe Maksim Haxhia, *Komentari i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë (Pjesa e përgjithshme)* (Tiranë, GEER, 2006), faqe 246, paragrafi i fundit.

Më çuditërisht, gjykata e apelit kundërshtoi si të pabazuar, nisur nga sa më sipër, argumentin e avokatit mbrojtës se procesi i edukimit të akuzuarit, një i mitur në vit të dytë të shkollës së mesme, nuk duhej ndërprerë, dhe si rrjedhim zbatimi i një mase më të butë do të ishte më i përshtatshëm.²¹⁷ Ky interpretim i gjykatës përbën shkelje të drejtpërdrejtë të së drejtës procedurale, e cila parashikon kushte të veçanta për përcaktimin e masës së sigurimit ndaj të miturve. Neni 229 i KPrP-së, në fakt, thotë se, kur i pandehuri është i mitur, në caktimin e masës së sigurimit, gjykata duhet të marrë në konsideratë nevojën e të miturit për proces edukativ të pandërprerë.²¹⁸

Me pak fjalë, megjithëse vendimi i shkallës së parë për arrest në burg nuk ishte plotësisht i provuar (në raport me rrezikun që i akuzuari mund të largohet), gjykata e apelit nuk e anuloi vendimin. Nëse gjykata e apelit do të kishte rivlerësuar dhe justifikuar si duhet ekzistencën e kuadrit ligjor për masat e sigurimit, duket se mund të kishte zbatuar një masë të disponueshme më pak të ashpër (për shembull detyrim për t'u paraqitur në polici), në përputhje me nenin 249, pika 6.²¹⁹

C. Mosmarrja në konsideratë e argumenteve të mbrojtjes

Shpesh, gjykatat e apelit nuk marrin në konsideratë ose as nuk i përmendin argumentet e paraqitura nga apeluesi. Pavarësisht nëse këto argumente mund të jenë ose jo të vlefshme dhe të mbështetura mjaftueshëm, mospërfillja e tyre nga ana e gjykatës përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj shqiptare.

Më 24 mars 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë zgjati mbajtjen në burg të qytetarit **Gjok Biba**, i cili ishte arrestuar në flagrancë dhe akuzohej për vjedhje automjeti dhe mbajtje pa leje të armëve të gjahut. Në apel, avokati i të pandehurit kërkoi që masa e arrestit në burg të zëvendësohej me masën e sigurimit “detyrim për t'u paraqitur përpara policisë gjyqësore”. Avokati mbrojtës argumentoi se, duke qenë se i akuzuari nuk kishte precedent penal dhe kishte familje, nuk ekzistonin tregues se ai mund të përpiqej t'i shmangej drejtësisë ose që ishte aq i rrezikshëm sa të ishte e domosdoshme

²¹⁷ Gjykata gjithashtu hodhi poshtë edhe argumentin e avokatit mbrojtës se procesi i edukimit të të dyshuarit (në vit të dytë të shkollës së mesme) nuk duhej ndërprerë duke deklaruar se rrezikshmëria e veçantë e krimit dhe e autorit nuk lejonin që të aplikohet një masë sigurie më e butë se ajo e arrestit në burg.

²¹⁸ KPrP, neni 229, pika 3. Komentari më tej thekson se, kur bëhet fjalë për të mitur, kriteret dhe kushtet për përcaktimin e masës së sigurimit duhen vlerësuar duke marrë në konsideratë të lartë moshën e të pandehurit, në mënyrë që ky i fundit të mos pengohet të marrë edukim ose trajnim profesional. Komentari i KPrP-së, faqe 327.

²¹⁹ KPrP, neni 249, pika 6.

të mbahej në burg në pritje të gjykimit. Avokati mbrojtës argumentoi se i akuzuari ishte përfshirë në procesin e blerjes së automjetit nga një individ tjetër dhe nuk e dinte që mjete ishte i vjedhur,²²⁰ dhe se arma që ai zotëronte ishte një armë “teke”, dhe jo një armë gjahu, siç mendohej të vërtetohej nga një certifikatë hyrjeje e lëshuar nga Dogana e Gjirokastrës. Më 10 prill 2006, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e shkallës së parë pa shpjeguar se pse masa më e lehtë e sigurimit (detyrim për t’u paraqitur në polici) e kërkuar nga apeluasi konsiderohej e papërshtatshme. Gjykata e apelit nuk shqyrtoi asnjë nga argumentet e paraqitura nga apeluasi dhe i shpërfilli ato shkurtimisht duke deklaruar se nuk mund të merreshin në konsideratë pasi “ato do t’i shërbenin një faze tjetër të gjykimit”.

Është e paqartë se pse gjykata e apelit nuk mori në shqyrtim argumentet e mbrojtjes kundrejt ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm dhe të rrezikut të arratisjes. GjEDNj-ja ka gjetur se, megjithëse neni 5 (4) i KEDNj-së nuk vendos detyrim mbi një gjyqtar, i cili shqyrton një ankim ndaj caktimit të masës së arrestit në burg për të adresuar çdo argument që përmban paraqitja e apeluasit, garancitë e këtij neni do të humbitnin thelbin e tyre nëse gjyqtari do t’i shpërfillte ose do t’i trajtonte si të parëndësishme faktet konkrete të parashtruara nga i paraburgosuri, të cilat mund të hedhin dyshim mbi ekzistencën e kushteve thelbësore për ligjshmërinë e heqjes së lirisë.²²¹

Më 12 mars 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi arrest në burg për qytetarin **Bilbil Tota**, i cili akuzohej për vjedhjen e një makine ekspresi nga një lokal në bashkëpunim me një individ tjetër të paidentifikuar.²²² Sipas hetimit, më 2 dhjetor 2003, pronari i lokalit kishte parë dy persona të largoheshin me makinën e ekspresit. Pasi i ndoqi, ai arriti të merrte sërish makinën e ekspresit e cila ishte braktisur rreth 70 metra larg vendngjarjes. Gjurmët e gishtave të gjetura mbi makinën e ekspresit pothuajse tri vjet pas ngjarjes²²³ çuan në arrestimin e të akuzuarit më 10 mars 2006. Pasi vleftësoi të ligjshëm ndalimin, Gjykata e Rrethit Tiranë caktoi masën e arrestit në burg. Pa dhënë asnjë tregues mbi rrethanat specifike dhe individuale në mbështetje të argumenteve ligjore për aplikimin e masës arrest në burg (kriteret e ekzistencës së “dyshimit të arsyeshëm” të shoqëruara nga rreziku i largimit dhe rreziku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë dhe rreziku i përsëritjes së veprimtarisë kriminale), gjyqtari i

²²⁰ Siç provohet dhe nga fakti që ai e mbante dukshëm përpara shtëpisë së tij, dhe se nuk kishte ndryshuar as ngjyrën e as shasinë e makinës.

²²¹ Çështja “Ilijkov kundër Bullgarisë”, GjEDNj, 26 korrik 2001, para. 94.

²²² Vjedhja, kur kryhet në bashkëpunim me të tjerë, ndëshkohet me pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie. Shih KP, neni 134, pika 2.

²²³ Ekspertimi daktiloskopik nr. 1065, 3 mars 2006.

vetëm urdhëroi arrestin në burg për të dyshuarin duke deklaruar se “në rastin konkret, rrezikshmëria shoqërore e veprës dhe e autorit të saj plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, për caktimin e masave të sigurimit personal të karakterit shtrëngues të cilat parashikohen nga nenet 228, 229 dhe 230 të KPrP-së”. Përveç se nuk justifikoi ekzistencën e kriterëve të veçanta, gjykata gjithashtu nuk dha arsye pse masa të tjera më pak shtrënguese konsiderohen të papërshtatshme dhe pse vepra penale dhe i akuzuari paraqisnin “një rrezik të veçantë”. Si përfundim, gjykata duket se e ka cilësuar ngjarjen në mënyrë të gabuar si vjedhje dhe jo vjedhje e mbetur në tentativë (krimi nuk ishte përfunduar pasi makina e ekspresit në fund nuk u vodh por u braktis në rrugë).

Më 21 mars 2006, i pandehuri bëri një ankim ndaj vendimit për caktimin e masës së arrestit në burg. Kërkesa ankimore argumentoi që arresti në burg ishte urdhëruar në kundërshti me kriteret dhe shkaqet për caktimin e masës së arrestit në burg,²²⁴ dhe kërkoi që urdhri të ndryshohej në masën “detyrim për t’u paraqitur përpara policisë gjyqësore”, siç përcaktohet në nenin 234 të KPrP-së.²²⁵ Më konkretisht, ankimi argumentoi se:

- (a) vepra penale duhet cilësuar si “vjedhje e mbetur në tentativë”, dhe jo vjedhje, dhe vepra penale paraqet rrezikshmëri të ulët shoqërore (faktet tregonin që të dyshuarit nuk e kishin përfunduar krimin pasi ishin të dehur dhe nuk mund ta mbanin makinën e ekspresit, të cilën e kishin braktisur në mes të rrugës, pasi pronari ishte vënë në ndjekje të tyre);
- (b) në caktimin e masës së sigurimit, gjykata gjithashtu duhet të kishte marrë në konsideratë masën e sanksionit që zbatohet për rastin konkret, duke i hapur rrugën zbatimit të masave alternative më pak shtrënguese;
- (c) një sërë faktorësh dëshmonin në favor të zbatimit të masave më pak shtrënguese, si për shembull: koha e gjatë që kishte kaluar nga kryerja e krimit deri në caktimin e masës së arrestit në burg; natyra e diskutueshme e kësaj mase në lidhje me edukimin; i pandehuri, i cili ishte i mitur në kohën e kryerjes së krimit, sipas ligjit gëzonte të drejtën për gjykim të veçantë dhe nuk ishte

²²⁴ Për shembull, argumentet e parashikuara në KPrP nenet 228 -230.

²²⁵ KPrP, neni 232, parashikon një sërë masash sigurie: ndalim i daljes jashtë shtetit, detyrim për t’u paraqitur përpara policisë gjyqësore, ndalim ose detyrim për të qëndruar në një vend të caktuar, garanci pasurore, arrest në shtëpi, arrest në burg; shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik. Sipas nenit 234, gjykata mund ta urdhërojë të pandehurin që të paraqitet në data dhe orë të caktuara përpara policisë gjyqësore. Shih KPrP, neni 234.

plotësisht i aftë të vlerësonte pasojat e veprimeve të tij (e vërtetuar nga fakti që ai u pendua, nuk kishte precedent penal dhe kishte referenca të shkëlqyera në punë).

Më 10 prill 2006, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për arrest në burg. Duke përdorur pothuajse të njëjtin formulim standard që ishte përdorur nga gjyqtari i shkallës së parë, gjykata e apelit thjesht deklaroi që ekziston “dyshimi i arsyeshëm” që i pandehuri të ketë kryer krimin, dhe se *gjykata e shkallës së parë ka “vlerësuar drejt kushtet dhe kriteret për përcaktimin e masës së sigurimit personal të parashikuar në nenet 228, 229 dhe 230 të KPrP-së”*. Gjithashtu deklaroi se masa ishte në përjesëtueshmëri me rrezikshmërinë e paraqitur nga vepra penale dhe autori i saj. Në përfundim gjykata hodhi poshtë shkaqet e ankimit duke deklaruar kategorikisht se *“pretendimet e të pandehurit të parashtruar në kërkesën ankimore, nuk i përkasin kësaj faze të gjykimit, por fazës së gjykimit të themelit dhe si të tilla nuk duhen pranuar”*. Duhet vërejtur se gjykata nuk bëri asnjë përpjekje të argumentonte kundër nocionit të vjedhjes së mbetur në tentativë. Asnjë shpjegim tjetër nuk u dha.

Duket se, në këtë çështje, gjykata e apelit nuk ka identifikuar dhe korrigjuar mungesën pothuajse të plotë të justifikimit të vendimit të shkallës së parë për arrest në burg. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim asnjë prej argumenteve të ngritura në ankimin e të pandehurit – disa prej të cilave ishin të shprehura relativisht mirë dhe mund të ishin të vlefshme. Më konkretisht, duke përdorur në mënyrë të papërshtatshme një formulim standard dhe stereotip, gjykata nuk tregoi asnjë provë në mbështetje të “dyshimit të arsyeshëm” dhe nuk provoi shkaqe të tjera për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg. Çuditërisht, gjykata nuk vuri në dyshim vlefshmërinë e gjurmëve të gishtave të gjetura mbi makinën e ekspresit pothuajse *tri vjet më vonë* si e vetmja provë mbi të cilën bazohet dyshimi i arsyeshëm. Gjithashtu nuk vlerësoi “argumentin e përjesëtueshmërisë” duke mos marrë në konsideratë argumentin e kualifikimit të veprës si vjedhje e mbetur në tentativë, si dhe rrethanat lehtësuese të paraqitura në ankim. Vlen të përmendet se, megjithëse disa prej argumenteve të të pandehurit në ankim ishin të formuluar me terma të përgjithshme, ato kishin themele të forta në ligj. Për shembull, neni 229 i KPrP-së shprehet se, në përcaktimin e masës së sigurimit kur i pandehuri është i mitur, gjykata duhet të marrë në konsideratë nevojën për proces të pandërprerë edukimi. Neni 51 i KPrP-së thotë gjithashtu se koha e burgosjes për të miturit nuk duhet të tejkalojë gjysmën e kohës që normalisht parashikohet nga ligji, një fakt që duhet marrë në konsideratë në përcaktimin e rëndësisë së krimit si një nga faktorët mbi të cilët vendoset masa e sigurimit në rastin konkret.

Çuditërisht, gjykata e apelit as nuk tregoi pse masa alternative më e butë “detyrim për t’u paraqitur përpara policisë gjyqësore” nuk ishte e përshtatshme në rastin konkret. Siç është përmendur edhe më lart në këtë kapitull,²²⁶ duke qenë se i mungoi justifikimi dhe nuk mori në shqyrtim argumentet e apeluesit, vendimi i gjykatës së apelit ishte në shkelje të dispozitave ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për paraburgimin.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka vërejtur se, në ato raste të rralla ku Gjykata e Apelit Tiranë e ka gjetur arrestin në burg të urdhëruar nga gjykata e shkallës në shpërpjesëtim me rrethanat konkrete, nuk e ka vlerësuar siç duhet ekzistencën e këtij kriteri dhe të kriterëve të tjera për paraburgim, dhe nuk ka dhënë udhëzimet e përshtatshme në këtë aspekt.

Më 22 janar 2006, Gjykata e Rrethit Tiranë vleftësoi të ligjshëm ndalimin në flagrancë dhe caktoi “arrest në burg” për qytetarin **Fatmir Lala**, i cili akuzohej për vjedhje të përsëritur të paneleve sinjalistike të rrugës.²²⁷ Sipas hetimit paraprak, gjatë përpjekjeve për të vjedhur një tabelë rruge përpara ndërtesës së NATO-s në Tiranë, i dyshuari ishte filmuar nga kamerat dhe ishte kapur menjëherë nga kallëzuesi [një oficer i NATO-s]. Gjatë kontrollit pasues në shtëpinë e të pandehurit, policia gjeti dhe sekuestroi dy profile hekuri dhe një tabelë rrugore me sinjalistikë. Duke vleftësuar të ligjshëm ndalimin, gjykata e shkallës së parë gjeti se, nisur nga “rrezikshmëria shoqërore e veprës penale”, mosha e të akuzuarit, rrethanat e ngjarjes, kryerja e veprës më shumë se një herë²²⁸ dhe masa e dënimit, “ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 228, 229, 230 dhe 238 të KPrP-së për caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’”. Nuk jepet asnjë tregues tjetër se cilat rrethana specifike përligjnin aplikimin e kësaj mase sigurie shtrënguese.

Në vijim të ankimit nga ana e të akuzuarit (i cili kërkonte që masa të zëvendësohej me “detyrim për t’u paraqitur përpara policisë gjyqësore”), më 13 shkurt 2006, Gjykata e Apelit Tiranë ndryshoi vendimin e shkallës së parë duke e zëvendësuar me masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.²²⁹

²²⁶ Shih më lart, seksioni III “Justifikimi i Vendimeve për Arrest në Burg: Gjetjet”, faqe 61.

²²⁷ KP, neni 134, pika 2.

²²⁸ Duket se Gjykata e Rrethit në mënyrë të gabuar e cilësoi aktin e vjedhjes si të përsëritur. Megjithatë vendimi deklaronte se, sipas gjetjeve të hetimit paraprak, i pandehuri dukej se kishte vjedhur shenja rruge në dy raste të tjera - më 11 qershor dhe 20 janar 2006 - është e qartë se, në rastin më të fundit, ngjarja duhej cilësuar si “vjedhje e mbetur në tentativë”, pasi i pandehuri ishte ndaluar në kohë nga oficeri i NATO-s ndërsa përpiqej të hiqte tabelën e rrugës. Për sa i përket pretendimit se i pandehuri kishte vjedhur edhe më parë një tabelë rruge në të njëjtin vend (më 11 qershor 2006), Gjykata e Rrethit nuk paraqet asnjë provë që mbështet këtë akuzë - thjesht u referohet gjetjeve të hetimit paraprak.

²²⁹ KPrP, neni 237.

Në vendimin e saj, gjykata e apelit me të drejtë kundërshtoi gjykatën e shkallës së parë pasi kjo e fundit nuk kishte marrë në konsideratë kriterin e përpjesëtueshmërisë së masës siç parashikohet në nenet 229 dhe 230 të KPrP-së për caktimin e masës së arrestit në burg. Duke vepruar në këtë formë, gjykata e apelit kundërshtoi nocionin që vepra penale paraqet "rrezikshmëri të veçantë shoqërore", dhe theksoi mospasjen e precedentëve penalë të autorit si dhe mungesën e treguesve se ai mund t'i largohej drejtësisë. Megjithëse vëzhgimet e mësipërme duken të sakta, Prezenca e OSBE-së vëren se, në bazë të të njëjtave vëzhgime, masa e re e sigurimit "arrest në shtëpi" shfaqet jo në përpjesëtim, si pasojë e mungesës së justifikimeve të mëtejshme. Gjykata e apelit nuk bën të ditur pse masa e sigurimit e kërkuar nga apeluesi (detyrim për t'u paraqitur përpara policisë gjyqësore) u konsiderua e papërshtatshme. Si përfundim, gjykata e apelit mund të kishte parashtruar argumente më të plota kundër caktimit të masës së sigurimit të arrestit në burg me qëllim që të garantonte udhëzime për gjykatat më të ulëta në të ardhmen.

IV. PËRFUNDIM

Duke qenë se heqja e lirisë në pritje të gjykimit duhet të përdoret vetëm si masë e fundit, çdo vendim që urdhëron masën arrest në burg duhet arsyetuar plotësisht dhe qartë duke paraqitur provat, faktet dhe rrethanat specifike që mbështesin shkaqet ligjore për zbatimin e kësaj mase.

Siç mund të vërehet edhe nga shembujt e sjellë më lart, si Gjykata e Rrethit Tiranë ashtu edhe ajo e Apelit nuk i arsyetojnë vendimet për arrest në burg. Gjykatat e apelit shpesh i vulosin pa i shqyrtuar vendimet e gjykatës së shkallës së parë që urdhërojnë masën arrest në burg dhe nuk ndërhyjnë për t'i korrigjuar ato aty ku janë të argumentuara dhe të arsyetuara në mënyrë të pamjaftueshme. Duke mos arsyetuar drejt vendimet e tyre, dhe duke mos identifikuar arsyetimin e mangët në vendimet që ato marrin në shqyrtim, gjykatat e apelit veprojnë në shkelje të standardeve për një proces gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë, edhe në ato raste kur vendimi për paraburgim duket i përshtatshëm në rrethanat specifike. Duke mos përvijuar kornizat për kufizimet e pranueshme të lirisë së individit që është në pritje të gjykimit, gjykatat e apelit gjithashtu nuk japin udhëzime për gjykatat më të ulëta në këtë kontekst tejet të rëndësishëm. Praktika e diskutuar më lart e vendos të akuzuarin në një pozitë të pajustificueshme, ku barra e provës ndërron duar dhe parimet bazë të drejtësisë, si prezumimi i pafajësisë dhe liria në pritje të gjykimit, anashkalohen. Kjo është veçanërisht shqetësuese në realitetin shqiptar për sa i përket paraburgimit, ku zbatimi i

kësaj mase drastike duket se është mjaft i shpeshtë, dhe nuk përfaqëson aspak një përjashtim.²³⁰

Në këtë sfond, duhen marrë masa konkrete dhe pragmatike për të adresuar problemet e renditura më lart. Gjykatat e apelit duhet të zbatojnë funksionet e tyre rishikuese me më shumë forcë dhe efikasitet në këtë kontekst të rëndësishëm, dhe të parashtrajnë udhëheqje reale për gjykatat më të ulëta duke iu tërhequr vëmendjen tek detyra e tyre për të zbatuar ligjin. Kushtet ligjore për vendimet për paraburgim duhet të ritheksohen nga autoritetet e larta zyrtare. Trajnime të orientuara drejt praktikës mbi parimet bazë dhe kuadrin ligjor për paraburgimin duhen zhvilluar si me gjyqtarë të shkallës së parë, ashtu edhe me ata të apelit.

Më nëntor 2006, një nismë e përbashkët e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe e Këshillit të Evropës ofroi trajnim për gjyqtarë, avokatë mbrojtës për çështje penale, prokurorë dhe punonjës policie, mbi kuadrin ligjor vendës dhe ndërkombëtar për arrestin dhe paraburgimin.²³¹ Në seminarët trajnuese morën pjesë 85 vetë nga Tirana dhe Vlora. Megjithëse trajnimi mund të konsiderohet si mjaft i suksesshëm për sa i përket shkallës së pjesëmarrjes dhe interesit të shfaqur nga pjesëmarrësit, diskutimet gjatë trajnimit gjithashtu nxorën në pah nevojën për një kuptim më të mirë nga ana e pjesëmarrësve si të parimeve bazë të drejtësisë për procedurat e paraburgimit, ashtu edhe të kriterëve ligjore specifike për zbatimin e këtyre masave në rastet konkrete (për shembull ekzistenca e “dyshimit të arsyeshëm”, plus një ose më shumë nga tri shkaqet që justifikojnë paraburgimin, plus përpjesëtueshmërinë e masës në rastin konkret). Gjithashtu, megjithëse një nismë me vlera, trajnimi ishte i kufizuar për sa i përket shtrirjes – në fakt, asnjë nga 25 gjyqtarët që morën pjesë në trajnim nuk ishte nga gjykatat e apelit.

²³⁰ Në 2005, 16.987 procedime penale ishin në pritje të gjykimit, me 9.439 të pandehur, 2.984 prej të cilëve (rreth një e treta) u mbajtën në paraburgim. Shih “Informim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2005” (8 maj 2006). I disponueshëm në <http://www.pp.gov.al/alb/shtypi/FJALIM%20KUVEND.html> (vizituar për herë të fundit më 19 nëntor 2007).

²³¹ Çdo seancë trajnimi zgjati dy ditë.

V. REKOMANDIME

- Rekomandohet që të gjitha gjykatat të japin arsyetim të përshtatshëm dhe të saktë në vendimet për caktimin e masës së sigurimit, qofshin vendime fillestare, zgjatje të paraburgimit, apo vendime të gjykatës së apelit.
- Gjykatat e apelit kanë për detyrë të ushtrojnë autoritetin e tyre rishikues në mënyrë të përshtatshme dhe efikase, përfshirë edhe në kontekstin e ankimeve të bëra kundër vendimeve për caktimin e masës së sigurimit. Ato kanë për detyrim të shqyrtojnë me vërtetësi dhe hollësi ekzistencën e fakteve dhe argumenteve konkrete që përlligjin paraburgimin, në përputhje me standardet shqiptare dhe ndërkombëtare për një gjykim të drejtë, dhe të prishin ato vendime ku mungon arsyetimi i plotë.
 - Gjykata e apelit duhet të shqyrtojë vendimet për paraburgim në tërësinë e tyre, pavarësisht nga shkaqet e ankimit apo ato të paraqitura në vendimin që është marrë në shqyrtim.
- Do të ishte mirë që në vendimet e tyre, gjykatat e apelit të udhëzonin në mënyrë të vazhdueshme gjykatat më të ulëta që vendimet për paraburgim të përmbajnë një arsyetim të detajuar dhe të individualizuar që merr në konsideratë ekzistencën e shkaqeve provuese për të urdhëruar paraburgimin në një rast konkret.
- Do të rekomandohej që gjykatat e apelit të mos abdikojnë nga funksioni i tyre rishikues, dhe në mënyrë të vazhdueshme të lëshojnë vendime të arsyetuara në mënyrë korrekte duke i udhëzuar gjykatat më të ulëta që të justifikojnë drejt vendimet për paraburgim, në përputhje me të drejtën shqiptare dhe atë ndërkombëtare.

Mëspecifikisht, gjykatat e apelit duhet t'u kërkojnë gjykatave më të ulëta që të:

- citojnë provat e rëndësishme materiale dhe rrethanat specifike të çështjes që çuan në përfundimin se masa e arrestit në burg është e ligjshme;
- shqyrtojnë ekzistencën e vazhdueshme të dyshimit të arsyeshëm kundër të pandehurit kurdoherë që caktohet masa e arrestit në burg, në kombinim me një nga tri shkaqet ligjore (rreziku i largimit, rreziku i dëmtimit të provave, rreziku i krimeve të tjera);
- provojnë që masa alternative ndaj paraburgimit nuk janë të përshtatshme për rastin në fjalë, që do të thotë se arresti në burg, në fakt, është masa e fundit nën rrethanat specifike;

- tregojnë se argumentet e mbrojtjes të paraqitura në ankim janë shqyrtuar drejt, duke i marrë ato në konsideratë shprehimisht dhe në mënyrë specifike;
- mbështeten më shumë në masa sigurie alternative si ato të renditura në nenet 233-237 dhe 239 të KPrP-së, kur shihet e përshtatshme.
- Do të ishte mirë që Këshilli i Lartë i Drejtësisë të merrte në konsideratë mundësinë për të lëshuar një qarkore duke i kujtuar gjykatat se të gjitha vendimet për paraburgim duhen marrë në bazë të një vendimi plotësisht të arsyetuar e të shkruar ku detajohen shkaqet për caktimin e masës e arrestit në burg dhe provat në mbështetje të këtyre shkaqeve. Qarkorja mund të shprehë qartë se mungesa e justifikimit në një vendim për caktimin e masës së arrestit në burg, vetëm parafrazimi i ligjit, apo përdorimi i një formulimi standard, përbëjnë shkelje të procedurës penale, dhe si rrjedhojë, përbëjnë bazë për ankim. Do të ishte mirë që qarkorja të përmendte qartë se është detyrë e gjykatave të apelit që të shqyrtojnë me përpikëri ekzistencën dhe provat e këtyre shkaqeve (pavarësisht nga shkaqet e ngritura në ankim), dhe të ndryshojnë ose prishin ato vendime që janë të argumentuara në mënyrë të pamjaftueshme ose të cilave u mungon justifikimi.
- Rekomandohet që programi profesional fillestar i Shkollës së Magjistraturës dhe programi i formimit të vazhduar profesional mbi edukimin ligjor që mbulojnë arsyetimin dhe shkrimin ligjor, të trajtojnë specifikisht kriteret e vendimeve për caktimin e masës së arrestit në burg. Në këtë kontekst:
 - shembujt më të mirë të vendimeve për arrest në burg (vendime të arsyetuara drejt) duhet t'u shpërndahen të gjithë gjyqtarëve, përfshirë edhe gjyqtarët e apelit, si tregues të praktikave më të mira në këtë fushë, dhe ushtrime praktike dhe studime rasti të bazuara në ngjarje të vërteta mund të përdoren si instrumente pedagogjike parësore;
 - do të ishte mirë që një broshurë mbi arsyetimin ligjor në kuadrin e paraburgimit t'u shpërndahet të gjithë gjyqtarëve. Në broshurë do të trajtoheshin: e drejta kombëtare dhe ndërkombëtare që ka lidhje me paraburgimin dhe jurisprudenca (përfshirë atë në apel); udhëzime të përshtatshme dhe lehtësisht të përdorshme dhe lista të faktorëve dhe shkaqeve që duhen marrë në konsideratë sipas së drejtës vendëse, praktikave më të mira dhe kopje të vendimeve model, si nga Shqipëria ashtu edhe nga vende të tjera. Donatorë ndërkombëtarë ndoshta mund të sigurojnë financime dhe këshillim për prodhimin e broshurës.

- Do të rekomandohej që gjyqtarët e gjykatave të apelit të trajnoheshin mbi çështjet që kanë lidhje me paraburgimin, si dhe mbi si të vlerësonin, në raste individuale, ekzistencën e:
 - kriterit të dyshimit të arsyeshëm
 - rrezikut të largimit, ndërhyrjes në procesin e drejtësisë, dhe rrezikut të krimeve të tjera; dhe
 - kriterit të përpjesëtueshmërisë dhe domosdoshmërisë.
- Rekomandohet që trajnimi të bazohet, mes të tjerash, në diskutimin e çështjeve të GjEDNj-së që trajtojnë arsyetimin ligjor në kontekstin e paraburgimit dhe vërtetimin individual të shkaqeve për paraburgim. Gjithashtu, diskutimet të bazoheshin, sa më shumë që të ishte e mundur, mbi analizën e fakteve dhe rrethanave konkrete në çështje individuale.
- Do të ishte mirë që ushtrime praktike mbi mënyrën e hartimit të një vendimi për paraburgim të përdroreshin si një nga instrumentet pedagogjike, dhe gjyqtarët e gjykatave të apelit të pajiseshin me një vendim model se si t'i udhëzojnë gjykatat më të ulëta që të tregojnë në mënyrë specifike ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme në çdo çështje.
- Do të këshillohej që Avokati i Popullit, kryesisht, në bazë të ankesave individuale, të zhvillonte një hetim të plotë për ato raste ku pretendohet se autoritetet kompetente gjyqësore kanë gabuar në dhënien e masës arrest në burg, dhe të rekomandonte zgjidhje aty ku vërtetohen shkelje.²³²
- Rekomandohet gjithashtu që, Inspektorati nën Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe nën Ministrinë e Drejtësisë të kryejë rregullisht inspektime mbi mënyrën se si trajtohen nga gjykatat çështjet që lidhen me paraburgimin.²³³

²³² Shih ligjin nr. 8454, datë 16 shkurt 2000, "Për Avokatin e Popullit", nenet 12, 21.

²³³ Ligji nr. 8436, datë 28 dhjetor 1998, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", neni 17, deklaron se inspektorët emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Ministrisë së Drejtësisë. Ligji shprehet, mes të tjerash, se:

inspektorët, të cilët ngarkohen të inspektojnë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit për të verifikuar ankesat e shtetasve dhe të institucioneve, organizimet e shërbimeve gjyqësore, të bëjnë evidentimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve në kuptim të nenit 45 të këtij ligji, ngarkesën në punë dhe në tërësi eficientë e gjykatave.

Shih gjithashtu ligjin nr. 8811, datë 17 maj 2001, "Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë", neni 16, pika 1 (a), ku thuhet se Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë:

verifikon ose i dërgon Ministrisë së Drejtësisë për trajtim ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera që i drejtohen Këshillit të Lartë të Drejtësisë për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përbushjen e rregullt të detyrës. Inspektorati verifikon vetëm ato ankesa të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor ose për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues. Verifikon ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, të cilat gjykohen prej tij për t'u ndjekur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

KREU 3

VONESAT NË PROCEDIMET E ÇËSHTJEVE PENALE NË APEL

I. HYRJE

E drejta për t' u gjykuar brenda një afati kohor të arsyeshëm njihet nga e drejta ndërkombëtare dhe pasqyron "rëndësinë e dhënies së drejtësisë pa vonesa, të cilat mund të vënë në rrezik efektshmërinë dhe besueshmërinë e saj".²³⁴ Vonesat në shqyrtimin e çështjeve penale dhe zvarritjet e mëdha në gjykim nxisin mosndëshkimin dhe pakësojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Procedurat ligjore duhet të jenë mjaft të shkurtra me qëllim që të garantojnë siguri ligjore për qytetarët dhe për shtetin. Parimi i sigurisë ligjore ka rëndësi të veçantë në çështjet penale, ku kërkesa për afate kohore të arsyeshme jo vetëm i mbron personat e akuzuar nga ankthi i tepërt dhe i zgjatur mbi të ardhmen e tyre, por gjithashtu u garanton atyre që drejtësia jepet dhe se njerëzit e shohin dhënien e saj.

Me qëllim që të garantohet zhvillimi joproblematik i procedimeve gjyqësore, transmetimi dhe qarkullimi i akteve të tilla si fletëthirrjet, vendimet, kërkesat ankimore – pavarësisht nëse qarkullohen brenda gjykatës ose ndërmjet gjykatave – duhet bërë me efikasitet dhe në kohën e duhur. Moszhvillimi sipas rregullave të caktuara dhe vonesat në praktikën me të cilën kryhen këto veprime kanë ndikimin e mundshëm që ta pengojnë gjykatën në respektimin e një procesi të rregullt ligjor dhe e standardeve të një gjykimi të drejtë. Megjithatë, më shpesh, shtyrjet dhe vonesat rezultojnë thjesht në humbje kohe, përsëritje procedurash dhe në kosto shtesë që lidhen me ricaktimin e seancave gjyqësore.

Në Shqipëri, vonesat në përgatitjen e ankimit për çështjet penale shkaktohen kryesisht nga mosrespektimi i afateve kohore procedurale për dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe transferimin e dosjeve gjyqësore ndërmjet gjykatave, si dhe për shkak të shtyrjeve të shpeshta dhe të pajustificuara të seancave gjyqësore, si në shkallën e parë ashtu edhe në apel. Këto vonesa në pjesën më të madhe u atribuohen ngarkesës së madhe të punës, mungesës së bashkëpunimit mes autoriteteve gjyqësore, procedurave administrative gjyqësore të vjetruara dhe joefikasitetit, si dhe mosparaqitjes së palëve ose dëshmitarëve.

²³⁴ Çështja "H kundër Francës", GjEDNj, 24 tetor 1989, paragrafi 58.

Qëllimi i këtij kapitulli është që të japë informacion mbi shpeshhtësinë dhe shkaqet kryesore të vonesave në gjykatat penale të apelit dhe të japë rekomandime konkrete për përmirësime në këtë fushë. Në këtë kapitull jepen të dhëna statistikore mbi ecurinë e apelit për çështjet penale në lidhje me afatet procedurale të vendosura në Kodin e procedurës penale (afatet për dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe për dorëzimin e dosjes së çështjes nga gjykata e shkallës së parë në atë të shkallës së dytë).

II. E DREJTA PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE DHE AJO SHQIPTARE

E drejta për t'u gjykuar pa vonesa të tepërta mbrohet nga e drejta ndërkombëtare. Neni 6, pika 1, i KEDNj-së dhe neni 14, pika 3 (c) i PNDKCP-së i garantojnë kujtdo të drejtën për një seancë gjyqësore brenda një periudhe kohore të arsyeshme. Qëllimi i kësaj garancie është mbrojtja e "të gjitha palëve në procedimet gjyqësore ... kundër vonesave të panevojshme procedurale".²³⁵ Në çështjen *H. kundër Francës*, GjEDNj-ja theksoi "rëndësinë e dhënies së drejtësisë pa vonesa që mund të vë në rrezik efektshmërinë dhe besueshmërinë e saj".²³⁶ Në çështjet penale, kjo garanci i shërben gjithashtu funksionit të mbrojtjes së individëve nga të qenit për një kohë të gjatë të paqartë mbi fatin e tyre.²³⁷ Gjykimi i shpejtë është veçanërisht i rëndësishëm kur personi i akuzuar mbahet në paraburgim. Në një rast të tillë, ligji kërkon që i burgosuri të ketë të drejtën të gjykohet brenda një periudhe kohe të arsyeshme ose të lirohet nga paraburgimi. Periudha kohore e arsyeshme garanton që koha ecën që nga data kur personi akuzohet²³⁸ deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, përfshirë shterimin e gjithë rrugëve të zakonshme të ankimit.²³⁹

²³⁵ Çështja "Stögmüller kundër Austrisë", GjEDNj, 10 nëntor 1969, paragrafi 5.

²³⁶ Çështja "H kundër Francës", GjEDNj, 24 tetor 1989, paragrafi 58.

²³⁷ Çështja "Stögmüller kundër Austrisë", GjEDNj, 10 nëntor 1969, paragrafi 5.

²³⁸ Çështja "Imbroscia kundër Zvicrës", GjEDNj, 24 nëntor 1993, paragrafi 36. Sipas GjEDNj-së, fjala "akuzë" zakonisht tregon njoftimin zyrtar, i cili i bëhet një individit nga autoriteti kompetent, të një deklaratë që personi ka kryer një vepër penale. Megjithatë, akuzës i duhet dhënë më tepër një kuptim "real" sesa një kuptim formal, si dhe është e nevojshme "të shohim përtej pamjes së jashtme dhe t'i hetojmë faktet e procedimit në fjalë". Për të marrë një vendim nëse ka ose jo një akuzë, analizohet nëse i dyshuari "është ndikuar thelbësisht prej hapave që ndërmerren ndaj tij". Shih çështjen "Deweere kundër Belgjikës", GjEDNj, 27 shkurt 1980, paragrafi 42, 44 dhe 46. Në praktikë, një person i nënshtrohet një akuze, atëherë kur p.sh., arrestohet për një vepër penale, kur i bëhet e ditur zyrtarisht ndjekja penale ndaj tij ose kur personi cakton një avokat mbrojtës pasi organi i prokurorisë ka hapur një dosje, në vijim të një kallëzimi të bërë në polici. Shih D.J. Harris, M. O'Boyle, C. Warbrick, *Law of the European Convention on Human Rights* [E drejta e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut] (Londër, Butterworths, 1995), faqet 171-172.

²³⁹ Çështja "Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë", GjEDNj, 15 korrik 1982, paragrafi 76; çështja "Neumeister kundër Austrisë", GjEDNj, 27 qershor 1968, paragrafi 19. Shih gjithashtu Komentin e Përgjithshëm 13, paragrafi 10 i Komitetit për të Drejtat e Njeriut që deklaroi se garancia për t'u gjykuar pa vonesa të tepërta lidhet "jo vetëm me kohën kur duhet të fillojë gjyqi, por edhe me kohën kur duhet të mbarojë dhe të jepet gjykimi; të gjitha etapat duhet të zhvillohen pa vonesa të kota".

Autoritetet janë të detyruara të sigurojnë përfundimin e të gjithë procedimeve dhe nxjerrjen e vendimeve përfundimtare brenda një periudhe kohore të arsyeshme. Për të përcaktuar se çfarë do të thotë “afat kohor i arsyeshëm” në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, duhen marrë parasysh rrethanat e çdo çështjeje duke përfshirë, veçanërisht, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e të akuzuarit, *sjelljen e autoriteteve në atë çështje*, si dhe rëndësinë e asaj që rrezikohet për të pandehurin.²⁴⁰ Në disa juridiksione është vendosur që për të përcaktuar nëse ka shkelje të nenit 6 të KEDNj-së për shkak të vonesave procedurale të pajustificuara, nuk është e domosdoshme të tregohet se personi i akuzuar është cenuar gjatë përgatitjes ose paraqitjes së mbrojtjes.²⁴¹

Vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të merren parasysh për të përcaktuar nëse ka patur shkelje të së drejtës për një seancë gjyqësore brenda një afati kohor të arsyeshëm. Kështu, autoritetet shtetërore nuk janë përgjegjëse për vonesat që i atribuohen të pandehurit ose avokatëve të tij.²⁴² Megjithatë, shteti përgjigjet për vonesat që i atribuohen prokurorisë ose gjykatës. Me qëllim që të bëhet i mundur administrimi i menjëhershëm i drejtësisë, shtetet duhet të garantojnë shërbime gjyqësore efçente. Në çështjen *Muti kundër Italisë*, GjEDNj-ja u shpreh se shtetet kanë për detyrë “t’i organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që t’i lejojnë gjykatat të përmbushin kërkesat e nenit 6, pika 1, përfshirë atë të gjykimit brenda një afati kohor të arsyeshëm”.²⁴³ Kështu, ngarkesa shumë e madhe e çështjeve dhe numri i kufizuar i gjyqtarëve mund ta justifikojnë vonesën vetëm në rast se këto rrethana janë të jashtëzakonshme, të përkohshme, dhe jo institucionale. Në raste të tilla, duhen marrë menjëherë masa të përshtatshme – si caktimi i gjyqtarëve ose stafit administrativ shtesë – në mënyrë që të zgjidhet problemi.²⁴⁴ Vonësata që rezultojnë nga zvarritjet e gjata të punës në sistemin gjyqësor shoqëruar me mosmarrjen e masave korrigjuese nga ana e shtetit, janë konsideruar si shkelje të KEDNj-së.²⁴⁵ Këto vonesa kanë të bëjnë me transferimin e çështjeve ndërmjet gjykatave, me komunikimin e vendimit personit të akuzuar, me përgatitjen

²⁴⁰ Çështja “Buchholz kundër Republikës Federale të Gjermanisë”, GjEDNj, 6 maj 1981, paragrafi 49. Në raste të tjera, GjEDNj-ja ka bërë një vlerësim të përgjithshëm në vend që t’u referohej këtyre kritereve.

²⁴¹ Çështja “Crummock LTD kundër HM Advocate”, The Times, 9 maj 2000; cf. Att.-Gen.’s Ref. (Nr. 1 i 1990) ç1992] Q.B. 630.

²⁴² Çështja “König kundër Republikës Federale të Gjermanisë”, GjEDNj, 28 qershor 1978. Shih gjithashtu çështjen “Balliu kundër Shqipërisë”, GjEDNj, 16 qershor 2005.

²⁴³ Çështja “Muti kundër Italisë”, GjEDNj, 23 mars 1994, paragrafi 15; çështja “Süßmann kundër Gjermanisë”, GjEDNj, 16 shtator 1996, paragrafi 55-56. Shih gjithashtu çështjen “Boddaert kundër Belgjikës”, GjEDNj, 12 tetor 1992, paragrafi 39 (që deklaroi se gjykatat vendëse kanë për detyrë t’i trajtojnë në mënyrë korrekte çështjet që ju paraqiten).

²⁴⁴ Çështja “Buchholz kundër Gjermanisë”, GjEDNj, 6 maj 1981, paragrafi 51; çështja “Horvat kundër Kroacisë”, GjEDNj, 26 korrik 2001, paragrafi 59.

²⁴⁵ Çështja “Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës”, GjEDNj, 13 korrik 1983, paragrafët 27-32; çështja “Guincho kundër Portugalisë”, GjEDNj, 10 korrik 1984, paragrafët 40-41.

e ankimit dhe me zhvillimin e seancës gjyqësore në apel.²⁴⁶ Në çështjen *Agga kundër Greqisë*, për shembull, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut arriti në përfundimin se autoritetet shtetërore ishin përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga mosparaqitja e dëshmitarëve të palës akuzuese dhe nga greva e nëpunësve gjatë seancës gjyqësore të shkallës së parë, si dhe nga zvarritjet në gjykatë që vinin nga një grevë e avokatëve, e cila kishte shkaktuar vonesa në procedimet e shkallës së dytë.²⁴⁷ Ndërkohë që e drejta për t'u gjykuar brenda një afati kohor të arsyeshëm ka një rëndësi kryesore për të siguruar administrimin e drejtë të drejtësisë, kjo e drejtë duhet balancuar me të drejtën e personit të akuzuar për të pasur kohë të mjaftueshme dhe lehtësira për përgatitjen e mbrojtjes së tij.

Duke pasqyruar standardet ndërkombëtare, neni 42 i Kushtetutës shqiptare thekson se kushdo ka të drejtën për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati kohor të arsyeshëm.²⁴⁸ Është përgjegjësi e gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor që të sigurojnë se të gjithë ata që luajnë një rol në procedime të bëjnë çmos për të shmangur çdo vonesë të panevojshme.²⁴⁹

III. DORËZIMI DHE KOMUNIKIMI I AKTEVE TË GJYKATËS

Dorëzimi dhe komunikimi i akteve të gjykatës në mënyrë të shpejtë dhe efçente është një tipar kryesor i sistemeve gjyqësore moderne e funksionale, si dhe është përgjegjësi e autoriteteve gjyqësore. Sipas së drejtës shqiptare, kryetari është kryesisht përgjegjës për drejtimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të gjykatës si dhe për organizimin dhe funksionimin e administratës së gjykatës.²⁵⁰ Me qëllim që të garantohet një proces sa më efektiv e pa pengesa në procedimet ligjore, transmetimi dhe qarkullimi i akteve të tilla si fletëthirrjeve, vendimeve, kërkesave ankimore (brenda dhe ndërmjet gjykatave) duhet bërë në kohën e duhur, përndryshe ekziston rreziku i kompromentimit të standardeve të procesit të drejtë.

A. Dorëzimi i vendimeve me shkrim nga gjykatat e shkallës së parë

Një nga të metat e vëna re në procedimet e çështjeve penale në apel, është vonesat e shpeshta dhe mungesa e unifikimit të praktikave që kanë të bëjnë me dorëzimin

²⁴⁶ Po aty. Shih gjithashtu çështjen "Orchin kundër Mbretërisë së Bashkuar" (1983), 6 E.H.R.R. 391 (paraqitja e një *nolle prosequi*) 1983.

²⁴⁷ Çështja "Agga kundër Greqisë", GjEDNj, 27 janar 2000, paragrafi 24-26.

²⁴⁸ Kushtetuta, neni 42, pika 2.

²⁴⁹ Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë së administratës gjyqësore bëhet nga kryetari i gjykatës, zëvendëskryetari dhe kancelari. Shih Urdhrin nr. 1830 të Ministrit të Drejtësisë, datë 3 prill 2001, "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore", neni 2.

²⁵⁰ Shih po aty, neni 7. Kryetari mund të zëvendësohet nga zëvendëskryetari.

e vendimeve me shkrim nga gjykatat e shkallës së parë. Vonesat në nxjerrjen e vendimeve me shkrim mund të komprometojnë të drejtën e një personi të akuzuar për t' u gjykuar pa vonesa të tepërta, sepse ato mund të zgjasin kohën e trajtimit dhe dëgjimit të ankimit të të akuzuarit nga një gjykatë më e lartë. Mund të pengojnë gjithashtu mundësinë e të pandehurit për të ushtruar efektivisht të drejtën për apel kur ai nuk ka akses në vendimin me shkrim, duke e kufizuar mundësinë për të ngritur argumente kundër vendimit. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse merret në konsideratë kërkesa procedurale për ta depozituar "menjëherë" vendimin gjyqësor në kuadrin e afatit të shkurtër ligjor për të bërë një ankim, që është dhjetë ditë nga dita e nesërme e shpalljes ose njoftimit të vendimit.²⁵¹ Ndërsa vonesat në dorëzimin e vendimeve me shkrim janë përgjegjësi e autoriteteve gjyqësore, dispozitat e KPrP-së që dispijlojnë afatin kohor për dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe për paraqitjen e ankimeve duket se janë të papërshtatshme. Kur kombinohen dhe lexohen së bashku, këto dispozita parashikojnë afate kohore joreale dhe shumë të shkurtra, të cilat mund të komprometojnë *de facto* ushtrimin e së drejtës për apel.

1. E drejta përkatëse shqiptare dhe ndërkombëtare

Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka argumentuar se e drejta për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm përfshin të drejtën për të pasur një vendim të arsyetuar, në gjykimin e çështjes në shkallë të parë dhe atë në apel, brenda një afati kohor të arsyeshëm. Më tej, ky Komitet shprehet se *mosdhënia e një vendimi të arsyetuar me shkrim brenda një afati kohor të arsyeshëm e pengon të pandehurin që të gëzojë ushtrimin efektiv të së drejtës për rishikimin e dënimit dhe të vendimit nga një gjykatë më e lartë.*²⁵² Po ashtu, në çështjen *Adjianastassiou kundër Greqisë*, GjEDNj-ja argumentoi se mosdhënia në kohë e një vendimi të arsyetuar, për të bërë që i pandehuri të paraqesë në mënyrë të plotë shkaqet e tij për rishikim para Gjykatës së Kasacionit, i mohoi atij kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen.²⁵³ Në këtë rast, Gjykata Ushtarake e Apelit në Greqi e kishte shpallur vendimin e saj me gojë në prani të personit të akuzuar (një ushtarak i dënuar për përhapje të sekreteve ushtarake), por vetëm në mënyrë të përmblodhur dhe pa ngritur disa çështje që ishin marrë parasysh për marrjen e vendimit. Atëherë kur personi i akuzuar mori dokumentin e plotë të vendimit të gjyqit, ai u pengua që të zgjeronte shkaqet e ankimit në Gjykatën e Kasacionit. Përveç mospasjes së një vendimi të arsyetuar, ekzistenca e *afateve*

²⁵¹ KPrP, neni 415, pika 1.

²⁵² Shih Raportin e Komitetit për të Drejtat e Njeriut në çështjen "Currie kundër Xhamajkës", 29 mars 1994 (Komunikata Nr. 377/1989); shih gjithashtu çështjen "Victor Francis kundër Xhamajkës", Komiteti për të Drejtat e Njeriut, 24 mars 1993 (Komunikata Nr. 320/1988); çështja "Little kundër Xhamajkës", Komiteti për të Drejtat e Njeriut, 1 nëntor 1991 (Komunikata Nr. 283/1988).

²⁵³ Çështja "Hadjanastassiou kundër Greqisë", GjEDNj, 16 dhjetor 1992.

*kohore jashtëzakonisht të shkurtra për të bërë ankim mund të përbëjë një pengesë në realizimin e së drejtës për apel.*²⁵⁴

KPrP-ja parashikon se gjykata duhet të marrë një vendim menjëherë pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor.²⁵⁵ Pas shpalljes, vendimi duhet shkruar dhe arsyetuar duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.²⁵⁶ Më tej, neni 386, pika 1 e KPrP-së kërkon që vendimi të depozitohet në sekretarinë e gjykatës menjëherë pas shpalljes së tij.²⁵⁷ Pastaj nëpunësi i gjykatës e nënshkruan dhe shënon datën e depozitimit.²⁵⁸ Duke qenë se as Kodi i procedurës penale dhe as komentari i tij nuk thonë asgjë kundër, është e arsyeshme të supozohet se një kopje e vendimit të plotë dhe plotësisht të arsyetuar duhet të depozitohet në kohën e duhur pranë sekretares së gjykatës, pas shpalljes së tij në seancë. Kur interpreton termin “menjëherë”, komentari i KPrP-së thotë se vendimet e gjykatës duhen depozituar në sekretari brenda pesë ditëve nga dita që janë bërë.²⁵⁹ Për më tepër, duket se afati kohor procedural i ngurtë i vendosur nga neni 386, pika 1 e KPrP-së - i cili kërkon që vendimet të depozitohen në sekretarinë e gjykatës menjëherë pas shpalljes së tyre - imponon një kërkesë shumë të ngurtë, të cilën gjykatat shqiptare nuk kanë mundur ta respektojnë në praktikë. Gjetjet e mëposhtme duket se e mbështesin këtë argument.

2. Gjetjet

Siç u përmend më lart, e drejta shqiptare kërkon që vendimet të depozitohen në sekretarinë e gjykatës menjëherë pas shpalljes.²⁶⁰ Megjithatë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka vënë re se koha e dorëzimit të vendimeve me shkrim nga ana e gjykatave shqiptare nuk është kudo e njëjtë. Gjithashtu, vonesat e depozitimit të vendimeve gjyqësore të shkallës së parë pranë sekretarisë së gjykatës, për çështje themeli, janë të shpeshta.

Ashtu si në vende të tjera, në Shqipëri, gjykatat e shkallës së parë rrallë nxjerrin me shkrim vendime plotësisht të arsyetuara menjëherë pas shpalljes. Në fakt, është praktikë e zakonshme që vendimet të lexohen dhe të shpallen publikisht në bazë të shënimeve me dorë të bëra nga kryetari i trupit gjykues, dhe më pas

²⁵⁴ Report on the Situation of Human Rights in Panama [Raport mbi situatën e të drejtave të njeriut në Panama], OEA/Ser. L/V/II.44, dok. 38, rev. 1, 1978.

²⁵⁵ Marrja e vendimit nuk mund të shtyhet përveçse në rast pamundësie absolute. KPrP, neni 379.

²⁵⁶ KPrP, 382.

²⁵⁷ KPrP, neni 386, pika 1.

²⁵⁸ Kur i pandehuri është gjykuar në mungesë, atij i duhet dërguar njoftimi për depozitimin së bashku me një kopje të vendimit. KPrP, neni 386.

²⁵⁹ Komentari i KPrP-së, faqe 185.

²⁶⁰ KPrP, neni 386, paragrafi 1.

shënimet u jepen sekretareve të gjykatës për t'i shtypur sipas formatit standard. Shpesh, vendimet lexohen vetëm në mënyrë të përmbledhur në fund të gjyqit, ku gjyqtari lexon me zë "*dispozitivin*", d.m.th, konkluzionin e vendimit që jep vendimin e dënimit. Pjesa arsyetuese e vendimit zakonisht nuk lexohet ose lexohet vetëm pjesërisht. Në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, si dhe të faktorëve të tjerë si angazhimet dhe disponueshmëria e gjyqtarëve individualë, sasia e kohës që mund të duhet për të dorëzuar një vendim plotësisht të arsyetuar ndryshon në praktikë dhe zgjat nga disa ditë deri në disa javë.

Vonesat dhe mosnxjerrja në kohën që nevojitet e vendimeve me shkrim mund të komprometojnë të drejtën e të akuzuarit për t'u gjykuar pa vonesa të tepërta, duke qenë se këta faktorë mund ta zgjasin kohën e nevojshme për procedimin dhe për dëgjimin e të akuzuarit nga një gjykatë më e lartë. Ndërkohë që për vonesa të tilla janë përgjegjës gjyqtarët individualë, duket se dispozitat procedurale që dispijlojnë afatin kohor për dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe për paraqitjen e ankimeve janë të papërshtatshme. Për të sqaruar më tej, ligji kërkon që ankimi të paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dita e nesërme e shpalljes ose e njoftimit të vendimit.²⁶¹ Kur dispozitat e mësipërme kombinohen dhe lexohen së bashku, ato parashikojnë afate jashtëzakonisht të shkurtra. Ndërkohë që ligji ia njeh palës ankimuese të drejtën që, brenda pesë ditëve para seancës në apel, ta ndryshojë ankimin, duke përmendur arsye të tjera që lidhen me të,²⁶² vonesat dhe praktikatat e paunifikuara të gjykatave në dorëzimin e vendimeve me shkrim mund të pengojnë të pandehurit të ushtrojnë me efektivitet të drejtën e tyre për apel. Nëse të pandehurit, përfaqësuesit e tyre ligjorë ose prokurorët nuk kanë akses në kopjet zyrtare të vendimeve të arsyetuara me shkrim, mundësia e tyre për të ngritur argumente kundër vendimit dhe për të gjetur të meta në interpretimin e ligjit nga ana e gjyqtarit komprometohet.²⁶³

Në këtë kuadër, avokatët i janë shprehur Prezencës së OSBE-së në Shqipëri se shpesh u duhet të paraqesin një ankim "të thjeshtuar", të cilin e hartojnë duke u mbështetur në kujtesën e tyre lidhur me vendimin e shpallur publikisht, me qëllim që të ushtrojnë të drejtën e ankimit brenda afatit ligjor të parashikuar (d.m.th., dhjetë ditë). Megjithëse ata shpesh marrin kopje të vendimit para se të dëgjohet apeli, kjo nuk ndodh për çdo rast. Në të paktën një çështje, ankuesi nuk i shprehu shkaqet për ankim si rezultat i drejtpërdrejtë i këtyre vonesave.²⁶⁴

²⁶¹ KPrP, neni 415, paragrafi 1.

²⁶² KPrP, neni 415, paragrafi 2.

²⁶³ Megjithëse në asnjërën prej kërkesave ankimore të shqyrtuara për këtë raport nuk përmendet ky problem, disa avokatë janë ankuar se vonesat në marrjen e vendimeve me shkrim i pengojnë të kryejnë në mënyrë efektive punën e tyre.

²⁶⁴ Shih çështjen Guri, të diskutuar në faqen 38-40, në të cilën prokurori bëri apel pa përmendur asnjë shkak ligjor.

Intervistat e zhvilluara në qershor 2006 nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri e ilustron më mirë këtë problem.²⁶⁵

Në **Tiranë**, avokatët mbrojtës për çështjet penale shprehen se me përjashtim të ankimeve ndaj një vendimi që urdhëron paraburgimin, vonesat për të marrë kopje të vendimeve në Gjykatën e Rrethit të Tiranës përbëjnë rregull, dhe jo përjashtim. Me sa duket, është pothuajse e pamundur që këto vendime të vihen në dispozicion brenda dhjetë ditëve pas shpalljes së tyre, duke kompromentuar në këtë mënyrë mundësinë për ta përgatitur si duhet çështjen për apel. Avokatët e intervistuar u shprehën se koha që nevojitet për përgatitjen e vendimeve me shkrim varet nga ngarkesa e punës dhe gatishmëria e sekretareve të gjykatës për të përmbushur detyrat e tyre dhe deri diku varet edhe nga zotësitë individuale të avokatit për t'i bindur këto të fundit. Sipas Kryetarit të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, ndërsa dispozitivi i vendimit²⁶⁶ shpesh publikohet në faqen e internetit të gjykatës ditën pas shpalljes, afati për dorëzimin me shkrim të të gjithë vendimit ndryshon nga çështja në çështje.²⁶⁷ Kancelari i Gjykatës së Rrethit të Tiranës deklaroi se shpesh atij i duhet t'i lutet kryetarit të seancës që t'i dorëzojë vendimet me shkrim brenda afatit dhjetëditor për paraqitjen e ankimit. Ai deklaroi gjithashtu se Ministria e Drejtësisë ka nxjerrë një udhëzim për përgatitjen e vendimeve me shkrim brenda pesë ditëve. Megjithëse, pavarësisht nga përpjekjet, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nuk ishte në gjendje ta konfirmonte këtë, ia vlen të vihet në dukje se ekzistenca e një udhëzimi nga Ministria e Drejtësisë si autoritet ekzekutiv nuk e zëvendëson ligjin, pra afatin që jep KPrP-ja. Sekretarja e gjykatës konfirmoi se ajo e merr vendimin dhe dosjen përkatëse të çështjes vetëm disa ditë pas shpalljes.

Në **Shkodër**, vonesat në dorëzimin e vendimeve me shkrim janë një çështje seriozisht shqetësuese. Sipas kancelarit dhe kryesekretares së Gjykatës së Rrethit të Shkodrës, dorëzimi i vendimeve me shkrim nga gjykatat e shkallës së parë mund të shkojë nga pesë deri në shtatë ditë, por edhe deri në një muaj e gjysmë. Si rezultat i këtyre vonesave, vendimet e gjykatës nuk dërgohen në kohë në zyrën e prokurorisë për zbatim. Avokatët ankohen se në këto rrethana ata nuk janë në gjendje të përgatisin dhe të argumentojnë si duhet ankimet e tyre.

²⁶⁵ Të intervistuarit ishin avokatë mbrojtës që merren me çështje penale, gjyqtarë dhe personeli i administratës së gjykatave.

²⁶⁶ Kjo pjesë tregon veprën për të cilën akuzohet i pandehuri, vendimin e dënimit si dhe masën e llojin e dënimit.

²⁶⁷ Intervistë me z. Albert Meçe, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Tiranë, qershor 2006. Kryetari i Gjykatës së Rrethit Tiranë i informoi punonjësit e OSBE-së se kishte nxjerrë një udhëzim verbal për ta dorëzuar vendimin me shkrim brenda 10 ditëve pas shpalljes së tij.

Në **Kukës**, raportohet se vendimet me shkrim të gjykatës së rrethit dorëzohen nga njëzet ditë deri në katër muaj pas shpalljes së tyre. Në raste të tilla, ankimi i prokurorit bazohet vetëm në informacionin që përmban dosja e gjyqit. Sipas rregullores së brendshme të miratuar nga Gjykata e Rrethit të Tropojës, sekretarja e gjykatës duhet t'ia dorëzojë vendimin me shkrim zyrës së kancelarit brenda 5 ditëve nga shpallja. Sipas Kryetarit të Gjykatës së Rrethit të Tropojës, kur një palë synon të ankimojë një vendim, gjykata i vë në dispozicion asaj dosjen gjyqësore.

Sipas Kancelarit të Gjykatës së Apelit në **Durrës**, vendimet e gjykatës së rrethit dorëzohen me shkrim brenda një muaji nga shpallja e tyre.

3. Të dhëna statistikore mbi kohën që nevojitet për dorëzimin e vendimeve me shkrim

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka mbledhur të dhëna statistikore mbi numrin e ditëve nga data e shpalljes së një vendimi në përfundim të gjykimit të shkallës së parë në datën kur ky vendim depozitohet me shkrim në sekretarinë e gjykatës.

Ndërkohë që u kërkua informacion nga gjashtë gjykata të rretheve (Tiranë, Kukës, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër), nuk qe e mundur të merrej informacion nga gjykatat e rretheve Vlorë, Gjirokastër dhe Shkodër.²⁶⁸ Tabelat e mëposhtme tregojnë se në shumicën e rasteve vendimet me shkrim të gjykatave të rretheve që u morën si shembull ishin nxjerrë me vonesë, pasi kishte kaluar afati dhjetëditor për ankim.

Gjykata e Rrethit Tiranë

Me qëllim që të sigurohej informacion mbi intervalin kohor nga shpallja e vendimit deri në dorëzimin e vendimit me shkrim, nga regjistri i quajtur "*Numërori i vendimeve penale për gjykatat e shkallës së parë*" u morën si referencë 60 raste.

-Në 18 çështje penale (30%), fashikujt e gjykimit (përfshirë vendimin) iu dorëzuan sekretares së gjykatës nga 2 deri në 10 ditë pas datës së shpalljes së vendimit.

²⁶⁸Për mbledhjen e të dhënave, kryesekretareve dhe kancelarëve të gjashtë gjykatave të rretheve (Tiranë, Kukës, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër) iu kërkua ta jepnin informacionin përkatës ashtu siç ishte në regjistrat e gjykatave. Për një shpjegim mbi pamundësinë e marrjes së informacionit në Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër, shih më poshtë, faqe 89.

-Në 32 çështje (53%), pra shumica e çështjeve, fashikujt e gjykimit u dorëzuan 11-20 ditë pas datës së shpalljes së vendimit.

-Në 7 çështje (12%), fashikujt e gjykimit u dorëzuan në sekretari 21-30 ditë pas datës së shpalljes së vendimit.

-Në 3 çështje (5%), dosja iu dorëzua sekretares 31-40 ditë pas datës së shpalljes së vendimit.

Dosja iu dorëzua sekretares së gjykatës:	Nr. i çështjeve	Përqindja
ditën kur u shpall vendimi	0	0%
1 ditë më pas	0	0%
2-10 ditë më pas	18	30%
11-20 ditë më pas	32	53%
21-30 ditë më pas	7	12%
31-40 ditë më pas	3	5%
41-50 ditë më pas	0	0%
më shumë se 50 ditë më pas	0	0%
Totali i çështjeve	60	100%

Gjykata e Rrethit Durrës

Tridhjetë raste u morën si referencë nga regjistri i quajtur “Regjistri i çështjeve penale”.²⁶⁹

-Në 28 çështje penale (93%), pra shumica e çështjeve, fashikujt e gjykimit iu dorëzuan sekretares së gjykatës 2-10 ditë pas datës së shpalljes së vendimit.

-Në 2 çështje (7%), fashikujt e gjykimit iu dorëzuan sekretares së gjykatës 11-20 ditë pas datës të shpalljes së vendimit.

Dosja iu dorëzua sekretares së gjykatës:	Nr. i çështjeve	Përqindja
ditën kur u shpall vendimi	0	0%
1 ditë më pas	0	0%
2-10 ditë më pas	28	93%
11-20 ditë më pas	2	7%
21-30 ditë më pas	0	0%
31-40 ditë më pas	0	0%
41-50 ditë më pas	0	0%
më shumë se 50 ditë më pas	0	0%
Totali i çështjeve	30	100%

²⁶⁹ Gjykata e Rrethit Durrës ka një regjistër të veçantë të quajtur “Regjistri i çështjeve penale”, i cili përmban, ndër të tjera, informacion mbi datën dhe numrin e vendimit, vendimin e dënimit ndaj të pandehurit, apeluesin, numrin dhe datën e çdo vendimi të dhënë nga një gjykatë më e lartë. Ky regjistër përmban gjithashtu me shkrim dore datën në të cilën dosja e gjykatës (përfshirë vendimin e shkallës së parë) i është dorëzuar kryesekretares.

Gjykata e Rrethit Kukës

Tridhjetë raste u morën si referencë nga “Libri i dorëzimit të dosjeve” i Gjykatës së Rrethit Kukës.²⁷⁰

-Statistikat tregojnë se vetëm në 1 çështje (3 %) dosja e gjyqit u mor të nesërmen e ditës së shpalljes së vendimit, ndërkohë që asnjë dosje nuk u mor në të njëjtën ditë. Në një rast (3%) dosja iu dorëzua sekretares së gjykatës 2-10 ditë pas ditës në të cilën ishte shpallur vendimi.

-Në 9 çështje penale (30%), dosjet gjyqësore iu dorëzuan sekretares së gjykatës 11 deri 20 ditë pas ditës kur ishte shpallur vendimi.

-Në 5 çështje (17%), dosjet u morën 21-30 ditë pas ditës së shpalljes së vendimit të gjykatës.

-Në 4 çështje (13%) dosjet iu dorëzuan sekretares 31-40 ditë pas shpalljes së vendimit.

-Në 1 çështje (3%) dosja iu dorëzua sekretares 41-50 ditë pas shpalljes së vendimit.

-Për 9 çështje (30%), u deshën më shumë se 51 ditë që sekretarja të merrte fashikujt e gjykimit.

Dosja iu dorëzua sekretares së gjykatës:	Nr. i çështjeve	Përqindja*
ditën kur u shpall vendimi	0	0%
1 ditë më pas	1	3%
2-10 ditë më pas	1	3%
11-20 ditë më pas	9	30%
21-30 ditë më pas	5	17%
31-40 ditë më pas	4	13%
41-50 ditë më pas	1	3%
më shumë se 50 ditë më pas	9	30%
Totali i çështjeve	30	100%

Gjykatat e rretheve Vlorë, Gjirokastrë dhe Shkodër

Gjykata e Rrethit Shkodër nuk ka regjistër që të raportojë datën se kur është depozituar dosja e çështjes në sekretari. Sipas Kancelarit të Gjykatës së Rrethit Vlorë, megjithëse një regjistër i tillë nuk ekziston (d.m.th., regjistra të ardhur nga Ministria e Drejtësisë), sekretaret e gjykatës mund ta shënojnë këtë datë në mënyrë jozyrtare në blloqet e tyre private. Në Gjykatën e Rrethit

²⁷⁰ Në Kukës, regjistri i gjykatës së rrethit quhet “Libri i dorëzimit të dosjeve”. Ky regjistër përmban, ndër të tjera, emrin e të pandehurit, akuzën, emrin e kryetari të seancës, datën kur u shpall vendimi dhe datën kur dosja e plotë u dorëzua tek kryesekretarja.

* Shuma totale e përqindjeve të tabelës rezulton 99% për shkak të rumbullakosjes së disa shifrave. Megjithatë, shuma totale reale është 100%.

Gjirokastrë, sekretaria e gjykatës mban një regjistër që tregon datën kur ka përfunduar çështja si dhe datën kur i është dorëzuar kryesekretares dosja e gjyqit. Sekretarja e gjykatës ia mohoi Prezencës së OSBE-së në Shqipëri aksesin në këtë regjistër, duke deklaruar se ishte vetëm për “përdorim të brendshëm”.

4. Zgjidhje të mundshme lidhur me pamjaftueshmërinë e afateve procedurale për nxjerrjen e vendimeve me shkrim dhe paraqitjen e ankimeve

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mendon se vonesat në dorëzimin e vendimeve me shkrim mund të reduktohen pjesërisht nëpërmjet sqarimit dhe modifikimit të dispozitave procedurale mbi afatin kohor për përgatitjen e vendimeve me shkrim. Siç u përmend më lart, KPrP-ja parashikon se vendimi duhet depozituar në sekretarinë e gjykatës menjëherë pas shpalljes.²⁷¹ Kjo kërkesë ka rezultuar shumë e ashpër dhe është injoruar në praktikë, duke krijuar pasiguri dhe çoroditje. KPrP-ja parashikon gjithashtu një afat kohor të prerë dhe fiks (d.m.th., dhjetë ditë) për të ngritur ankim. Ky afat duket se është shumë i shkurtër, sidomos aty ku vonesat për dorëzimin e vendimeve me shkrim janë të shpeshta. Siç u përmend më lart, afatet kohore jashtëzakonisht të shkurtra për ankim janë parë nga GjEDNj-ja si pengesa për realizimin e së drejtës për apel.²⁷² Mund të argumentohet se afati kohor ligjor prej dhjetë ditësh për të ngritur ankim është jashtëzakonisht i shkurtër duke pasur parasysh se vendimet plotësisht të arsyetuara të gjykatës shpesh dorëzohen pasi kanë kaluar këto dhjetë ditë.

Një zgjidhje më e mirë mund të ishte një rregullim i veçantë i afateve kohore për përgatitjen e vendimit me shkrim kur kjo mund të kërkojë më shumë kohë (p.sh., kur arsyetimi i vendimit mund të kërkojë më shumë kohë në çështjet komplekse),²⁷³ dhe afati kohor për paraqitjen e ankimit të nisë nga momenti kur dorëzohet një vendim me shkrim. Kjo mund të reduktojë vonesat dhe praktikën jo të unifikuar në dorëzimin e vendimeve me shkrim, duke garantuar nga ana tjetër ushtrimin efektiv të së drejtës për apel. Siç tregohet më poshtë, kodet procedurale të disa vendeve lejojnë më shumë fleksibilitet në vendosjen e afatit kohor për dorëzimin e vendimeve me shkrim të gjykatës dhe për paraqitjen e ankimeve.

²⁷¹ KPrP, neni 386, pika 1.

²⁷² Report on the Situation of Human Rights in Panama [Raport mbi situatën e të drejtave të njeriut në Panama], OEA/Ser. L/V/II.44, dokumenti 38, rev. 1, 1978.

²⁷³ Për shembull, Kodi shqiptar i procedurës civile parashikon që vendimet në çështjet civile të dorëzohen në sekretari pas procedimeve ose në çështje të ndërlikuara brenda dhjetë ditëve. Shih Kodin e procedurës civile, neni 308.

KPrP-ja e Bosnje-Hercegovinës, për shembull, parashikon që **vendimi të përgatitet me shkrim brenda 15 ditëve pa shpalljes së tij, dhe brenda 30 ditëve si përjashtim në çështje komplekse.**²⁷⁴ Nëse vendimi nuk shkruhet brenda afatit kohor të rekomanduar, kryetari i seancës është i detyruar ta informojë kryetarin e gjykatës përkatëse mbi arsyet e vonesës. Së fundi, po të jetë e nevojshme, kryetari do të ndërmarrë masat e nevojshme për ta shkruar sa më shpejt vendimin.²⁷⁵ Një kopje zyrtare e vendimit i dërgohet prokurorit dhe palës së dëmtuar, personit të akuzuar dhe avokatit mbrojtës, së bashku me udhëzimet për të drejtën e apelit.²⁷⁶ Përveç kësaj, KPrP-ja e Bosnje-Hercegovinës e përshtat afatin kohor për ngritjen e ankimit duke marrë si referencë datën e dorëzimit të vendimit me shkrim, dhe njëkohësisht parashikon një afat kohor më të gjatë. Sipas KPrP-së së **Bosnjës, ndërsa një apel mund të ngrihet zakonisht brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kopjes së vendimit, në çështjet komplekse, me kërkesën e palëve ose të avokatit mbrojtës, gjykata mund ta zgjasë afatin për ngritjen e ankimit në një maksimum prej 15 ditësh.**²⁷⁷ Afati për ngritjen e ankimit fillon vetëm kur gjykata vendos mbi këtë kërkesë.²⁷⁸ Pala tjetër dhe avokati mbrojtës mund t'i paraqesin gjykatës përgjigjet e tyre ndaj ankimit brenda tetë ditëve nga data e njoftimit të ankimit.²⁷⁹

Po ashtu, **KPrP-ja e Republikës Serbe** shprehet se **vendimi me shkrim duhet përgatitur brenda tetë ditëve pas shpalljes, dhe përjashtimisht brenda 15 ditëve në rastin e çështjeve komplekse.** Nëse justifikohet nga numri i të pandehurve ose nga numri i veprave penale, nga kompleksiteti i provave të paraqitura dhe rrethana të tjera të rëndësishme që llogariten në kompleksitetin e jashtëzakonshëm të çështjes, Kryetari i trupit gjykuesi kërkon Kryetarit të Gjykatës të miratojë zgjatjen e afatit kohor deri në një muaj. Nëse vendimi nuk shkruhet brenda afatit kohor të rekomanduar, Kryetari i trupit gjykues është i detyruar ta informojë me shkrim Kryetarin e Gjykatës mbi arsyet e vonesës, dhe së fundi, Kryetarit të Gjykatës i kërkohet të marrë masat e nevojshme për të siguruar përgatitjen sa më të shpejtë të vendimit.²⁸⁰ Dorëzimi i kopjes së vërtetuar të vendimit është gjithashtu përgjegjësi e gjykatës.²⁸¹ Për më tepër, ligji parashikon se e drejta për apelim kundër një gjykimi të dhënë nga një gjykatë e shkallës së parë ushtrohet brenda 15 ditëve nga data e dhënies së kopjes së vendimit.²⁸²

²⁷⁴ KPrP i Bosnje-Hercegovinës, neni 289 pika 1.

²⁷⁵ Po aty.

²⁷⁶ KPrP i Bosnje-Hercegovinës, neni 289 pikat 3 & 4.

²⁷⁷ KPrP i Bosnje-Hercegovinës, neni 292.

²⁷⁸ KPrP i Bosnje-Hercegovinës, neni 292, pika 3

²⁷⁹ KPrP i Bosnje-Hercegovinës, neni 302.

²⁸⁰ KPrP i Republikës së Serbisë, neni 384, pika 1-4.

²⁸¹ Po aty neni 384, pikat 6-8.

²⁸² Po aty, neni 387, pika 1.

Kodi italian i procedurës penale parashikon një afat kohor elastik për përgatitjen dhe depozitimin e vendimit dhe e përcakton periudhën për ngritjen e ankimit në bazë të datës së dorëzimit të vendimit. Ndërsa si rregull i përgjithshëm, vendimi i arsyetuar duhet depozituar në kancelarinë e gjykatës menjëherë pas botimit të tij, përjashtimisht mund të depozitohet brenda 15 ditëve nga data e shpalljes ose brenda një afati më të gjatë të vendosur nga gjyqtari. Ky afat më i gjatë në asnjë rrethanë nuk duhet të kalojë 90 ditë (duke nisur nga data e shpalljes së vendimit).²⁸³ Kur vendimi nuk depozitohet brenda 30 ditëve ose brenda afatit më të gjatë të vendosur nga gjyqtari, njoftimi i depozitimit i komunikohet prokurorit dhe u njoftohet palëve private që kanë të drejtë të apelojnë kundër vendimit, si dhe avokatit mbrojtës të së pandehurit.²⁸⁴ Afati për ankim është: (a) 15 ditë kur vendimi dorëzohet *me dyer të mbyllura* ose kur vendimi i arsyetuar pëgatitet me shkrim menjëherë pas shqyrtimit; (b) 30 ditë kur vendimi i arsyetuar dorëzohet me shkrim brenda 15 ditësh pas shqyrtimit; dhe (c) 45 ditë kur vendimi me shkrim depozitohet brenda afatit më të gjatë të caktuar nga gjyqtari, dhe në çdo rast pa kaluar 90 ditë nga shqyrtimi real.²⁸⁵ **Afatet e ankimit fillojnë:** (a) nga njoftimi i depozitimit të vendimit të shpallur me dyer të mbyllura; (b) nga leximi i vendimit të arsyetuar në seancë gjyqësore lidhur me palët që janë të pranishme ose mendohet të jenë të pranishme, megjithëse mund të mos jenë kur lexohet vendimi; (c) nga afati i zgjatur kur është përgatitur vendimi i arsyetuar (vendosur nga gjyqtari) ose nga njoftimi i depozitimit të tij në rastin e nenit 548, pika 2, pra një vendim i arsyetuar brenda 15 ditëve; (d) nga data kur vendimi iu njoftua (ose iu komunikua depozitimi) personit të akuzuar, i cili gjykohet në mungesë, dhe prokurorit në gjykatën e apelit.²⁸⁶

Sipas **Kodit suedez të procedurës gjyqësore**, vendimi në një çështje penale merret dhe dorëzohet nëse është e mundur, në gjyq të hapur. Kur kërkohet domosdoshmërisht kohë shtesë për përcaktimin ose shkrimin e vendimit, gjykata mund të vendosë ta shtyjë atë; megjithatë, **nëse nuk ka ndonjë pengesë të jashtëzakonshme, vendimi duhet shkruar dhe dorëzuar brenda një jave** nga përfundimi i seancës nëse i pandehuri është i paraburgosur, ose përndryshe, brenda dy javëve nga përfundimi i seancës. Nëse vendimi nuk dorëzohet në seancën kryesore, duhet dorëzuar në një seancë tjetër

²⁸³ Kodi italian i procedurës penale, nenet 548 dhe 544. Afati më i gjatë i vendosur nga gjyqtari zbatohet aty ku hartimi i pjesës arsyetuese të vendimit është veçanërisht kompleks për shkak të numrit të palëve të përfshira ose numrit dhe rëndësisë së akuzave. Shih Kodin italian të procedurës penale, neni 544, pika 3.

²⁸⁴ Kodi italian i procedurës penale, neni 548, pika 2. Neni 548, pika 3 thotë se njoftimi i depozitimit së bashku me një fragment të vendimit i dorëzohet personit të akuzuar të gjykuar në mungesë dhe i komunikohet prokurorit të përgjithshëm të gjykatës së apelit.

²⁸⁵ Po aty, neni 585.

²⁸⁶ Po aty, neni 585.

të gjykatës ose të shpallet duke u bërë i disponueshëm në regjistrin e gjykatës.²⁸⁷

5. Përfundim

Vonesat dhe praktikat e paunifikuara në dorëzimin e vendimeve me shkrim mund të ndikojnë mbi të drejtën për t'u gjykuar pa vonesa të tepërta dhe mund të vonojnë kohën e rishikimit të vendimit nga një gjykatë më e lartë ose të pengojnë ushtrimin efektiv të së drejtës së personit të akuzuar për t'iu ankuar një gjykatë më të lartë. Veçanërisht, po të marrim parasysh afatin e shkurtër që parashikon e drejta shqiptare për të paraqitur një ankim. Ndërsa e drejta shqiptare e lejon palën që ka bërë ankim ta ndryshojë atë deri në pesë ditë para seancës në apel,²⁸⁸ vonesat dhe praktikat e paunifikuara të gjykatave në dorëzimin e vendimeve me shkrim krijojnë çoroditje dhe paqartësi dhe mund të ndikojnë në cilësinë e ankimit. Lidhur me sa është thënë më lart, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mendon se duhet marrë në konsideratë ndryshimi i KPrP-së në mënyrë që të parashikohet një afat kohor më fleksibël për dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe paraqitjen e ankimit, si dhe të përcaktohen më qartë nga ligji kriteret për t'a zgatur atë në raste të jashtëzakonshme. Nga njëra anë, kjo do të ndihmonte të sigurohej dorëzimi në kohë i vendimeve me shkrim për "çështjet e thjeshta" dhe eliminimi i diskrecionit të gjyqtarit për këto çështje; nga ana tjetër, kjo do t'u jepte palëve kohën e duhur për të përgatitur çështjet e tyre për apel.

B. Transferimi i fashikujve të gjykimit nga gjykatat e shkallës së parë në gjykatat e apelit

1. E drejta ndërkombëtare dhe ajo shqiptare

Autoritetet gjyqësore kanë si detyrë kryesore të përshpejtojnë procedimet. Nëse për shkak të pakujdesisë nuk e bëjnë këtë në çdo fazë, ose harxhojnë kohë të tepërt për të kryer detyra të caktuara, kjo kohë mund të konsiderohet e paarsyeshme. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të së Drejtave të Njeriut sugjeron se në përgjithësi, vështirësitë administrative dhe logjistike në menaxhimin e një çështjeje konsiderohen si përgjegjësi e autoriteteve gjyqësore.²⁸⁹

Në kontekstin e apelit të çështjeve penale, KPrP-ja shprehet se sekretaria e gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin duhet të dërgojë aktet e

²⁸⁷ Kodi suedez i procedurës gjyqësore, kapitulli 30, pika 7.

²⁸⁸ KPrP, neni 415, pika 2.

²⁸⁹ Çështja "Agga kundër Greqisë", GjEDNj, 25 janar 2000, paragrafët 24-26.

procedimit (d.m.th, fashikullin e gjykimit) dhe ankimin në gjykatën e apelit brenda dhjetë ditëve nga data e regjistrimit të ankimit.²⁹⁰ Sekretarja e gjykatës së apelit duhet t'i regjistrojë pastaj ankimin dhe dosjen që i përket atij. Po ashtu, Rregullat mbi organizimin e administratës gjyqësore shprehen se sekretarja e gjykatës është përgjegjëse për dërgimin e çështjeve në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë.²⁹¹ Shkelja e këtyre rregullave sjell përgjegjësi disiplinore.²⁹²

Kancelari i gjykatës organizon dhe mbikëqyr aktivitetin e përditshëm të sekretarisë gjyqësore.²⁹³ Kryetari i gjykatës, në bashkëpunim me kancelarin, është përgjegjës për mbikëqyrjen e dorëzimit të fashikujve të gjykimit të përfunduara në sekretarinë gjyqësore në përputhje me afatet procedurale të parashikuara nga ligji.²⁹⁴ Ai ushtron gjithashtu kontroll për të siguruar respektimin e afateve procedurale.²⁹⁵ Rekomandimet për përmirësimin e strukturës dhe organizimin e administratës gjyqësore mund të paraqiten periodikisht nga kancelari tek kryetari i gjykatës.²⁹⁶

2. Gjetjet

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka vënë re se afatet procedurale për transferimin e fashikujve të gjykimit nga gjykata e rrethit në gjykatën e apelit respektohen rrallë. Shpesh këto vonesa janë pasojë e drejtpërdrejtë e vonesave në dorëzimin e vendimeve gjyqësore me shkrim. Vonesat në transferimin e dosjeve gjyqësore mes gjykatave mund të shkaktojnë vonesa të tepërta në zhvillimin dhe përfundimin e procedimeve të ankimit, të cilat nga ana tjetër mund të ndikojnë negativisht në kohën që nevojitet për përfundimin e përgjithshëm të procedimeve gjyqësore në një çështje.²⁹⁷

Me sa duket, në shumicën e rasteve, dosjet gjyqësore dorëzohen në sekretarinë e gjykatës së rrethit nga sekretarja e kryetarit të seancës pas përfundimit të afatit ligjor prej dhjetë ditësh. Kjo, nga ana tjetër, shkakton vonesa në transmetimin e fashikujve të gjykimit dhe njoftimit për apel nga shkalla e parë në gjykatën e apelit.

²⁹⁰ KPrP, neni 419. Komentari i KPrP-së, faqe 545.

²⁹¹ Urdhri i Ministrisë së Drejtësisë nr. 1830, datë 3 prill 2001, "Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore", neni 19, pika 15.

²⁹² Po aty, neni 27, pika 1.

²⁹³ Po aty, neni 9, pika 1.

²⁹⁴ Po aty, neni 8, pika 9.

²⁹⁵ Po aty, neni 8, pika 1.

²⁹⁶ Po aty, neni 10, pika 14.

²⁹⁷ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka shqyrtuar regjistrin e gjykatës në gjykatat e rretheve dhe të apeleve.

Duhet vënë në dukje se ka gjithashtu konfuzion mbi funksionimin e afateve kohore siç parashikohen nga ligji. Kryetari i Gjykatës së Rrethit të Tiranës për shembull, u tha zyrtarëve të OSBE-së se afati prej dhjetë ditësh për dërgimin e fashikujve të gjykimit fillon nga momenti kur apeli i njoftohet palës tjetër.²⁹⁸ Ndërsa neni 419 i KPrP-së është formuluar në mënyrë të paqartë, duke thënë thjesht se gjykata që jep dënimin do t'i dërgojë gjykatës përkatëse të apelit aktet e procedimeve dhe ankimin, pa treguar se nga cili moment fillojnë dhjetë ditët, ky lexim kundërshton interpretimin e dhënë nga komentari i KPrP-së, ku thuhet se afati fillon nga dita kur regjistrohet ankimi.

Të dhëna statistikore mbi numrin e ditëve të nevojshme për transferimin e fashikujve të gjykimit nga gjykatat e shkallës së parë në gjykatat e apelit

Tabela e mëposhtme përmban të dhëna mbi numrin e ditëve që u deshën për të transmetuar dosjet gjyqësore nga gjykatat e shkallës së parë në gjykatat e apelit në Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Vlorë dhe Shkodër. Secila gjykatë apeli i siguroi Prezencës së OSBE-së në Shqipëri informacion mbi 20 raste për të cilat u apeli kishte dhënë një vendim gjatë vitit 2006,²⁹⁹ siç ishin pasqyruar në "Regjistrin themeltar penal".³⁰⁰

Siç tregohet më lart, KPrP-ja shprehet se ankimi duhet regjistruar brenda dhjetë ditëve pas ditës së nesërme të shpalljes ose njoftimit të vendimit.³⁰¹ Sekretaria e gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin duhet t'i dërgojë aktet e procedimeve (fashikullin e gjykimit dhe ankimin përkatës) në gjykatën e apelit brenda dhjetë ditëve nga regjistrimi i ankimit.³⁰² Kështu, duke supozuar skenarin e rastit më të keq, pra që vendimi është ankimuar në fund të ditës së dhjetë (duke filluar nga dita pas së cilës u shpall vendimi), dhe që sekretarja e gjykatës e dërgon dosjen përkatëse të çështjes në Gjykatën e Apelit ditën e dhjetë pas ditës së regjistrimit të ankimit), duket se periudha maksimale mes ditës së shpalljes së vendimit të shkallës së parë dhe ditës kur gjykata e apelit duhet të marrë fashikullin e gjykimit nuk duhet t'i kalojë njëzet e një ditët.

²⁹⁸ Intervistë me Albert Meçen, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Tiranë, qershor 2006.

²⁹⁹ Në Gjirokastrë, për çështjet e marra në konsideratë ishte marrë një vendim gjatë periudhës 2006-2007.

³⁰⁰ Regjistri përmban informacion të detajuar mbi ankimet penale të paraqitura në gjykatat më të larta, si data e regjistrimit të çështjes së ankimuar në sekretarinë e gjykatës së apelit, emrin e të pandehurit, palën që paraqet ankimin, akuzën, numrin e çështjes, datën, gjyqtarin dhe gjykatën e shkallës së parë që kanë dhënë vendimin, vendimin e dënimit, të dhëna për dosjen (p.sh., numrin e regjistrimit të çështjes), numrin dhe llojin e vendimit të marrë në këtë rast nga gjykata e apelit së bashku me emrin e gjyqtarit raportues ose kryetarit të seancës në apel. Regjistri përmban gjithashtu datën, numrin dhe mjetet e dorëzimit të shkresës që e përcjell dosjen mbrapsht në gjykatën e shkallës së parë.

³⁰¹ KPrP, neni 415, pika 1.

³⁰² KPrP, neni 419. Komentari i KPrP-së, faqe 545.

Tabela e mëposhtme tregon, për secilin nga njëzet rastet dhe për çdo gjykatë apeli, numrin e ditëve që kanë kaluar nga data kur u shpall vendimi në gjykatën përkatëse të rrethit në datë kur çështja u regjistrua në gjykatën e apelit. **Vonesat më shumë se të njëzetenjë ditët në transmetimin e dosjeve gjyqësore, aty ku janë vëzhguar, tregohen me të zezë.**

Në Gjykatën e Apelit Tiranë, vonesat u vunë re në 8 nga 20 çështje; në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë vonesat u evidentuan në 15 nga 20 çështje; në Gjykatën e Apelit Vlorë, vonesat u evidentuan në 17 nga 20 çështje. Në Gjykatën e Apelit Shkodër, vonesat u evidentuan në 19 nga 20 çështje. Në Gjykatën e Apelit Durrës, dosjet nuk u dorëzuan brenda afatit ligjor të parashikuar.

Gjykata e Apelit Tiranë	Gjykata e Apelit Durrës	Gjykata e Apelit Gjirokastrë	Gjykata e Apelit Shkodër	Gjykata e Apelit Vlorë
<i>Numri i ditëve</i>				
14 ditë	2 muaj dhe 29 ditë	15 ditë	20 ditë	16 ditë
15 ditë	3 muaj dhe 3 ditë	17 ditë	26 ditë	18 ditë
15 ditë	3 muaj dhe 3 ditë	18 ditë	28 ditë	19 ditë
15 ditë	3 muaj dhe 4 ditë	19 ditë	28 ditë	ditë
15 ditë	3 muaj dhe 4 ditë	27 ditë	31 ditë	27 ditë
15 ditë	3 muaj dhe 5 ditë	27 ditë	33 ditë	28 ditë
15 ditë	3 muaj dhe 9 ditë	29 ditë	34 ditë	28 ditë
16 ditë	3 muaj dhe 26 ditë	31 ditë	38 ditë	29 ditë
20 ditë	3 muaj dhe 26 ditë	38 ditë	41 ditë	29 ditë
21 ditë	3 muaj dhe 28 ditë	41 ditë	42 ditë	29 ditë
21 ditë	4 muaj	43 ditë	46 ditë	32 ditë
21 ditë	5 muaj dhe 21 ditë	43 ditë	49 ditë	33 ditë
22 ditë	5 muaj dhe 22 ditë	43 ditë	54 ditë	34 ditë
22 ditë	5 muaj dhe 23 ditë	46 ditë	2 muaj dhe 4 ditë	42 ditë
28 ditë	5 muaj dhe 24 ditë	50 ditë	2 muaj dhe 6 ditë	67 ditë
28 ditë	5 muaj dhe 24 ditë	51 ditë	2 muaj dhe 13 ditë	2 muaj dhe 20 ditë
36 ditë	5 muaj dhe 26 ditë	56 ditë	3 muaj dhe 15 ditë	6 muaj
36 ditë	5 muaj dhe 28 ditë	59 ditë	4 muaj dhe 18 ditë	9 muaj dhe 15 ditë
1 vit, 3 muaj dhe 15 ditë	6 muaj dhe 4 ditë	2 muaj dhe 2 ditë	7 muaj	1 vit dhe 5 muaj
2 vjet dhe 1 muaj	6 muaj dhe 28 ditë	2 muaj dhe 4 ditë	1 vit	8 vjet

Tabelat e mëposhtme tregojnë për çdo gjykatë ndarjen e vonesave, duke marrë si referencë afatet e mëposhtme kohore të transmetimit të dosjeve gjyqësore:

1-21 ditë (d.m.th., dosjet janë transmetuar brenda afateve ligjore);
 22-30 ditë;
 31-40 ditë; 41-50 ditë;
 më shumë se 50 ditë.

Gjykata e Apelit Tiranë

Të dhënat kanë të bëjnë me çështje të gjykuara në shkallën e parë nga gjykatat e rretheve Tiranë, Kurbin dhe Bulqizë. Nga 20 çështje, 12 dosje të gjykatës (60%) u dorëzuan pranë Gjykatës së Apelit Tiranë brenda afatit kohor ligjor – pra, në më pak se 21 ditë nga data kur u shpall vendimi i shkallës së parë; 4 dosje (20%) u dorëzuan nga 22 deri në 30 ditë pas shpalljes së vendimit; 2 dosje (10%) u dorëzuan nga 31 deri në 40 ditë më pas. Në 2 çështje (10%), dosjet u kaluan pas më shumë se 50 ditëve.

Regjistri i Gjykatës së Apelit Tiranë

Dosja u dorëzua në gjykatën e apelit pas:	Nr. i çështjeve	Përqindja
1-21 ditëve	12	60%
22-30 ditëve	4	20%
31-40 ditëve	2	10%
41-50 ditëve	0	0%
më shumë se 50 ditëve	2	10%
Totali i çështjeve	20	100%

Gjykata e Apelit Durrës

Të dhënat kanë të bëjnë me çështje të gjykuara në shkallën e parë nga gjykatat e rretheve Durrës, Kavajë, Librazhd, Elbasan dhe Gramsh. Të 20 çështjet e marra si referencë (100%) u kaluan nga gjykatat përkatëse të rrethit në Gjykatën e Apelit Durrës pas më shumë se 50 ditëve nga dita kur u shpall vendimi.³⁰³

Regjistri i Gjykatës së Apelit Durrës

Dosja u paraqit në gjykatën e apelit pas:	Nr. i çështjeve	Përqindja
1-21 ditëve	0	0%
22-30 ditëve	0	0%
31-40 ditëve	0	0%
41-50 ditëve	0	0%
më shumë se 50 ditëve	20	100%
Totali i çështjeve	20	100%

³⁰³ Pas kërkesës për informacion të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri mbi vonesat, Gjykata e Rrethit Durrës pretendoi se i transmeton dosjet e çështjeve brenda afatit kohor ligjor dhe se vonesat me të cilat Gjykata e Apelit Durrës i regjistron çështjet mund të jenë shkaktuar nga problemet administrative ose nga ngarkesa e madhe e punës. Nga ana tjetër, Gjykata e Apelit Durrës pretendoi se gjykatës së shkallës së parë mund t'i duhen dy deri në katër javë për të nxjerrë vendime me shkrim. Për më tepër, Gjykata e Apelit Durrës u ankua gjithashtu për ngarkesën shumë të madhe të punës për shkak se çështjet nuk vijnë vetëm nga Gjykata e Rrethit Durrës por gjithashtu edhe nga gjykata të tjera (Elbasan, Kavajë, etj.).

Gjykata e Apelit Gjirokastrë

Çështjet e mëposhtme u gjykan në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve Gjirokastrë, Sarandë, Përmet dhe Tepelenë. Nga 20 çështje, 6 dosje (30%) u dorëzuan në Gjykatën e Apelit të Gjirokastrës nga 41 deri 50 ditë pas ditës kur u shpall vendimi i shkallës së parë; 5 dosje (25%) u transmetuan më shumë se 50 ditë më pas; 3 dosje (15%) u dorëzuan nga 22 deri në 30 ditë më vonë; dhe 2 (10%) u dorëzuan nga 31 deri 40 ditë pas shpalljes së vendimit. Vetëm 4 dosje (20%) u dorëzuan brenda 21 ditëve.

Regjistri i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë

Dosja u paraqit në gjykatën e apelit pas:	Nr. i çështjeve	Përqindja
1-21 ditëve	4	20%
22-40 ditëve	3	15%
31-40 ditëve	2	10%
41-50 ditëve	6	30%
Më shumë se 50 ditëve	5	25%
Totali i çështjeve	20	100%

Gjykata e Apelit Shkodër

Çështjet e mëposhtme u gjykan në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve Shkodër, Lezhë, Kukës, Tropojë dhe Pukë. Nga 20 dosje të gjykatës, 8 (40%) u dorëzuan në Gjykatën e Apelit Shkodër pas më shumë se 50 ditëve nga dita kur u shpall vendimi i shkallës së parë; 4 (20%) u dorëzuan nga 31 deri në 40 ditë më pas; për 3 (15%) dosje u deshën 22 deri në 30 ditë për t'u transmetuar pas ditës në të cilën u shpall vendimi; 4 dosje (20%) u dorëzuan nga 41 deri në 50 ditë pas ditës kur u shpall vendimi; dhe vetëm një dosje (5%) u dorëzua në më pak se 21 ditë (d.m.th., brenda afatit ligjor).

Regjistri i Gjykatës së Apelit Shkodër

Dosja u paraqit në gjykatën e apelit pas:	Nr. i çështjeve	Përqindja
1-21 ditëve	1	5%
22-30 ditëve	3	15%
31-40 ditëve	4	20%
41-50 ditëve	4	20%
më shumë se 50 ditëve	8	40%
Totali i çështjeve	20	100%

Gjykata e Apelit Vlorë

Tabela më poshtë tregon të dhëna mbi çështjet e gjykuara në shkallën e parë nga gjykatat e rretheve Vlorë, Fier, Berat, Skrapar, Lushnjë dhe Kuçovë dhe

të apeluara në Gjykatën e Apelit Vlorë. Nga 20 dosje të gjykatës, 6 (40%) u paraqitën në gjykatën e apelit më shumë se 50 ditë pas ditës së shpalljes së vendimit të shkallës së parë; 7 dosje (35%) u paraqitën nga 22 deri 30 ditë pas ditës në të cilën ishte shpallur vendimi; 3 (15%) u paraqitën nga 31 deri 40 ditë pas ditës në të cilën ishte shpallur vendimi; dhe 3 (15%) u transferuan brenda afatit ligjor (nga 1 deri në 21 ditë). Në 1 çështje (5%), dosja u paraqit pas 41 deri 50 ditëve pas ditës në të cilën ishte shpallur vendimi.

Regjistri i Gjykatës së Apelit Vlorë

Dosja u paraqit në gjykatën e apelit pas:	Nr. i çështjeve	Përqindja
1-21 ditëve	3	15%
22-30 ditëve	7	35%
31-40 ditëve	3	15%
41-50 ditëve	1	5%
më shumë se 50 ditëve	6	30%
Totali i çështjeve	20	100%

Intervistat e bëra nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri me zyrtarë të gjykatës duket se i konfirmojnë përfundimet e mësipërme.

Sipas Kancelarit të Gjykatës së Apelit **Shkodër**, vonesat në transferimin e dosjeve të çështjeve të ankimuar nga gjykatat e rretheve brenda juridiksionit territorial të Gjykatës së Apelit Shkodër janë të zakonshme. Kjo është shqetësuese për çështjet që kanë të bëjnë me ankime kundër masave të sigurimit, ku dosja arrin në Gjykatën e Apelit përtej afatit ligjor.³⁰⁴ Vonesat në transmetimin e dosjes së gjykatës nga Gjykata e Rrethit Shkodër në Gjykatën e Apelit shkaktohen gjithashtu nga vonesat në njoftimet që i bëhen palës tjetër për ankimin e paraqitur.

Janë raportuar gjithashtu vonesa në transmetimin e dosjeve të gjykatës nga gjykatat e apelit te gjykatat e rretheve. Në **Vlorë**, ky transferim nganjëherë ka zgjatur deri në 6 muaj. Në **Shkodër**, duhen zakonisht rreth 15 ditë që vendimet e Gjykatës së Apelit të dorëzohen me shkrim në zyrën e kryesekretares. Vonesat mund të jenë më të gjata në varësi të ngarkesës së punës së sekretares së gjyqtarit. Një prokuror i apelit i ka deklaruar Prezencës së OSBE-së në Shqipëri se vonesat në dorëzimin e vendimeve me shkrim kanë pasoja serioze për punën e tij, meqë atij mund t'i duhet të paraqesë një rekurs në Gjykatën e

³⁰⁴ E drejta për ankim kundër masës së sigurimit "arrest në burg" mund të ushtrohet nga i pandehuri ose avokati i tij mbrojtës brenda dhjetë ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit për caktimin e masës. Kërkesa ankimore regjistrohet nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin, e cila duhet t'ia transmetojë dosjen gjykatës kompetente brenda pesë ditëve. KPrP, neni 249. Vonesat në transferimin e dosjeve të gjykatës mes gjykatave mund të komprometojnë ushtrimin efektiv të së drejtës për apel duke shkaktuar vonesa të tepërta në mbajtjen dhe përfundimin e procedimit të apelit.

Lartë kundër vendimit në një çështje të veçantë brenda 30 ditëve të caktuara nga ligji, pa pasur në dispozicion një kopje të tij.

Ndonëse, siç tregohet nga të dhënat e raportuara më lart, vonesat në transmetimin e dokumenteve të gjykatës lidhur me çështjet e ankimuar, në vend që të përbëjnë përjashtim, ndodhin shpesh. Kjo çështje nuk është ngritur nga inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë në kuadrin e punës së tyre.³⁰⁵

C. Shtyrjet në orarin e seancave të apelit

Kryerja në mënyrë efikase, e organizuar dhe në kohë e seancave gjyqësore është, së pari, një tipar kryesor i sistemeve gjyqësore moderne, të cilat funksionojnë mirë, së dyti, një nga aspektet e shumta të një procesi të drejtë dhe së treti, një tregues i nivelit të respektimit të parimeve të shtetit të së drejtës.

KPrP-ja parashikon që gjykatat duhet të përpiqen t'i përfundojnë shqyrtimet gjyqësore brenda një seance ose, nëse nuk është e mundur, gjatë ditës së nesërme të punës dhe se vetëm për arsye të veçanta shqyrtimi gjyqësor mund të shtyhet deri në pesëmbëdhjetë ditë.³⁰⁶ Kjo dispozitë përputhet me standardet ndërkombëtare që garantojnë të drejtën për t'u gjykuar pa vonesa të tepërta.

Megjithatë, siç është vënë re nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, proceset penale shpesh vazhdojnë për periudha të zgjatura kohe dhe në disa raste përfundojnë pas disa vitesh. Shqyrtimet gjyqësore përfundojnë rrallë brenda një seance gjyqësore, ndërkohë që në vend që të vazhdojnë ditën tjetër të punës, zakonisht shtyhen me periudhën maksimale që lejon ligji, d.m.th., pesëmbëdhjetë ditë. Ndërsa kjo praktikë ndikon sidomos te seancat gjyqësore në shkallën e parë të gjykimit,³⁰⁷ mosrespektimi i orarit të gjyqeve dhe vonesat në zhvillimin e seancave ndodhin shpesh si dhe janë vëzhguar edhe në gjykatat e shkallës së dytë në të gjithë Shqipërinë.

Këto vonesa ndikojnë negativisht në besimin e publikut tek administrimi i drejtësisë dhe mund të rezultojnë në shkeljen e së drejtës për një gjykim pa vonesa të tepërta. Vonesat shkaktohen nga faktorë të tillë si planifikimi i keq i orareve të gjyqeve, vështirësitë që lidhen me thirrjen e të pandehurve në seancë,

³⁰⁵ Intervista telefonike me znj. Enkelejda Hajro, Shefe e Drejtorisë së Përgjithshme për Çështjet e Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë (21 shkurt 2006).

³⁰⁶ KPrP, neni 342.

³⁰⁷ *Analizë e sistemit penal të drejtësisë në Shqipëri*, faqe 178

Shkaqet e vonesave janë identifikuar si: mosgjetja/mosnjoftimi i personave të përfshirë; mosparaqitja e personave të njoftuar; mosjellja e personave të paraburgosur në gjykatë nga ana e policisë; mosparaqitja e avokatit mbrojtës; mosparaqitja e prokurorëve; mungesa e planifikimit/përgatitjes; zgjatja e pajustificuar e hetimeve para gjykimit.

si dhe mosparaqitja e palëve pa shkaqe të arsyeshme. Siç ka vëzhguar Prezenca e OSBE-së në Shqipëri “ rritja e përpjekjeve për të siguruar pjesëmarrjen e të gjithë personave të përfshirë mund të kërkojë më shumë shpenzime, por nga ana tjetër proceset gjyqësore më të shkurtra dhe më efikase do t’i ulnin shpenzimet në mënyrë të konsiderueshme për të gjitha palët e përfshira dhe, në këtë mënyrë do të krijohej mundësia që burimet të përdreshin për të gjykuar më shumë çështje”.³⁰⁸ Paragrafët e mëposhtëm japin një përmbledhje të vonesave të vëzhguara nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në seancat gjyqësore të apelit.

1. Thirrja e palëve dhe planifikimi i seancave në apel

Vështirësia për thirrjen e palëve në një çështje është një nga faktorët kryesorë që shkaktojnë shtyrje dhe vonesa të shpeshta në drejtimin e apelit të çështjeve penale. Sipas nenit 140 të KPrP-së, njoftimet u jepen të pandehurve në gjendje të lirë duke i dorëzuar një kopje të këtyre akteve. Kur i pandehuri nuk gjindet, njoftimi mund të dorëzohet në banesën e tij ose në vendin e punës duke ia dhënë një familjari, fqinjit ose një personi që punon me të. Kur këta persona mungojnë ose refuzojnë të pranojnë aktin, i pandehuri kërkohet në vende të tjera. Si mundësi e fundit, kur i pandehuri nuk mund të gjendet në vende të tjera të përcaktuara nga ligji, fletëthirrjet mund të dorëzohen në qendrën administrative të lagjes ose fshatit ku i pandehuri jeton ose punon, ndërsa njoftimi afishohet në shtëpinë ose vendin e punës së të pandehurit.³⁰⁹ Nëpunësi i gjykatës njofton pastaj të pandehurin për dorëzimin me letër të prokurorit dhe efektet e njoftimit fillojnë të veprojnë nga marrja e letrës së porositur.³¹⁰ Ligji kërkon që fletëthirrjet të shpërndahen nga ftuesit gjyqësorë, shërbimi postar ose policia gjyqësore.³¹¹ Kur një i pandehur është i ndaluar, njoftimi i duhet bërë në vendin e paraburgimit duke ia dorëzuar atij aktin ose, kur ai refuzon ta pranojë ose mungon për shkaqe të justifikuara, duke ia dorëzuar dokumentin personit përgjegjës për institucionin, i cili duhet të njoftojë të pandehurin me mjetin më të shpejtë të mundshëm.³¹²

Në shumë nga proceset e apelit të vëzhguara nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, seancat u desh të ricaktoheshin për shkak të mosparaqitjes së të pandehurve, si dhe të shtyheshin më tej për një periudhë prej dy javësh.³¹³ Kjo është shqetësuese, sidomos duke pasur parasysh që në shumë raste personi i

³⁰⁸ *Analizë e sistemit penal të drejtësisë në Shqipëri*, faqe 177.

³⁰⁹ KPrP, neni 140.

³¹⁰ KPrP, neni 140, pika 4.

³¹¹ KPrP, neni 132.

³¹² KPrP, neni 139.

³¹³ KPrP, neni 342.

akuzuar ishte pala apeluese. Në raste të tjera, seancat u deshën të ricaktoheshin për shkak të mosparaqitjes të të tjerëve (avokati mbrojtës ose prokurori) për shkaqe të paarsyeshme. Megjithëse nuk është shkak i vetëm i vonesave, sistemi i mangët i gjendjes civile dhe i adresave ka shkaktuar vështirësi të mëdha për dorëzimin e saktë dhe në kohën e duhur të njoftimeve tek palët.

Arsye tjetër për shtyrjen e shpeshtë të seancave është se gjyqet nuk planifikohen siç duhet nga autoritetet e gjykatës. Ndonëse, çështja se ç' mënyrë zgjedh çdo gjykatë, në përgjithësi, dhe çdo trup gjykues, në veçanti, për të organizuar dhe për t'i dhënë përparësi detyrave në punë, mbetet një sfidë e vazhdueshme për çdo sistem gjyqësor, vonesat e panevojshme dhe të pajustificueshme nuk duhen toleruar.

Më poshtë jepet shembulli i një çështjeje ku programimi dhe planifikimi i pamjaftueshëm i seancës së bashku me mosparaqitjen e prokurorit dhe avokatit mbrojtës për shkaqe të pajustificuara kanë shkaktuar vonesa të tepërta.

Në 14 korrik 2004, Altin Diko u dënua me 9 vjet burgim për përdhunim nga Gjykata e Rrethit Tiranë. Avokati i tij mbrojtës e ankimoi vendimin brenda afatit, më 23 korrik 2004. Nga shqyrtimi i dosjes së gjykatës del se për shkaqe të paqarta, seanca e parë para Gjykatës së Apelit Tiranë u caktua në 17 nëntor 2004, katër muaj më vonë. Kjo seancë u shty për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës. Më 15 dhjetor 2004, seanca e dytë u shty për shkak të mungesës së gjyqtarëve që ishin jashtë shtetit. Seanca e tretë e programuar më 20 dhjetor 2004 u shty përsëri për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës. Më 14 janar 2005, 6 muaj pas ankimit, Gjykata e Apelit Tiranë mbajti seancën e parë në të cilën u mbështet vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë për fajësi.

Fillimisht, seanca u desh të shtyhej për shkak të menaxhimit të keq të çështjes, siç tregohet nga shtyrja e seancës së parë, si dhe nga administrimi i dobët i planit të ditës së gjyqtarëve. Meqënëse mungesa e gjyqtarëve (që me sa duket udhëtonin jashtë shtetit) me siguri ishte e parashikuar, gjykata duhet t'i kishte informuar palët me kohë që seanca nuk do të ishte e mundur të mbahej dhe duhet ta kishte ricaktuar seancën. Në dy raste të tjera, seanca u desh të shtyhej për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës për shkaqe të pajustificuara. Megjithëse ky është një shkak i shpeshtë për shtyrjen e seancave në gjykatat shqiptare dhe përdoret shpesh për qëllime ngadalësimi, deri më sot Dhoma Kombëtare e Avokatëve nuk ka marrë masa disiplinore kundër asnjë avokati.³¹⁴

³¹⁴ Intervista telefonike me z. Virgjl Karaj, Sekretar i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatëve (18 korrik 2007). Gjatë bisedës telefonike, z. Karaj mohoi në mënyrë kategorike që avokatët të kenë kontribuar ndonjëherë në vonesat e procedimeve.

Përveç kësaj, duhet theksuar se në rastin në fjalë, në 20 dhjetor 2004, Gjykata e Apelit Tiranë i pezulloi afatet e paraburgimit për të pandehurin për shkak të mosparaqitjes në seancë të avokatit, sipas nenit 265 të KPrP-së.³¹⁵ Siç është vënë në dukje më parë nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, ndërsa kjo dispozitë synon të pengojë të pandehurit dhe avokatët mbrojtës që ta përdorin shtyrjen si strategji zvarritëse, ajo mund të përdoret gjithashtu në mënyrë të papërshtatshme për të penalizuar të pandehurit për fakte dhe vonesa që i atribuohen vetëm avokatit mbrojtës.³¹⁶

Në çështje të tjera, vonesat u shkaktuan nga mosparaqitja e gjyqtarëve, avokatit mbrojtës ose prokurorit.

Në çështjen e **Ardian Gurit**, të cilit iu dha pafajësia për trafikimin e lëndëve narkotike pas një gjykimi të shkurtuar, prokurori apeloj në 4 nëntor 2005. Seanca e parë e apelit, e planifikuar për t'u zhvilluar tre muaj pas ankimit, në 10 shkurt 2006, u shty për shkak të mungesës së prokurorit si rezultat i një inspektimi nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm. Në 15 shkurt 2006, seanca e dytë u shty për shkak të mungesës së Prokurorit për "arsye të papritura urgjente". Seanca e fundit u mbajt në 28 shkurt 2006, gjatë së cilës Gjykata e Apelit Shkodër mbështeti vendimin e gjykatës së shkallës së parë për dhënien e pafajësisë.

Në 21 dhjetor 2005, vëllezërit **Kovaçi** (Pjetër dhe Gjon) u dënuan nga Gjykata e Rrethit Shkodër me dhjetë vjet burgim për vrasje të paramenduar të kryer në bashkëpunim me të tjerë, mbetur në tentativë. Në 29 dhjetor, të pandehurit e ankimuan vendimin. Në 27 mars 2006, seanca e apelit u shty për shkak të mungesës së njërit prej të bashkëtëpandehurve; në 12 maj 2006, seanca u shty për shkak të mungesës së gjyqtarëve (që merrnin pjesë në një seminar); në 24 maj, seanca u shty për shkak të mungesës (për shkaqe të pajustificuara) të njërit prej gjyqtarëve; në 31 maj seanca u shty për shkak të mungesës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit (në një udhëtim pune); në 13 qershor, seanca u shty për t'i dhënë kohë avokatit mbrojtës që të përgatiste konkluzionet e veta me shkrim; në 19 qershor seanca u shty përsëri për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës (që ndodhej në varrimin e një anëtari të familjes); në 4 korrik, seanca u shty për shkak të mungesës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit (mungonte për arsye familjare); së fundmi, në 17 korrik, seanca u shty me qëllim që ta lejonte gjykatën të merrte vendimin.

³¹⁵ Sipas kësaj dispozite, afatet e paraburgimit të një personi të akuzuar mund të pezullohen me vendim të ankimueshëm të gjykatës, për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë, ndër të tjera, për shkak të mosparaqitjes ose largimit të një ose më shumë mbrojtësve, që lënë pa ndihmë një ose më shumë të pandehur. KPrP, neni 265.

³¹⁶ *Analiza e sistemit penal të drejtësisë në Shqipëri*, faqe 182.

Në total u mbajtën dhjetë seanca gjyqësore në apel nga 27 marsi deri në 18 korrik 2006. Nga këto dhjetë, gjashtë u pezulluan për shkak të mosparaqitjes për shkaqe të pajustificuara ose lehtësisht të parashikueshme³¹⁷ të njëjës prej palëve ose gjyqtarëve. Këto vonesa të pajustificuara nuk duhet të ishin lejuar nga gjykata.

2. Zgjidhjet

Nga sa u tregua më lart, duket se ka një prirje të gjykatave të apelit ta pranojnë mosparaqitjen për shkaqe të pajustificuara të prokurorëve, të pandehurve dhe të avokatëve mbrojtës në seancat e planifikuara. Mungesa e çdo lloji sanksioni ndaj mosparaqitjes së të pandehurve dhe avokatëve për të marrë pjesë sipas planifikimit kontribuon në administrimin e duhur të drejtësisë, si dhe ul autoritetin dhe besueshmërinë e gjykatës.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mendon se mund të ndërmerren disa hapa për të trajtuar problemet e përmbledhura më lart.

Së pari, mund të jetë e përshtatshme të ndryshohen dispozitat e procedurës penale shqiptare *që i pandehuri të deklarojë qartë në kërkesën ankimore adresën e tij për efekt të njoftimit*. Çdo akt që ka lidhje me apelin, i cili dorëzohet në atë adresë duhet konsideruar se i është njoftuar ankuesit. Kur ankuesi gjendet nën arrest në kohën kur paraqet kërkesën ankimore, ai duhet të deklarojë emrin e institucionit në të cilin ndodhet nën arrest, së bashku me një adresë tjetër përveç asaj të institucionit ku mund t'i dërgohet njoftimi.³¹⁸ Kur njoftimi për datën e zhvillimit të seancës bëhet nga nëpunësit gjyqësorë, nga policia gjyqësore ose me letër të parositur, subjektit të njoftimit i duhet kërkuar të konfirmojë dhe të sigurojë informacion kontakti shtesë, veçanërisht numra telefoni.

Së dyti, kodi mund të ndryshohet në mënyrë që ta autorizojë gjykatën të nxjerrë një urdher arresti për të pandehurin që nuk është paraqitur për shkaqe të pajustificuara megjithëse është thirrur siç duhet në seancën gjyqësore.³¹⁹

Nga ana tjetër, siç tregon një raport i mëparshëm i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, mund të konsiderohet edhe mundësia që pas njoftimit fillestar lidhur

³¹⁷ D.m.th, kur mosparaqitja e gjyqtarëve ose palëve në gjyq nuk u raportua me shkrim, ose kur ka qenë e mundur të parandalohet sepse ishte e parashikueshme, me qëllim që pala e interesuar të jepte njoftimin e duhur dhe në kohën e duhur në mënyrë që të shmangte humbjen e kohës për personat e tjerë të përfshirë (p.sh., në rastin kur gjyqtarët merrnin pjesë në trajnim).

³¹⁸ Shih, p.sh., British Columbia Criminal Appeal Rules [Rregullat e apelit penal të provincës British Columbia], neni 5, paragrafet 2 dhe 3.

³¹⁹ Po aty, neni 125, pika 1.

me procedimin, palët mund të njoftohen në një mënyrë më të thjeshtë se njoftimi i parë; p.sh., nëpërmjet shërbimit të thjeshtë postar ose mjeteve teknike.³²⁰

Sistemi i mangët i gjendjes civile dhe i adresave në Shqipëri krijon pengesa të mëdha për njoftimin e personave të përfshirë në çështje gjyqësore. Në janar 2007, Delegacioni i BE-së dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nënshkruan një marrëveshje për t'i siguruar asistencë teknike qeverisë shqiptare për modernizimin e sistemit të adresave dhe sistemit të gjendjes civile. Një memorandum mirëkuptimi u nënshkrua mes Prezencës së OSBE-së dhe Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë për zbatimin e projektit. Ky projekt financohet me 2.5 milionë euro nga programi CARDS i BE-së dhe do të zbatohet gjatë një periudhe trevjeçare nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës dhe *Statistics Norway*.³²¹ Megjithëse është shumë shpejt për parashikime, shpresohet që përmirësimet në këtë fushë do të rrisin në mënyrë të konsiderueshme mundësitë për thirrjen e personave në gjyq.

Dhoma e Avokatëve në Shqipëri duhet ta ushtrojë më me përgjegjësi rolin e saj dhe të marrë masa ndaj avokatëve që vazhdimisht nuk marrin pjesë në proceset gjyqësore, sidomos kur ka të dhëna që shtyrjet përdoren si taktikë zvarritëse.³²² Gjithashtu, duhet marrë në konsideratë mundësia e parashikimit të masave disiplinore në KPrP. Masat që mund të vihen janë detyrimi për të paguar një pjesë apo të gjitha shpenzimet procedurale, gjobat, ndalimi për të përfaqësuar çështjen konkrete ose ndalimi për të dalë në përgjithësi si avokat para gjykatës. Megjithatë, masa e parë dhe më e rëndësishme është që gjykatat t'ua bëjnë absolutisht të qartë të gjitha palëve që nuk do të tolerohet më zvarritja e procedimeve dhe se çdo vonesë që nuk mund të justifikohet në mënyrë objektive do të çojë në masa disiplinore. Nëse mungesa ose vonesa e parë e pajustificuar mund të ndëshkohet me gjobë, disa vonesa të pajustificuara duhet të çojnë në detyrimin për të paguar shpenzimet procedurale. Abuzimet sistematike dhe të përsëritura duhet të bëjnë që avokatit t'i ndalohet të vazhdojë përfaqësimin

³²⁰ *Analizë e sistemit penal të drejtësisë në Shqipëri*, faqe 180.

³²¹ Projekti nisi në shkurt 2007 dhe do të përfundojë në tetor 2009. Projekti mbështetet gjithashtu pjesërisht nga kontributi i Qeverisë së Sh.B.A-së. Shih Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Komunikatë për shtyp, Komisioni Evropian, OSBE mbështet modernizimin e sistemit shqiptar të adresave dhe regjistrat civil (Tiranë, 30 janar 2007), e disponueshme në http://www.osce.org/albania/item_1_23124.html (e konsultuar për herë të fundit në datë 19 nëntor 2007).

³²² Neni 38 i Ligjit për Avokatët parashikon që një avokat i nënshtrohet procedimit disiplinor, ndër të tjera, nëse ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e avokatëve, me rregullat e vendosura nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve ose dhomat e avokatisë, ose me rregullat e Kodit të Etikës së Avokatit. Shih ligjin nr. 9109, datë 17 korrik 2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pikat (a) dhe (b). Shih gjithashtu Kodin e Etikës së Avokatit, që kërkon që avokatët të mos shkaktojnë vonesa të panevojshme në rrjedhën e procedimeve gjyqësore. Kodi Shqiptar i Etikës për Avokatët, i miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve në nëntor 2005, neni 34.

e çështjes që ka në dorë dhe nëse përcaktohet se një avokat mbrojtës ka një histori zvarritjesh të proceseve gjyqësore atij ose asaj i duhet ndaluar të dalë përpara gjykatës në fjalë.³²³

Lidhur me problemet e administrimit të dobët të gjyqeve dhe planifikimit të seancave nga autoritetet gjyqësore, këta të fundit duhet t'i caktojnë seancat më me përgjegjësi. Para fillimit të seancës në apel, gjykata duhet të përgatisë një projektplan të detajuar që të tregojë numrin dhe përmbajtjen e parashikuar të çdo seance. Plani duhet diskutuar dhe gjykata duhet të bjerë dakord për të me prokurorin dhe avokatin mbrojtës, me qëllim që ky plan të respektohet. Kur për shkak të palëve ose gjyqtarit, është i nevojshëm ndryshimi i planit ose i datave të seancave, ky ndryshim duhet komunikuar menjëherë në mënyrë që gjykata të ketë mundësi ta ricaktojë seancën.

IV. PËRFUNDIME

Zgjidhja në kohë e çështjeve penale ka tri qëllime kryesore: të garantojë të drejtën e personit të akuzuar për një gjykim të shpejtë, duke i dhënë kështu fund paqartësisë së gjendjes së tij; të nxisë më tutje interesin e publikut (përfshirë viktimat dhe dëshmitarët) për zgjidhjen e drejtë dhe në kohë të çështjeve penale; dhe të sigurojë përdorimin efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare. Zgjidhja e shpejtë e çështjeve penale duhet të barazpeshohet gjithmonë me parimet themelore konkurruese të paanaësisë dhe përpikërisë së procesit të drejtësisë penale.

Në gjykatat shqiptare, shumica e vonesave i atribuohen ngarkesës së madhe të punës, mungesës së bashkëpunimit mes autoriteteve të gjykatës, procedurave të vjetra dhe paefektshme të administrimit të gjykatave, si dhe mosparaqitjes së palëve ose dëshmitarëve të një çështjeje. Veçanërisht, vonesat dhe paqëndrueshmëritë janë vënë re në praktikën me të cilën dorëzohen vendimet me shkrim plotësisht të arsyetuara të shkallës së parë. Dispozitat që dispijlojnë afatin kohor për dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe për paraqitjen e kërkesave ankimore, sidomos kur kombinohen dhe lexohen së bashku, duket se japin afate kohore shumë të shkurtra që në praktikë provohet të jenë të vështira për t'u respektuar.

Vonesat dhe paqëndrueshmëritë në praktikën me të cilën dorëzohen vendimet me shkrim, të shoqëruara me afatin e shkurtër kohor për ankim, mund

³²³ *Analizë e sistemit penal të drejtësisë në Shqipëri*, faqe 182.

të pengojnë aftësinë e të pandehurve për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën për apel. Vonesat në zgjidhjen e çështjeve penale në apel ndodhin edhe për shkak të mosrespektimit të afateve procedurale për transferimin e dosjeve ndërmjet gjykatave, si dhe shtyrjeve të shpeshta dhe të pajustificuara të seancave të apelit që i atribuohen mosparaqitjes së palëve (prokurori, i pandehuri që thirret sipas rregullave dhe avokati mbrojtës). Në rastet kur vonesat i atribuohen mosparaqitjes së palëve në seancat e apelit (prokurori, i pandehuri që thirret sipas rregullave dhe avokati mbrojtës), gjykatat i kanë toleruar mjaft këto praktika.

Vonesat në trajtimin e çështjeve, sado të vogla, pengojnë përdorimin efikas të burimeve administrative dhe financiare që mund të përdoren për të gjykuar më shumë çështje. Kur vonesat në procedimin e çështjeve gjyqësore janë shumë të mëdha, janë të shmangshme dhe mund t'i atribuohen shtetit, ato mund të cenojnë të drejtën e personit të akuzuar për një gjykim të drejtë, si dhe të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati kohor të arsyeshëm. Meqë KEDNj-ja vendos mbi palët kontraktuese detyrimin për t'i organizuar sistemet e tyre ligjore në mënyrë që t'i lejojnë gjykatat të përmbushin kërkesat e nenit 6, pika 1, për gjykim të drejtë, autoritetet shtetërore shqiptare mund të mbajnë përgjegjësi për mosrritjen e burimeve dhe për të metat strukturore që shkaktojnë vonesa procedurale.

Përmirësimet në këtë fushë mund të arrihen duke identifikuar praktikën e përdorura nga gjykatat të cilat kanë një nivel më të lartë efektshmërie dhe duke i zbatuar ato në gjykata të tjera. Rekomandimet e mëposhtme, nëse do të zbatoheshin, mund të reduktonin gjithashtu vonesat dhe të rrisnin efikasitetin e gjykatave në trajtimin e çështjeve penale në apel.

V. REKOMANDIME

Dorëzimi i vendimeve gjyqësore plotësisht të arsyetuara me shkrim (në shkallën e parë)

- Shprehja “menjëherë” në nenin 386 (1) të KPrP-së (që parashikon se vendimi duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës *menjëherë* pas shpalljes së tij)³²⁴ duhet sqaruar.
- Do të ishte mirë që autoritetet e gjykatës (kryetari dhe kancelari) të ishin më vigjilentë për të siguruar që vendimet të depozitohen dhe të dorëzohen brenda periudhës kohore të rekomanduar (menjëherë). Gjykata mund të nxjerrë qarkore të brendshme për të dënuar praktikën e dorëzimit të vendimeve plotësisht të arsyetuara me shkrim me vonesë, që mund të zgjasë ditë apo javë.
- Rekomandohet që Këshilli i Lartë i Drejtësisë të ndër marrë masa disiplinore në rastet kur gjyqtarët janë përgjegjës për vonesa të paarsyeshme në dhënien e vendimeve me shkrim; përparësi u duhet dhënë rasteve kur këto vonesa pengojnë rishikimin e vendimeve nga një gjykatë më e lartë për personat që ndodhen në paraburgim.
- Dispozitat e KPrP-së lidhur me afatet kohore për përgatitjen dhe dorëzimin e vendimeve me shkrim dhe paraqitjen e ankimit, mund të rishikohen për t’i bërë ato më lehtësisht të zbatueshme. Do të rekomandohej që ndryshimet të përfshinin:
 - një dispozitë që parashikon afate kohore më të gjata për përgatitjen e vendimeve me shkrim në çështje komplekse;
 - një dispozitë që e përshtat afatin kohor për paraqitjen e ankimit duke marrë si referencë datën e dorëzimit të vendimit me shkrim;
 - një dispozitë që e autorizon Kryetarin e Gjykatës të ndër marrë masa me qëllim hartimin e vendimit brenda një periudhë sa më të shkurtër, në rast se Kryetari i trupit gjykues nuk e përfundon brenda afatit kohor ligjor.

³²⁴ KPrP, neni 386, pika 1.

Dorëzimi i fashikujve të gjykimit ndërmjet gjykatave të shkallës së parë dhe atyre të apelit

- Rekomandohet të ngrihen sisteme që sigurojnë transferimin e fashikujve të gjykimit ndërmjet gjykatave të rretheve dhe gjykatave të apelit në kohën e duhur, në mënyrë që të shmangen vonesat e panevojshme në trajtimin e seancave të çështjeve të ankimuara. Sugjerohet që:
 - Ministri i Drejtësisë të nxjerrë një qarkore që të tregojë dhe theksojë detyrat ligjore të nëpunësve të gjykatës për dorëzimin e dosjeve gjyqësore në kohën e duhur në gjykatën përkatëse të apelit në rastet kur çështja ankimohet;
 - të ndërmerret një monitorim sistematik i këtyre praktikave nga autoritetet përgjegjëse, përfshirë Kryetarin dhe Kancelarin e gjykatës së rrethit, si dhe inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
 - Kryetari i Gjykatës të ushtrojë pushtetin e tij disiplinor në rastet kur vonesat e përsëritura janë përgjegjësi e personelit të gjykatës;³²⁵
 - personeli administrativ i gjykatës t'i raportojë Kryetarit të Gjykatës rregullisht mbi çështjet funksionale dhe administrative dhe pengesat që ata hasin në trajtimin e çështjeve penale që janë ankimuar. Për aq sa është e mundur, këto raporte duhet të përmbajnë gjithashtu rekomandime praktike për përmirësimin e sistemit.

Planifikimi dhe caktimi i seancave të apelit

- Rekomandohet që çdo juridiksion, përfshirë juridiksionet apeluase, të hartojë procedura për vlerësimin e funksionimit të sistemit (dhe të secilës njësi organizative që ka përgjegjësi për aspekte të veçanta të çështjeve) me synimin që çështjet të zgjidhen në kohë. Kryetarët e gjykatave, zyrat e prokurorisë, avokatët mbrojtës, institucionet e zbatimit të ligjit dhe qeveria duhet të informohen në mënyrë të rregullt mbi ecurinë e punës.
- Do të ishte e përshtatshme që informacioni mbi funksionimin e sistemit përsa i përket zgjidhjes në kohë të çështjeve penale të bëhet rregullisht i

³²⁵ Shih Urdhrin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 1830, datë 3 prill 2001, "Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore", neni 8, pika 19, i cili shprehet se Kryetari i Gjykatës monitoron disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të gjykatës dhe se, në rast shkeljeje nga këta të fundit, mund të marrë masa disiplinore.

disponueshëm për publikun, p.sh., nëpërmjet publikimit të statistikave (mbi numrin e çështjeve penale të paraqitura në gjykatë, numrin e çështjeve të zgjidhura, numrin e çështjeve të ankimuara, numrin mesatar të seancave, kohën mesatare prej datës të paraqitjes së ankimit në atë të marrjes së vendimit, etj.).

- Do të rekomandohej të miratoheshin praktika dhe procedura efektive për menaxhimin e fluksit të çështjeve, si hartimi i një plani për menaxhimin efektiv të çështjeve në të gjitha jurisiksionet, përfshirë juridiksionet e apelit. Lidhur me këtë, rekomandohet që:
 - pas marrjes së dosjes gjyqësore, gjykata të përgatisë një plan të detajuar për seancën duke u konsultuar me palët. Plani duhet të detajojë numrin e parashikuar të seancave të apelit dhe përmbajtjen e tyre. Për projektplanin duhet rënë dakord me palët përpara fillimit të gjykimit. Më pas, ky plan duhet respektuar;³²⁶
 - Kryetari i gjykatës ta planifikojë listën e çështjeve gjyqësore në gjykim për të mundësuar zgjidhjen e shpejtë të çështjeve të vogla duke lejuar kohë të mjaftueshme për çështjet komplekse që mund të kërkojnë shqyrtime më të kujdesshme, si dhe ripërsëritjen e shqyrtimit gjyqësor;
 - gjykatat e apelit të miratojnë një politikë që lejon shtyrjet e seancave në apel vetëm pasi të ekzistojë një arsye bindëse dhe vetëm për aq kohë sa është e nevojshme, duke marrë parasysh jo vetëm kërkesën e prokurorit ose mbrojtjes por gjithashtu edhe interesin publik për zgjidhjen e menjëhershme të çështjeve;
 - të jepen udhëzime që të përcaktojnë se çfarë konsiderohet shkak i justifikueshëm për zgjatjen/shtyrjen e seancave;
 - Kryetari i trupit gjykues të ndërmarrë një rol më të vëmendshëm në planifikimin e seancave gjyqësore dhe në sigurimin e admini-strimit efikas të caktimit të seancave, p.sh., duke shmangur ricaktimin e orarit të seancave kur gjyqtarët nuk mund të jenë të pranishëm, ose duke i komunikuar menjëherë ndryshimet në caktimin e seancës për shkak të rrethanave të papritura dhe të jashtëzakonshme.

³²⁶ EURALIUS rekomandon gjithashtu që (1) dosja të kontrollohet për çdo informacion që mungon; (2) palët duhet të tregojnë dëshmitarët dhe çështjen për të cilën kërkohet dëshmia e tyre kur është e përshtatshme. Shih EURALIUS, *Feasibility Study on Measures to Shorten the Duration of Court Proceedings* [Studim fizibiliteti mbi masat për të shkurtuar zgjatjen e procedimeve gjyqësore] (Tiranë, EURALIUS, 2006), faqe 48.

- Përgjegjësia e gjykatave për sigurimin e gjykimeve efçente mund të theksohet dhe detajohet në *instruksione administrative* të nxjerra nga Ministri i Drejtësisë.
- Rekomandohet që Ministri i Drejtësisë të bëjë një studim për të përcaktuar se pse disa gjykata penale janë më efikase në menaxhimin e fluksit të çështjeve. Pasi të identifikohen “praktikat më të mira” administrative, ato duhen ndarë me kryetarët e të gjitha gjykatave. Këta të fundit duhet të përpqen t’i miratojnë dhe t’i zbatojnë këto praktika duke i përdorur më mirë burimet e tyre dhe duke shmangur vonesat e panevojshme në shqyrtimin e çështjeve.
- Gjithashtu, rekomandohet të organizohen seminare të detyrueshme trajnimi mbi procedurat dhe teknikat e administrimit të fluksit të çështjeve për gjykatat penale të apelit dhe administruesit e gjykatave.
- Do të ishte e përshtatshme që kryetarët e trupave gjykues të apelit të raportonin rregullisht te kryetari i gjykatës mbi fazën dhe gjendjen në të cilën ndodhen çështjet, të cilat kanë mbetur pezull në gjykim.
- Kryetari i gjykatës së apelit mund të monitorojë nga afër madhësinë, fazën dhe gjendjen në të cilën ndodhen çështjet në gjykim për të siguruar që afatet e gjykimit në çështjet individuale të mos i tejkalojnë kërkesat e vendosura për një gjykim të shpejtë.

Njoftimi për thirrjet

- Të gjithë aktorët e përfshirë duhet të përpqen të shmangin çdo vonesë të pajustificuar në trajtimin e seancave penale të apelit dhe autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin masat e duhura për t’iu përgjigjur këtyre vonesave.
 - Kur vonesat shkaktohen nga mungesa e pajustificuar dhe e përsëritur e avokatit mbrojtës, Dhoma Kombëtare e Avokatëve duhet të ndërmarrë masat e duhura disiplinore (p.sh., nxjerrjen e paralajmërimeve me shkrim) në përputhje me pushtetin që ushtron sipas ligjit.³²⁷

³²⁷ Ligji për Avokatët u bën atyre thirrje për të respektuar, ndër të tjera, rregullat e etikës profesionale. Në të parashikohet gjithashtu se, në rast shkeljeje të dispozitave që rregullojnë aktivitetin e avokatëve, komisioni disiplinor i dhomës së avokatëve mund të marrë masa disiplinore, përfshirë paralajmërimet me shkrim kundër avokatit në fjalë. Shih ligjin nr. 9109, datë 17 korrik 2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, nenet 9 dhe 34, pika (a).

- KPrP-ja mund të rishikohet për të përfshirë mundësinë që gjykatat të vendosin gjoba për palët e thirrura rregullisht, të cilat, pa shkaqe të arsyeshme, nuk paraqiten.
- KPrP-ja mund të rishikohet për të përfshirë mundësinë që gjykatat të miratojnë masa disiplinore ndaj avokatëve mbrojtës, të cilët, pa shkaqe të arsyeshme, nuk paraqiten.
- KPrP-ja mund të rishikohet për të përfshirë mundësinë që gjykatat të zëvendësojnë prokurorët që, pa shkaqe të arsyeshme, nuk janë paraqitur në mënyrë të përsëritur.
- Kryetari i Gjykatës duhet të mundohet të shmangë shtyrjet kur palët e thirrura sipas procedurës së rregullt, pa shkaqe të arsyeshme, nuk janë paraqitur.
- Rregullat e njoftimit duhen rishikuar:
 - KPrP-ja mund të ndryshohet duke u kërkuar ankuesve të deklarojnë qartë në kërkesën ankimore adresën për efekt të njoftimeve që mund të bëhen në të ardhmen nga gjykata. Çdo dokument i dorëzuar në atë adresë duhet konsideruar se i është dorëzuar ankuesit. Kur ankuesi është i ndaluar në kohën kur regjistron kërkesën ankimore, ai duhet të deklarojë emrin e institucionit në të cilin mbahet së bashku me një adresë tjetër, përveç asaj të institucionit.
 - Të parashikohet një dispozitë e re për të autorizuar gjykatën që të nxjerrë një urdhër arresti për të pandehurin, i cili është thirrur në kohën e duhur dhe me mënyrat e parashikuara në një seancë gjyqësore dhe pa shkaqe të arsyeshme, nuk është paraqitur.
 - Çdo njoftim të kërkojë që marrësi të konfirmojë dhe të japë informacione shtesë të rëndësishme për një njoftim të suksesshëm.
 - Të gjitha komunikimet e dala nga gjykatat të specifikojnë se kush duhet kontaktuar në rast mosparaqitjeje pas thirrjes.

KREU IV TRANSPARENCA DHE AKSESI NË PROCEDIMET GJYQËSORE

“Nëse dihet se çdo gjykim penal i nënshtrohet një rishikimi bashkëkohës në forumin e opinionit publik, atëherë do të ketë një frenim të efektshëm ndaj abuzimit të mundshëm të pushtetit ... Nëse gjykimet nuk bëhen publike, atëherë çdo lloj kontrolli tjetër është i pamjaftueshëm”.

In re Oliver, 333 U.S. 257, 68 S. Ct. 499 (1948)

I. HYRJE

Transparenca e veprimtarive dhe e proceseve gjyqësore është një parim i rëndësishëm që nxit shumë vlera themelore, siç janë: besimi i publikut në sistemin gjyqësor, njohja e administrimit të drejtësisë dhe përgjegjshmëria e gjyqësorit. Mundësia e marrjes së informacionit nga gjykatat dhe administratat e gjykatave është e domosdoshme për të parandaluar praktikën korruptuese, për të mbrojtur të drejtën e një gjykimi të drejtë si dhe për të garantuar një akses të mirëfilltë në sistemin gjyqësor. Parimi i “drejtësisë së hapur” është interpretuar nga disa burime të besueshme si një e drejtë publike “për të diskutuar dhe paraqitur opinione e kritika në lidhje me praktikën dhe procedimet gjyqësore”.³²⁸

E drejta shqiptare parashikon një detyrim të përgjithshëm për gjyqësorin që të mundësojë marrjen e informacionit që gjendet në dokumentet zyrtare, me anë të

³²⁸ *Canadian Broadcasting Corp v. New Brunswick* (Attorney general) [Korporata Kanadeze e Transmetimeve kundër New Brunswick (Prokuror i Përgjithshëm)] [1996] 3 SCR 480, [23].

Shih gjithashtu edhe vendimin e gjykatës së lartë amerikane në *Richmond Newspapers kundër provincës Virginia*, 448 U.S. 444 (1980).

Shih gjithashtu Jeremy Bentham për një interpretim jogjyqësor të parimit të drejtësisë së hapur: “Publikimi është vetë shpirti i drejtësisë. Është shpirti më i rreptë ndaj ushtrimit të drejtësisë dhe mbrojtësi më i sigurtë ndaj pandershmërisë. E mban gjyqtarin nën gjykim, ndërsa ai gjykon”. Jeremy Bentham, *The Works of Jeremy Bentham* [Veprat e Jeremy Bentham], vëllimi 4 (Londër, John Bowring, 1838-1843), faqet 316-17.

një kërkese, dhe ta bëjë këtë me të njëjtat kushte me të cilat marrin informacion edhe institucionet qeveritare.³²⁹ Përveç informacionit rreth çështjeve që lidhen me veprimtarinë dhe procedurat e përditshme gjyqësore, kjo nënkupton edhe transparencën në lidhje me vendimet gjyqësore dhe aktet e tjera të gjykatës. Për të garantuar këtë, gjykatat duhet të bëjnë të mundur që informacioni për seanca dëgjimore të merret pa vështirësi dhe në mënyrë të shpejtë, si dhe duhet të krijojnë lehtësira për pjesëmarrjen e publikut në këto seanca.³³⁰ Po kështu duhet të garantohet edhe akses i publikut në procesverbalet dhe regjistrat e gjykatës.

Ky kapitull paraqet shkurtimisht kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe vendës lidhur me të drejtën e një gjykimi publik dhe të drejtën për të marrë informacion mbi veprimtaritë gjyqësore. Më tej, kapitulli shtjellon se si pasqyrohen këto të drejta në praktikën shqiptare për sa i përket të drejtës për akses publik në procedimet gjyqësore dhe në vendimet gjyqësore. Gjithashtu, ai diskuton shkurtimisht çështjet e transparencës së procesverbaleve dhe regjistrave të gjykatës. Në fund jepen disa rekomandime për trajtimin e problemeve të vërejtura në këto fusha.

³²⁹ Ligji nr. 8503, datë 30 qershor 1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", neni 3, thotë:

Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet.

Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

Çdo informacion për një dokument zyrtar, që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur ky informacion përbën të dhëna vetjake të vetë personit, të cilit i është dhënë informacioni.

Këtu duhet përmendur se e drejta për ta marrë informacionin që gjendet në dokumentet zyrtare mund të jetë më kufizuese se e drejta për ta marrë informacionin që zotërohet nga autoritetet publike. Në fakt, e drejta e parë mund të mos i detyrojë autoritetet publike që të gjenerojnë një informacion të cilin nuk e kanë, atëherë kur përgjigjja e një kërkese nuk mund të nxirret nga dokumentet ekzistues. Edhe pse autoriteteve publike nuk u duhet kërkuar të krijojnë informacion të ri në përmbushje të një kërkese, në parim, nuk duhet të përjashtohet nxjerrja e informacionit nga dokumentet që ata kanë, edhe kur kjo kërkon krijimin e një dokumenti të ri. Sipas një komentuesi "dobishmëria e një regjimi aksesi do të rrezikohet rëndë nëse ajo do të kufizohet vetëm në leximin apo kopjimin e dokumenteve ekzistues". Shih "The importance of the right of access to information held by public authorities, and the need for the United Nations to take steps to further elaborate, codify, protect and promote this right" [Rëndësia e të drejtës për ta marrë informacionin që kanë autoritetet publike dhe nevoja që Kombet e Bashkuara të ndërmarrin hapa të mëtejshëm për ta rritur, kodifikuar, mbrojtur dhe nxitur këtë të drejtë], prezantim i Sandra Coliver-it në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për masat anti-korrupsion, mirëqeverisjen dhe të drejtat e njeriut, Varshavë, 8-9 nëntor 2006, faqe 9, e disponueshme në faqen: <http://www.ohchr.org/english/issues/development/governance/docs/Coliver.pdf> (konsultuar për herë të fundit më 19 nëntor 2007).

³³⁰ Çështja "Van Meurs kundër Holandës" (215/1986), 13 korrik 1990, Raporti i Komitetit për të Drejtat e Njeriut (A/45/40), 1990, paragrafi 6.2.

II. TRANSPARENCA E VEPRIMTARIVE DHE PROCEDIMEVE GJYQËSORE: E DREJTA PËR SEANCË PUBLIKE

E drejta për seancë publike është e garantuar nga e drejta ndërkombëtare.³³¹ Ajo është e zbatueshme jo vetëm për palët e çështjes, por edhe për publikun e gjerë, ku përfshihen përfaqësuesit e medias, të cilët kanë të drejtë të jenë të pranishëm në seancat dëgjimore gjatë shqyrtimit të çështjes në themel.³³² Qëllimi është që të garantohet “mbrojtja e ndërgjyqësve nga administrimi i drejtësisë në mënyrë të fshehtë, pa shqyrtimin e publikut”, duke nxitur në këtë mënyrë besimin e publikut te gjykatat dhe duke kontribuar në zhvillimin e një gjykimi të drejtë.³³³

Parimi i përgjithshëm i seancave publike ka përjashtime të pakta dhe të kufizuara. Gjykatat mund të mos lejojnë të gjithë publikun apo një pjesë të tij, vetëm në interes të drejtësisë, moralit shoqëror, rendit, sigurisë kombëtare ose jetës private të palëve.³³⁴ Më tej, sipas së drejtës ndërkombëtare, kjo e drejtë mund të kufizohet përsa i përket procedimit në apel.³³⁵ Por, nëse një gjykatë apeli e ka kompetencën për të vendosur mbi çështje si të faktit ashtu dhe të ligjit, ajo mund të jetë e detyruar ta zhvillojë seancën dëgjimore me pjesëmarrjen e publikut, në varësi të rrethanave dhe të asaj se çfarë është në interes të të

³³¹ E drejta ndërkombëtare parashikon që “çdo njeri ka të drejtën e një [...] seance publike”. Shih Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, neni 10; KEDNj, neni 6, pika 1; PNDCP, neni 14, pika 1. Me përjashtim të rasteve me rrethana të përcaktuara shumë qartë, seancat gjyqësore dhe gjykimet duhet të jenë publike. Komitetit për të Drejtat e Njeriut, komenti i përgjithshëm nr. 13, paragrafi 6.

³³² Komitetit për të Drejtat e Njeriut, komenti i përgjithshëm nr. 13, paragrafi 6.

³³³ Çështja “Pretto kundër Italisë” A 71 paragrafi 21 (1983). Komiteti i të Drejtave të Njeriut shprehet se “bërja publike e seancave është një garanci e rëndësishme në interes të individit dhe shoqërisë në përgjithësi”. Komenti i përgjithshëm nr. 13, paragrafi 6.

³³⁴ Shih KEDNj-në, neni 6, pika 1; PNDCP, neni 14, pika 1. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka konsideruar të lejueshëm përjashtimin e publikut nga procedimet për divorc dhe nga procedimet disiplinore mjekësore për të mbrojtur jetën private të palëve dhe është shprehur se për “interes të drejtësisë” mund të justifikohet dhënia e provave nga dëshmitarët me dyer të mbyllura për të garantuar sigurinë e tyre. Shih D.J. Harris, M. O’Boyle, C. Warbrick, *Law of the European Convention on Human Rights* [E drejta e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut] (Londër, Butterworths, 1995), faqe 220.

Shih gjithashtu edhe KPrP, nenet 339-340, sipas së cilit një gjyqtar mund të vendosë zhvillimin e një shqyrtimi gjyqësor penal me dyer të mbyllura: kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që mbahen sekret në interes të shtetit, në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga organi kompetent; kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës; kur është e nevojshme të mbrohet siguria e dëshmitarëve ose e të pandehurve; ose kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve.

³³⁵ GjEDNj-ja shprehet se për sa kohë që seanca ka qenë publike në gjykatën e shkallës së parë “mungesa e një ‘seance publike’ përpara një gjykate të shkallës së dytë ose të tretë mund të justifikohet me veçoritë e çështjes në fjalë”, siç mund të jetë fakti që procedimet mund të bëhen për një ankim në lidhje me çështje të ligjit. Shih çështjen “Ekbatani kundër Suedisë”, GjEDNj, 26 maj 1998, paragrafi 31 (citohet gjykimi i Monnell dhe Morris, në lidhje me lejen për të paraqitur ankim, dhe gjykimi i Sutterit në lidhje me procedimet përpara Gjykatës së Kasacionit).

pandehurit.³³⁶ Për të garantuar respektimin e së drejtës për një seancë publike, gjykatat duhet të sigurojnë që informacioni për seancat dëgjimore të merret në mënyrë të shpejtë dhe pa vështirësi, si dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e publikut në to.³³⁷

A. Bërja publike e listave të gjyqeve

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut shprehet se: “një gjykim e përmbush kërkesën për publicitet vetëm nëse publiku është në gjendje të marrë informacion rreth datës dhe vendit të gjyqit”.³³⁸ Nga kjo del që, si pjesë e detyrimit të tyre për bërjen publike të seancës, autoritetet duhet t’i japin publikut informacion rreth vendit dhe datës së zhvillimit të gjyqit.

Neni 24 i Rregullores për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore, parashikon që çdo gjykatë të ketë zyrën e marrëdhënieve me publikun me qëllim që të informojë publikun dhe median rreth veprimtarive të gjykatës. Ndër të tjera, kjo zyrë ka për detyrë të përgatisë dhe të publikojë informacione në lidhje me listën e gjyqeve.³³⁹ Megjithëse në rregullore parashikohet krijimi i zyrës së marrëdhënieve me publikun në çdo gjykatë,³⁴⁰ në gjykatat shqiptare të apelit nuk duket të ketë një zyrë të tillë. Në Durrës dhe në Vlorë, kancelarët e gjykatës janë ngarkuar jozyrtarisht të veprojnë si persona kontakti me publikun. Në Gjykatën e Apelit në Shkodër, kryesekretari është përgjegjës për kontaktet me publikun e gjerë dhe u përgjigjet pyetjeve, ndërsa kancelari mbulon marrëdhëniet me mediat dhe përgatit listën e gjyqeve. Në

³³⁶Në çështjen “Kremzow kundër Austrisë”, GjEDNj-ja u shpreh se prania e të pandehurit ishte e domosdoshme kur Gjykata e Lartë duhet të shqyrtonte nëse dënimi kundër tij duhej rritur nga njëzet vjet në burgim të përjetshëm dhe nëse dënimi do të kryhej në një burg të zakonshëm në vend të një institucioni për të dënuarit me çrregullime mendore. Duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes në interes të të pandehurit, GjEDNj-ja u shpreh se ai duhet të kishte qenë në gjendje të “mbronte vetë veten e tij”, siç parashikohet në nenin 6, pika 3 të KEDNj-së, dhe që shteti kishte detyrim pozitiv të garantonte praninë e tij në gjyq në të tilla rrethana. Kështu që, GjEDNj-ja konstatoi shkelje të nenit 6, pika 1, së bashku me pikën 3 (c). Shih çështjen “Kremzow kundër Austrisë”, GjEDNj, 21 shtator 1993, paragrafët 67-69. Shih gjithashtu çështjen “Ekbatani kundër Suedisë”, në të cilën çështja kryesore e konsideruar nga Gjykata e Apelit ishte ajo e fajësisë apo pafajësisë së kërkuesit. Sipas GjEDNj-së një rishikim i duhur i asaj çështjeje do të kishte qenë të dëgjohej nga gjykata edhe njëherë plotësisht kërkuesi dhe ankuesi. Për shkak se Gjykata e Apelit nuk e bëri këtë gjë, GjEDNj-ja arriti në përfundimin se shteti Suedez kishte shkelur nenin 6, pikën 1 të KEDNj-së. Çështja “Ekbatani kundër Suedisë”, GjEDNj, 26 maj 1998, paragrafët 32-33.

³³⁷ Çështja “Van Meurs kundër Holandës” (215/1986), 13 korrik 1990, Raporti i Komitetit për të Drejtat e Njeriut (A/45/40), 1990, paragrafi 6.2.

³³⁸ Shih çështjen “Riepan kundër Austrisë”, GjEDNj, 14 nëntor 2000, paragrafi 29.

³³⁹ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 1830, datë 3 prill 2001, “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”, neni 24, pika 8.5.

³⁴⁰ Po aty, neni 24.

secilin nga këto raste, personat e përfshirë kanë shprehur shqetësim se këto detyrime u kanë shkaktuar ngarkesë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.³⁴¹

Ndërsa shumë gjykata apeli i afishojnë listat e seancave penale dhe civile që do të zhvillohen, niveli i saktësisë dhe rregullsisë, me të cilën ato afishohen në praktikë, ndryshon. Siç tregohet më poshtë, në një numër gjykatash apeli lista e plotë, e saktë dhe e përditësuar e gjyqeve nuk bëhet publike. Ky veprim mund të shkelë të drejtën e të pandehurit për të pasur një seancë publike.

Në **Tiranë**, shorti për ndarjen e çështjeve zhvillohet një herë në muaj dhe pas kësaj botohet lista e gjyqeve. Sipas punonjësve pranë kësaj gjykate, informacioni për listën e gjyqeve botohet rregullisht një herë një muaj. Ndërkohë nuk është bërë asnjë përpjekje që publiku ta ketë të lehtë marrjen e këtij informacioni. Orari i çështjeve civile afishohet në të njëjtin vend me atë të çështjeve penale, duke vështirësuar punën e publikut në gjetjen e datës së një seance të caktuar. Përveç Gjykatës së Rrethit Tiranë, në hyrjen e të cilës është vendosur një shërbim kompjuterik ku mund të konsultohen datat e seancave, lista e seancave në Gjykatën e Apelit nuk është e përditësuar. Duket sikur disa gjyqtarë janë të mendimit se ai person që është i interesuar do të vijë në seancën e parë dhe aty do të marrë vesh se kur bëhet seanca e radhës. Ai person nga publiku që humbet një seancë, pengohet të marrë pjesë në seancat pasuese.

Në **Vlorë**, lista afishohet çdo dhjetë ditë në një tabelë të vendosur në muret e jashtme të ndërtesës së gjykatës. Megjithatë, publiku përsëri e ka të vështirë të marrë vesh saktë datat e seancave pasi ato nuk janë të lexueshme qartë dhe listat e vjetra që mbeten në tabelë të ngatërrojnë. Të dhëna thelbësore, siç janë emri i gjyqtarit apo numri i sallës nuk jepen. Për më tepër, lista nuk përditësohet kur ka shtyrje të seancave.

Në **Shkodër**, lista e çështjeve vendoset në mënyrë të rregullt në pjesën e jashtme të gjykatës çdo javë dhe përditësohet kur është e nevojshme. Një kopje e listës së gjyqeve vendoset edhe në këndin e njoftimeve të gjykatave të rrethit të cilat janë nën juridiksionin e gjykatës së apelit. Në listën e orarit të gjyqeve vendoset i gjithë informacioni i nevojshëm, data e seancës, emri i të pandehurit, emri i gjyqtarit, vepra për të cilin akuzohet i pandehuri si dhe salla ku do të zhvillohet seanca.

Në **Durrës**, lista afishohet një herë në muaj në pjesën e jashtme të ndërtesës së gjykatës së apelit, kështu që konsultimi i saj nga publiku bëhet më i thjeshtë dhe praktik. Megjithëse lista nuk përditësohet kur seancat shtyhen, palët në gjykim njoftohen me shkrim.

³⁴¹ Intervista me telefon të bëra nga Zyra e Projekteve të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, 20 mars 2007.

B. Aksesi i publikut në ndërtesën e gjykatës

E drejta për seancë publike kërkon gjithashtu që autoritetet përkatëse të sigurojnë ambientet e përshtatshme që gjyqi të ndiqet edhe nga publiku i interesuar.³⁴²

Në Shqipëri, megjithëse e drejta vendëse garanton publicitetin e seancave, niveli i pjesëmarrjes reale të publikut në seancat e apelit ndryshon nga gjykata në gjykatë për shkak të hapësirës së kufizuar që kanë gjykata të ndryshme. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri shpreh shqetësimin për mungesën e një dhome ku dëshmitarët mund të presin, mosqenia e së cilës shkakton probleme me sigurinë e dëshmitarëve që thirren nga organi i akuzës për të dëshmuar në gjyq, të cilët presin në të njëjtin vend më të pandehurit. Për shembull, në gjykatën e apelit në Shkodër nuk ka një dhomë pritjeje brenda gjykatës, kështu që njerëzit duhet të presin në korridorin kryesor të gjykatës. Po ashtu edhe në Gjykatën e Apelit në Tiranë nuk ka një dhomë pritjeje dhe njerëzve u duhet të presin në një bar ngjitur me gjykatën derisa të njoftohet me megafon çështja. Ndërsa në Vlorë, megjithëse gjykata e re e apelit u inaugurua në fund të vitit 2006, ajo nuk ka dhomë pritjeje për publikun apo për dëshmitarët.³⁴³

Ndërsa në disa raste hapësira e pamjaftueshme e sallave të gjyqit pengon pjesëmarrjen e publikut në seanca, në raste të tjera policia e gjykatës dhe praktikantët e gjykatës u kufizojnë hyrjen një kategorie të caktuar individësh. Për shembull, sipas rregullores së shkruar të brendshme të Gjykatës së Apelit Tiranë, përfaqësuesve të medias u lejohet të ndjekin seancat vetëm pasi prania e tyre t'i jetë komunikuar kryetarit të trupit gjykues nga roja. Në disa raste është vërejtur që përfaqësuesit e OSBE-së, por jo mjetet e informimit masiv, janë lejuar të ndjekin seancat gjyqësore. Ndërsa, në disa raste të tjera, pjesëmarrësit nga publiku janë pyetur përse donin të ndiqnin seancën, dhe më pas sekretarja ka pyetur kryetarin e gjykatës përpara se t'i lejonte të hynin brenda.³⁴⁴

III. BOTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE

Një akses i gjerë në vendimet gjyqësore bën të mundur që puna e gjykatës të shqyrtohet nga publiku duke nxitur në këtë mënyrë transparencën dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit. Botimi i vendimeve të gjykatës edukon

³⁴² Çështja "Van Meurs kundër Holandës" (215/1986), 13 korrik 1990, Raporti i Komitetit të së Drejtave të Njeriut (A/45/40), 1990, paragrafi 6.2.

³⁴³ Godina e re e gjykatës, e hapur më datë 3 nëntor 2006, ka katër salla gjyqi, secila me kapacitet për 50-70 persona.

³⁴⁴ *Analizë e sistemit gjyqësor penal në Shqipëri*, faqe 163.

komunitetin e juristëve dhe publikun e gjerë mbi çështje ligjore dhe gjyqësore, duke ndihmuar në të njëjtën kohë zhvillimin e jurisprudencës në vend. Ky parim ka dy efekte: e para, të gjitha vendimet gjyqësore duhen bërë publike përveçse në rastet e përcaktuara shumë qartë³⁴⁵ dhe duhet të jenë të disponueshme për çdo palë të interesuar; e dyta dhe më e rëndësishmja (në mos të gjitha) vendimet e apelit për çështjet penale duhen botuar dhe shpërndarë gjerësisht.

Një vendim konsiderohet të jetë bërë publik nëse është shpallur gojarisht në një seancë gjyqësore të hapur për publikun ose është nxjerrë një vendim me shkrim. Kërkesa që vendimet e gjykatës të bëhen publike, zbatohet edhe nëse pjesëmarrja e publikut nuk është lejuar gjatë të gjithë gjykimit apo vetëm gjatë disa pjesëve të tij.³⁴⁶

Sipas GjEDNj-së, e drejta për një gjykim publik cenohet kur vendimet u bëhen të disponueshme vetëm një grupi të caktuar njerëzish ose kur vendimin mund ta konsultojnë vetëm disa njerëz që kanë një interes të caktuar.³⁴⁷ Në Rekomandimin Nr. R (95) 12 për administrimin e drejtësisë penale, Këshilli i Evropës është shprehur se gjyqësori duhet të jetë i angazhuar të zbatojë një politikë shpërndarjeje të informacionit ku të përshpejtohet rrjedhja e informacionit dhe të ketë më shumë komente mbi rezultatin e çështjeve me të cilat merret. Këshilli i Evropës ka sugjeruar gjithashtu që administrata e drejtësisë penale të përqendrohet më tepër në "zhvillimin e marrëdhënieve më të mira, të trajtojë në mënyrë të veçantë nevojat dhe shqetësimet e përdoruesve të drejtësisë penale, mediat ... qytetarët dhe institucionet e tyre demokratike..."³⁴⁸ Gjithashtu, Rekomandimi R (2001) 3 i Këshillit të Evropës për dhënien e shërbimeve gjyqësore dhe ligjore përmes përdorimit të teknologjisë thotë se komunikimi me gjykatat përmes mjeteve të reja të teknologjisë duhet të lehtësohet sa më shumë, dhe u bën thirrje sistemeve të gjykatave të shteteve palë ta bëjnë informacionin e tyre, si dhe praktikën gjyqësore, të disponueshme për publikun.³⁴⁹

³⁴⁵ PNDPCP, neni 14, pika 1; KEDNj, neni 6, pika 1. Përjashtimet e kërkesës për një gjykim publik sipas nenit 14, pika 1 të PNDPCP, lidhur me çështjet ku përfshihen të miturit, ku duhet ruajtur jeta e tyre private, mosmarrëveshjet bashkëshortore në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve. E drejta për shpalljen publike të vendimeve, është e zbatueshme për të gjitha vendimet e dhëna nga cilado gjykatë, përfshirë gjykatat e posaçme dhe ato ushtarake si dhe gjykatat e apelit. Shih komentin e përgjithshëm nr. 13, paragrafi 4, të Komitetit për të Drejtat e Njeriut.

³⁴⁶ Komiteti për të Drejtat e Njeriut, komenti i përgjithshëm nr. 13, paragrafi 6.

³⁴⁷ Në çështjen Sutter, në të cilën vendimi nuk u lexua me zë të lartë në sallë por palët e çështjes morën kopje të tij dhe vendimi u depozitua në evidencat e gjykatës, i disponueshëm për cilindo që do të kishte interes, GjEDNj-ja u shpreh se nuk kishte shkelje të nenit 6, pika 1 të KEDNj-së. Çështja "Sutter kundër Zvicrës", GjEDNj, 22 shkurt 1984, paragrafi 34.

³⁴⁸ Rekomandimi nr. R (95) 12 mbi administrimin e drejtësisë penale, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, shtator 1995.

³⁴⁹ Rekomandimi nr. R(2001) 3 për dhënien e shërbimeve gjyqësore ligjore përmes përdorimit të teknologjisë, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, neni 3.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon që të gjitha vendimet e gjykatës duhet të shpallen publikisht.³⁵⁰ Siç parashikohet edhe në ligjin për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, shtetasit shqiptarë mund të kërkojnë informacion mbi dokumente zyrtare në lidhje me veprimtarinë e organeve shtetërore pa shpjeguar motivet e kërkesës.³⁵¹ Sipas po këtij ligji, vendimet përfundimtare për çështje të caktuara (siç mund të jenë, vendimet gjyqësore, megjithëse kjo është e debatueshme) përgatiten paraprakisht për t'u paraprirë kërkesave të publikut. Për më tepër, paraprakisht përgatiten kopje të dokumenteve zyrtare që u janë dhënë më parë të paktën një personi dhe që mund të jenë me interes edhe për persona të tjerë.³⁵² Po në këtë ligj parashikohet gjithashtu që autoriteti publik "nxjerr rregullore dhe krijon lehtësi strukturore e praktike për marrjen nga ana e publikut, në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë të informacionit për dokumentet zyrtare".³⁵³ Edhe pse kjo është thelbësore për të detajuar dhe qartësuar të drejtën e marrjes së informacionit nga dokumentet zyrtare (duke përfshirë edhe vendimet e gjykatës), deri tani nuk janë marrë masa nga autoritetet gjyqësore apo Ministria e Drejtësisë për t'i shpjeguar në mënyrë më të qartë këto të drejta.³⁵⁴

KPrP-ja parashikon që "cilido që ka interes" mund të marrë, me shpenzimet e veta, gjatë procedimit apo pas përfundimit të tij "kopje, ekstrakte ose vërtetime, të akteve të veçanta".³⁵⁵ Ndërkohë që termi i përgjithshëm "akte" përfshin patjetër vendimet gjyqësore, formulimi i kësaj dispozite duket se e kufizon mundësinë për t'i kërkuar këto akte, vetëm tek ata persona "që kanë interes". Megjithëse komentari i KPrP-së thekson se një kërkesë e tillë duhet respektuar vetëm nëse paraqitet nga një "i interesuar", ai nuk hedh dritë as mbi natyrën e interesit as mbi mënyrën se si duhet interpretuar kjo dispozitë.³⁵⁶ Ndonëse thuhet se kërkesa për marrjen e akteve gjatë hetimit paraprak shqyrtohet nga prokurori, kurse kërkesa për aktet e gjykimit shqyrtohet nga gjykata, për dokumentet e tjera nuk përmendet asgjë.³⁵⁷ Neni 197 i KPrP-së parashikon që me kërkesën e të interesuarit, organi procedues "mund" të autorizojë sekretarinë të lëshojë kopje të vërtetuara të dokumentit,³⁵⁸ duke lënë shteg për një lloj kufizimi.

³⁵⁰ Kushtetuta, neni 146, pika 2.

³⁵¹ Ligji nr. 8503, datë 30 qershor 1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", neni 3.

³⁵² Po aty, neni 9 (a) dhe (c).

³⁵³ Po aty, neni 6.

³⁵⁴ Megjithëse projektregullorja për të drejtën e informimit e përgatitur nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me USAID-in, përcakton kuptimin e dokumentit zyrtar dhe përcakton se si dorëzohet kërkesa për informacion, ajo nuk mbulon dokumente të tilla si vendimet e gjykatës.

³⁵⁵ KPrP, neni 105, paragrafi 1.

³⁵⁶ Komentari i KPrP-së, faqe 182.

³⁵⁷ KPrP, neni 105, pika 2.

³⁵⁸ KPrP, neni 197. Këtu duhet pasur parasysh se Komentari i KPrP komenton se autoriteti procedues lëshon kopje të vërtetuara të dokumenteve "në çdo rast, me kërkesën e të interesuarit", duke mos ia lënë në dorë zgjedhjen autoritetit, Komentari i KPrP-së, faqe 248.

Megjithatë në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore thuhet se sekretaria e gjykatës ka për detyrë, ndër të tjera, të lëshojë kopje të vendimeve dhe akteve të tjera procedurale për qytetarët.³⁵⁹ Kjo duket se nuk përkon me atë që thuhet në Kodin e procedurës.

A. Praktika shqiptare

Në Shqipëri, aksesit i publikut në gjykatat e apelit është i kufizuar, duke kompromentuar kështu të drejtën bazë të publikut për të shqyrtuar punën e gjykatave dhe për të parë vendimet që merren në emër të tij. Në fakt, shpeshherë është e vështirë edhe për palët në një çështje të marrin kopje të vendimeve. Në vend që vendimet e gjykatës të jenë të gatshme për çdo palë të interesuar, autoritetet përkatëse gjyqësore vendosin t'i japin ose jo këto vendime sipas rastit konkret dhe kjo rezulton në praktika të veçuara që mund të cenojnë të drejtën e një gjykimi të drejtë.

Për shembull, Kryetari i **Gjykatës së Apelit, Tiranë**, i tha Prezencës së OSBE-së në Shqipëri se ndërsa palët e përfshira në çështje dhe të afërmit e tyre të ngushtë mund të marrin vendimet penale të apelit, kjo e drejtë nuk u takon automatikisht palëve të treta (d.m.th., individëve që nuk kanë lidhje apo një interes relativisht të ngushtë në një çështje). Në të tilla raste, zyrtarët e gjykatës vendosin të japin një vendim gjyqësor sipas vlerësimit të tyre dhe sipas çështjes. Kjo praktikë nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare për një gjykim të drejtë. GjEDNj-ja është shprehur se e drejta për një gjykim publik shkelet kur vendimet u vihen në dispozicion vetëm një grupi të caktuar individësh apo *kur vetëm një grupi njerëzish që kanë interes të caktuar, u lejohet të kontrollojnë një vendim*.³⁶⁰ Së fundi, ekziston një praktikë e vendosur mirë tashmë, ku gazetarëve, të cilët kërkojnë kopje të vendimeve të gjykatës, u kërkohet të vendosin emrin dhe gazetën e tyre në një regjistër, dhe pritet që ata të mos jenë kritikë ndaj vendimeve të apelit për të mos kompromentuar reputacionin dhe besueshmërinë e gjykatës. Kjo praktikë duhet dënuar, pasi janë pikërisht gazetarët të cilët, me kritikën dhe shkrimet e tyre informative, e bëjnë publikun të ndërgjegjshëm për gabimet dhe padrejtësitë e mundshme të drejtësisë.

Në **Vlorë**, ndonëse gazetarët zakonisht i marrin kopjet e vendimeve të lëshuara nga Gjykata e Apelit të Vlorës, pas paraqitjes së një kërkesë me shkrim, sekretarja e kësaj gjykate i ka shprehur Prezencës së OSBE-së në Shqipëri rezervat e saj për t'u dhënë vendime individëve që nuk kanë lidhje me çështjen. Këtë gjë e ka

³⁵⁹ Urdhri i Ministrisë të Drejtësisë nr. 1830, datë 3 prill 2001, "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore", neni 19, pika 18.

³⁶⁰ Shih çështjen "Sutter kundër Zvicrës", GjEDNj, 22 shkurt 1984.

bërë shumë rrallë dhe në raste të veçanta. Sipas të njëjtit person do të ishte “e dyshimtë” t’i jepej vendimi një personi “që nuk ka lidhje me çështjen”.

Në **Shkodër**, vendimet e gjykatës së apelit u jepen vetëm palëve të interesuara në bazë të një kërkesë me shkrim, pavarësisht se kjo gjë nuk kërkohet me ligj.³⁶¹ Sipas kancelarit të gjykatës, ligji parashikon që emri i kërkuarit të regjistrohet në një regjistër të veçantë. Vendimi i jepet kërkuarit brenda 24 orësh nga dorëzimi i kërkesës, përkundrejt pagesës së një tarife.

Në **Durrës**, me kërkesën e palëve të çështjes, atyre u vihen në dispozicion pesë kopje të vendimit të gjykatës së apelit. Pjesëtarët e tjerë të publikut duhet të dorëzojnë një kërkesë me shkrim, e cila duhet miratuar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit. Sipas kancelarit të Gjykatës së Apelit, deri më sot nuk është depozituar ndonjë kërkesë e tillë.

Përveç vendimeve të gjykatave të disa rretheve të caktuara³⁶² si dhe vendimeve të Gjykatës së Lartë, që janë botuar përkatësisht në faqet e internetit të gjykatave dhe në Buletinin e Praktikës Gjyqësore të Gjykatës së Lartë, vendimet e gjykatave të apelit nuk janë botuar deri më sot.

IV. PROCESVERBALET NË PROCEDIMET GJYQËSORE

Mbajtja e saktë e procesverbaleve në seancat gjyqësore i jep publikut një mjet për të kontrolluar punën e gjyqësorit, në mënyrë që të garantohet se gjykatat i gjykojnë çështjet drejtë, me paanësi dhe në mënyrë transparente. Në çështjet penale, procesverbali i seancave gjyqësore mund të mbahet në mënyrë të përmblodhur apo të plotë dhe me dorëshkrim kur nuk ka mjete teknike në dispozicion.³⁶³ Kur veprimet që duhet të pasqyrohen kanë përmbajtje të thjeshtë ose kur mungojnë mjetet mekanike, gjykata mund të vendosë që procesverbali të mbahet në formë të përmblodhur. Në rastin e fundit gjykata duhet të sigurohet që të shënohen pjesët

³⁶¹ Ligji parashikon vetëm që “Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare ... pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet”. Nuk parashikon ndonjë formë për një kërkesë të tillë. Shih ligjin nr. 8503, datë 30 qershor 1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 3.

³⁶² Gjykata e Rrethit Tiranë e boton pjesën më të madhe të vendimeve në faqen e internetit dhe i bën ato të disponueshme në formë të shtypur. Gjykata të tjera të shkallës së parë që botojnë në faqen e internetit tekstet e plota të vendimeve apo pjesë nga vendime të caktuara janë gjykata e Shkodrës, Fierit dhe Kavajës. Shih botimin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, *Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri* (Tiranë, OSBE, 2006), faqe 158.

³⁶³ KPrP, neni 115.

thelbësore.³⁶⁴ Gjatë gjykimit, është detyrë e sekretares gjyqësore që të reflektojë në procesverbal pyetjet e bëra nga palët dhe nga kryetari i trupit gjykues, si dhe përgjigjet e personave të pyetur. Është përgjegjësia e kryetarit të trupit gjykues të sigurojë që procesverbali të jetë mbajtur saktë dhe qartë.³⁶⁵

Mbajtja e saktë dhe e plotë e procesverbalit është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e procedimeve të apelit, ku gjykata duhet të shqyrtojë punën e bërë nga gjyqtarët e shkallës së parë për të verifikuar nëse e kanë interpretuar dhe zbatuar saktë ligjin. Procesverbalet e pasaktë iu hapin rrugën manipulimeve dhe u mohojnë palëve një mjet shumë të rëndësishëm në përgatitjen e çfarëdolloj ankimi.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, ka vërejtur se në disa raste, procesverbalet e mbajtura nga gjykatat shqiptare nuk janë të plota në kuptimin që ato ose nuk pasqyrojnë pyetjet që u janë bërë dëshmitarëve ose nuk pasqyrojnë se cila nga palët (p.sh., prokurori, avokati mbrojtës) i ka bërë pyetjet. Më tej, kur dëshmitarët apo palët thirren për të konfirmuar apo për t'u ballafaquar me deklaratat kontradiktore të dhëna prej tyre në fazën paraprake të gjykimit, shpeshherë në procesverbal nuk pasqyrohen të gjitha kundërthëniet e pretenduara.

Në disa raste, cilësia e dobët e procesverbaleve të mbajtura me shkrim dore, i pengon praktikisht palët e interesuara që të kenë mundësi t'i rishikojnë ato. Në Shkodër për shembull, vëzhguesit e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri patën pak mundësi të studionin fashikujt pikërisht për këtë arsye. Një projekt për trajnimin e sekretarëve në shtypjen me kompjuter u financua nga USAID-i dhe u zbatua pjesërisht në gjykatat e rrethit në Tiranë, Fier, Kavajë, Mat, Shkodër dhe Vlorë, por u ndërpre më vonë për shkak të problemeve të bashkërendimit mes donatorëve.³⁶⁶

V. AKSESI NË REGJISTRAT E GJYKATËS

E drejta e publikut për akses në regjistrat e gjykatës përfshihet në parimin e gjykatave të hapura dhe të drejtave për akses në dokumentet zyrtare.

Duke kërkuar akses për të konsultuar regjistrat e gjykatës në kontekstin e procedimeve penale të apelit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka ndeshur nganjëherë rezistencë dhe dyshim nga administruesit e gjykatave. Në disa raste, Prezencës së OSBE-së në Shqipëri i është mohuar aksesit për të konsultuar

³⁶⁴ KPrP, neni 120.

³⁶⁵ KPrP, neni 345, pika 2.

³⁶⁶ ABA/CEELI, *Judicial Reform Index for Albania* [Indeksi i reformës gjyqësore për Shqipërinë], vëllimi III (Washington, DC, American Bar Association [Organizata e juristëve amerikanë], 2006), faqe 51.

qoftë edhe regjistrat dhe dokumentet më të thjeshta të gjykatës. Për shembull, Kryesekretarja e Gjykatës së Apelit Tiranë vazhdimisht ka mohuar aksesin për t'u konsultuar me regjistrin e ankimeve penale. Kopjet nga ky regjistër u bënë të mundur të merreshin vetëm pas paraqitjes së një kërkesë zyrtare Kryetarit të gjykatës. Në Gjirokastrë, sekretarja e gjykatës së rrethit i ka mohuar Prezencës së OSBE-së në Shqipëri aksesin për të konsultuar regjistrin ku ishte regjistruar data kur dosja e çështjes merrej nga sekretaria, duke deklaruar se ishte vetëm për "përdorim të brendshëm".

Më tej, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka vënë re se praktikatat e mbajtjes së regjistrave të gjykatës ndryshojnë nga gjykata në gjykatë, duke krijuar konfuzion dhe duke penguar *de facto* mundësinë e barabartë për të marrë informacion dhe dokumente gjyqësore.

Për shembull, Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Durrës kanë regjistra që tregojnë mes informacioneve të tjera edhe datën e shpalljes së vendimit në një çështje dhe datën kur fashikulli i çështjes (përfshirë vendimin) është depozituar në sekretarinë e gjykatës.³⁶⁷ Nga ana tjetër, Gjykata e Rrethit Shkodër, nuk ka asnjë regjistër që tregon datën kur është depozituar në sekretari dosja e çështjes. Ndërkohë, sipas kancelarit të Gjykatës së Rrethit Vlorë, megjithëse një regjistër i tillë nuk ekziston, sekretaret e gjykatës mund ta shkruajnë datën në blloqet e tyre private të shënimeve. Në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë, sekretaria e gjykatës mban një regjistër që tregon datën e përfundimit të çështjes si dhe datën e dorëzimit të dosjes së çështjes tek kryesekretarja. Siç është vënë në dukje më lart, sekretarja e kësaj gjykate ia mohoi Prezencës së OSBE-së në Shqipëri aksesin në këtë regjistër, duke deklaruar se ishte vetëm për "përdorim të brendshëm".

VI. PËRFUNDIME

Siç u përmend më lart, aksesin publik në aktivitetet dhe informacionin gjyqësor u shërben funksioneve të rëndësishme publike, d.m.th, nxitjen e publikut që të jetë i informuar dhe nxitjen e një kulture të të qenit i hapur, si dhe përgjegjshmërinë e sistemit gjyqësor. Këto, nga ana e tyre, nxisin administrimin e drejtë dhe efikas të drejtësisë.

Në Indeks të Reformës Gjyqësore të ABA/CEELI-t (2006), gjyqësori shqiptar mori një vlerësim negativ për sa u përket transparencës dhe përgjegjshmërisë. Sipas ABA/CEELI-t, pavarësisht nga garancitë ligjore për pavarësi, gjyqësori

³⁶⁷ Në Tiranë, regjistri quhet "Numëror i vendimeve penale për gjykatat e shkallës së parë"; në Durrës, regjistri quhet "Regjistri i çështjeve penale".

mbetet i prekshëm ndaj ndikimit të tepërt dhe perceptohet gjerësisht si i korruptuar.³⁶⁸ Në një vëzhgim të vitit 2005, qytetarët shqiptarë e renditën gjyqësorin si një nga institucionet më të korruptuara në sektorin publik, dhe vetëm 35% e tyre u shpreh se kishin besim që gjyqësori ishte në gjendje të vendoste drejtësi në çështjet penale.³⁶⁹ Siç është vënë re më lart, transparenca e procedimeve ligjore në Shqipëri pengohet nga një numër i madh vështirësish praktike dhe logjistike, përfshirë praktikën e paqëndrueshme për sigurimin e informacionit të përditësuar mbi procedimet gjyqësore, ambientet e pamjaftueshme në gjykata dhe aksesin e kufizuar në vendimet gjyqësore. Praktikën jo të unifikuar të mbajtjes së regjistrave në gjykata dhe pasaktësitë në mbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore mund ta pengojnë gjithashtu transparencën e veprimtarive gjyqësore.

Disa nga këto çështje mund të zgjidhen vetëm duke akorduar fonde dhe burime të mjaftueshme për sistemin gjyqësor – p.sh., duke pajisur me faqe interneti gjykatat e apelit, ashtu siç është bërë për shumë gjykata rrethi, ose duke nxitur pjesëmarrjen e publikut në seancat gjyqësore të apelit duke mundësuar dhoma pritjeje në të gjitha godinat e gjykatave. Ndërkohë disa çështje të tjera mund të kërkojnë ndërhyrje administrative për të sqaruar qëllimin dhe efektet praktike të së drejtës për të marrë informacion gjyqësor. Mungesa e normave dhe rregulloreve të posaçme dhe të detajuara që garantojnë mundësinë për të marrë informacion gjyqësor, të shoqëruara me vështirësitë konkrete që ndeshin palët dhe publiku i gjerë për marrjen e informacionit, pengon realizimin e parimeve të një drejtësie të hapur dhe transparente, si dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri.

³⁶⁸ ABA/CEELI, *Judicial Reform Index for Albania* [Indeks i reformës gjyqësore për Shqipërinë], vëllimi III (Washington, DC, American Bar Association [Organizata e juristëve amerikanë], 2006), faqe 43-44 (vini re gjithashtu se pavarësisht raporteve të shumta dhe akuzave për korrupsion, nuk ka pasur ndjekje penale ndaj gjyqtarëve për akuzat për korrupsion gjatë vitit 2006).

³⁶⁹ Casals & Associates dhe Instituti për Studimet dhe Alternativat e Zhvillimit, *Corruption in Albania: Perception and Experience, SURVEY 2005- Summary of findings* [Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Eksperiencia, STUDIM 2005- Përmbledhje e rezultateve] (qershor 2006), faqet 6, 14.

VII. REKOMANDIME

Të përgjithshme

- Do të ishte mirë që të gjithë zyrtarët publikë, ku përfshihen edhe zyrtarët e gjykatave e të sistemit të drejtësisë, të trajnoheshin mbi të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare.
- Me anë të fushatave publike ndërgjegjësuese, publiku duhet informuar rreth së drejtës së tij për të ndjekur gjyqet dhe për të marrë informacion për dokumentet publike, ku përfshihen edhe vendimet e gjykatës.
- Rekomandohet që secila gjykatë apeli të ketë strukturat e përshtatshme për t'iu përgjigjur kërkesave të publikut për informacion. Kjo gjë mund të bëhet nëpërmjet:
 - ngritjes së një zyre shtypi apo zyre informacioni në çdo gjykatë apeli;
 - caktimit të një punonjësi të gjykatës si pikë kontakti apo si specialist shtypi.
- Gjithashtu, rekomandohet që inspektorët e gjykatave në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë të kenë parasysh çështjet e transparencës kur kryejnë kontrollet e tyre.

Mundësia e marrjes së informacionit gjyqësor dhe e pjesëmarrjes në seancat gjyqësore në apel

- Të gjitha gjykatat penale, ku përfshihen edhe gjykatat e apelit, duhet të vënë rregullisht në dispozicion të publikut informacionin mbi datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancave publike.
 - Informacioni duhet të afishohet në një vend ku të mund të lexohet lehtësisht nga publiku, pra lista e seancave duhet të vihen në një tabelë njoftimesh, të cilat mund të shihet nga publiku.
 - Informacioni duhet të përditësohet rregullisht dhe për çdo gjyq.
 - Lista e seancave duhet hartuar dhe duhet mbajtur pastër dhe qartë.

- Do të ishte mirë që, për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë të nxjerrë udhëzime lidhur me aksesin e publikut në drejtësi, duke u kërkuar administratorëve dhe kryetarëve të gjykatave që të bëjnë të mundur që:
 - listat e plota e të përditësuara të çështjeve të afishohen në një tabelë njoftimesh ku mund të shihen nga publiku;
 - procedimet e apelit të jenë publike si parim i përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, si dhe të mos ketë pjesëmarrës nga publiku që të përjashtohen apo t'u kufizohet mundësia e marrjes së tyre.
- Praktikrat e gjykatës të cilat kërkojnë "leje të veçanta" për t'ia mundësuar informacionin kategorive të caktuara (si p.sh., gazetarëve) duhet të pushohen menjëherë.
- Rekomandohet që të gjitha gjykatat e apelit në Shqipëri të kenë ambiente të përshtatshme për publikun që dëshiron të ndjekë seancat, dhe çdo gjykatë duhet të ketë dhoma pritjeje për dëshmitarët brenda ndërtesës së saj.

Vendimet gjyqësore

- Do të rekomandohej që të gjithë zyrtarët e gjykatave të apelit të trajnoheshin veçanërisht mbi të drejtën për të marrë kopje të vendimeve gjyqësore.
- Në një vështrim afatshkurtër, të gjitha vendimet e gjykatave të apelit për çështjet penale duhet të bëhen të disponueshme për çdo palë të interesuar me kërkesë dhe kundrejt një pagese që mbulon vetëm kostot, në përputhje me ligjin. Asnjë lloj kufizimi nuk duhet të zbatohet për anëtarët e publikut që bëjnë një kërkesë të tillë. Prandaj, çdo politikë që kërkon që i interesuari të japë justifikime për një kërkesë të tillë duhet shmangur.
- Në një vështrim afatgjatë, në të gjitha gjykatat e apelit duhet vënë në punë një faqe interneti. Faqja e internetit duhet të botojë përmbledhje të vendimeve të gjykatave, kronologji nga seancat gjyqësore dhe arsyet e pezullimeve, dhe të sigurojë mundësinë për të parë nëse çështja është ankimuar në Gjykatën e Lartë.

- Brenda një periudhe afatgjatë, këshillohet që një numër i madh vendimesh të gjykatave të botohen në tërësi. Duke qenë se kjo është një ndërmarrje ambicioze, do të ishte e mjaftueshme që në një vështrim afatshkurtër të publikoheshin tërësisht, të paktën vendimet më të rëndësishme të gjykatave të apelit. Kjo do të përfshinte çështjet ku jepet një interpretim i ri i ligjit. Përveç kësaj, do të ishte mirë të publikohej të paktën një numër i caktuar vendimesh të zgjedhura rastësisht me qëllim që gjyqtarët ta dinë se për secilin vendim të marrë ekziston një mundësi që të shqyrtohet lehtësisht nga ana e publikut.
- Udhëzimet e Ministrisë së Drejtësisë të propozuara më lart për aksesin e publikut në sistemin e drejtësisë, duhet të përmbajnë rregulla dhe procedura të standardizuara lidhur me marrjen e kërkesave nga publiku për vendimet e gjykatave të apelit. Rregullat e standardizuara duhet të theksojnë se parimi i “drejtësisë së hapur” është rregull e përgjithshme dhe se mund të bëhet subjekt vetëm i përjashtimeve të kufizuara dhe të përgatitura me kujdes, atëherë kur parimi duhet të krahasohet me vlera të tjera krahasuese, si e drejta e individit për një jetë private ose për siguri.³⁷⁰ Udhëzimet duhet të caktojnë gjithashtu se në ç’mënyrë do t’i jepet medias informacioni mbi vendimet dhe aktet gjyqësore.

Regjistrat e gjykatës

- Është e nevojshme që regjistrat e gjykatës në lidhje me procedimet penale të apelit të mbahen me saktësi, si dhe të zbatohen standarde të unifikuara për evidentimin dhe regjistrimin e çështjeve. Në regjistrat e gjykatës duhet të tregohen data e seancës gjyqësore, numri i fashikullit, palët, vendndodhja e gjykatës, vepra penale dhe të dhënat mbi vetë dokumentin.
- Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të nxjerrë udhëzime për sqarimin e kuptimit dhe qëllimit të së drejtës së publikut për akses në aktet e administrimit gjyqësor. Politika që do të merret si shembull, edhe pse duhet të bazohet në parimin kryesor të aksesit të barabartë në aktet gjyqësore, duhet të pranojë gjithashtu se mund të ketë përjashtime nga ky parim. Këto kufizime mund të justifikohen vetëm kur janë të nevojshme, d.m.th., në rastet kur e drejta e jetës private dhe siguria e personit rrezikohet seriozisht, ose kur ekzistojnë interesa të tjera të rëndësishme si ato që kanë lidhje me administrimin e duhur të drejtësisë. Çdo rast kufizues duhet parë me kujdes në mënyrë që ndikimi te parimi i gjykatave të hapura të jetë minimal dhe ai duhet të zbatohet vetëm kur përfitimet nga kufizimi të jenë më të mëdha se efektet e tij negative.

³⁷⁰Shih, p.sh., *Canadian Judicial Council Model Policy* [Politika model e Këshillit Gjyqësor kanadez], gjendet në <http://www.cjc-ccm.gc.ca/article.asp?id=3000> (parë për herë të fundit më 19 nëntor 2007).

Procesverbalet e gjykatave

- Teknikat për përgatitjen e procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësor në shkallën e parë dhe në apel duhen përmirësuar dhe duhen miratuar metoda që minimizojnë kohën e nevojshme të transkriptimit të procesverbaleve të seancave gjyqësore, duke siguruar që ato të jenë të sakta dhe të plota.
 - Në të gjitha gjykatat e apelit duhet të përvetësohen procese të reja elektronike dhe teknologjike për përgatitjen e procesverbaleve në mënyrë që të lejojnë mbajtjen e tyre në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.³⁷¹
- Saktësia e procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësor duhet përmirësuar. Duhet eliminuar sidomos praktika e mosraportimit fjalë për fjalë të pyetjeve dhe të përgjigjeve që bëhen nga palët gjatë shqyrtimit gjyqësor.

³⁷¹ Sipas KPrP-së neni 115, procesverbalet mund të mbahen në stenotipi, me mjete të tjera teknike kur ato janë të disponueshme, ose me dorëshkrim. Shih KPrP, neni 115, paragrafi 2.

SHTOJCA

SHTOJCA A
TABELA E FASHIKUJVE TË GJYKIMIT QË JANË KONSULTUAR LIDHUR ME
PROCEDIMET E ÇËSHTJEVE PENALE NË APEL

Emri i të pandehurit	Numri dhe data e regjistrimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë	Akuza	Data e shpalljes së vendimit në shkallën e parë	Data e paraqitjes së ankimit	Data e shpalljes së vendimit nga gjykata e apelit
Gjykata e Apelit Tiranë					
Gazmir Koleci	481; 9 janar 2004	Vrasje me dashje, e mbetur në tentativë, mbajtje pa leje e armëve (KP, nenet 76, 22, 278/2)	4 tetor 2004	13 tetor 2004	11 mars 2005
Leonard Hanku	440; 6 janar 2003	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur në moshën katërbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç (KP, neni 101/1)	22 maj 2003	29 maj 2003	06 tetor 2003
Altin Diko	757; 22 mars 2004	Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura (KP, neni 102)	14 korrik 2004	23 korrik 2004	14 janar 2005
Tefta Dosti (ankimi u tërhoq)	600; 4 shkurt 2005	Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (KP, neni 259)	3 mars 2005	11 mars 2005	14 korrik 2005
Gjykata e Apelit Gjirokastrë					
Bledar Andoni	56; 9 mars 2005	Trafikim i femrave (KP, neni 114/b, paragrafi 1) Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese (KP, neni 114/a, paragrafi 4 dhe 5)	20 qershor 2005	29 qershor 2005	24 nëntor 2006
Arben Bardhi		Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese (KP, neni 114/a, paragrafi 4 dhe 5)			
Sazan Hoxha		Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese (KP, neni 114)			
Rexhep Muçi	187 (48); 22 dhjetor 2005	Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor kur shkakton vdekjen <i>ndryshuar</i> në vrasje nga pakujdesia (KP, neni 290/1 <i>ndryshuar</i> në nenin 85)	6 shkurt 2006	16 shkurt 2006	29 mars 2006

Gjykatë e Apelit Shkodër								
Ton Roku	35/288; 28 maj 2004	Vrasje me dashje, mbajje pa leje e armëve (KP, nenet 76, 278/2)	28 shkurt 2005	9 mars 2005	7 qershor 2005			
Gjon Kovaçi Pjeter Kovaçi	234; 26 prill 2005	Vrasje me paramendim, në bashkëpunim, e mbetur në tentativë (KP, nenet 78/1, 22, 25)	21 dhjetor 2005	29 dhjetor 2005	18 korrik 2006			
Sami Berisha	142; (data nuk është e disponueshme) ¹	Kanosje (KP, neni 84)	3 tetor 2005	4 tetor 2005	23 janar 2006			
Hamdi Paça Syli Hoxha	11/191; 22 mars 2005	Shpërdorim i detyrës, falsifikim ose përdorim i akteve të gjendjes civile (KP, nenet 248, 191/1)	11 shkurt 2006	14 shkurt 2006	31 maj 2006			
Sirian Alia (ankimi u tërhoq)	334; 12 shtator 2006	Kanosje, mbajje pa leje e armëve (KP, nenet 278/2, 84)	24 korrik 2006	28 shtator 2006	17 nëntor 2006			
Ardian Guri	99/353; 2 shtator 2004	Trafikim i narkotikëve (KP, neni 283/a)	24 tetor 2005	4 nëntor 2005	28 shkurt 2006			
Gjykatë e Apelit Vlorë								
Gjergj Selimaj	116; (data nuk është e disponueshme)	Vrasje në rrethana të tjera cilësuese (KP, neni 79/e)	5 tetor 2004	13 tetor 2004	22 dhjetor 2004			
Taulant Saçaj	134; (data nuk është e disponueshme)	Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese (d.m.th., është kryer jashtë territorit të vendit) (KP, neni 114/a, paragrafi 5)	8 korrik 2005	12 korrik 2005	23 shtator 2005			
Selvie Liçaj	332; 10 shtator 2004	Prodhim dhe shitje narkotikësh, mbajje pa leje e armëve dhe municionit luftarak (KP, nenet 283/1, 278/2, 278/3)	6 dhjetor 2004	13 dhjetor 2004	3 qershor 2005			

¹Data e regjistrimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë nuk u gjet në vendimin e dhënë nga kjo gjykatë.

SHTOJCA B
TABELA E VENDIMEVE PËR ÇAKTIMIN E MASËS SË ARRESTIT NË BURG QË JANË
KONSULTUAR LIDHUR ME PROCEDIMET E ÇËSHTJEVE PENALE NË APEL

Emri i të pandehurit	Numri i regjistrimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë	Akuza	Data e shpalljes së vendimit në shkallën e parë	Data e paraqitjes së animit	Data e shpalljes së vendimit nga gjykatë e apelit
Gjykata e Apelit Tiranë					
Bashkim Ibi	341	Mjekim i pakujdesshëm (KP, neni 96)	31 mars 2006	10 prill 2006	14 qershor 2006
Nasser Almalak	966	Marrëdhënie seksuale dhe homoseksuale në vende publike, në bashkëpunim; ushtrim prostitucioni, në bashkëpunim (KP, nenet 107, 25; 113,25)	20 gusht 2006	25 gusht 2006	7 shtator 2006
Fatmir Lala	77	Vjedhje në shumë se një herë (KP, neni 134/2)	23 janar 2006	31 janar 2006	13 shkurt 2006
Bilbil Tota	281	Vjedhje në bashkëpunim (KP, neni 134/2)	12 mars 2006	21 mars 2006	10 prill 2006
Kledion Shijaku	92	Vjedhje në bashkëpunim (KP, neni 134/2)	27 janar 2006	1 shkurt 2006	15 shkurt 2006
Elvis Ismailisufaj	140	Vjedhje kur ka sjellë pasojë të rënda (KP, neni 134/3)	8 shkurt 2006	13 shkurt 2006	20 shkurt 2006
Gjok Biba	319	Vjedhje; prodhim dhe mbajtje pa leje i armëve të gjetisë dhe sporteve (KP, nenet 134, 280)	24 mars 2006	30 mars 2006	10 prill 2006
Arben Çela	1423	Falsifikim i dokumenteve; falsifikim i dokumenteve shkollore; falsifikim i dokumenteve shëndetësore; falsifikim i vulave; falsifikim i akteve të gjendjes civile; prodhim i mjeteve për falsifikim të dokumenteve (KP, nenet 186, 187, 188, 190, 191, 192)	16 dhjetor 2006	16 dhjetor 2006	4 janar 2007
Erma Dedeci	916	Mbajtje pa leje e armëve, bombave, minave apo lëndëve plasëse (KP, neni 278/2)	10 gusht 2006	10 gusht 2006	12 shtator 2006
Ferik Tafa	998	Prodhim dhe shitje markotikësh, në bashkëpunim; mbajtje pa leje e municionit luftarak (KP, nenet 283/1, 278/3)	27 gusht 2006	6 shtator 2006	14 shtator 2006